

BIBLIOTEKA

80

012



SHABAN DEMIRAJ

**EQREM ÇABEJ**



**Shaban Demiraj**, Ka lindur në Vlorë më 1.1.1920. U diplomua në Institutin e Lartë Pedagogjik 2-vjeçar më 1948 dhe atë 4-vjeçar më 1954. Qysh nga viti 1954 është emëruar pedagog në ish-Institutin e Lartë Pedagogjik, kurse më 1954 në Universitetin e Tiranës. Ka marrë titullin "profesor" më 1972 dhe është zgjedhur anëtar i Akademisë së Shkencave të RPSSH më 1989. Ka shërbyer si përgjegjës i katedrës së gjuhës shqipe gjatë vjetëve 1962-1989. "Mësues i Popullit" më 1977; "Çmimi i Republikës i Klasit II" më 1979 dhe "Çmimi i Republikës i Klasit I" më 1989. Profesor Sh. Demiraj është autor i disa veprave shkencore, si **Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe** (1961 - ribotuar në Prishtinë më 1971); **Çështje e sistemit emëror të gjuhës shqipe** (1972); **Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe** (1975); **Morfologjia historike e gjuhës shqipe I, II** (1973, 1976 - ribotuar në Prishtinë më 1980); **Gramatikë historike e gjuhës shqipe** (1986 - ribotuar në Prishtinë më 1988); **Gjuha shqipe dhe historia e saj** (1988 - ribotuar në Prishtinë më 1989) etj.

Ka marrë pjesë në disa kongrese dhe konferenca ndërkombëtare dhe ka botuar artikuj shkencorë edhe në disa revista të huaja. Ka mbajtur Ilgjërata pasuniversitare ose kumtesa në: Prishtinë, Shkup, Beograd, Sofje, Kluzh, Kopenhagë, Aarhus, Insbruk, Vjenë, Romë, Paris dhe Këln.

REDAKTOR: ARSHIN XHEZO

RECENSUES: Prof. MAHIR DOMI  
Doc. NASHO JORGAQI  
SHABAN SINANI

PIKTOR: SPIRO KRISTO  
FORMULIMI GRAFIK: ARTION BABOÇI  
REDAKTOR TEKNIK: PIRRO PANDELI  
KORREKTORE LETRARE: NINI IHSANI

---

PËRPUNIMI I MATERIALIT  
FOTOGRAFIK: NAIM KASAPI

## DY FJALË

Nisma e lavdërueshme e shtëpisë botuese «8 Nëntori» për t'i bërë të njohur një mase sa më të gjerë lexuesish jetën dhe veprimtarinë shumë të frytshme shkencore të dijetarit tonë të shquar, Eqrem Çabejt, më vuri përpara një detyrë sa të vështirë, aq edhe të mirëpritur. Ajo më nxiti ta mënjanoja shpejt ngurrimin e natyrshëm për t'iu futur një pune të tillë, e cila ishte për mua edhe një detyrim, edhe një peng nderimi. Besimi se mund t'ia dilja mbanë kësaj detyrë, m'u forcua qysh në fillim, kur vura re gatishmërinë e plotë të familjes Çabej, të shtëpisë botuese «8 Nëntori», të Akademisë së Shkencave, të Arkivit Qendror të Shtetit, të Muzeut të Gjirokastrës dhe të miqve e dashamirëve të profesorit të nderuar këtu në Tiranë, në Gjirokastrë, Shkodër e gjetkë për të më ndihmuar me gjithçka që do të kishin mundësi.

Dhe në qoftë se në këtë libër është arritur të hidhet ndopak dritë mbi jetën e këtij shkencëtari të madh, një meritë e veçantë u takon, pra, të gjithë atyre, që në një mënyrë a në një tjetër, më ndihmuan me dashamirësi në këtë ndër marrje të guximshme. Dhe jam i bindur se të gjithë ata, ashtu si edhe recensuesit e librit, krahas mirënjohjes sime të thellë, do të ndiejnë edhe kënaqësinë e ligjshme për ndihmën e dhënë për hartimin e këtij libri, i cili uroj të ndiqet së shpejti nga ndonjë botim tjetër edhe më i plotë.

SHABAN DEMIRAJ



## PARATHËNIE

*Libri për Eqrem Çabejn i bie në duar lexuesit shqiptar në një kohë që i duhet më shumë se kurrë. Sepse në orët plot trysni të një kombi, atëherë kur dikush rreket t'i sulmojë themelitë: gjuhën, kulturën, artin dhe mendësinë e tij, figura të tilla si ajo e Eqrem Çabejt ndriçohen edhe më fort, njëlloj siç ndriçohen prej vetëtimave në kohë furtune malet e larta. Në sfond të tyre sulmuesit xhuxhë, siç janë shovinistët e sotëm, ngjajnë atëherë edhe më të vegjël e më të mjerë! Në kulturën e një kombi, ashtu siç ka vepra madhore që janë lehtësisht të kapshme për të gjithë, gjithashtu ka vepra, që, ndonëse peshë e rëndësia u dihen, për shkak të veçantisë së tyre janë të parritshme lehtë për publikun e gjerë. Vepra e Çabejt hyn ndër këto të dytat. Ndonëse ka të bëjë me gjërat themelore të kombit shqiptar, ajo ka nevojë për një medium për të arritur tërësisht te lexuesi.*

*Libri për Çabejn, i shkruar me dije, qartësi dhe fisnikëri nga profesor Shaban Demiraj, e kryen më së miri këtë rol. Në këtë libër, që është një akt kulturor e moral i admirueshëm, lexuesi ynë do të gjejë të përshkruar qartë tërë aksionin e dijetarit dhe njeriut të madh, ngjijtjen e tij në lartësitë e vështira të shkencës, mundin, hulumtimet, përfytjen, thellimin gjer në ditët e fundit të jetës në atë univers që është sa pasionant, aq dhe i tmerrshëm në ndërlikimin e tij: universin e gjuhëve.*

*Profesor Demiraj, në mënyrën më të kuptueshme që mund të bëhej, na ka shpalosur planin e ngrehinës Çabejane, përmasat, spikamën e përgjithshme, lartësitë dhe kullat e saj. Lexuesi do të kuptojë nga ky libër përse kjo ngrehinë është e madhe*

dhe tejet e rëndësishme, një bastion i vërtetë i qytetërimit shqiptar. Në këtë pasqyrë janë shtjelluar njëra pas tjetrës të gjitha fushat ku punoi, u lodh e triumfoi Eqrem Çabej: studimet diakronike, studimet për prejardhjen e gjuhës shqipe, hedhja poshtë e tezave që mohojnë prejardhjen ilire, hedhja poshtë e pseudoargumenteve, e atyre që rrjedhin prej argumentum ex silentio (argumentim prej heshtjes), studimet në fushë të fonetikës e të gramatikës historike, të dialektologjisë, sidomos të të folmes së arbëreshëve — pasioni i tij i vjetër e i pandryshueshëm, studimet për marrëdhëniet e shqipes me gjuhë të tjera, huazimet e ndërsjella, tezat për restriksionin dhe jo ekspansionin e elementit shqiptar në Gadishull, studimi monumental për Gjon Buzukun, hulumtimet për Pjetër Budin, për pastërtinë e gjuhës, për drejtshkrimin, studimet në fushë të etimologjisë, që mund të thuhet se janë kurora e veprës së tij shkencore, referatat e kumtesat në kongreset e simpoziumet ndërkombëtare; së fundi, studimet e përsiatjet në fushë të folklorit shqiptar e të marrëdhënieve të tij me mitologjinë e lashtë ballkanase, në fushë të gjenezës së letërsisë shqipe, të disa miteve të veçanta e të disa personaliteteve të shquara të saj e të botës, si Noli, Poradeci, Jokli, Krecmeri etj.

Kur arrijmë të kapim tërësisht përmasat e veprës së Eqrem Çabejt, vlerësimi ynë për të fiton një ndërgjegjësim të ri, e bashkë me të mirënjohja jonë dhe ndoshta ndjesa jonë që nuk arritëm më parë të bënim diçka më shumë për të. Është një peng që shoqëron shpesh njerëzit e mëdhenj, sepse madhështia e vërtetë, me kalimin e viteve spikat edhe më fort, në po atë masë që e rremja shuhet.

Kam patur fatin ta njoh e ta takoj shumë herë Eqrem Çabejn. Më shumë se i njëjti qytet ku kishim lindur, na bashkonte mbarë gjuha shqipe, ajo që flitej nga jugu në veri, e përtej kufijve e përtej detit e përtej oqeanit Atlantik. Njohja me të më erdhi nëpërmjet një drejtimi të lumtur: poezisë. Ishte Lasgush Poradeci që më kishte folur shpesh për «të dashurin Çabej», duke kujtuar vitet kur të dy ndodheshin për studime në Vjenë. S'ishte ndoshta e rastit që këta dy Faustër të botës shqiptare qenë miqësuar për një kohë aq të gjatë. Studionin në jusha të ndryshme, por ashtu si shkencëtari i ardhshëm e kishte për zemër poezinë, ashtu dhe poeti që i fortë në dije gjuhësh të gjalla e të vdekura.

Më pas, kur u njoha me Çabejn, ai gjithashtu më ka treguar për ato vite, dhe ishte vërtet një mrekulli të dëgjoje të njëjtat ngjarje të para nga dy optika krejt të ndryshme: nga truri i

kthjellët e i thellë i dijetarit dhe nga truri madhërisht i mje-  
guituar i poetit. Por Çabej, ndonëse ishte dhjetë vjet më i ri se  
Poradeci, vdiq dhjetë vjet përpara tij, ndaj poetit i ra fati i tri-  
shtë të fliste më shumë e më pikëllueshëm për të kur mbeti  
i vetëm.

Në fundverën e vitit 1979, pak kohë përpara vdekjes së tij,  
pata fatin të bëj një udhëtim të gjatë me Çabejn në përbërje  
të një delegacioni të Akademisë Shqiptare.

Kongresi ndërkombëtar ku do të merrnim pjesë, zhvillohej  
në Ankara, por rrugën e bëmë me makinë, duke përshkuar gji-  
thë Greqinë Veriore, Selanikun, Kavallën, pastaj bregdetin e  
Marmarasë, Stambollin dhe së fundi rrafshultën anadolliane.  
Ishte një udhëtim që i shkonte atij. Rruga kalonte nëpër treva  
ku kishin lëvizur ushtri, tribu, popuj të tërë me veglat, armët,  
gjuhët apo psikikën e tyre të rëndë. Ishin zona ku kishin shpër-  
thyer ndriçime të mëdha, por po aq fatkeqësi të pandreqshme.

Pranë kufirit greko-turk ca katundarë nga Qyteza (Ibrik-  
-Tepe), vendlindja e Fan Nolit, që ndodhej aty pranë, kishin  
dalë qysh në mëngjes në rrugë e po na prisnin. E kishin marrë  
vesh, s'ëdi se si, që do të kalonim dhe donin të na kthenin në  
katund, por ne ishim vonë e s'ndalonim dot. «Kur do të vërtiti?»,  
pyesnin ata me zë të ëmbël, çka do të thoshte, siç ma shpjegoi  
Çabej, «Kur do të ktheheni?».

«Në gjithë këtë trevë është folur e vazhdon të flitet një  
shqipe e bukur», më shpjegonte Çabej.

Rruga ishte e lodhshme dhe na u desh të flinim në Selanik,  
në Kavallë e në Stamboll, por ai nuk u ankua asnjëherë nga  
asgjë.

Në Ankara, në mjediset e Kongresit Ndërkombëtar për  
Studimet Jugevropiane, u përtëri e u gjallërua siç nuk e kisha  
parë kurrë. Dukej më i ri e më i gjatë, me shkathtësi përshkonde  
korridorët i ndjekur nga adhurimtarët, që donin të dëgjonin  
kumtesat e tij dhe gjermanishten e tij të shkëlqyer. Ishte krejt  
në botën e vet, i lumtur si «midis dritës», siç do të thoshte Nai-  
mi. Përshëndeste më të majtë e më të djathtë kolegët e vet e u  
puthte dorën si xhentëlmen i vërtetë që ishte zonjave shken-  
cëtare, ndonëse për këtë gjest kishte patur një herë probleme.  
Si një pjesë e të mëdhenjve, nuk dinte të mbrohej nga insi-  
nuatat dhe sulmet meskine, ndaj, kur qe kritikuar një herë se  
i kishte puthur dorën një dijetareje të huaj në kohën që kjo  
gjë s'qe e këshillueshme për rrethana politike, dhe kur të ne-  
sërmen ajo zonjë për fat të keq i kishte dalë prapë përpara dhe  
ai prapë kishte bërë të njëjtën gjë, s'kishte ditur fare si të për-

ligjej, veç kishte thënë: po të jetë kështu, mos më çoni më në kongrese botërore. Jam i vjetër për të mësuar gjeste të tjera.

Por ai ishte xhentëlmen jo vetëm me zonjat e shquara, kolege të tij, por me të gjithë, burrat e gratë, madje i nderonte njëlloj edhe ato gra të thjeshta që ndoshta s'ua dinte as emrin. Një grua e tillë shërbente për mjaft kohë si ujitëse lulësh në varrezën lindore të Tiranës në rrëzë të Malit të Dajtit, atje ku ndodhet varri i tij. Kur dikush e ka pyetur se si nuk harronte kurrë të kujdesej veçanërisht për varrin e profesorit, ajo është përgjigjur: si të harroj? Ishte i vetmi që, kur vinte këtu për të vizituar varrin e të birit, nuk harronte kurrë të më përshëndeste duke hequr borsalinën, sikur të isha një zonjë e madhe.

Ishte një kënaqësi e madhe të bisedoje me të pasditeve ose pasdarkave, që ishin orët e tij të pushimit. Si të gjithë mjeshtrit e sigurt, nuk kërkonte kurrë të mahniste askënd me dijet e me gjithë atë rrëmet që kishte në kokë. Përkundrazi, kishte shpesh në sjelljet e në bisedën e tij atë naivitete vetanak që shoqëron si një kundërpeshtë e natyrës rëndimin dramatik të njeriut të madh. Gjithmonë i vëmendshëm, të ndiqte në bisedë me një kërshtëri prekëse, sidomos kur flitej për gjëra jetësore, larg, shumë larg gjuhësisë. Madje kisha përshtypjen se në orët e lira nuk e kujtonte kurrë, ose bënte sikur nuk e kujtonte atë që, duke aenë dashuria dhe tempulli i tij, ishte njëkohësisht mundimi dhe purgatori i tij.

Ai u mor tërë jetën me një nga përmasat më të gjera, më madhështore e më misterioze të jetës sonë: gjuhën. Ai punoi tërë jetën me mund prej titani për gjuhën tonë shqipe, atë gjuhë që, duke u përtypur si ushqim nga gojë e mendjet e dhjetëra milionë shqiptarëve nëpër shekuj, duke i bashkuar ata e mendimet e tyre, mbajti ajallë unitetin e kombit e u mbajt edhe vetë gjallë prej tij. Të lidhura kështu me këtë materie të pavdekshme, emri dhe vepra e Erem Çabejt e kanë të natyrshe, si një cilësi të racës, pavdekësinë.

ISMAIL KADARE

Tiranë, qershor 1990



## KREU I

### Jeta dhe vepra

1. Eqrem Çabej, një ndër përfaqësuesit më të shquar të gjuhësisë së re shqiptare, lindi më 7 gusht 1903 dhe vdiq më 13 gusht 1980 në një klinikë të Romës, ku kishte vajtur për t'u mjekuar nga një sëmundje e rëndë. Ai jetoi, pra, në një nga periudhat më dinamike të historisë së Shqipërisë.

Gjatë kësaj periudhe, sic dihet, populli shqiptar ka përjetuar ngjarje nga më të rëndësishmet të historisë së tij shumëshekullore në truallin e vet në brigjet lindore të Adriatikut dhe të Jonit. Shpallja e Pavarësisë në Vlorë, më 28 Nëntor 1912, pas përpjekjeve shekullore kundër sundimit të huaj, shënoi përvshim një kthesë të rëndësishme në historinë e këtij populli të lashtë të Ballkanit. Vendosmërinë e tij për të jetuar i lirë dhe i pavarur në trojet e të parëve të vet nuk mundën ta përkulnin as pushtimet e huaja gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918) dhe as pushtimi nazifashist (1939-1944), as intrigat e armiqve të jashtëm e të brendshëm. Falë kësaj vendosmërie, si edhe Luftës së tij heroike Nacionalçlirimtare, ai mundi më në fund të siguronte më 29 Nëntor 1944 lirinë dhe pavarësinë e plotë dhe të niste rrugën e zhvillimit dhe të përparimit të gjithanshëm.

2. Jeta dhe veprimtaria e Çabejt janë të lidhura ngushtë me fazat e ndryshme të kësaj periudhe aq të ngjeshur me ngjarje historike. Mësimet e para i mori në Gjirokastrë. Atje ai mbaroi më 1921 shkollën qytetëse me përfundime të shkëlqyera. Atje, në gjirin e familjes dhe në rrethin e bashkëqytetarëve të tij, të njohur për dashurinë e madhe për Atdheun dhe për arsimin, u mbrujt edhe karakteri i tij. Pas mbarimit të shkollës qytetëse ai fitoi të drejtën e një burse të dhënë nga Prefektura e atëherëshme e Gjirokastrës për të vazhduar studimet e mesme dhe të larta jashtë shtetit. Dhe kështu ai nisi, ashtu si edhe të rinj shqiptarë të tjerë, rrugën e mërgimit në kërkim të diturisë.

Vitet e fëmijërisë, që kaloi në Gjirokastrë, lanë mbresa të pashlyeshme në vetëdijen e shkencëtarit të ardhshëm. I cili, edhe në moshë të thyer, i kujtonte gjithnjë me mall ato vite. Ndër të tjera, në kujtimet e të nipit, Dragush Çabejt, aty nga viti 1967, kur ky shërbente si mësues i gjuhës dhe letërsisë shqipe në gjimnazin «Asim Zeneli» thuhet: «Kishte shumë mall për Gjirokastrën. Shkonte me shumë dëshirë kur gjente kohë. Në prill të 1967-s e prita sa erdhi. Zbriti te Sheshi i Çerçizit. Ishte vonë kur mbërriti. Qëndroi një copë herë duke parë monumentin e tij. Pastaj, si e brodhi me sy të gjithë qytetin, u kthye nga unë e më tha: «Dua të rri pak vetëm, se kështu më duket sikur bisedoj me Gjirokastrën dhe çmallem me të. Ika kendej fëmijë fare, njëmbëdhjetë vjeç pa bërë.»

Pas një copë here morëm Qafën e Pazarit. Ai, i heshtur gjithmonë, duke kaluar nëpër kalldrëmet, tani zuri të fliste e të fliste për bukuritë e Gjirokastrës. Qëndroi para shtëpisë së tij: «Këtu u vra bimbashi turk. Këtu përballë ka qenë furra e Kolës. Paskan ndërtuar një shtëpi në vend të furrës. Bahçeja jonë. Këtu me Fejziun, Tahsimin, Feritin e të tjerë luanim me cingla, dollapet, top-gropën. . . Shtatë Kronjet. Këtu, me vëllanë merrnim gjymat dhe mbushnim ujë. Hani i Stavros. Këtu vinin e bujtnin më shumë fshatarë nga Labëria. Hani i Zagories. Këtu bujtnin nga Zagoria, Sopiku. . . Ja libraria e Nimet Karagjozit. Këtu nxënësit e shkollës blinin libra e broshura të Buzukut. Matrangës, Samiut, Naimit, letërsi klasike frënge. . .»

Desha t'i thosha ndonjë fjalë tjetër, po, kur vura re se as po më shikonte fare, e kuptova që donte të bisedonte me veten dhe nuk foli. Mos e nga, Dragush, i thashë vetes, ka mall e nuk do trazuar».

## *Eqrem Çabej*

3. Për të vazhduar studimet, Eqrem Çabej u dërgua në Austri. Lexuesi i merr me mend përshtypjet e para të një djaloshi të ri, të padalë nga vendi i tij, kur e pa veten në një vend të huaj shumë të zhvilluar. Ai dhe shokët e tij shqiptarë përpjekshin që të paraqiteshin sa më mirë në atë ambient të ri të panjohur.

Kështu, p.sh., ata atje nisën të mbanin edhe kravata. Por në fillim e patën ca të vështirë, derisa mësuan t'i lidhnin. E një gjë të tillë ai e rikujtonte shpesh me njëfarë humori, siç na dëshmon edhe bashkëshortja e tij, Shyretja, në kujtimet e saj. Ajo vë në dukje se në familje e ngacmonin herë pas here për historinë e kravatës dhe ai niste e tregonte: «Ishtë nata e parë në Vjenë dhe të gjithë bashkëstudentët e mi e kishin shqetësim si do të bënin në mëngjes të lidhnin kravatën. Nuk ishin mësuar me to dhe nuk dinin t'i lidhnin. Edhe unë gjithashtu isha gjithë shqetësim. Nuk flisja, po mendjen aty e kisha. Mëngjesi ishte shumë i shqetësuar. Shumica, me kravata në dorë, i luteshin njëri-tjetrit për t'ua lidhur. Kur më panë mua me kravatën të lidhur, shtangën për një çast, pastaj m'u zemëruan që nuk i kisha ndihmuar. Dikush tha edhe ndonjë fjalë më tepër. U qetësuan dhe u paqëtova me ta vetëm kur u fola:

— Edhe unë nuk dija ta lidhja. Kam fjetur pa e hequr fare kravatën. . . »

Në Austri, para se të hynte në ndonjë shkollë, iu desh të qëndronte një vit pranë familjes Rainmyler, në St. Pölten afër Vjenës, për të mësuar gjermanishten. Rasti e solli që të binte në një familje të kulturuar dhe dashamirëse, që u kujdes për të si ta kishte birin e vet. Gjatë qëndrimit pranë kësaj familjeje ai punoi shumë për të përvetësuar sa më shpejt gjermanishten, duke lënë përshtypje shumë të mira jo vetëm me zellin e madh, por edhe me sjelljen e tij shembullore. Familja që e strehoi për një vit, mbajti lidhje të vazhdueshme me E. Çabejn dhe me familjen e tij. Këtu po shkëpusim një pjesë nga një letër e 82-vjeçares Eli Rainmyler, e vitit 1977, dërguar vajzës së prof. Çabejt:

«Meqenëse në të shumtën e kohës jam vetëm, mendimet e mia shpesh shtegtojnë në të kaluarën dhe të gjitha më shfaqen edhe njëherë fare qartë përpara syve. Për shembull, ajo dita kur im shoq. fare papritur, hyri në dorë me një djalë të vogël me një qeleshe ngjyrë gri. Ne kishim pranuar të merrnim një djalë shqiptar, por mendonim se do të na lajmëronin

## Eqrem Çabej

para se të mbërrinin. Por nuk ndodhi kështu, sepse një ditë djemtë erdhën dhe burri im, me shikimin e tij prej njohësi, zgjodhi Eqrem Çabejn. Ai ishte një djalë trim, dhe im shoq i gëzohej shumë nxënësit të vullnetshëm. Na duhej ta nxirrnim me zor në kopsht djalë, që s'ndahej dot nga librat. Dhe pas disa vjetësh, kur dha provimin e pranimit për në klasën e pestë të gjimnazit, dhe profesori i gjermanishtes pas pak kohe konstatoi se Eqrem Çabej ishte më i miri i klasës, ne të gjithë ishim krenarë për të. Historinë e «Kramsus-it» me siguri ai duhet t'ua ketë treguar shpesh, se ishte shumë zbavitëse. Edhe sot e kësaj dite e kam ende në vesh atë zërin e lartë e të emocionuar: «Ç'është ajo që dëgjoj jashtë, përpara portës, ç'thuhet atje tek ura. . .»

Sa do të ishte gëzuar im shoq po ta shihte Eqremimin edhe njëherë!»<sup>1</sup>

4. Dëshira për t'u bërë sa më i vlefshëm për Atdheun, e nxiti atë që, pas një vit qëndrimi në St. Pölten për të mësuar gjermanishten, vitin tjetër të merrte njëherësh dy klasa të gjimnazit që e mbaroi shkëlqyeshëm në vitin 1926 në Klagenfurt të Austrisë.

Dhe këtu fillon faza kritike për të ardhmen e këtij të riu të talentuar. I ati, një gjykatës i diplomuar në Dar-ul-Hukuk të Stambollit, i nisur nga dëshira që i biri të kishte një të ardhme të sigurt, e këshilloi të vazhdonte universitetin për mjekësi. Por i biri kishte tjetër dëshirë e tjetër mendim. Ai donte të bëhej gjuhëtar. «Gjuhësia është për pasanikët, — i tha i ati prerazi, — kurse neve na duhet një zanat që të na sigurojë jetën». Atëherë djali, «i bindur», u regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Romës. Por këtu ai më fort shkante e studionte vepra gjuhësore e letrare nëpër bibliotekat romane. Në këto rrethana, babai i urtë e la të lirë të birin të bënte ashtu si donte vetë, por jo edhe pa i thënë: «Paç veten më qafë, o bir!»

Me babanë i riu Çabej kishte pasur edhe më parë ndonjë mospërputhje mendimesh. Sipas dëshmisë së bashkëshortes së tij, ai u kishte treguar një herë në familje:

«Një profesorit tim një ditë iu duk se kisha vesh e shprehi muzikore. Më propozoi që të regjistrohesha në një shkollë muzike. Në fillim edhe mua më pëlqente kjo ide. Jo se vërtet kisha

---

1) Origjinali i letrës ndodhet në familjen e E. Çabejt (Shën. i Red.).



## Eqrem Çabej

të dhëna për muzikë, po nga që më pëlqente. Profesori insistoi por unë këmbëngula t'i shkruaja babait. Po ç'hyn babai këtu, përderisa kjo është dëshira jote, më tha profesori. Hyn, i thashë. Do të kërkoj leje. I shkrova dhe babai m'u përgjigj prerë. «Shiko shkollën dhe hiqe nga mendja qemanen». Që atëherë e fshiva nga kujtesa shkollën e muzikës. Po muzikën jo. Nuk mund të kuptohet intelektual i që nuk e do muzikën. Dhe jo vetëm intelektual, po çdo njeri».

Pra, faza vendimtare për të ardhmen e të riut Çabej nis atëherë kur ai fitoi «lirinë» për të ndjekur degën që i pëlqente. Në vitin akademik 1927-1928 u regjistrua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Gracit, ku ndoqi studimet për dy gjashtëmuorë (semestra). Pastaj studimet i vazhdoi në Universitetin e Vjenës.

5. Dega e gjuhësisë në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Vjenës kishte një traditë të vyer. Aty kishin punuar profesorë të tillë të shquar si sllavistët e njohur Franc Miklosiç (Miklosich) (1813-1891)<sup>1</sup>, Vatroslav Jagiç (1838-1923)<sup>2</sup>, romanisti me emër Vilhelm Majer-Lybke (Meyer-Lübke) (1861-1936)<sup>3</sup> etj.

Në kohën që u regjistrua Çabej, në atë universitet punonin, ndër të tjerë, indoevropianisti dhe grecisti i njohur P. Kreçmer (P. Kretschmer) (1866-1956)<sup>4</sup>, albanologu i dëgjuar Norbert Jokl

---

1) Ky gjuhëtar prodhimtar ka botuar edhe studime për gjuhën shqipe, si *Albanische Forschungen (Hulumtime shqiptare)* I, II. Për gjuhën shqipe ai ka shkruar edhe studime të tjera sidomos në *Die slavischen Elamerte im Rumänischen (Elementet sllave në rumanishtë)*. Është autor i veprës madhore *Vergleichende Grammatik der slavischen Sprachen (Gramatika krahasuese e gjuhës sllave)* dhe konsiderohet si themelues i sllavistikës moderne.

2) Ky gjuhëtar (me origjinë kroate) është autor i disa veprave për historinë e gjuhës dhe të letërsisë sllave.

3) Ky gjuhëtar (me origjinë zviceriane) ka botuar, ndër të tjera, studimin e gjatë *Rumänisch, romanisch, albanesisch* dhe ka ripunuar studimin e G. Majerit (G. Meyerit), *Die lateinischen Elemente im Albanesischen (Elementet latine në shqip)*. Është autor i veprës madhore *Grammatik der Romanischen Sprachen Gramatikë e gjuhëve romane* etj.

4) Gjuhëtar i shquar (me origjinë gjermane), ka shkruar edhe për ilirishten dhe shqipen. Me rastin e vdekjes së tij E. Çabej ka botuar një nekrologji në revistën «Nëntori», 2/1957.

## Eqrem Çabej

(1877-1942)<sup>1</sup>, arkeologu dhe historiani i njohur Karl Paç (K. Patsch) (1865-1945)<sup>2</sup> etj. Të kujtojmë se në Austri ishte krijuar një traditë e mirë edhe për studimin e historisë së gjuhës shqipe dhe të historisë së popullit shqiptar. Mjafton të përmendim këtu, sa për shembull, veprën e njohur *Albanesische Studien* (*Studime shqiptare*) (1854) të konsullit austriak (me origjinë gjermane) në Janinë, Georg fon Han (G. von Hahn)<sup>3</sup> si edhe veprimtarinë e gjerë albanologjike të Gustav Majerit (Meyer), profesor në Universitetin e Gracit.<sup>4</sup> Të kihet parasysh edhe veprimtaria shkencore e albanologëve austriakë N. Jokl (shih § 4) dhe Maksimilian Lamberc (M. Lambertz)<sup>5</sup> etj. Prandaj vendimi i gjuhëtarit të ardhshëm për t'i vazhduar studimet universitare në Vjenë ishte plotësisht i përligjur.

6. Në kohën që Çabej shkoi në Universitetin e Vjenës, vazhonte të zhvillonte ligjërata për indoevropianistikën etj. gjuhëtari i njohur Paul Kreçmer, që do të jetë edhe një nga nënshkruesit e diplomës së gjuhëtarit tonë të ardhshëm, i cili edhe pas mbarimit të studimeve do të mbajë lidhje me të nëpërmjet letërkëmbimit. Por më shumë lidhje si gjatë kohës së studimeve universitare ashtu edhe pas mbarimit të tyre Çabej pati me Norbert Joklin, i cili pas vdekjes së G. Majerit (1900)

---

1) Albanolog i shquar, u zhduk nga nazistët gjermanë më 1942. Me rastin e 30-vjetorit të vdekjes së tij (më 1972) u organizua një konferencë ndërkombëtare në Insbruk të Austrisë. Kumtesat e asaj konference, ku morën pjesë edhe gjuhëtarë shqiptarë, janë botuar në një vëllim më vete më 1977.

2) Ka botuar, ndër të tjera, veprën *Sanxhaku i Beratit në Shqipëri*, ku jep njoftime me interes për rezultatet e kërkimeve të tij arkeologjike dhe etnografike në Shqipëri.

3) Ka botuar, ndër të tjera, edhe veprat *Reise von Belgrad nach Saloniki*. (*Udhëtim nga Beogradi në Selanik*) dhe *Reise durch die Gebiete des Drin und Vardar* (*Udhëtim nëpër viset e Drinit dhe të Vardarit*).

4) G. Majer (1850-1900), me origjinë gjermane, ka botuar, ndër të tjera, *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe* dhe gjashtë vëllime të serisë *Albanesische Studien* (*Studime shqiptare*).

5) M. Lamberc (1882-1963) ka botuar, ndër të tjera, disa vepra për folklorin shqiptar, si *Die Volkspoesie der Albaner* (Poezia popullore e shqiptarëve), *Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde* (*Përralla shqiptare dhe tekste të tjera të folklorit shqiptar*).

dhe pasi H. Pedersen i filloi të merrej më pak me shqipen dhe më shumë me gjuhë të tjera<sup>1</sup>, mbeti albanologu më prodhimtar. Ky dijetar i shquar, që ishte njëkohësisht mik i Shqipërisë, i përqendroi pothuaj të gjitha energjitë e tij në hulumtime dhe studime kushtuar gjuhës shqipe dhe historisë së saj.<sup>2</sup> Qysh nga viti 1916 deri më 1940 ai mbajti rregullisht edhe rubrikën bibliografike për studimet mbi gjuhën shqipe dhe për Shqipërinë në përgjithësi në revistën «*Indo-germanisches Jahrbuch*» («Vjetari indoevropian»).

Norbert Jokli, duke çmuar talentin e studentit të ri shqiptar, e mbajti afër atë dhe kështu u zhvillua midis tyre një miqësi e ngushtë dhe një bashkëpunim i frytshëm, që ndihmoi aq shumë për ta përudhur Çabejn e ri në studimin e thelluar shkencor të gjuhës shqipe. Dhe këtë punë studimore ky e nisi qysh kur ishte ende student. Në përputhje me kërkesën e Universitetit të Vjenës që për të marrë diplomën me gradën e doktorit në profilin përkatës studenti duhej të mbronte një disertacion, diplomanti E. Çabej zgjodhi për këtë qëllim temën *Studime italo-shqiptare (Italoalbanische Studien)*. Për këtë disertacion ai punoi me zell të madh dhe shkoi e mblodhi material pranë arbëreshëve të Sicilisë në vitin 1932. Disertacioni u mbrojt

1) Ky gjuhëtar i talentuar, që është marrë sidomos me gjuhët kelte, me armenishten etj., na ka lënë disa studime me vlerë edhe për gjuhën shqipe, si: *Die Gutturale im Albanesischen (Grykoret në shqipe)*, *Albanesisch 1905*, *Das Neutrum im Albanesischen (Asnjësi në shqipe)* etj.

2) Nga veprat e tij duhen përmendur sidomos *Beiträge zur alb. Grammatik (Ndihmesa për gramatikën shqipe)* I, IF 30 (1912), II IF 36 (1916), *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanesischen (Hulumtime gjuhësore-kulturore-historike nga fusha e shqipes)*. Berlin und Leipzig 1923, etj., etj.

Është me interes të shënojmë këtu se më 28.XII.1929 Eqrem Çabej, Aleks Buda, Skënder Luarasi dhe Gaspër Shoshi, atëherë studentë në Vjenë, i dërguan një letër Ministrisë së Arsimit për punë të N. Joklit. Ata i kërkonin asaj ministrie që të ndërmjetësoje pranë Fakultetit të Filozofisë të Universitetit të Vjenës për ta shkarkuar Joklin nga dhënia e disa lëndëve të tjera, me qëllim që ai të merrej vetëm me gjuhën shqipe. Ata shtonin se në këtë mënyrë do të formohej një katedër e qëndrueshme e albanologjisë në Vjenë, e cila më vonë mund të shërbente si bazë për krijimin e një Instituti Shqiptar pranë atij Universiteti. (AQSH, f. 295, d 124, v. 1929).

## Eqrem Çabej

më 7 tetor të vitit 1933 para prof. dr. Paul Kreçmerit, prof. dr. Norbert Joklit dhe prof. dr. Karl Paçit dhe për këtë atij iu dha diploma për gradën doktor nga Universiteti i Vjenës. Diploma është nënshkruar nga të tre profesorët e lartpërmendur për-krah vlerësimit *shkëlqyeshëm (Ausgezeichnet)*.

Disertacioni prej 145 faqesh të daktilografuara përbëhet prej pesë kapitujsh. Kreu i parë bën fjalë për emigrimin e arbëreshëve dhe për përhapjen e tyre në Italinë e Jugut dhe në Sicili (f. 1-50). I dyti përmban një skicë të sistemit gramatikor (f. 51-94). Në kreun e tretë trajtohet fjalëformimi dhe fjalori (f. 95-113): prapashtesat romane, etimologjia popullore, kalke gjuhësore dhe huazime (gjermane, turke, arabe). Në kreun e katërt janë përfshirë tekste të mbledhura nga vetë autori (f. 114-130): 1. Jeta baritore dhe mjekësia popullore; 2. përrallia; 3. këngë, ballada e Kostandinit të vogël, ringjallja e Lazërit. Kreu i pestë përmban një fjalorth.<sup>1</sup>

7. Vlerësimi «shkëlqyeshëm» i disertacionit të Çabejt nga ana e tre profesorëve të shquar të Universitetit të Vjenës ishte, pa dyshim, një dëshmi e qartë e punës së madhe të atij të riu të talentuar, i cili edhe para kësaj ngjarjeje të shënuar të jetës së tij kishte dhënë edhe të tjera shenja kuptimplote të një talenti dhe zelli të admirueshëm. Mjafton të kemi parasysh se ai, qysh kur ishte ende në vitet e para të universitetit, krahas punës së madhe si student ka bërë edhe një punë të lavdërueshme kërkimore në fushën e gjuhësisë e të letërsisë. Por mjerrisht kjo periudhë e jetës së Çabejt ka mbetur e panjohur mirë. Deri vonë dihej vetëm se ai kishte botuar në «Gazeta e re» të datës 22 shkurt 1929 një artikull vlerësues mbi poezinë e Lasgush Poradecit (shih VIII/17). Por nga të dhënat e Arkivit Qendror të Shtetit<sup>2</sup> del se në vitin 1929, kur ishte ende student në Grac, ai kishte shkruar edhe dy artikuj të tjerë (deri sot të pabotuar) me mjaft interes. «Një shkrim i panjohur i De Radës» dhe «Kundër pseudofilologëve». Për të parin do të bëhet fjalë në VIII/16. Prandaj këtu do të ndalemi pak vetëm në artikullin, ku ai demaskon me seriozitet dhe kompetencë një sëmundje të

1) Sipas njoftimit të Joklit në *Indogermanisches Jahrbuch*, vëll. XXI (1937), faqe 216. Disertacioni nuk është botuar. Familja ruan një kopje të tij, të cilën autori e ka mbushur me plotësime dhe shënime me dorë.

2) AQSH, f. 295, d. 124, v. 1929.



## Eqrem Çabej

përhapur në kohën e tij midis të ashtuquajturve intelektualë shqiptarë. Ishte fjala për disa pseudofilologë, që nëpërmjet artikujsh të botuar në shtypin e kohës orvateshin të shiteshin njëri më i përgatitur se tjetri për çështje të vështira filologjike, nga të cilat në të vërtetë nuk merrnin erë fare. Kundër këtyre pseudofilologëve studenti i ri ngrihet me guxim duke i quajtur diletantë, ashtu siç ishin. Në këtë artikull, që jo pa arsye nuk e pa dritën e shtypit, Çabej, pasi i vë në lojë këta të ashtuquajtur filologë, shkruan ndër të tjera:

«Tash, duke lënë të qeshurit, duhet të konstatojmë me hidhërim se është një turp kulturor për ne që Atdheu ynë është ai vend i Europës, në të cilin në shekullin XX njerëz që mundet të jenë të zotë për nëpunësira ndofta dhe të nalta, por që s'dinë as pikë prej filologjisë, njerëz që në jetën e tyre s'kanë dëgjuar një konferencë filologjike, njerëz që s'kanë as më të voglën ide mbi mënyrën si punohet sot në lëmën e gjuhës, që të tillë njerëz dalin e mbushin shtyllat e fletoret me artikuj jo vetëm fare të kotë, por edhe të dëmshëm, e duke u sharë me shoqishoqin. . .» Dhe më poshtë: «Zakoni i botës së qytetëruar e do që të luftohet për ide, e jo për inate personale, për çfryrjen e të cilëvevet janë të çelura kaq gjykatore!»

Dhe artikullin e tij ky student i ri e vazhdon duke vënë në dukje nevojën që për studimet gjuhësore duhet bërë një punë e madhe përgatitore, dhe thekson: «Kurrkush nuk ka të drejtë të shkruajë mbi gjuhën pa u pat marrë vjet me radhë me studimin e vërtetë të saj! Kurrkush! Se gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli, dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar! . . .»

Edhe nga kjo paraqitje e shkurtër duket qartë se ç'kërkesa serioze kishte i riu 22-vjeçar E. Çabej ndaj studimeve shkencore në fushën e gjuhësisë. Dhe me të tilla kërkesa, në radhë të parë ndaj vetes, ai punoi me zell të madh për të përfituar sa më shumë nga profesorët e tij, sidomos në Universitetin e Vjenës. Kjo është edhe arsyeja kryesore që ky i ri i talentuar tërhoqi vëmendjen e profesorëve të tillë të shquar, si Paul Krecqmeri, Norbert Jokli etj., me të cilët ai edhe diskutonte për probleme të rëndësishme, kur takohej me ta apo përmes letrave<sup>1</sup> siç na dëshmon për këtë edhe njëra prej shumë letrave të Norbert

1) Një pjesë të letrave drejtuar Çabejt (që ruhen në familjen e tij), autori e ka përfshirë në kapitullin SELEKTAE (Shën. i Red.).

## *Eqrem Çabej*

Joklit, si ajo e datës 17 prill 1940. Në këtë letër, në të cilën Jokli i drejtohet Çabejt me «I dashur mik», pasi e ngushëllon për vdekjen e babait, i shkruan, ndër të tjera:

«Për mua ka qenë gjithëmonë gëzim i madh që vitet e studimeve tuaja në Vjenë kanë lënë tek ju mbresa të përzemërta e miqësore. Shpesh kujtoj me ëndje ato vite të punës sonë të përbashkët, bisedat e shumta e të zjarrta për të gjitha problemet e shkencës albanologjike dhe të historisë së saj. Por letra juaj i bën më të gjalla të gjitha këto kujtime...»

8. Kryerja me sukses e studimeve të larta i nxiti autoritetet drejtuese të Universitetit të Vjenës që t'i propozonin të diplomuarit E. Çabej të qëndronte në atë universitet si asistent pranë N. Joklit. Një propozim i tillë nuk mund ta joshte atë për të qëndruar në qytetin e bukur të Vjenës, ku përveç jetës së rehatshme do të kishte edhe mundësi më të mëdha për zhvillimin e tij të mëtejshëm shkencor. *Balta e mëmëdheut* për të porsadiplomuarin shqiptar ishte më e ëmbël dhe më joshëse se bulevardet e kryeqytetit të ish-Perandorisë Austro-hungareze. Ajo e ftonte atë të kthehej në gjirin e popullit të tij për t'i shërbyer atij deri në fund të jetës.

Dhe kështu 25-vjeçari Eqrem Çabej, pas mbarimit me sukses të studimeve universitare u kthye përfundimisht në Shqipëri, me diplomën e Universitetit të Vjenës në xhëp dhe me dëshirën e zjarrtë për t'i vënë dituritë dhe energjitë e tij në shërbim të atdheut.

Në kohën që u kthye Çabej në Shqipëri, kriza ekonomike që kishte përfshirë gjithë botën, këtu kishte sjellë pasoja edhe më të rënda, që mplekseshin edhe me rrjedhojat e një prapambetjeje të madhe në fushën e arsimit dhe të kulturës. Nga plaga e rëndë e analfabetizmit vuanin mbi 80 për qind e popullsisë. Edhe në ato pak shkolla të mesme që mbaheshin në këmbë, niveli i përgatitjes së nxënësve, me gjithë përpjekjet e mëdha të disa arsimitareve atdhetarë si Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipoja, Ahmet Gashi, Vasil Vinjau, Kolë Paparistoja, Sotir Papahristoja, Sotir Kuneshka, Minella Karajani, Hysni Babamefoja, Gjergj Cancoja etj. ishte ende larg nivelit mesatar të kohës. Tekstet mësimore ishin shumë të pakta dhe numri i nxënësve nëpër ato shkolla ishte shumë i vogël në krahasim me nevojat e mëdha të një vendi të prapambetur, siç ishte Shqipëria e asaj kohe. E megjithatë ndonjë deputet atëherë

## Eqrem Çabej

kishte guximin të ankohej në parlament për një superprodhim intelektual në Shqipëri!

9. Në këto rrethana u kthye i diplomuari i Universitetit të Vjenës në Tiranë, ku u mor vendimi për ta emëruar nëndrejtor të konviktit «Malet tona», pranë Gjimnazit të Shkodrës, me të drejtën për të dhënë edhe orë mësimi në atë shkollë. Në këtë gjimnaz, të themeluar në vitin 1922, Çabej zhvilloi lëndën e letërsisë shqipe. Por, siç del edhe nga teksti *Elemente të gjuhës e të literaturës shqipe* (për shkollat e mesme), botuar prej tij më 1936, në orët e mësimit ai jepte edhe njohuri për gjuhën shqipe dhe folklorin shqiptar. Për këtë dëshmojnë edhe temat e maturës me shkrim, që ai dha në Gjimnazin e Shkodrës (në degën e Normales) për vitin shkollor 1933-1934: 1. *Gjuha shqipe si gjuhë indoevropiane dhe monumentet e para gjuhësore të saj*. 2. *Naim Frashëri si patriot dhe si shkrimtar shqiptar*. 3. *Ballada italo-shqiptare Konstandini i vogëlith*. Kurse në degët reale dhe klasike të po atij gjimnazi ai dha si tema mature me shkrim: 1. *Gjuha shqipe si gjuhë indoevropiane dhe teoritë e ndryshme përmbi rrjedhjen e saj*. 2. *Vepra patriotike dhe vepra letrare e Girolamo de Radës*. 3. *Ballada italo-shqiptare e Garentinës*.

Në vitin shkollor 1935-1936 Çabej u transferua në Shkollën Normale të Elbasanit, ku — ashtu si në Shkodër — ka lënë përshtypje shumë të mira jo vetëm për kulturën e gjerë, por edhe për sjelljen dhe lidhjet e tij me nxënësit. Një nga ish-nxënësit e tij, arsimtari pensionit Dhimitër Grillo, e kujton me nderim të madh këtë «njeri fisnik, që ishte i afruar me nxënësit dhe të impononte respekt me sjelljen e tij korrekte». Me interesimin e profesorit të tij, ky ish-nxënës i Normales së Elbasanit mbledhi në fshatin e tij të lindjes, Vuno, këngën e Dhoqinës, të cilën Çabej e përfshiu në artikullin *Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare*.<sup>1</sup> Në këtë artikull ai ka përfshirë edhe një version të kësaj kënge të kumtuar atij nga një bari (shih VIII/8).

Edhe në Normalen e Elbasanit Çabej qëndroi vetëm një vit. Që andej u transferua në Ministrinë e Arsimit për t'u marrë me drejtimin e arsimit të mesëm. Me sa kuptohet nga qëndrimi i tij, ai nuk e kishte mirëpritur një emërim të tillë. Në një lutje më datë 17.12.1936, drejtuar Ministrisë së Arsimit,

1) Botuar në revistën *Normalisti* të Elbasanit, 6/1934.

## Eqrem Çabej

ai kërkon që për arsye shëndetësore të transferohet nga ai dikaster e të riemërohet si profesor i letërsisë në liceun e Tiranës. Por një kërkesë e tillë, me sa duket, nuk u pëlqeu drejtuesve të atij dikasteri, të cilët vendosën ta hiqnin qafe «me lezet», duke e derguar që «të mësonte» në Shkollën e Plotësimit Ushtarak! Duke qenë se vuan nga një sëmundje mushkërisht, ai kërkoj që të lirohej nga një detyrim i tillë, por lutja e tij jo vetëm që nuk u mor parasysh, por edhe i solli kokëçarje të tjera. Me «çështjen Çabej» u mor më në fund edhe Këshilli i Ministrave të asaj kohe, i cili vendosi që Çabej, pas mbarimit të Shkollës së Plotësimit Ushtarak, të transferohej si profesor në Gjirokastër dhe që, po të tregonte shenja të tjera të padëshiruara, kundër tij të merreshin masa edhe më të rënda.<sup>1</sup>

10. Duke paraqitur peripecitë e kësaj periudhe, që pa dyshim duhet të kenë lënë mbresa dëshpërimi në shpirtin e Çabejt, nuk mund të mos veçojmë, nga ana tjetër, edhe një ngjarje të shënuar të jetës së tij. Eshtë fjala për ligjëratën që ai mbajti më 25 korrik të vitit 1930 në ceremoninë e varrimit të atdhetarit të njohur të Rilindjes, Bajo Topulli. Me atë rast, pasi vuri në dukje shpirtin bujar dhe burrërinë e atij atdhetari të palodhur të Rilindjes sonë Kombëtare, që tërë jetën e shkriu në shërbim të Shqipërisë, Çabej e përfundoi ligjëratën e tij me këto fjalë: «Por ne, djalëria, e kemi për nder të quhemi djemtë e idesë sate. Ti, o i rrëzuari lis, si ata lisa që ngrihen ndër malet tona! Ti, mësues e edukator i kaq brezave shqiptare!

Bajo, prehu, pra! Dergje trupin tënd te balta jote! Për Atdhenë që e bërë dhe na e le trashëgim, mos ki frikë! Ne djalëria betohemi këtu para trupit tënd, se ç'fitove ti, ne do ta ruajmë, goftë edhe me gjakun tonë. Plas për lirinë e kombit...»<sup>2</sup>

Për Bajo Topullin Çabej gjatë tërë jetës së tij ruajti një ndjenjë nderimi të veçantë. E për këtë na dëshmon më së

1) AQSH, f. 259, d. IV/441/1, v. 1936.

2) Botuar në gazetën «Demokratia» të Gjirokastrës më 2 gusht 1930. (Originali i këtij fjalimi ruhet në Muzeun e Gjirokastrës.). Gjashtë vjet më vonë, në korrik të vitit 1936, varri i Bajo Topullit u bë i ri. Me atë rast, midis të tjerëve, siç dihet, në emër të djalërisë shqiptare foli studenti Enver Hoxha (Shën. i Red.).



## Eqrem Çabej

miri intervista me kujtimet e tij, që ai i dha Radio Tiranës në vitin 1979 dhe që u botua në gazetën «Zëri i Popullit» më 4.8.1989:

«Figurën hijerëndë të Bajo Topullit ne nxënësit e shkollave të mesme të Gjirokastrës e ndiqnim me adhurim, kur e ndeshnim ndonjëherë në ndonjë rrugë të qytetit.

Pata nderin ta njoh Bajo Topullin më për së afri aty nga vitet 30, kur isha student në Vjenë dhe kur ai erdhi e u shtrua në një spital të atij qyteti, i pushtuar nga një sëmundje e rëndë, e cila u dha fund edhe ditëve të tij. Në bisedat që zhvillonte me ne studentët kur venim e vizitonim në spital, ai na fliste me admirim për figurat e shquara të Rilindjes sonë Kombëtare, që kishte pasur rastin t'i njihje në rini të tij. Ai mbante qëndrim të drejtë e parimor edhe ndaj patriotëve si edhe ndaj pseudopatriotëve të kohës së tii.

«Fjalët na mësojnë, shembujt na tërheqin». — thotë një proverb i mocëm. Mbresa të thella na linin fjalët e këshillat e tij, por mbresa më të thella na linte shembujt e tij. Na linte qëndrimi i një burri me karakter të fortë në mes të fatkeqësisë që e kishte pushtuar. Pas disa javësh qëndrimi në spital dhe miekimi të pafryt, ai u kthye në atdhe.

Në fillimin e pushimeve verore u ktheva edhe unë dhe e vizitova për herën e fundit në Sarandë.

Nuk shkuan shumë ditë dhe ky patriot dha frymën e fundit. Në ceremoninë e varrimit që u bë në Gjirokastrë, sheshi «Cerciz Topulli» dhe kodrat përreth u mbushën me popullin e qytetit, i cili po vajtonte këtë bir të tij të shtrenjtë.

Pata nderin me këtë rast të them edhe unë dy fjalë për-kujtimi.

Kujtimi i Bajo Topullit si një nga figurat e shquara të Rilindjes sonë mbetet i pashlyer në të gjithë ata, të vietër e të rinj, që kanë pasur nderin ta njohin nër së gjalli si një patriot të madh e të flaktë dhe si një karakter me burrëri të rrallë».

11. Gjatë viteve 1938-1939 e gjejmë përsëri arsimtar, kë-saj radhe në Gjirokastrë, ku vazhdoi të jente mësimin e letërsisë të bashkërenduar me elemente të gjuhës shqipe. Edhe këtu E. Çabej, ka lënë nërshtypje shumë të mira. Një nga ish-nxënësit e tij, arsimtari pensionist Koco Mosko, kujton me nderim se «profesor Eqrem Çabej na kënaqte me shpjegimet e tij për letërsinë arbëreshe» dhe se ai i këshillonte nxën-

## Eqrem Çabej

nësit që në hartime të shkruanin shkurt e qartë. Ai kujton gjithashtu se «për hartime të mira nga shkrimi i pastër dhe nga përmbajtja në klasën tonë, me mbi 40 nxënës, shquhej Themo Vasi».<sup>1</sup>

Një tietër ish-nxënës i Çabejt në klasën e shtatë të Gjinnazit të Gjirokastrës gjatë vitit 1938-1939. Nasho Nathanaili, në një shënim përkujtimor dërguar Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave në Tiranë, duke sjellë ndër mend një gjest të profesorit të tij pak ditë pas pushtimit fashist të Shqipërisë më 1939, shkruan ndër të tjera:

«Ishte 12 ose 13 prilli i 1939-s, pas pushtimit të atdheut tonë nga okupatorët fashistë italianë. Ai erdhi në mësim jo si herët e tjera, i çelur e buzagaz, por i vrenjtur dhe i mërzhitur. U ul në katedrën e tij dhe, pasi na vërejti të gjithëve me kujdes, na u drejtua me këto fjalë:

— Nxënësit e mi! Ju e kuptoni se si për ne dhe gjithë popullin tonë u krijuan kondita të tjera, të atilla si ato të para vitit 1912. Unë me ju zhvilloj dy lëndë, filozofi dhe gjuhë shqipe. Për të parën, po të doni, ma mësoni, po të doni, ma mësoni, unë do t'ju jap një notë kaluese. Por, për sa i përket gjuhës shqipe, unë s'ju lëshoj asnjë fije, sepse për të tani janë krijuar kondita të tjera, fillon periudha e luftës për eliminimin e saj. Prandaj, sa më shumë të jenë njerëzit që e njojnë mirë atë, aq më shumë do të jenë edhe ata që do ta mbrojnë atë nga eliminimi i saj. Unë jua them këtë si mësuesi iuaj, si prindi iuaj. Kush të dojë, le të vejë në karabinieri dhe le të informojë për këtë këshillë që ju dha mësuesi iuaj».

Dhe autori i shënimit shton se midis një heshtjeje prej varri, që u krijua në ato çaste, u ngrit nxënësi Niko Avrami (i cili ra dëshmor gjatë Luftës Nacionalçlirimtare) dhe tha: «Midis nesh, profesor, nuk ka të tillë njerëz, mos kini frikë. Të gjithë jemi me mendimin dhe kërkesën tuaj».

12. Në vitin shkollor 1939-1940 Çabej u transferua në Gjinnazin e Tiranës, ku u ngarkua me drejtimin e shkollës. Me sa duket, autoritetet pushtuese shpresonin ta bënin për

<sup>1</sup> Themo Vasi (1915-1943), Hero i Popullit, ra heroikisht në luftë kundër nazistëve gjermanë më 1.10.1943.

## Eqrem Çabej

vete këtë profesor me kulturë, që kishte fituar emër të mirë me studimet dhe botimet e tij. Por u gabuan. Ai ishte njeri që nuk gënjehej nga të joshurat e armiqve dhe nuk bëhej në asnjë mënyrë vegël e tyre. E këtë e kuptuan shpejt edhe autoritetet pushtuese, siç na dëshmon, ndër të tjera, edhe një shkresë që Federata e Fashios së Tiranës i dërgonte Drejtorisë Qendrore të Partisë Fashiste Shqiptare më 29.7.1940. Në këtë shkresë, ku jepeshin të dhëna karakterizuese për mësuesit e Liceut të Tiranës, për Çabejn thuhej:

«Eqrem Çabej: Drejtor. I vetmi person përgjegjës për veprimet e këqia të krvera nga studentët e Liceut në demonstratat e njohura të 28 nëntorit 1939. Deri më sot nuk ka treguar asnjë shenjë afrimi në politikën fashiste. Prandaj duhet konsideruar i rrezikshëm dhe duhen marrë masa për ta shkar-kuar nga detyra që kryen tashti».<sup>1</sup>

13. Në këto rrethana autoritetet pushtuese italiane e larguan «me lezet» Çabejn nga Shqipëria, duke i gjetur një «punë shkencore» pranë Akademisë së Shkencave në Romë. Këtu ai e shfrytëzoi qëndrimin e tij të mbikëqruar, për të punuar për *Atlasin gjuhësor shqiptar* (shih V/2).

Gjatë qëndrimit në Romë autoritetet italiane më 1942 dhe gjermanët më 1943 i propozuan që të bëhej ministër i Arsimit në qeveritë kuislinge të Tiranës,<sup>2</sup> por ai nuk pranoi. Lidhur me këto propozime ai shkruan, ndër të tjera, në autobiografinë e tij: «Kam hedhur poshtë çdo propozim për bashkëpunim me të huajin, çdo gjë që nuk paitohej me nderin tim si shqiptar dhe me të mirën e vendit e të popullit».

Një tjetër ngjarje e shënuar e kësaj periudhe është edhe letra e datës 27.9.1942 drejtuar kryetarit të *Institutit Mbret-nuer të Studimeve Shqiptare*. Në atë letër ai shkruan, ndër të tjera:

«Ju lutem, në mënyrë miqësore, të keni mirësinë e të më shlyeni nga lista e anëtarëve të Institutit të Studimeve Shqiptare. Arsyeja e kësaj kërkesë është se si mis i këtij Instituti figuron Atë Fulvio Cordignano, të cilin unë vërtet as nuk e njoh personalisht, veçse njihet botërisht si armik i rreptë i racës shqiptare. . .».<sup>3</sup>

1) AQSH, f. 264, d. 138, viti 1940, f. 15.

2) Emërimi i E. Çabejt si ministër i Arsimit në qeverinë e Rexhep Mitrovicës është shpallur edhe në gazetën «Kombi» më 6.11.1943.

3) AQSH, f. 400, d. 1, viti 1942, f. 16.

14. Në Romë Çabej qëndroi deri në korrik të vitit 1944, kur ende ziente Lufta e Dytë Botërore. Atëherë ai vendosi të kthehej përsëri në Shqipëri ku, më në fund, arriti pas një udhëtimi shumë të vështirë me anë të bregdetit dalmat në një kohë që atje, siç dihet, ziente lufta partizane kundër nazistëve gjermanë. Edhe në këtë rast nuk është vështirë të merret me mend fuqia e madhe tërheqëse që ka ushtruar «balta e mëmëdheut» ndaj këtij intelektualit atdhetar, i cili mund të siguronte pa shumë vështirësi një jetë të rehatshme larg Shqipërisë. Por një njeri i ndershëm si Çabej nuk mund të zgjidhte një rrugë të tillë në një kohë që atdheu kishte nevojë për të. Për më tepër, ai e njëjtte mirë jetën e hidhur të mërgimit, sepse e kishte provuar vetë se «sa e kripur është buka e huaj dhe sa e rëndë është të ngjitesh e të zbresësh nëpër shkallët e botës».<sup>1</sup>

15. Pas Çlirimit të Shqipërisë edhe për Çabejn fillon një jetë me perspektiva të mëdha. Zhvillimi i gjithanshëm dhe i shpejtë i vendit kërkonte bashkëpunimin e të gjithë qytetarëve të ndershëm, që ishin të gatshëm të jepnin ndihmesat e tyre në fushat përkatëse. E këto ndihmesa nuk ishin më pak të nevojshme në fushën e arsimit, të kulturës e të shkencës, në një kohë kur populli ynë nën udhëheqjen e Partisë iu fut rrugës së vështirë por të lavdishme për të kapërcyer me hap të shpejtë prapambetjen shekullore të trashëguar nga e kaluara. Këtu nuk është fjala vetëm për zgjerimin e vrullshëm të arsimit fillor dhe të mesëm, por edhe për zhvillimin e shpejtë të arsimit të lartë, të kulturës dhe të shkencës. Kështu, p.sh., menjëherë pas Çlirimit u vendos riorganizimi i Institutit të Shkencave me tre sektorë: *gjuhë-letërsi*, *histori-gjeografi* dhe *shkencat natyrore*. Po kështu në vitin 1946 u hap në Tiranë e para shkollë e lartë, ish-Instituti Pedagogjik dyvjeçar me katër degë: *gjuhë-letërsi*, *histori-gjeografi*, *matematikë-fizikë* dhe *kimi-biologji*. Ky institut më 1951 u shndërrua në një Institut Pedagogjik katërvjeçar. Po në atë vit u hapën edhe institute të

1) Këto janë tri nga vargjet, me të cilat stërgjyshi Kaçaguida (Cacciaguida) i paralajmëron Dante Aligierit mërgimin e hidhur nga qyteti i tij i lindjes, Firencja. (Shih: Dante Alighieri, *Divina Commedia*, III, kënga XVII, vargjet 58-60).

## *Eqrem Çabej*

tjera të larta katërvjeçare dhe më 1957 u themelua Universiteti i Tiranës.

Shkolla e lartë u hap në Shqipëri pa pasur asnjë përvojë në këtë fushë pa tekste mesimore dhe pa kuadër të përgatitur për këtë qëllim. Për më tepër, Shqipëria e porsaçliruar, pas një pushtimi të huaj prej më shumë se pesë vjetësh duhej të përballonte, në radhë të parë, kërkesat e rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta e pabarabartë kundër armiqve të ndryshëm. Në këto rrethana hapja e shkollës së lartë ishte një hap me të vërtetë shumë i guximshëm. Por ky hap shumë i guximshëm u hodh dhe, me gjithë vështirësitë e kuptueshme, ia arriti plotësisht qëllimit. Dhe një meritë të madhe për këtë kanë, në radhë të parë edhe pedagogët atdhetarë, si: Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Kostaq Cipoja, Aleks Buda, Dhimitër Shuteriqi, Mahir Domi etj., të cilët morën përsipër ta përballonin me guxim një punë kaq të vështirë.

16. Shkruesi i këtvre radhëve në atë kohë punonte si përkthyes në Agjencinë Telegrafike Shqiptare dhe, kur mori vesh se në Institutin Pedagogjik dyvjeçar mund të pranoheshin edhe studentë me korrespondencë, shkoi e u regjistrua në degën e gjuhës e të letërsisë shqipe.

Duke qenë se mësimet zhvilloheshin në mbrëmje, vendosa që të isha i pranishëm të paktën në ligjëratat e para. Dhe takimin e parë e patëm me profesor Kostaq Cipon, një burrë i niekur dhe i thjeshtë, që të linte mbresa shumë të mira si me të folurit e qartë e tërheqës, ashtu edhe me kulturën e gjerë. Të tilla mbresa të linin edhe ligjëratat e profesorëve të tjerë, si: Aleksandër Xhuvanit, Eqrem Çabejt, Dhimitër Shuteriqit etj. Që të gjithë bënin përpjekje të mëdha për të zgjuar te dëgjuesit e tyre dëshirën për t'u futur sa më thellë në të fshehtat e diturisë. Fillimi, pra, që i mbarë e shumë prëmtues dhe të nxiste t'i ndiqje studimet me dëshirë në këtë të parën shkollë të lartë shqiptare, ku Çabej zhvilloi lëndët *linguistikë* dhe *albanologji*.<sup>1</sup> Ai e vazhdoi punën pedagogjike edhe më pas në Institutin Pedagogjik katërvjeçar dhe sidomos në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, që u ngrit mbi bazën e Institutit

---

1) Tekstet e këtyre dy lëndëve janë botuar nga Instituti Pedagogjik dyvjeçar më 1947 si dispensa, e para 149 faqe dhe e dyta 120 faqe.

## Egrem Çabej

katërvjeçar në kuadrin e Universitetit të Tiranës, që u krijua në vitin 1957. Këtu ai zhvilloi për shumë vjet lëndën *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe* dhe *Fonetika historike e shqipes*, për të cilën hartoi edhe tekstin përkatës, që është ende në përdorim.<sup>1</sup>

17. Punën pedagogjike Çabej, ashtu si edhe disa profesorë të tjerë, e kryente si pedagog i jashtëm, duke qenë se ai ishte punonjës shkencor më parë në ish-Institutin e Shkencave dhe, pas riorganizimit të këtij në vitin 1957, në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë. Ai punonte në sektorin e gjuhësisë, që më parë drejtohej nga Aleksandër Xhuvani dhe qysh nga viti 1955 nga Mahir Domi. Që të dy këta gjuhëtarë kanë treguar mirëkuptim të plotë ndaj interesave shkencore të Çabejt, ashtu siç tregonte edhe ky ndaj veprimtarisë drejtuese dhe shkencore të tyre. Bashkëpunimi shkencor midis tyre ka qenë shembullor dhe shumë i frvtshëm. Mijafton të sillet ndër mend bashkëpunimi i tij me Aleksandër Xhuvanin në hartimin e dy monografive për parashtesat dhe prapashtesat e gjuhës shqipe (shih VII 8-9).

18. Në veprimtarinë gjysmëshekullore të Çabejt vendin kryesor e zë pa dyshim prodhimtaria e tij e pasur shkencore, e cila mund të ndahet në dy faza kryesore. Faza e parë vazhdon deri në prag të Çlirimit të Shqipërisë dhe faza e dytë nis pas vitit 1945. Veprimtaria e tij shkencore gjatë këtyre dy fazave është kushtëzuar jo vetëm nga interesat e tij shkencore, por edhe nga nunët që ishte ngarkuar të kryente. Sidoqoftë, në fazën e parë ai është marrë edhe me studime thjesht shkencore edhe me botime të nevojshme për shkollën e mesme. Në prodhimtarinë e tij të asaj faze bie në sy një interesim i madh jo vetëm për gjuhësinë, por edhe për folklorin e letërsinë artistike, me një anim të lehtë nga kjo fushë e dytë. E kjo duket qartë edhe nga titujt e botimeve të tij të asaj periudhe, kur krahas studimeve thjesht gjuhësore ka botuar edhe studime nga fusha e folklorit dhe e letërsisë, ose edhe studime me karakter të përzier gjuhësor e letrar. Nga studimet thjesht gju-

---

1) Botuar si dispensë nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë më 1957 (botimi i parë 94 faqe). Ky tekst është ribotuar disa herë. Ai është ribotuar si libër edhe në Prishtinë.

## Egrem Çabej

hësore të asaj periudhe mund të përmendim: 1. *Tekste italo-shqiptarë*<sup>1</sup> (1935). 2. *Elemente dialektore nga Italia*.<sup>2</sup> 3. *Marrëdhëniet midis shqipes dhe rumanishtes*.<sup>3</sup> 4. *Shprehje dhe frazeologji paralele në gjuhët ballkanike*.<sup>4</sup> 5. *Atlasi gjuhësor shqiptar*.<sup>5</sup>

Nga fusha e folklorit dhe e letërsisë mund të përmendim ndër të tjera: 1. *Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare*.<sup>6</sup> 2. *Zakone dhe doke të shqiptarëve*.<sup>7</sup> 3. *Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut*.<sup>8</sup> 4. *Për gjenezën e literaturës shqipe*.<sup>9</sup> 5. *Kulti dhe vijimi i huësoshës Diana në Ballkan*.<sup>10</sup>

Nga studimet me karakter të përzier (gjuhësor, letrar dhe folklorik) duhen përmendur sidomos *Studime italo-shqiptare* (shih § 5) dhe teksti për shkollat e mesme *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe (me pjesë të zgjedhura)*.<sup>11</sup> Ky tekst, siç del edhe nga vetë titulli, është i ndarë në tri pjesë. Në pjesën e parë (f. 10-22) jepen disa njohuri të përmblëdhura mbi gjuhën, mbi gjuhët e botës, mbi gjuhët indoevropiane dhe mbi gjuhën shqipe.<sup>12</sup> Në pjesën e dytë (f. 24-62) jepen njohuri të përmblëdhura për shkrimtarët e vjetër shqiptarë dhe arbëreshë,<sup>13</sup> për shkrimtarët e shekullit XIX dhe të fillimit të sheku-

---

1) Botuar në *Hylli i Dritës*, XI (1935).

2) Botuar gjermanisht në revistën e Vjenës *Glotta*. XXV (1936), f. 50-57.

3) Botuar gjermanisht në *Revue internationale des études balkaniques* (Beograd 1936), Viti I, nr. 2.

4) Po aty, nr. 4-6.

5) Pyetësor 1-2578 çështje. Grottaferrata, 1943.

6) Botuar në revistën *Normalisti* (Elbasan), viti VI (1934), nr. 6.

7) Botuar në revistën *Illyria I* (1936), nr. 37, 39, 43, 46, 49.

8) Botuar në *Hylli i dritës XIV* (1937).

9) Botuar në *Hylli i dritës*, XIV (1937) dhe XV (1959).

10) Botuar gjermanisht në revistën *Leipziger Vierteljahrschrift für Südosteuropa V* (1941), Leipzig.

11) Botuar në Tiranë më 1936.

12) Për gjuhën shqipe jepen njohuri për përhapjen e saj, për dialektet dhe ndryshimet midis tyre, për gjuhën e përbashkët, për buri-min e shqipes dhe për emrin e shqiptarëve.

13) Këtu janë përfshirë Dokumentet e para, Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Matrënga, Variboba, De Rada, Dara, Serembe etj., etj.

## Eqrem Çabej

llit XX<sup>1</sup> si edhe për poezinë popullore shqiptare dhe arbëreshe. Në pjesën e tretë (f. 64-201) janë radhitur pjesë të zgjedhura nga shkrimtarët e vjetër shqiptarë dhe arbëreshë.<sup>2</sup> nga shkrimtarët shqiptarë dhe arbëreshë të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX<sup>3</sup>, si edhe nga poezia popullore e arbëreshëve të Greqisë dhe të Italisë dhe nga Shqipëria.<sup>4</sup>

19. Veprimtaria shkencore e Çabejt mori një zhvillim shumë të madh në fazën e dytë, d.m.th. pas Çlirimit, kur ai punoi pranë ish-Institutit të Shkencave dhe më vonë pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (shih §5) dhe njëkohësisht edhe si pedagog në shkollën e lartë (shih §15-16). Si punonjës shkencor, krahas punës së madhe që bëri për zhvillimin e temave të planit vetjak nga fusha e gjuhësisë, ai dha ndihmesa me vlerë edhe në kryerjen e disa punimeve në bashkëpunim me gjuhëtarë të tjerë. Këtu duhet përmendur, në radhë të parë, bashkëpunimi i tij i frytshëm me profesor Aleksandër Xhuvanin në hartimin e monografive *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956) dhe *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1962), që janë dy nga studimet shkencore më të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare (shih edhe VII, 8-9). Bashkëpunimi i çiltër midis këtyre dy dijetarëve të shquar, i mbështetur në nderimin dhe korrektësinë ndaj njëri-tjetrit, mund dhe duhet të shërbejë si shembull, kur ndërmerret ndonjë punim i gjerë shkencor nga disa bashkautorë.

Çabej, që ka pasur rastin e mirë të bashkëpunojë me A. Xhuvanin edhe në vepra të tjera, shkruan me nderim për shoirtgjerësinë e këtij dijetari në bashkëpunimin me të tjerët: «I gatshëm e i pakursyer për çdo ndihmë, ai ka dhënë një kontribut të vlefshëm edhe në ato punime të kuadrove tonë, ku nuk shfaqet emri i tij, si bie fjala në *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 1954. Si në jetën private, edhe në fushën shkencore ai,

---

1) Këtu janë trajtuar Kristoforidhi, Naimi, Mjeda, Çajupi, Gj. Fishta, Asdreni, Fan Noli etj.

2) Këtu janë përfshirë pjesë të zgjedhura nga Buzuku, Matrënga, Budi, Bardhi, Bogdani, nga Kullurioti, Filia, Variboba. De Rada, Dara, Serembe, Skiró etj.

3) Nga Naimi, Mjeda, Çajupi, Asdreni, Fishta, Noli etj.

4) Këtu janë përfshirë, ndër të tjera, disa përralla nga arbëreshët e Greqisë, Këngët e *Doruntinës*, *Kostandinit të vogëlith*, *Ringjallja e Lazërit* etj., nga arbëreshët e Italisë, si edhe *Dhoqina*, *Ago Ymeri* dhe disa përralla nga Shqipëria.



## Eqrem Çabej

nga sa kam parë, ka qenë i parimit që është më bukur të japësh sesa të marrësh. Në këtë mënyrë interesi personal tek ai dhe në lëmin e dijes ka mbetur gjithë kohën shumë prapa interesit të përgjithshëm».<sup>1</sup> E ky gjykim e vlerësim i karakterit të A. Xhuvanit mund të jepet edhe për E. Çabejn nga ata që kanë pasur rastin e mirë të bashkëpunonin me të, ose të kërkonin ndihmën e tij.

20. Çabej ka bashkëpunuar edhe në mjaft vepra të tjera kolektive, si në përgatitjen e *Fjalorit serbo-kroatisht-shqip* (1947) dhe në hartimin e 13 terminologjive për shkencat e ndryshme<sup>2</sup>. Ai ka bashkëpunuar gjithashtu edhe në redaksitë e revistave shkencore të ish-Institutit të Shkencave dhe të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, në komisionet përgatitore të konferencave dhe sesioneve shkencore të organizuara nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, si edhe në komisionin përgatitor të *Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe* (1972).

21. Por, natyrisht, krahas bashkëpunimit nëpër vepra kolektive, nëpër komisione etj., ai si punonjës shkencor institutesh kërkimore kishte edhe plane vetjake dhe këto kanë qenë kurdoherë të ngjeshura. Nga sa kam pasur rastin të mësoj, ai jo vetëm që i plotësonte gjithnjë në kohë detyrimet që merrte përsipër, por kryente edhe punime të tjera të papara-shikuara, që i dilnin përpara në rrugë e sipër. Për arritjet kryesore të veprimtarisë së tij shkencore pas Çlirimit do të bëhet fjalë më gjerësisht në kapitujt II-VIII të këtij libri. Prandaj, këtu do të ndalemi shkurt vetëm në disa konsiderata të përgjithshme dhe në disa të dhëna nga veprimtaria e tij, që nuk do të pasqyrohen në kapitujt ndjekës.

22. Siç u vu në dukje edhe në § 19, pas vitit 1945 Çabej iu përkushtua më fort gjuhësisë dhe veprimtaria e tij shkencore në këtë fushë ka qenë pa krahasim më e frytshme dhe më e rëndësishme se në fusha të tjera (shih për këto § 38). Ky përkushtim shpjegohet jo vetëm me animin e tij më fort nga gjuhësia, por edhe me kushtet objektive që u krijuan për të gjatë kësaj periudhe. Të dyja këto rrethana ndikuan shumë që ai, krahas bashkëpunimit në vepra kolektive me karakter gjuhësor (shih § 20) të ndërmernte edhe disa punime të rëndësishme afatgjata, që diktoheshin jo vetëm nga interesat e tij shkencore, por edhe nga kërkesat e reja të zhvillimit të gju-

1) Shih *Mësuesi*, 19.3.1975.

2) Shih § 38.

## Eqrem Çabej

hësisë shqiptare. Si dishepull i gjuhëtarëve të tillë të mëdhenj si Krecmeri, Jokli etj. ai i vuri vetes si detyrë afatgjatë sqarimin e disa çështjeve të rëndësishme të gjuhës shqipe, që kërkonin zgjidhje sa më të argumentuara dhe që do të ndihmonin për zhvillimin e mëtejshëm të studimeve gjuhësore në Shqipëri. Në këtë rast është fjala sidomos për studime në rrafshin historik (diakronik), ku deri atëherë fjalën e parë dhe të fundit e thoshin pothuaj vetëm studiuesit e huaj. Gjuhëtarët shqiptarë deri atëherë ishin marrë kryesisht me çështje të gjuhës së sotme shqipe dhe rrallë e tek ishin ndërmarrë edhe studime nga fusha e historisë së shqipes, sidomos nga ndonjë autor arbëresh.<sup>1</sup> E një gjendje e tillë nuk është e pashpjegueshme, po të mbahet parasysh se edhe gjatë periudhës pas Shpalljes së Pavarësisë (1912-1944) zhvillimi i mendimit shkencor në vendin tonë mbeti gjithnjë mjaft prapa zhvillimit shkencor të vendeve të tjera të Evropës, përfshirë këtu edhe vendet e Ballkanit. Përpjekjet e veçuara të Aleksandër Xhuvanit e të ndonjë gjuhëtarit tjetër ishin përqendruar me të drejtë në plotësimin e kërkesave më të ngutshme të kohës me hartimin e teksteve të gjuhës shqipe për shkollat fillore dhe për ciklin e ulët të shkollave të mesme.

23. Pas vitit 1945 riorganizimi i Institutit të Shkencave (shih § 5) dhe më vonë krijimi i Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, si edhe themelimi i arsimit të lartë (shih § 5) qenë një nxitje e fuqishme edhe për zhvillimin e mendimit gjuhësor shqiptar në rrafshin bashkëkohor (sinkronik) dhe historik (diakronik). Kjo nxitje e fuqishme nuk mungoi të jepte shpejt fryte të mira falë edhe punës së madhe themelvënëse të disa gjuhëtarëve të talentuar si Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipoja, Eqrem Çabej, Mahir Domi, Selman Riza etj. Këta ditën t'i shfrytëzonin kushtet e favorshme që iu krijuan për t'iu futur me guxim studimit të shumanshëm të gjuhës shqipe. Përfshirë këtu edhe studimin historik të saj. Në këtë mënyrë u kapërcye

---

1) Është fjala kryesisht për Dhimitër Kamardën (1821-1882), autor i veprës *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese* (-Sprovë gramatologjie të krahasuar mbi gjuhën shqipe-), vëll. I 1864 dhe vëll. II (shtojca) 1866. Natyrisht, ka pasur edhe gjuhëtarë të tjerë shqiptarë dhe arbëreshë si A. Xhuvani, M. la Piana etj., që janë marrë edhe me çështje të historisë së gjuhës shqipe, por jo në mënyrë sistematike.

## *Eqrem Çabej*

edhe ajo ndjenjë druajtjeje dhe pasigurie për t'iu futur studimit diakronik të shqipes, që deri atëherë, siç u vu në dukje edhe pak më sipër (§ 22), kishte mbetur «monopol» i albanologëve të huaj. Për kapërcimin e kësaj ndjenje druajtjeje dhe pasigurie rol vendimtar luajti pa dyshim fryma e bashkëpunimit që u krijua nga gjuhëtarët e lartpërmendur dhe sidomos nga gjuhëtari veteran Aleksandër Xhuvani, ish-kryetar i Seksionit të gjuhësisë, letërsisë dhe folklorit pranë ish-Institutit të Shkencave dhe nga Mahir Domi, përgjegjës i Sektorit të gramatikës dhe të dialektologjisë pranë Institutit të Gjuhësisë. Të dy këta dijetarë kanë përkrahur me dashamirësi çdo nismë për zhvillimin e shpejtë të gjuhësisë shqiptare (shih § 17).

24. Në këto rrethana, E. Çabej, i frymëzuar nga dashuria e madhe për gjuhën amtare dhe nga dëshira për të hedhur sa më shumë dritë mbi historinë e kësaj gjuhe të lashtë të Ballkanit, i përqendroi energjitë dhe talentin e tij kryesisht në këtë fushë studimesh, natyrisht pa lënë pas dore edhe disa anë të tjera të interesave të tij shkencore (shih për këto § 38). Siç del qartë nga veprimtaria e tij e kësaj periudhe, synimet e tij kryesore në fushën e gjuhësisë kanë qenë t'i përqendronte përpjekjet më fort në sqarimin e disa çështjeve të rëndësishme të historisë së gjuhës shqipe, natyrisht pa lënë pas dore edhe çështjet e shqipes bashkëkohore.

Interesat e tij në fushën e historisë së gjuhës shqipe kane qenë të shumanshme, por ndihmesa më të rëndësishme ai ka dhënë sidomos në fushën e etimologjisë, të fonetikës historike, të gramatikës historike e të dialektologjisë si edhe për çështjen e prejardhjes së gjuhës shqipe. Për ndihmesat kryesore të këtij gjuhëtari të talentuar në këto fusha do të bëhet fjalë në kapitujt II-VII të këtij libri. Prandaj, këtu do të ndalemi vetëm në disa çështje me karakter të përgjithshëm.

25. Së pari, duhet sqaruar përse Çabej në këtë periudhë iu përkushtua më fort studimit diakronik të shqipes. Sqarimi i kësaj pyetjeje natyrisht nuk është i lehtë, përderisa vetë autori nuk di të jetë shprehur shkoqur për këtë. Megjithatë, mund të merren me mend rrethanat që e kanë shtyrë atë të përqendrohet në këtë fushë studimesh. Një rol vendimtar këtu duhet të ketë luajtur drejtimi i përgatitjes në Universitetin e Vjenës, ku profesorët e tij kryesorë, Paul Kreçmeri dhe Norbert Jokli, si indoevropianistë, merreshin kryesisht me studime diakronike. Edhe në periudhën e parë të veprimtarisë së

## Eqrem Çabej

tij shkencore ai ka dhënë shenja interesimi për historinë e gjuhës shqipe (shih § 18). Por në atë periudhë atij i është dashur në radhë të parë të përballonte kërkesat e punës mësimore si arsimtar (shih §8-12).

Kurse në periudhën pas vitit 1945, si gjuhëtar pranë një instituti kërkimor dhe si pedagog në shkollën e lartë, atij iu krijuan më në fund mundësitë që ta realizonte ëndrrën e tij të vjetër. Për më tepër, tashti kishte edhe më shumë përvojë për t'iu futur studimeve shkencore të një niveli më të lartë. Në këtë rast, ndoshta, do të ketë ndikuar edhe njëfarë ndarjeje pune midis gjuhëtarëve që punonin në të njëjtin institut kërkimor në vitet e para pas Çlirimit. Është fjala për Aleksandër Xhuvanin dhe Kostaq Cipon, dy gjuhëtarë të njohur, nga të cilët i pari për arsye të moshës së shkuar nuk mund t'i përkushtohet gjerësisht një fushe të tillë studimi,<sup>1</sup> ndërsa i dyti, gjithashtu i moshuar dhe shëndetlig u mor më fort me çështje të gramatikës së gjuhës shqipe.<sup>2</sup> Në këto rrethana njeriu më i përshtatshëm për fushën e gjerë të studimit diakronik të shqipes ishte Çabej, i cili në këtë rast ka pasur edhe mbështetjen dashamirëse të kolegëve të tij më të moshuar.

26. Vendosmëria e Çabejt për t'iu përkushtuar studimit diakronik të shqipes duhet të jetë nxitur edhe nga dëshira e tij për të ndriçuar më tej disa probleme të historisë së kësaj gjuhe të lashtë të Ballkanit në një kohë kur studimet albanologjike jashtë Shqipërisë po pësonin një rënie të dukshme. N. Jokli, albanologu më prodhimtar i viteve njëzet e tridhjetë të këtij shekulli, u zhduk në mënyrë tragjike nga nazistët gjermanë në vitin 1942. H. Pedersen, tashmë i plakur, nuk merrej më prej kohësh me gjuhën shqipe. Disa studiues të tjerë të shqipes në vende të tjera të Evropës nuk kishin as kushtet e nevojshme. as përgatitjen e duhur për të ndërmarrë studime të gjera nga fusha e historisë së gjuhës shqipe. Kjo zbrazëti e krijuar në këtë fushë studimesh duhej mbushur dhe vendi ku mund të bëheshin përpjekje të suksesshme për këtë qëllim, ishte Shqi-

1) Me gjithë moshën e thyer, ai bashkëpunoi me Çabejn për hartimin e dy monografive mbi parashtesat dhe prapashtesat e gjuhës shqipe, ku vështrimi diakronik mplekset me vështrimin sinkronik.

2) K. Cipoja (1892-1952) ka botuar, ndër të tjera, dy vepra të rëndësishme të gramatikës së gjuhës shqipe: *Gramatika shqipe* (1949) dhe *Sintaksa* (1952).

## Eqrem Çabej

përia e çliruar, e cila, me gjithë problemet e mëdha që paraqiste kapërcimi i pasojave të luftës së pabarabartë, u tregua e gatshme për ta përballuar edhe këtë ndërmarrje të vështirë. Në këtë mënyrë, krahas thellimit të mëtejshëm të studimit sinkronik të shqipes, filloi në Shqipëri edhe studimi diakronik i kësaj gjuhe, i cili mori një hov të dukshëm gjatë këtyre dyzet e pesë vjetëve të fundit sidomos me punën e palodhur dhe të frytshme të E. Çabejt dhe të disa gjuhëtarëve të tjerë, që ecën në gjurmët e tij.

Studimet diakronike të shqipes gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit nuk janë konceptuar të shkëputura nga problemet e studimit sinkronik të kësaj gjuhe. Përkundrazi, ato janë konceptuar dhe trajtuar në mënyrë të tillë që të ndriçojnë më mirë edhe gjendjen e shqipes së sotme dhe të ndihmojnë kështu edhe për të përcaktuar sa më drejt normat e saj letrare, duke u mbështetur edhe në rrugën që ka ndjekur evolucioni i fakteve dhe i dukurive të kësaj gjuhe. Për më tepër, si në studimet e E. Çabejt ashtu edhe në ato të gjuhëtarëve të tjerë shqiptarë, gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit, sqarimi historik i dukurive gjuhësore të shqipes sa herë paraqitet rasti, është vëzhguar edhe në përjasje me dukuritë e ngjashme të gjuhëve të tjera, sidomos të gjuhëve ballkanike. Në këtë mënyrë arritet e gjuhësisë së re shqiptare kanë bërë të mundur edhe zhvillimin e mëtejshëm të një bashkëpunimi shkencor të frytshëm midis studiuesve shqiptarë dhe albanologëve, ballkanologëve dhe indoevropianistëve në vende të ndryshme të botës. E në këtë pikë Çabej ka luajtur te ne një rol prej pionieri.

27. Me interes është edhe rruga (metoda) e ndjekur nga Çabej në studimet e tij diakronike. Si në studimet etimologjike ashtu edhe në ato për fonetikën, gramatikën dhe dialektologjinë historike, ai është mbështetur në parimin që, duke u nisur nga faza e dokumentuar e shqipes dhe duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e mundshme, të ngjitemi shkallë-shkallë në fazat më të hershme të saj. Pra, baza e metodës së tij hulumtuese është krahasimi i brendshëm, duke u nisur nga e njohura për të zbuluar të panjohurën. Për t'ia arritur sa më mirë këtij qëllimi, ai është mbështetur edhe në krahasimin me gjuhët e tjera indoevropiane, por krahasimin e jashtëm ai e ka shfrytëzuar si një mjet plotësues. Gjithashtu në shqyrtimin historik të fjalëve ose të dukurive të shqipes ai ka marrë në vështirim

## Eqrem Çabej

edhe përhapjen e tyre gjeografike: a kanë qenë, përkatësisht a janë të mbarë shqipes, apo kanë pasur, përkatësisht kanë një shtrirje të kufizuar dialektore apo nëndialektore? Një tjetër veçori e metodës së tij hulumtuese, sidomos në studimet etimologjike, ka qenë zbatimi me sukses i parimit të shkollës «Fjalët dhe sendet»<sup>1</sup>, që ishte zbatuar edhe nga mësuesi i tij i shquar N. Jokli. Zbatimi i kësaj metode shkencore në mënyrë krijuese i ka dhënë mundësi Çabejt që të mënjanojë disa nga gabimet, ku kishin rënë ca studiues të mëparshëm të gjuhës shqipe.

Duke qenë se në këtë rast kemi të bëjmë me rrugën e ndjekur nga gjuhëtari ynë sidomos në fushën e studimeve etimologjike, ku ai ka punuar gjatë tërë jetës dhe ka pasur arritjet më të mëdha të veprimtarisë së tij shkencore, po ndalemi edhe pak në këtë çështje. Përsa i takon rrugës së ndjekur për realizimin e synimeve të tij në studimet etimologjike, ai është nisur nga parimi që «objekti i një dije përcakton deri diku edhe metodën që do të ndiqet».<sup>2</sup> Për rastin konkret ai pohon shkoqur: «Në kundërshtim me shumicën e etimologëve të gjertanishëm, me ndonjë përjashtim të rrallë si Norbert Jokli<sup>3</sup>, në studimin etimologjik të leksikut të shqipes nuk nisemi nga jashtë e të hyjmë brenda, nga rrethanat e gjuhëve të tjera të depërtojmë në problemet e kësaj gjuhe; po nisemi konsekuentisht e në mënyrë të vetëdijshme nga brenda e dalim jashtë, shqyrtojmë gjendjen e brendshme të shqipes, e kalojmë në krahasime përtej caqeve të saj. Krah më krah me këtë përpiqemi që të nisemi prej fakteve konkrete të gjuhës e mbi dëshmitë e këtyre të formojmë mendimet edhe tezat, e jo anasjelltas. Përveç kësaj, e në plotësim të kësaj metode pune, ndiqet zhvillimi i fjalës në hapësirë e në kohë, me zbatim — brenda caqeve të mundësisë — të parimit matematik të kalimit prej së njohurës në të panjohurën, duke u ngjitur pra nga gjendja

---

1) Një drejtim kërkimor në fushën e onomastikës, themeluar në fillim të shek. XX nga R. Meringer (R. Meringer) dhe H. Shuhard (H. Schuchardt). Sipas kësaj shkollë gjuhësore, duhen pasur parasysh lidhjet e ndërsjella midis sendeve dhe fjalëve përkatëse.

2) Shih: E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, 33.

3) Në *LKU 2 (Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*. Berlin und Leipzig 1923).

## Egrem Çabej

e tanishme shkallë-shkallë në të kaluarën e saj.<sup>1</sup> Dhe pasi shton se në një hulumtim të tillë janë pasur parasysh edhe të dhënat e fonetikës e të morfologjisë historike të shqipes si edhe «disa faktorë të tjerë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë» (shih § 29-30), autori vë në dukje se «me gjithë rrahjen e disa rrugeve të reja në këtë truall, mundësitë për të depërtuar në historinë e fjalëve e gjer në burim të tyre kanë kufijtë e vet. Si në të tjera gjuhë, edhe në shqipen ka fjalë që sqarohen gjer në njëtarë shkalle të zhvillimit, po që përtej kësaj mbeten dora-dorës të errëta».<sup>2</sup>

28. Për t'ia arritur këtij synimi të shumanshëm, Çabej krahas përgatitjes së tij të vazhdueshme teorike, iu përvesh një pune të madhe shumëvjeçare për vjeljen sistematike të fjalëve dhe shprehjeve të gjuhës shqipe jo vetëm nga fjalorët e kësaj gjuhe por edhe nga burime të drejtpërdrejta, siç janë, ndër të tjera, veprat e autorëve të vjetër shqiptarë dhe arbëreshë, botimet me materiale dialektore nga arbëreshët e Greqisë, të Italisë dhe të ngulimeve të tjera të vjetra shqiptare jashtë Atdheut, si edhe nga krahina të ndryshme të Shqipërisë. Për më tepër, ai interesohej vazhdimisht të qëmtonte e të mblidhte edhe vetë lëndë leksikore nëpërmjet kontakteve vetjake me individë të shtresave të ndryshme nga të katër anët e vendit dhe nga arbëreshët e Italisë.<sup>3</sup> Dhe interesimi ishte i shumanshëm: për trajtën fonetike, për anën morfologjike, sidomos për anën kuptimore të fjalës dhe për fushën e përdorimit konkret të saj në të folme të ndryshme të shqipes. Jashtë vëmendjes së tij nuk mbeteshin asnjëherë as fjalët onomatopeike, pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe emrat e përveçëm të vendeve dhe të njerëzve. Ai i kushtonte një vëmendje të posaçme edhe anës sociologjike të fjalës (shih § 30). Me fjalë të tjera, interesohej për gjithçka që mund t'i hynte në punë për të njohur sa më mirë jetën e gjallë të fjalëve dhe historinë e tyre në kohë dhe në vise të ndryshme, ku flitej gjuha shqipe.

29. Për të mos e ngarkuar jashtë mase këtë kapitull, do të ndalemi këtu vetëm në nja dy nga këto burime, që janë shfrytëzuar me dobi nga Çabej në studimet e tij etimologjike: shfrytëzimi i onomastikës dhe i anës «sociologjike» të fjalëve. Përsa

1) Shih E. Çabej, *vep. e cit.*, 47.

2) Shih *Po ai, po aty*, f. 47.

3) Të kihet parasysh edhe disertacioni i vitit 1933 (shih § 5).

## Eqrem Çabej

i takon onomastikës, ai ka vënë në dukje se në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në gjuhët e tjera, një pjesë e pasurisë leksikore të zhdukur është ruajtur «në disa emra visesh e personash, pjesërisht gjer më sot, pjesërisht për kohët e kaluara nëpërmjet dokumentimit historik. Në këtë mënyrë materiali onomastik përbën në njëfarë vështrimi një pjesë të pashkruar e me këtë edhe një pasurim të leksikut, me rëndësi dyfishe për një gjuhë me shkrim relativisht të vonë, siç është shqipja...»<sup>1</sup> Dhe, në mbështetje të këtij mendimi ai përmend shumë emra vendesh dhe personash, ku janë ruajtur fjalë të vjetra që janë zhdukur nga leksiku i përgjithshëm i gjuhës shqipe. P.sh., te toponimet *Qafa e Agrit, Snpinagër, Shpiragër*, sipas tij, ruhet fjala e vjetër agër «gomar» që ndeshet te Buzuku. Po kështu toponimet *Kudhër, Lëkurës, Lopës, Mashtërkorë*, përmbajnë emra zejtarësh të dikurshëm. Edhe në toponime të tilla, si: *Frakull, Groflat, Këshqel, Shutrrija, Val, Vü, Vinjull*<sup>2</sup> etj. «shfaqen mbeturina (relike) elementesh latine të shqipes, elemente që nuk rrojnë thujse aspak më si apelativa».

30. Përsa i takon anës sociologjike të fjalës, ai vë në dukje: «Një aspekt qenësor në kërkimin etimologjik përbën mjedisin i formimit të fjalës, prane gjeografisë, pra «sociologjia» e saj. Dihet se shumë fjalë në tulum nuk kanë qenë të mbarë gjuhës, po të një shtrese a sferë të kufizuar, disa i përkasin një mjeshtrie të caktuar, një dege të veçantë të veprimtarisë njerëzore. Kështu, bie fjala, *stërvit*, sot me kuptim «ushtror», fjalë e mbarë gjuhës, sipas fjalorit të Kristoforidhit (f. 319), është përdorur në Myzeqe kryesisht për disa katshë shtëpiake kur bëhen motake (vit) e ushtrohen për një punë të caktuar, *stërvit mëzin, stërvit zagarin. Almise e pluar* janë fjalë detare, të cilat në kushtet e veçanta të vendit kaluan në sferën e bujqësisë, e një specializim në këtë drejtim duket se ka ngjarë edhe me *parmendën*...»<sup>4</sup>

Më tej ai shton se «në lidhje me sociologjinë e fjalëve, e rëndësishme për formimin e tyre është edhe fusha e pasur e

1) Shih: «Studime etimologjike», I, f. 98.

2) Në këta emra pasqyrohen fjalët latine *Oraculum, crupta, castellum, subterraneum, vallis, villa, vinealis* etj. (shih vep. cit., f. 98).

3) Shih po ai, po aty, f. 98.

4) Po ai, po aty, 51 V. Këtu ai përmend edhe mjaft fjalë të tjera të këtij tipi.



eufemizme dhe e fjalëve tabu». Dhe këtu ai jep një varg shembujsh si *bukla* (e bukura e dheut), *gojëlidhuni*, *gojëfarkuti*, *gojëmsheluni*, e *veshcurri* për *ujkun*, *përdhesi*, *dheutokësi*, *tokësi* e *përtokësi* e *përtokët* për *gjarprin*, *mjalcë*, *mizare*, *mizë* *mjalti* për *bletën* etj., etj.<sup>1</sup> Ai ka vënë në dukje edhe raste të tjera të lindjes së fjalëve të reja nëpërmjet përdorimit të figurshëm të fjalëve ekzistuese, që me kohë kanë zënë vend të qëndrueshëm në gjuhë, si p.sh., *vetull mali*, *faqe mali*, *qafë mali*, *grykë mali*, *grykë deti*, *shpatull mali*, *rrëzë mali*<sup>2</sup> etj.

31. Në metodën e zbatuar nga ky dijetar në studimet e tij të ndryshme bie në sy edhe përpjekja e tij e vazhdueshme për të qenë sa më objektiv në interpretimin e fakteve të shqyrtuara d.m.th. për t'i interpretuar ato ashtu siç janë dhe jo ashtu siç do të na pëlqente të ishin. Duke zbatuar drejt këtë parim, ai nuk ka ngurruar, p.sh., që të pranojë burimin e huaj të një fjale a të një dukurie gjuhësore të shqipes, edhe kur gjuhëtarë të tjerë më parë kanë shprehur një mendim të ndryshëm. Nga ana tjetër, ai nuk është pajtuar me disa mendime të gjuhëtarëve të mëparshëm, kur vetë shqyrtimi i fakteve nuk i përlligjte ato mendime.<sup>3</sup>

32. Duke zbatuar një metodë rreptësisht shkencore në hulumtimet dhe studimet e tij, ky dijetar i talentuar, i frymëzuar nga dëshira për të dhënë sa më shumë ndihmësa për zhvillimin e shpejtë të shkencës së re shqiptare, arriti që brenda pesë dhjetëvjeçarësh (sidomos gjatë viteve 1950-1980) të hartonte e të botonte një numër të madh veprash shkencore, artikujsh shkencorë dhe kumtesash në fusha të ndryshme të dijes: në gjuhësinë historike dhe përshkruese të shqipes, në ballkanistikë, dialektologji, folklor, letërsi etj. Ai pati edhe kënaqësinë e madhe që shumicën dërrmuese të shkrimeve të veta i pa të botuara (shpeshherë edhe të ribotuar) brenda dhe jashtë Shqipërisë.<sup>4</sup>

33. Kryet e vendit në prodhimtarinë e tij shkencore e

1) *Po ai, po aty*, 52 V.

2) Shih *po ai, po aty*, 60.

3) Shih p.sh. III/6.

4) Për listën e plotë të botimeve dhe të ribotimeve të veprave dhe të artikujve të E. Çabejt, brenda dhe jashtë Shqipërisë, shih Jup Kastrati, *Bibliografia e punimeve të prof. Eqrem Çabejt (1929-1981)*, në *SE* 3/1981/219-252.

## Eqrem Çabej

zënë *Studimet etimologjike në fushë të shqipes*. Në këto studime ai ka synuar të shpjegojë burimin e një numri të përzgjedhur fjalësh të shqipes, që e ka parë më të nevojshme t'i marrë ose t'i rimarrë në shqyrtim. Një pjesë të këtyre studimeve etimologjike ai arriti t'u jepte formën përfundimtare dhe t'i botonte në revista shkencore.<sup>1</sup> Por vdekja e parakohshme nuk e lejoi që t'u jepte dorën e fundit të gjithave dhe t'i shihte të botuara në vëllime më vete.<sup>2</sup> Siç do të shtjellohet në III/15, në këto studime ai ka dhënë mjaft ndihmesa të rëndësishme lidhur me burimin e një numri të madh fjalësh të gjuhës shqipe, të patrajuara ose të interpretuara ndryshe nga gjuhëtarë të tjerë para tij.

34. Një tjetër temë, që ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e këtij gjuhëtari, ka qenë ajo e prejardhjes së gjuhës shqipe, së cilës ai i është kthyer disa herë me plotësime argumentesh (shih kreun II). Arsyeja e një interesimi të tillë për këtë çështje duhet kërkuar në faktin e njohur që çështja e burimit të gjuhës shqipe, sidomos gjatë shekullit XX, ka ngjallur diskutime të shumta. Siç do të shtjellohet më gjerë në kreun II, ndërsa për dijetarët e mëparshëm prejardhja e shqipes nga ilirishtja ishte një gjë e vetëkuptueshme, qysh nga fundi i shekullit të kaluar dhe sidomos gjatë shekullit tërë disa gjuhëtarë e kanë kundërshtuar këtë mendim dhe kanë mbrojtur hipotezat, sipas të cilave shqipja është hijë e trakishtes, apo e së ashtuquajturës dakomizishtes etj. Çabej në artikujt dhe kumtesat e tij me argumente gjuhësore, historike-gjeografike etj. i ka kundërshtuar ato hipoteza dhe ka mbrojtur tezën e burimit ilir të shqipes. Dhe mund të pohohet se nëpërmjet ndihmesave të tij kjo tezë ka gjetur tashmë përkrahje në një numër gjithnjë e më të madh studiuesish të huaj.

35. Ndihmesa të rëndësishme ka dhënë Çabej edhe në fu-

---

1) Ato janë botuar në revistën *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore*, nga nr. 4 i vitit 1960 deri në nr. 4 të vitit 1964 dhe më pas në revistën *Studime filologjike* nga 1/1965 deri në 3/1968. Ato janë botuar në Prishtinë në vëll. I dhe II (1967) të *Studime gjuhësore* të këtij autori.

2) Ai arriti t'u jepte dorën e fundit vëllimit I (Hyrje) dhe vëll. II (shkronjat A-B) dhe III (shkronjat C-D), që janë botuar përkatësisht më 1982, 1976 dhe 1987. Është parashikuar të botohen edhe katër vëllime të tjera, nga të cilat i katërti (shkronjat E-F) është në shtyp.

shën e fonetikës dhe të gramatikës historike të shqipes. Nga fonetika historike ai në tekstin për shkollat e larta<sup>1</sup> dhe në studime e artikuj të ndryshëm, të botuar brenda dhe jashtë vendit, ka trajtuar çështje të rëndësishme të evolucionit të sistemit fonetik të gjuhës shqipe, siç janë, ndër të tjera: *Mbi disa rregulla të fonetikës historike të shqipes*,<sup>2</sup> *Disa aspekte të fonetikës historike të shqipes në dritën e gjuhës së Gjon Buzukut*,<sup>3</sup> *Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe*,<sup>4</sup> *Trajtimi i zanoreve initiale te Gjon Buzuku*,<sup>5</sup> *Diftongje dhe grupe zanoresh të shqipes*,<sup>6</sup> *Për historinë e konsonantizmit në gjuhën shqipe*,<sup>7</sup> *Disa mendime mbi nazalizmin e shqipes*<sup>8</sup> etj. Këto studime janë ribotuar më 1988 në një vëllim më vete nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, me titullin: E. Çabej, *Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe*. Për ndihmesat e tij kryesore në fushën e fonetikës historike të shqipes do të bëhet fjalë në kreun IV të këtij libri.

E. Çabej është marrë edhe me disa çështje të rëndësishme nga fusha e gramatikës historike të shqipes, siç janë: *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*,<sup>9</sup> *problemi i nyjave të shqipes*,<sup>10</sup> *çështja e gjinisë asnjane*<sup>11</sup> etj. Edhe për ndihmesat e tij në fushën e gramatikës historike të shqipes do të bëhet fjalë në kreun IV të këtij libri.

36. Si studiues i evolucionit historik të gjuhës shqipe Çabej nuk mund të mos i kushtonte një vëmendje të posacme hulumtimit dhe studimit të dialekteve të kësaj gjuhe. Në mënyrë të vecantë atë e kanë tërhequr ato të folme të shqipes që ruajnë më shumë elemente arkaike, siç janë, p.sh., të folmet e

1) Ky tekst është ribotuar disa herë në Tiranë në formë dispense. Përshtë ribotuar si libër në Prishtinë më 1970.

2) Shih SF 2/1970.

3) Shih BSH i Institutit Pedagogjik të Shkodrës, 1/1971.

4) Shih BSHSH 1/1956.

5) Shih BUSHT, SSSH 1 /1957.

6) Shih BUSHT, SSSH 3/1958.

7) Shih BUSHT, SSSH 1/1958.

8) Shih *Gjurmime albanologjike* (Prishtinë), 1/1977, (1978).

9) Tiranë, 1967.

10) Shih sidomos artikullin *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BSHSH 3.1963. 69-101.

11) Shih kreun IV.

arbëreshëve të Italisë. Madje, siç u vu në dukje në § 5, edhe tema e disertacionit të tij të mbrojtur në Universitetin e Vjenës mban titullin *Studime italo-shqiptare*. Të dhëna nga dialektet e shqipes gjejmë pothuaj në të gjitha studimet e tij gjuhësore. Por ai ka botuar edhe artikuj me karakter thjesht dialektologjik, si *Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë*<sup>1</sup>, *Nga leksiku i dialekteve arbëreshe të Kalabrisë*<sup>2</sup> etj. Për ndihmesat e tij në fushën e dialektologjisë shih kreun V.

37. Duke qenë se studimet diakronike në fushë të shqipes nuk mund të mendohen pa njohur mirë autorët e vjetër, veprat e të cilëve ruajnë edhe mjaft elemente gjuhërore arkaike, ishte e natyrshme që Çabej gjatë veprimtarisë së tij shkencore t'i kushtonte një vëmendje të veçantë edhe njohjes dhe studimit të atyre autorëve. Një punë të madhe bëri ai sidomos për studimin e gjuhës së Gjon Buzikut, veprën e të cilit edhe e ribotoi të transliteruar dhe të transkribuar. Veç kësaj, ai ka botuar edhe artikuj studimorë mbi gjuhën e autorëve të vjetër shqiptarë dhe arbëreshë. Nga këta duhen përmendur sidomos: *Hyrja e gjatë në pjesën e parë të veprës «Meshari i Gjon Buzikut I»*<sup>3</sup>, *Gjon Buzuku, një studim i shumanshëm historiko-gjuhësor*<sup>4</sup>, *Tekstet e vjetra shqipe dhe disa kritere rreth botimit të tyre*<sup>5</sup>, *Pjetër Budi dhe gjuha e tij*<sup>6</sup> etj.

Në këto studime, ku bëhet një analizë e hollësishme e gjuhës së autorëve tanë të vjetër, ka edhe mjaft ndihmesa me vlerë, për të cilat do të flitet në kreun VI të këtij libri.

38. Në përgjithësi Çabej njihet si një gjuhëtar që është marrë me probleme të historisë së gjuhës shqipe dhe si rrjedhim nga një masë e gjerë pak njihet puna e tij për shqipen, e sotme letrare. Por, po të shihet nga afër veprimtaria e tij

1) Botuar në SF 1975/2 dhe ribotuar në vëllimin E. Çabej, *Në botën e arbëreshëve të Italisë* të shtëpisë botuese «8 Nëntori», Tiranë, 1987.

2) Botuar së pari gjermanisht në «Serta romanica», *Festschrift für Gerhard Rohlfz zum 75. Geburtstag*, Tübingen, 1968, dhe ribotuar në vëll. *Në botën e arbëreshëve të Italisë*.

3) Tiranë, 1968.

4) Botuar në SF 1955, nr. 1, 2, 3, 4.

5) Botuar në BUSHT, SSHSH 2/1959.

6) Botuar në BUSHT, SSHSH 4/1966.

## Eqrem Çabej

shkencore, sidomos në periudhën e dytë, bie në sy se ai është interesuar dhe ka punuar mjaft edhe për gjuhën e sotme letrare. Për këtë do të bëhet fjalë më gjerë në kreun VII të këtij libri. Prandaj këtu do të përmendim shkurt vetëm disa nga artikujt dhe kumtesat e tij për këtë çështje. siç janë, ndër të tjera: *Mbi disa çështje të shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes*,<sup>1</sup> kumtesë e mbajtur në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*<sup>2</sup> etj.

Në këta artikuj, sidomos në të dytin, ai vë në dukje edhe nevojën për pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja të panevojshme dhe jep edhe shembuj konkretë për këtë gjë (shih VII/5-6). Gjithashtu ai ka marrë pjesë gjallërisht edhe në 13 komisione për hartimin e terminologjisë së shkencave dhe disiplinave të ndryshme dhe pikërisht për hartimin e fjalorëve të terminologjisë për botanikën, matematikën dhe mekanikën teorike, energjinë atomike, termodinamikën, optikën, akustikën, elektromagnetizmin, mekanikën, elektroteknikën, kiminë, gjeologjinë, arkitekturën dhe gjuhësinë, si dhe në komisionet për hartimin e *Udhëzuesve drejtshkrimorë* të viteve 1949, 1951, 1953 dhe 1956 dhe të *Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*, që u miratua në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe të vitit 1972.

39. Edhe në periudhën e dytë të veprimtarisë së tij shkencore, ashtu si në periudhën e parë (shih § 18). Çabej nuk e ndërpreu interesimin e tij për folklorin dhe letërsinë. Interesimi i tij për folklorin ishte i lidhur edhe me faktin se në krijimet popullore ai gjente edhe elemente gjuhësore arkaike, që i hyjnë në punë sidomos për studimet e tij diakronike.

Por, duke qenë se kohën më të madhe duhej t'ua kushtonte studimeve gjuhësore, në periudhën e dytë të veprimtarisë së tij shkencore ai ka botuar më pak shkrime për folklorin sesa në periudhën e parë (shih VIII/2-10).

Nga shkrimet e tij të kësaj periudhe duhen përmendur: *Poezia popullore e arbëreshëve të Italisë*,<sup>3</sup> *Disa figura të besimeve popullore shqiptare*<sup>4</sup> etj.

1) Shih SF 1/1973.

2) Botuar së pari në gazetën *Mësuesi* më 28.3. dhe 4.4.1979 dhe ribotuar në revistën *Gjuha jonë*, 1/1981.

3) Botuar në revistën «Arsimi popullor» 10/1961 dhe ribotuar në vëllimin *Në botën e arbëreshëve të Italisë*.

4) Botuar në revistën «Gjurmime albanologjike», 2/1972.

## Eqrem Çabej

Për mendimet dhe ndihmesat e tij në fushën e folklorit do të bëhet fjalë në kreun VIII, ku do të trajtohen edhe shkrimet e tij për letërsinë. Edhe me probleme të letërsisë Çabej ka pasur rast të merret më shumë në periudhën e parë të veprimtarisë së tij (shih § 6). Nga shkrimet për letërsinë gjatë periudhës së dytë mund të përmenden: *Vatra dhe bota në poezinë e De Radës*,<sup>1</sup> *Fan Noli ynë*<sup>2</sup> dhe *Disa burra të shquar të arbëreshëve të Italisë*<sup>3</sup>, ku bëhet fjalë edhe për poetin Nikollë Keta.

40. Ndihmesa të rëndësishme ka dhënë Çabej edhe me kumtesa, referate dhe diskutime nëpër konferenca dhe kongrese shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë. Këtu po përmendim kumtesat e tij kryesore në këto veprimtari kombëtare dhe ndër-kombëtare.

Nga pjesëmarrja e tij në konferencat dhe kongreset e mbajtura brenda vendit duhen përmendur:

1. *Detyrat e gjuhësisë shqiptare në lidhje me gjuhën letrare kombëtare e probleme të tjera*, diskutim i mbajtur në *Sesionin e dytë shkencor për vitin 1952 të Seksionit të gjuhës e të letërsisë*.<sup>4</sup>

2. *Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe*, kumtesë e mbajtur në *Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike më 1962*.<sup>5</sup>

3. *Ilirishtja dhe shqipja*, kumtesë e mbajtur në *sesionin shkencor Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve*, Tiranë, 1969.<sup>6</sup>

4. *Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe*, kumtesë e mbajtur në *Kuvendin e Parë të Studimeve Ilire*, Tiranë, 1972.<sup>7</sup>

5. *Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejt-*

---

1) Botuar në vëllimin *J. de Rada*, Tiranë, 1965, dhe ribotuar në librin: *Në botën e arbëreshëve të Italisë*.

2) Botuar në revistën «*Nëntori*», 4/1965.

3) Botuar në «*Revista pedagogjike*» 4/1974 dhe ribotuar në librin *Në botën e arbëreshëve të Italisë*.

4) Shih BSHSH 4/1952, 114-119.

5) Shih BUSHT, SSHSH 4/1962/117-139.

6) Shih, *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve*, vëll. III (Tiranë, 1969), f. 41-52.

7) Shih *SH Studime historike* 4/1972/3-27.

## Eqrem Çabej

shkrimit të gjuhës shqipe, kumtesë e mbajtur në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1972.<sup>1</sup>

41. Nga kumtesat e mbajtura nëpër konferenca ndërkombëtare po shënojmë vetëm disa, si:

1. *Die älteren Wohnsitze der Albaner auf der Balkanhalbinsel im Lichte der Sprache und der Ortsnamen (Vendbanimet e hershme të shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës dhe të emrave të vendeve)*, kumtesë e mbajtur në VIII Congresso Internazionale di Scienze Onomastiche.<sup>2</sup>

2. *Der Beitrag des Albanischen zum Balkansprachbund* (Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike), referat i mbajtur në Kongresin I Ndërkombëtar të Studimeve Ballkanike dhe të Evropës Juglindore, Sofje, 1966.<sup>3</sup>

3. *Das albanologische Werk Norbert Jokls*. (Vepra albanologjike e Norbert Joklit), referat i mbajtur në Kolokiumin Albanologjik Ndërkombëtar të Innsbrukt më 1972<sup>4</sup> etj.

42. Gjatë veprimtarisë së tij shkencore aq të frytshme Çabej ka botuar edhe një numër të madh artikujsh dhe studimesh në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja. Artikujt dhe studimet në gjuhën shqipe i ka botuar nëpër revistat shkencore të Shqipërisë dhe të Kosovës. Ai ka botuar artikuj me karakter shkencor edhe nëpër revista kulturore dhe gazeta të Shqipërisë dhe të Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi në gjuhën shqipe. Pasqyrimi i gjithë kësaj veprimtarie botuese këtu do të zinte shumë vend. Prandaj të interesuarit mund të shikojnë për të gjitha këto *Bibliografinë e punimeve* të prof. Eqrem Çabejt të botuar nga *Jup Kastrati* në SF 3/1981/219-254.

43. Çabej ka botuar një numër të madh artikujsh shkencorë edhe në gjuhë të huaja nëpër revista ose nëpër vëllime përkujtimore në vende të ndryshme të botës. Këtu po përmendim artikujt kryesorë (pa recensionet përkatëse) sipas vendeve ku janë botuar, duke i renditur sipas alfabetit.

1) Shih SF 1/1973/97-108, si edhe vëllimin *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*, Tiranë 1973, vëll. I, f. 247-264.

2) Shih VIII Congresso Internazionale di Scienze Onomastiche, Firenze-Pisa, 4-8 aprile 1961, I, f. 241-251.

3) Shih *Actes du Premier Congrès International des Etudes Balcaniques et Sud-Est-Européennes*, VI (Linguistique), Sofia, 1968, f. 41-54.

4) Shih *Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972* (Innsbruck, 1977), f. 3-21.

## Eqrem Çabej

### Austri

*Mundartliches aus Italien (Elemente dialektore nga Italia)* «Glotta», XXV, 50-57 (1936).

*Gestalten des albanischen Volksglauben (Disa figura të besimeve popullore shqiptare)*. «Studien zur Sprachwissenschaft und Kulturkunde», Innsbruck, 1968.

*Heimische Elemente in der Gebirglandschaft betreffenden Nomenklatur (Elemente vendëse në terminologjinë gjeografike malore të shqipes)*. 10. Internationaler Kongress für Namenforschung (8-13/9/1969). 187-216 (Wien 1971).

*Das albanologische Werk Norbert Jokls* 3-32. Innsbruck 1977.

*Das Albanische und seine Nachbarsprachen (Shqipja dhe gjuhët fqinje të saj)*, «Die Sprache», Band XIII, Heft 1, 39-51 Wien 1967.

*Über einige Lautregeln des Albanischen (Mbi disa rregulla fonetike të shqipes)*. «Die Sprache», Wien, 1972. XVIII. Band, 2 Heft, 132-154.

### Francë

*Die Herkunftsfrage der albanischen Kolonien in Italien im Lichte vornehmlich der Sprache und der Eigennamen. Çështja e prejardhjes së ngulimeve arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetjakë*). Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences, Paris, 1966. f. 70-81.

### Greqi

*Der Name Alexander in der albanischen Volkssprache (Emri Aleksandër në shqipen popullore)*. Megas Alexandros. Thessaloniqi, 1980, f. 157-159.

### Gjermani

*Die albanische Volksdichtung (Poezia popullore shqiptare)*, «Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa» III (1939), 194-213.

*Volkstum und Volksname der Albaner (Populli dhe emri i shqiptarëve)*. Po aty, IV (1940), 78-95.

*Kult und Fortleben der Göttin Diana auf dem Balkan (Kulti dhe vijimi i hyjneshës Diana në Ballkan)*. Po aty, V(1941), 229-240.

*Über einige mit z anlautende Wörter des Albanischen (Mbi disa fjalë të shqipes që nisin me z)*. «Zeitschrift für Phonetik



## Eqrem Çabej

und allgemeine Sprachwissenschaft» Berlin. 9. Jahrgang (1956). Heft 3, 203-229.

*Ältere Stufen des Albanischen im Lichte der Nachbarsprachen (Disa faza më të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje).* «Zeitschrift für Balkanologie», vëll. II, 6-32, Wiesbaden 1964.

*Zur Geschichte der mundartlichen Struktur des Albanischen (Për historinë e strukturës dialektore të shqipes).* «Zeitschrift für mundartforschung», Beihefte, Neue Folge, Nr. 3 und 4, 136-145. Marburg, Wiesbaden, 1967.

*Zum Wortschatz der albanischen mundart in Kalabrien (Mbi leksikun e të folmeve arbëreshe të Kalabrisë).* «Serta Romanica», Tübingen, 1968, 115-124.

*Zur slavischen und albanischen Wortgeschichte (Për historinë e disa fjalëve të sllavishtes e të shqipes).* «Serta slavica in memoriam Aloisi Schmaus», München, 1971, 92-103.

### Itali

*Die älteren Wohnsitze der Albaner auf der Balkanhalbinsel im Lichte der Sprache und der Ortsnamen (Vendbanimet e hershme të shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik në dritën e gjuhës dhe të emrave të vendeve).* VII. Congresso Internazionale di Scienze Onomastiche. Firenze-Piza, 4-8 aprile 1961, I, 241-251.

*Di alcuni problemi fondamentali di storia antica della lingua albanese (Mbi disa probleme themelore të historisë së lashtë të gjuhës shqipe).* «Rassegna di studi albanesi», nr. 1, 155-177, Roma, 1963.

*Nochmals die Ringinschriften aus Nordalbanien (Edhe një herë mbi mbishkrimet e unazave të Shqipërisë Veriore).* «Studi Salentini», XIV, 337-340. Lecce, 1964.

*Su alcuni antichi elementi balcanici nell'Italia Meridionale e in Sicilia (Mbi disa elemente ballkanike në Italinë Jugore dhe në Sicili).* «Rendiconti dell'Istituto Lombardo di Scienze e Lettere», Classe di Lettere, Milano, 1965, vëll. 99, 214-220.

*Keltisch-albanische Isoglossen (Disa izoglosa kelto-shqiptare), Studi linguistici in onore di Vittore Pisani,* Brescia, vëll. I (1969). 167-186.

*Westöstliche Miscellen (Të ndryshme perëndimore dhe lindore).* Scritti in onore di Giuliano Bonfante, Brescia, f. 97-108.

*Gli italo-albanesi e le loro parlate (Arbëreshët dhe të folmet e tyre),* «Zjarri», VIII/1-2 (Roma, 1976), IX/1-2 (Roma, 1977).

Albanische Beiträge zur Kenntnis des lateinischen Wortschatzes. (Kontribute shqiptare për njohjen e thesarit gjuhësor latin), «Bollettino dell'Atlante Linguistico Mediterraneo», 13-15 (1971-1973), Firenze, 1976, 365-377.

Storia linguistica e struttura dialettale dell'albanese d'Italia, (Historia gjuhësore dhe struktura dialektore e arbërishtes së Italisë), «Problemi di morfosintassi dialettale», Atti del XI Convegno per gli Studi Dialettali Italiani, Cosenza 1-4 Aprile 1975, 1976.

#### Jugosllavi<sup>1</sup>

Život i običaji Arbanasa. Porodica i društveni, Knjiga o Balkanu, vëll. I, 303-319, Beograd, 1936. Izdanje Balkanskog Instituta (Përkthim serbokroatisht i artikullit Doke e zakone të shqiptarëve).

Rumänisch-albanische Lehnbeziehungen (Marrëdhëniet midis rumanishtes dhe shqipes). «Revue Internationale des études balkaniques», II, I-II (3-4), 172-184 (Beograd, 1936).

Parallele Ausdrücke und Redensarten in den Balkansprachen (Shprehje dhe frazeologji paralele në gjuhët ballkanike). Po aty, f. 226-231.

Albaner und Slaven in Südtalien (Shqiptarët dhe sllavët në Italinë Jugore), Po aty, III, II (6), 555-566, Beograd, 1938.

Miszellen (Të ndryshme). Po aty, 571-574.

#### Poloni

Alb. vise Orte Plütze und die singularisierten Plurale im Albanischen (Fjala vise dhe shumëset e singularizuara në shqipë), «Lingua Posnaniensis», viti, VII, vëll. II, 145-200 (Poznan, 1959), viti VIII, vëll. III, 71-132 (Poznan, 1960).

Ringinschriften aus Nordalbanien (Mbishkrime unazash të Shqipërisë së Veriut). «Lingua Posnaniensis», vëll. IX, 98-102 (Poznan, 1962).

#### Rumani

Rumänische und albanische Wortdeutungen (Shpjegime fjalësh rumune dhe shqipe), «Cercetări de lingvistică», suplement, f. 131-134 (Cluj, 1958).

Unele probleme ale istoriei limbii albaneze (Disa probleme të historisë së gjuhës shqipe), «Studii și cercetări lingvistice» viti X, nr. 4, 527-560. (București, 1959).

Crăciun (Rreth fjalës crăciun) «Studii și cercetări lingvistice», viti XII, nr. 3, 313-317. (București, 1961).

1) Këtu nuk janë përfshirë botimet e Kosovës (shih § 44).

## Eqrem Çabej

Zur Charakteristik der lateinischen Lehnwörter im Albanischen (*Mbi karakteristikat e huazimeve latine të shqipes*), «Revue de linguistique», viti VII, nr. 1, 161-199 (Bucarest, 1962).

Zur aromunischen Wortforschung, (*Studime mbi leksikun aromun*), «Studii și cercetări lingvistice», viti XXVII, nr. 1, 3-16 (București, 1976).

Rumänisch-albanische Wortparallelen (*Fjalë paralele në rumanishte dhe në shqipe*). «Revue roumaine de linguistique», viti XXI, nr. 1, 55-58 (Bucarest, 1976).

Das Alpenwort «malga» (*Fjala alpine «malga»*). «Studii și cercetări lingvistice», XXIX, 519-521 (București, 1978).

### Turqi

Zu einer chronologischen Schichtung der türkischen Lehnwörter im Albanischen. (*Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*). *Türk dili bilmsel kurultayına sunulan bildiriler 1972' den ayribasım*, 123-130, Ankara, 1975.

44. Veprimtaria shkencore e Çabejt ka pasur jehonë të madhe në Kosovë, ku përveç artikujve të shumtë të ribotuar nëpër revista të ndryshme<sup>1</sup>, është bërë një punë e mirë edhe me ribotimin e të gjitha shkrimeve të tij në disa vëllime. Deri sot janë botuar shtatë vëllime me titullin *Studime gjuhësore* dhe me këtë përmbajtje:

Vëll. I, II, (1976). *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, rishtypur sipas lëndës së botuar në revistat *BUSHT* dhe *SF* (shih III/3).

Vëll. III (1976) *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike*.<sup>2</sup> *Parashtesat e prapashtesat. Shumësi i singularizuar*, rishtypur sipas botimeve të Tiranës.

Vëll. IV (1977) *Nga historia e gjuhës shqipe*. Këtu janë përfshirë artikuj e studime të botuara para dhe (sidomos) pas vitit 1945.

Vëll. V. (1975). *Gjuhë-Folklor-Letërti-Diskutime*. Edhe

---

1) Këto në përgjithësi janë ribotime. Por ka edhe ndonjë artikull që është botuar atje për herë të parë. Është fjala për artikullin *Dy çështje gjuhësore*: 1. Disa mendime për nazalizmin e shqipes. 2. Gjerbës, «Gjurmime albanologjike — Seria shkencat filologjike», VII-1977, Prishtinë, 1978, 27-35.

2) Ky tekst mësimor (shih § 16) është ribotuar edhe në vitin 1970 në një vëllim më vete.

## Eqrem Çabej

këtu janë përfshirë artikuj, studime dhe diskutime të botuara para dhe (sidomos) pas vitit 1945.

Vëll. VI (1977) *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*. Këtu janë përfshirë studime dhe artikuj për Gjon Buzukun dhe veprën e tij.

Vëll. VII. *Hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indoevropiane. Studime etimologjike në fushë të shqipësisë* (Prishtinë, 1986). Pjesa e parë është një kurs leksionesh pasuniversitare që Çabej ka mbajtur në Prishtinë gjatë vitit shkollor 1971-1972, kurse pjesa e dytë është një ribotim i pjesës shqipe (*Hyrje*) të vëll. I të veprës *Studime etimologjike në fushë të shqipësisë* (Tiranë, 1982).

45. Edhe kjo pasqyrë e veprave dhe e artikujve shkencorë të Çabejt, të botuar në vende të ndryshme të botës, dëshmon qartë për interesimin e madh që ka ngjallur veprimtaria shkencore e këtij gjuhëtari të shquar edhe jashtë Shqipërisë. Ky interesim do të dilte edhe më i plotë, po të përmendeshin këtu edhe recensionet e shumta që kanë botuar studiues të huaj për studimet e tij në organe të ndryshme shtypi shkencor të Austrisë, Gjermanisë, Rumanisë, Italisë, Francës, Polonisë etj.<sup>1</sup>

Për interesimin e madh që ka ngjallur në botën e jashtme vepra shkencore e E. Çabejt, dëshmon edhe letërkëmbimi shumë i gjerë që ka pasur ai me një numër të madh gjuhëtarësh të huaj, nga të cilët mjafton të përmendim disa nga më të shquarit, si: H. Pedersen, Paul Krecmeri, Norbert Jokli, Karl Paci, Maksimilian Lamberci, Aleksandër Grauri, Aleksandër Roseti, Vladimir Georgievi, Vaklav Cimohovski, Haralambie Mihëjesku etj., etj.

46. Si del edhe nga sa u parashtrua përmbledhtas në paragrafët e mëparshëm, veprimtaria shkencore e Çabejt gjatë një gjysmë shekulli, ka shënuar një rritje të vazhdueshme si në gjerësi edhe në thellësi. Ai u është futur me guxim, në radhë të parë, problemeve të shumta dhe të vështira, që paraqit evolucionin historik i sistemit të gjuhës shqipe në shumanshmërinë e tij — fjalor e fjalëformim, fonetikë e strukturë gramatikore — duke dhënë kudo ndihmesa të shumta

---

1) Për këto shih *Bibliografinë* e cituar të Jup Kastratit në SF 3/1981. Në atë *Bibliografi* janë pasqyruar edhe recensionet e këtij gjuhëtari për vepra dhe studime shkencëtarësh të ndryshëm (vendës dhe të huaj).

dhe të qëndrueshme, për të cilat do të bëhet fjalë në kapitujt II-VII të këtij libri. Në këtë mënyrë ai e përdhri gjuhësinë shqiptare edhe në një fushë studimesh, ku ajo më parë vetëm sa kishte hedhur ndonjë hap të druajtur (shih § 22). Me punën e tij të palodhur Çabej ia arriti të vërtetonte se gjuhëtarët shqiptarë janë në gjendje t'i zbulojnë dhe t'i shpjegojnë ligjësitë e evolucionit historik të gjuhës amtare me një përpikëri po aq të madhe sa edhe albanologët e huaj me emër, kur zbatojnë metoda shkencore të nivelit evropian bashkëkohor. E një nga meritat kryesore të Çabejt është pikërisht zbatimi i një metodologjie moderne në këtë fushë studimesh. Këtë gjë e vuri në dukje qysh në vitin 1938 indoevropianisti dhe albanologu i mirënjohur danez H. Pedersen, i cili në një letër të 3 korrikut të atij viti i shkruante Çabejt, ndër të tjera: «Është shumë e gëzueshme që tashti (pa dyshim për të parën herë) një shqiptar i lindur po e trajton gjuhën dhe historinë e popullit të vet me zotërim të plotë të metodave të zhvilluara në Evropën Perëndimore.»<sup>1</sup>

47. Zbatimi krijues i metodave bashkëkohore i dha dorë këtij gjuhëtari të talentuar dhe të palodhur që, duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara pas vitit 1945 në Shqipëri, të arrinte suksese gjithnjë e më të mëdha si në fushat e lartpërmendura ashtu edhe në fusha të tjera, si p.sh. në çështjen e prejardhjes së gjuhës shqipe, në tekstologji (me botimin e veprës së Buzukut), në dialektologji, në folklor, madje edhe në fushën e studimeve për gjuhën letrare shqipe.

Me këtë punë themelvënëse të Çabejt dhe me ndihmesat e gjuhëtarëve të tjerë shqiptarë që ndoqën shembullin e tij, gjuhësia e re shqiptare filloi të thoshte fjalën e saj me peshë edhe në një fushë studimesh, ndaj së cilës më parë ajo kishte mbajtur një qëndrim të druajtur, duke mos guxuar të përballonte probleme, që në radhë të parë, i takonin asaj. Dhe këtë ishte i vetëdijshëm dhe mirënjohës edhe E. Çabej, i cili

---

1) Siç del nga letërkëmbimi midis tyre, Pedersen kishte pasur raste ta ndiqte veprimtarinë e E. Çabejt; madje ky, qysh kur ishte ende student, i kishte dhënë Pedersenit shpjegimin e drejtë të shprehjes çame *shklata* në një nga përrallat e botuara prej tij më 1895. Dhe në një letër të 23 janarit 1932 Pedersen i shkruante Çabejt: «...Shumë faleminderit për kumtimin tuaj lidhur me *shklata*, prej çkle ata. Ju sigurisht keni plotësisht të drejtë».

fundit, edhe në studimin e historisë së gjuhës shqipe, ashtu si në studimin e shqipes së sotme, ndihmesat e gjuhësisë së re shqiptare kanë ardhur duke luajtur një rol gjithnjë e më vendimtar në studimet albanologjike në përgjithësi. Prandaj, vështruar edhe nën këtë prizëm, ndihmesat e gjuhësisë shqiptare në përgjithësi dhe të Çabejt në veçanti marrin një rëndësi që i kalon kufijtë e Shqipërisë.

48. Siç dihet, një dukuri e ngjashme është vërtetuar edhe në shkencat të tjera, madje jo vetëm në shkencat shoqërore. E ky përparim i dukshëm është pa dyshim fryt i punës së madhe, që kanë bërë shkencëtarët dhe studiuesit shqiptarë në fushat përkatëse. Por, kuptohet vetiu, përpjekjet e tyre nuk do të kishin mundur të arrinin atje ku kanë arritur, po të mos u ishin krijuar kushtet e nevojshme objektive. E për këtë ishte i vetëdijshëm dhe mirënjohës edhe E. Çabej, i cili në një mbledhje jubilarë të organizuar nga Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë me rastin e 70-vjetorit të lindjes së tij, tha, ndër të tjera: «Mirënjohja ime shkon në radhë të parë ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila me dorë të sigurt e me sy largpamës hapi shtigje të reja në vendin tonë edhe në lëmin e dijes e të kulturës... Po t'i hedhim një vështrim punës që kemi kryer në këto tridhjetë vjet në fushat e ndryshme të albanistikës, në gjuhësi, kritikë letrare, histori, arkeologji, etnografi e folklor e në degët e tjera të veçanta, në mënyrë objektive e njëkohësisht me kënaqësi të ligjshme, vëmë re se dija shqiptare thotë sot fjalën e vet në këto degë. Zëri i saj ndihet sot në Ballkan, në Evropë edhe në botë. Tek ne, vijon ai, vazhdimësia e çdo pune shkencore me formimin teorik të punonjësve tanë është siguruar. Përparimi shkencor është një ndërtesë, ku secili vë një gur e mbi të vendojnë gurë të tjerë ata që vijnë më pas». Duke bërë fjalë për kushtet që e bënë të mundur këtë zhvillim, ai tha: «Partia e Punës e Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë udhëheqësi i madh i saj, shoku Enver Hoxha, i kanë kushtuar vëmendje të pandërprerë vënies së studimeve shqiptare në udhë të drejtë dhe kanë krijuar kushtet për mbarëvajtjen e tyre». Dhe e përfundoi fjalën duke thënë: «Nderimi i madh që më bëhet sot, më vë përpara detyrës të punoj me gjithë fuqitë e mia, të vazhdoj të jap gjer në fund ndihmesën time modeste në fushën e gjuhësisë shqiptare, të mundohem të plotësoj

## *Eqrem Çabej*

me sa të mundem ato detyra që më kanë mbetur të pakryera gjer më sot.»<sup>1</sup>

49. Por vdekja e parakohshme ia ndërpreu në mes punën aq të frytshme këtij shkencëtari të shquar, i cili, edhe kur sëmundja e pashërueshme e vuri poshtë, vazhdoi të punonte me të gjitha fuqitë, për t'i plotësuar «ato detyra» që i kishin mbetur. Madje, edhe pak para se të mbyllte sytë përgjithmonë në një klinikë të Romës, ku u dërgua tri herë për t'u mjekuar,<sup>2</sup> pasi përmendi «këngën e mërgimit», shprehu keqardhjen që po vdiste në dhé të huaq dhe që «më mbeti. . .» ajo që s'pati më fuqi ta thoshte me gojë, dhe pikërisht vepra e papërfunduar.

Por të dyja këto «pengje të zemrës» së tij nuk mund të mbeteshin pa plotësuar nga shoqëria, për të cilën ai punoi me aq dashuri dhe zell një jetë të tërë. Eshtrat e tij pushojnë në gjirin e ngrohtë të dheut mëmë, ku ai kaloi fëmijnë, u burrërua dhe u zhvillua si shkencëtar. Edhe vepra e tij nuk do të mbetet e papërfunduar, sepse ai la prapa, bashkë me thesarin e çmuar të punimeve të tij, edhe një shkollë gjuhësore shqiptare, që po e vazhdon dhe do ta vazhdojë më tej punën e mësuesit të saj të talentuar.

50. Nga sa u parashtruan përmbledhtas në paragrafët e mëparshëm, kuptohet mirë vlerësimi i madh që i është bërë dhe i bëhet veprës së këtij dijetari të shquar në vendin tonë. Për ndihmesat e tij të rëndësishme në fushën e gjuhësisë atij i është dhënë tri herë Çmimi i Republikës i Klasit të Parë dhe pikërisht:

Më 1961 — «Për punën e tij krijuese në fushën e shkencës gjuhësore gjatë viteve 1959-1961, që është një kontribut i çmuar në ndërtimin e socializmit».

Më 1974 — «Për kontributin e dhënë si bashkautor i veprës «Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe», e cila me nivelin e saj të lartë shkencor shërbeu si mbështetje kryesore teorike e praktike për përvetësimin e për kristalizimin e normës së

---

1) Shih *SF* 1/1969/200.

2) Më 29 dhjetor të vitit 1979, shoku Enver Hoxha, në një telegram dërguar profesor Eqrem Çabejt në Romë ku kurohej, i shkruante: «Ju uroj nga zemra një vit të lumtur e të gëzuar. Ju uroj gjithashtu shërim të shpejtë, të na kthehesh me shëndet të plotë». (Enver Hoxha. *Letra të zgjedhura*. Vëll. 3, fq. 282).

gjuhës sonë letrare kombëtare dhe për zbatimin e kësaj norme në të gjitha fushat e veprimtarisë shtetërore e shoqërore».

Më 1984 (pas vdekjes), «Për veprën «Studime etimologjike në fushë të shqipes», që është një ndihmesë e shquar në fushën e historisë së gjuhës shqipe».

Gjithashtu, duke vlerësuar lart punën e tij aq të frytshme shkencore dhe pedagogjike, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPS të Shqipërisë më 1977 i dha Çabejt titullin e lartë «Mësues i Popullit». Përveç kësaj, ai është nderuar edhe me dekoratat e larta «Urdhri i Punës i Kl. II» (1957) dhe «Urdhri Flamuri i Kuq i Punës i Kl. I» (1973).

Një vlerësim i lartë i punës së madhe të këtij dijetari të shquar është edhe nderimi i Institutit të Lartë Pedagogjik të Gjirokastrës me emrin «Eqrem Çabej» (1989).

51. Gjatë një gjysmë shekulli Çabej ka punuar si rrallë-kush dhe me arritje të mëdha, gjithashtu si rrallë-kush, në fusha të ndryshme të albanologjisë dhe të ballkanologjisë. Gjerësia e interesave dhe e prodhimtarisë së tij shkencore dëshmon sheshazi se kemi të bëjmë me një shkencëtar të talentuar të kalibrit evropian, i cili ia kushtoi tërë jetën shkencës. Për më tepër, ai diti të shfrytëzonte me mjeshtëri të rrallë arritjet e hulumtimeve të tij në fusha të ndryshme studimi për të argumentuar po me mjeshtëri të rrallë një varg tezash të rëndësishme lidhur me historinë e gjuhës shqipe dhe me evolucionin e të gjitha pjesëve përbërëse të sistemit të saj — fjalor, fonetikë dhe strukturë gramatikore.

Shumësia dhe sidomos cilësia e ndihmesave të tij në fusha të ndryshme të shkencës dhe në mënyrë të veçantë në fushën e studimit diakronik të gjuhës shqipe, kanë bërë të mundur që të hapen horizonte të reja në studimet albanologjike në vendin tonë, ku tashmë është krijuar një shkollë gjuhësore shqiptare me synime të shumanshme dhe larvajtëse e me një metodologji të nivelit bashkëkohor. E një nga themelvënësit kryesorë të kësaj shkolle gjuhësore shqiptare është pa dyshim dijetari i talentuar dhe i palodhur prof. E. Çabej, emri dhe vepra e të cilit do të rrojnë ndër shekuj.

52. Në shenjë nderimi dhe mirënjohjeje për punën e madhe në shërbim të Atdheut dhe të shkencës, ky dijetar i shquar më 17.8.1980 u përcoll për në banesën e përjetshme, në dheun mëmë që aq shumë e donte, nga përfaqësuesit më të lartë të Partisë, të shtetit dhe të shkencës e kulturës shqiptare. Me



## *Eqrem Çabej*

vdekjen e tij shkenca dhe kultura shqiptare humbën një nga përfaqësuesit e tyre më të talentuar dhe më prodhimtarë. Por vepra e tij nuk ka të vdekur. Ajo «do të mbetet kurdoherë si një shembull, si një thesar i vyer në duart e studiuesve e të shkencëtarëve të sotëm e të ardhshëm të vendit tonë».1)

Gjithashtu në shenjë nderimi për këtë dijetar të madh, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, me rastin e 80-vjetorit të lindjes së tij organizoi një sesion shkencor kushtuar veprës së tij. Në atë sesion u mbajtën 12 kumtesa2).

---

1) Nga fjala e Prof. Aleks Budës, kryetar i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, në ceremoninë e varrimit të prof. Eqrem Çabejt.

2) Shih SF 3/1988. Në hartimin e kësaj monografie kushtuar jetës dhe veprës së E. Çabejt janë pasur parasysh edhe kumtesat e atij sesioni shkencor.

## KREU II

# Për historinë e gjuhës shqipe

1. Një studiues i thelluar i gjuhës shqipe në evolucionin e saj historik, siç ishte Çabej, nuk mund të linte jashtë interesave të tij shkencore sqarimin e disa çështjeve të rëndësishme të historisë dhe të parahistorisë së kësaj gjuhe dhe të popullit që e ka folur atë qysh nga kohët më të lashta. Është fjala sidomos për çështje të tilla themelore si prejardhja e kësaj gjuhe ballkanike, vendi ku ajo është folur në rrymë të shekujve dhe vendi që ajo zë në rrethin e gjuhëve të tjera simotra indoevropiane dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera. Interesimi i E. Çabejt për këto çështje bëhej edhe më i domosdoshëm për arsye se, sidomos qysh nga fundi i shekullit të kaluar këto çështje, sidomos ajo e preardhjes së gjuhës shqipe, ishin bërë objekt diskutimesh të zjarra midis shkencëtarësh të vendeve të ndryshme, të cilët mbronin dy teza të ndryshme që i kundërviheshin njëra-tjerës. Siç dihet, për brezat e mëparshëm të dijetarëve, duke nisur me J. Tunmannin (J. Thunman)<sup>1</sup> e duke vazhduar me G. Hahnin<sup>2</sup>,

1) J. Thunmann, *Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker* (Leipzig, 1774), f. 245, v.

2) G. von Hahn, *Albanesische Studien* (Wien, 1853), I, f. 213 v.

## Eqrem Çabej

G. Majerin,<sup>3</sup> H. Pedersenin<sup>4</sup>, N. Joklin<sup>5</sup> etj., prejardhja e gjuhës shqipe nga ilirishtja, apo më saktë nga një a disa dialekte të ilirishtes jugore, siç shprehet G. Majeri, ishte një gjë e vetëkuptueshme dhe për këtë ata kishin sjellë edhe argumente të ndryshme.<sup>6</sup>

Por qysh nga fundi i shekullit XIX e këtej disa gjuhëtarë të tjerë, si indoevropianisti i njohur H. Hirt<sup>7</sup>, G. Vajgandi,<sup>8</sup> V. Georgievi<sup>9</sup> etj.<sup>10</sup>, e kanë vënë në dyshim ose e kanë kundërshtuar tezën e prejardhjes ilire të shqipes dhe janë përpjekur të vërtetojnë, sidomos me argumente gjuhësore, që shqipja e ka burimin te gjuha e trakasve të vjetër, që banonin në viset lindore të Ballkanit, apo tek e ashtuquajtura dakomizishte e Ballkanit Qendror. Këto kundërteza kanë pasur mjaft jehonë dhe mjaft përkrahës, sidomos në vendet e Ballkanit. Por, natyrisht, ato nuk arritën të gjenin mbështetje ndër të gjithë studiuesit e historisë së gjuhës shqipe.

2. Në këto rrethana dijetari ynë, që gjatë tërë veprimtarisë së tij shkencore është udhëhequr nga parimi «të jemi objektivë, por jo indiferentë», herë pas here i është kthyer kësaj teme sa të rëndësishme aq edhe të vështirë, duke u përpjekur kurdoherë të sillte diçka të re për sqarimin e saj sa më të argumentuar. Përpjekjen e parë ai e bëri në veprën *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe — Fonetika historike e shqipes*, botuar si tekst mësimor nga Universiteti i Tiranës më 1959.<sup>11</sup> Më pas, për këtë problem ai ka botuar edhe disa

3 G. Meyer, në *Gröbers Grundriss*, I (1838), f. 804.

4) H. Pedersen, në KZ 36,299 v.

5) N. Jokl, *Albaner, Eberts Reallexicon der Vorgeschichte*, I (1924) f. 84 v. Do pasur parasysh se Jokli ka vënë në dukje edhe disa afri leksikore midis shqipes dhe trakishtes.

6) Shih për këto Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, 147 v.

7) H. Hirt, *Die sprachliche Stellung des Illyrischen*, në «Festschrift für H. Kiepert» (1898), f. 179-188.

8) G. Weigand, BA III. 227-251.

9) V. Georgiev, BE II, 18 v.

10) Shih: Sh. Demiraj, *vep. cit.* 150-156.

11) Ky tekst mësimor i shaptilografuar është ribotuar disa herë. Ai është ribotuar edhe nga Universiteti i Prishtinës më 1970. Edhe përpara botimit të këtij teksti ai e ka trajtuar çështjen e prejardhjes së gjuhës

## Eqrem Çabej

artikuj shkencorë, ndër të cilët duhen përmendur sidomos: *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve (BUSHT.SSHSH 1958/2)*, *Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe (BUSHT. SSHSH 1962/4)*, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe (BUSHT, SSHSH 1963/4)*, *Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe (SF 1972/4) etj.*

Në këto studime Çabej u ka bërë një analizë kritike mendimeve të shprehura nga gjuhëtarë dhe historianë të ndryshëm para tij mbi çështjen e prejardhjes së gjuhës shqipe. Mjafton të përmendim këtu vërejtjet objektive që ai u bën 12 argumenteve të parashtruara nga Vajgandi për mbrojtjen e tezës mbi prejardhjen trake të gjuhës shqipe (shih shën. 8). Dhe si këto argumente ashtu edhe mendimet e gjuhëtarëve të tjerë, që i ka bërë objekt shqyrtimi, ai i ka paraqitur me saktësinë e një shkencëtari objektiv, që shqetësohet në radhë të parë për sqarimin e së vërtetës. Këtu nuk është rasti të ndalemi gjerë e gjatë në të gjitha argumentet e parashtruara nga Çabej kundër tezës për prejardhjen jo-ilire të gjuhës shqipe dhe në të mirë të tezës së vazhdimësisë iliro-shqiptare. Personat e interesuar mund t'i lexojnë ato në vetë shkrimet e autorit. Këtu do të ndalemi vetëm në disa nga çështjet më të rëndësishme, ku edhe autori ynë është ndalur më shumë, duke dhënë kështu edhe më shumë ndihmesa vetjake. Por, më parë, e quajmë të nevojshme të theksojmë se Çabej në punimet e tij në përgjithësi ka shfrytëzuar me korrektësinë shkencore që e karakterizonte edhe gjithë arritjet e mëparshme të studiuesve të huaj dhe shqiptarë.

3. Midis argumenteve kundër tezës së prejardhjes joilire të gjuhës shqipe. që janë bërë objekt shqyrtimi në punimet e Çabejt, duhen përmendur sidomos ato që kanë të bëjnë: 1) me çështjen e evolucionit të toponimeve të vjetra të Shqipërisë, 2) me mungesën e pretenduar të termave të vjetër të lundrimit në këtë gjuhë. 3) me mospërmendjen e shqiptarëve para shekullit XI të erës sonë, 4) me lidhjet e vjetra midis shqipes dhe rumanishtes, 5) me mungesën e pretenduar të huazimeve nga greqishtja e vjetër dhe të huazimeve të lashta latine etj.

---

shqipe, por jo me synime shkencore të argumentuara (shih, p.sh., *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, f. 19-22).

## Eqrem Çabej

4. Përsa i takon mendimit të mbrojtur nga Vajgandi etj., që toponimet e vjetra paralatine dhe latine të Shqipërisë në gjuhën shqipe nuk paraqiten me ato trajta fonetike që duhej të kishin, po të kishin qenë në përdorim nga stërgjyshërit e shqiptarëve qysh nga kohët e lashta, Çabej ka arritur të vërtetojë bash mendimin e përkundërt, dhe për këtë është mbështetur edhe në mendimet e disa dijetarëve para tij. Kështu, p.sh., ai ka vënë në dukje me mprehtësi se emra të tillë të vjetër si *Dyrrhachion/Dyrrhachium* sot *Durrës*, *Isamnus* sot *Ishëm*, *Polatum* sot *Pult* < *Pülët*, *Drivastum* sot *Drisht* (me rënien e rregullt të rrokjes së dytë — va)<sup>1</sup>, stërgjyshërit e shqiptarëve i kanë theksuar mbi rrokjen e parë në përputhje me rregullsinë e njohur të theksimit të rrokjes nistore në ilirishte. E njëjta rregullsi theksimi ndeshet edhe tek emri i hershëm etnik i shqiptarëve *Arbën(ë)* / *Arbër(ë)*<sup>2</sup> si edhe te fjalët e trashëguara *emën(ë)*, *emër(ë)*, *dimën(ë)* / *dimër(ë)* etj. Në këto fjalë bie në sy edhe kthimi -n- > -r- në toskërishte, ku një dukuri e tillë është mjaft e vjetër (shih edhe IV/10). Këtë dukuri fonetike të toskërishtes ai e ka vënë në dukje edhe për emrin e *Vlorës*, që në krahasim me trajtën më të vjetër *Aulón* — ka pësuar edhe rënien e rregullt të zanores nistore A — të patheksuar. Ai ka vërtetuar gjithashtu se edhe mjaft emra të tjerë të vjetër, si: *Ulqi* < *Ulqin*, *Dri* < *Drin*, *Shkumbi* < *Shkumbin*, *Shkodër*, *Lesh*, *Mat* etj. në krahasim me trajtat e vjetra të dokumentuara *Ulkinion*, *Drinus*, *Scampinus*, *Scodra*, *Lissus*, *Mathis* etj., kanë evoluar në përputhje të plotë me rregullsitë e evolucionit historik të sistemit fonetik të gjuhës shqipe, pra kanë kaluar brez pas brezi nëpër gojën e stërgjyshëve të shqiptarëve qysh nga kohët e lashta.

1) Rënie të tilla janë të njohura për fjalë të një kohe të vjetër, si, p.sh., të krahasohet fjala *kalë* me gjegjësen latine *caballus*.

2) Lidhur me këtë emër autori vë në dukje: «Në këtë grup toponimesh trirrokëshe hyn nga pikëpamja territoriale si edhe nga pikëpamja tipologjike edhe emri i lashtë i shqiptarëve *arbën*, *arbër*, në lidhje me *Albanoi* -në e njohur të hartës botërore të Ptolemeut, një emër ky, i cili në pajtim me gjendjen që u shpjellua këtu, në shqiptimin lokal do të ketë qenë shqiptuar *Albanoi* me theksim inicial. Kundër H. Hirtit, H. Pedersenit ka parashtruar që ky emër, për arsye të b-së (jo v), nuk mund të jetë marrë prej greqishtes në një kohë më të vonë, porse duhet patjetër të jetë i vjetër se vetë shqiptarët (SF 4/1972/16).

## Eqrem Çabej

Të kihet parasysh se ndryshimet fonetike, që kanë pësuar këta emra vendesh, janë vërtetuar rregullisht edhe në emra të tjerë të zakonshëm, që shqipja i ka trashëguar nga një fazë e vjetër indoevropiane, ose i ka huazuar nga latinishtja, si p.sh. *zā/zē* ~ *zan-i/ zëri-i*, *bri* ~ *brin-i/ brir-i*, *kufi* ~ *kufin-i/ kufir-i* < lat. *confinis*, *shpesh* < lat. *spissus*, *shkoj* etj.

5. Përsa i takon mungesës së termave të trashëguar të lundrimit dhe të peshkatarisë në gjuhën shqipe, që Vajgandi e ndonjë gjuhëtar tjetër e kanë parashtruar si argument për të vërtetuar se stërgjyshërit e shqiptarëve kanë shtegtuar në viset bregdetare nga vise të brendshme të Ballkanit, Çabej mban një qëndrim të drejtë, kur pohon: «Kjo fushë e leksikut të shqipes, në shumicën më të madhe është në fakt e burimit të huaj, porse kryesisht në pjesën teknike të saj në më të shumtat terma të mjeteve të lundrimit e të pjesëve përbërëse të tyre, në emrat e llojeve të peshqve dhe të veglave të peshkimit. Jo shumë ndryshe paraqitet gjendja në të tjera gjuhë ballkanike të viseve bregdetare, ndër to edhe në historinë e re të greqishtes, gjuhë që dihet mirëfilli se nuk e ka ndryshuar territorin e saj.<sup>1</sup> Në gjuhën shqipe, ndërkaq, krahas me këto, ka edhe një element popullor me terma vendës si përsa i përket detit në përgjithësi, si përsa i përket anijes dhe pajisjes së saj, peshkut dhe pjesëve të trupit të tij, si edhe në lidhje me veglat e peshkimit». Dhe këtu ai përmend një varg fjalësh nga kjo fushë, si: *det*, *gji (deti)*, *grykë (deti)*, *mat*, *valë*, *suvalë*, *shkulm*, *anije* që shkon me *an*, *anë*, shumë *enë*, me *enët e mëdhaja*, *enët e vogla* «*anijet e mëdha*, *anijet e vogla*», *ballë* (i anijes), *shul*, *pëlhurë*, *halë*, *verzë*, *breshkujcë*, *iriq deti*, *leshterik*, *yll deti* etj. Dhe më tej shton: «Fakti që këta terma për një pjesë janë të një përdorimi dialektor të kufizuar, nuk do të thotë se ato duhet të jenë të gjitha të reja. E nëse ato pjesërisht — ashtu si ndodh edhe në gjuhë të tjera — janë përftuar me rrugë metaforike, me zbartje të kuptimit (*ballë*, *enë*, *grykë*, *gji*, *pëlhurë*, *shul* etj.) dhe nëse përdoren edhe për ujërat kontinentale, këndeje logjikisht nuk

---

1) Për shprehjet detare me burim roman në greqishten e mesme khs. M. Triandaphyllidis, *Die Lehnwörter der mittelgriechischen Vulgärliteratur* (1909), 131, 139, 143.

mund të nxirret se nuk kanë ekzistuar lashtësisht edhe si shprehje popullore të detarisë.<sup>1</sup>

6. Në të mirë të tezës së tij mbi autoktoninë e hershme të popullit shqiptar dhe të vijimësisë ilire-shqiptare Çabej ka parashtruar edhe argumente të tjera, ndër të cilat duhet vënë në dukje sidomos argumenti historik. Ja si shprehet ai për këtë: «Pikësëpari mendimit mjaft të përhapur që treva gjuhësore e shqipes është shpërngulur në periodën historike prej një vendi më në lindje ose më në veri në këtë të tanishmin, i mungon baza historike.<sup>2</sup> Do të ishte një dukuri përjashtimore që një shkulje (emigrim) e ngulim i një populli të tërë, i kryer brenda sferës së botës romake e greke e në dritë të plotë të historisë. të ketë ndodhur pa u vënë re prej historisë. Mendimi që ka lidhje me këtë tezë, që kemi të bëjmë aty me një popull barinjsh shtegtarë, lëvizjet e të cilëve si të tilla, që ishin, nuk tërhoqën vëmendjen e bashkëkohësve, jo vetëm që nuk është mjaft real nga pikëpamja ekonomike e përgjithshme, por nuk pajton as me faktet kulturore-historike e sociale konkrete, mbështetet prandaj po aq në një vështrim të njëanshëm sa edhe gjykimi i gjendjes mesjetare. . .»<sup>3</sup>

Për sa i takon vërejtjes së bërë nga disa dijetarë të huaj që emri i shqiptarëve përmendet për herë të parë në shekullin XI, Çabej thekson me të drejtë se «kjo është një *argumentum ex silentio*, një argumentim prej heshtjes, që nuk çon peshë. Periudha që shkon nga mbarimi i antikitetit e gjer në shekullin XI, në të cilën bie edhe formimi i popullit rumun, është edhe për anët tona pa burime historike vendimtare.»<sup>4</sup>

7. Në lidhje me çështjen e burimit të gjuhës shqipe Çabej u ka kushtuar një vëmendje të posaçme edhe marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera. E një gjë e tillë është e kuptueshme, po të kemi parasysh interesat e gjerë shkencorë të këtij dijetari poliedrik, si edhe faktin e njohur që shumë probleme të historisë dhe të etimologjisë së gjuhës shqipe nuk mund të sqarohen si duhet pa pasur parasysh edhe të dhënat

1) Shih SF 4/1972/19 v.

2) Të kihet parasysh se një gjë e tillë e pati vënë në dukje së pari J. Thunmani në veprën e tij gjermanisht *Hulumtime mbi historinë e popujve të Evropës lindore* (Leipzig, 1774).

3) SF, 4/1972/12.

4) *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Fonetika historike e shqipes*, 28 v.

që mund të nxirren nga historia e marrëdhënieve të saj me gjuhët e tjera në rrymë të shekujve. Këto marrëdhënie, të cilat kanë lënë gjurmë të dukshme në gjuhën shqipe, në shumë raste shërbejnë për të plotësuar mungesën e të dhënave të drejtpërdrejta për periudhën parashkrimore të kësaj gjuhe të lashtë të Ballkanit, e cila për arsye të ndryshme historike ka nisur të lëvrohet me shkrim relativisht vonë. Nga ana tjetër, studimi i marrëdhënieve midis gjuhës shqipe dhe gjuhëve të tjera të Ballkanit, është një kërkesë e pashmangshme për sqarimin e dukurive të përbashkëta të gjuhëve ballkanike, për të cilat Çabej ka treguar vazhdimisht një interesim të madh. Si rrjedhim, në studimet etimologjike si edhe në artikuj, kumtesa dhe vepra të ndryshme shkencore, ai i ka trajtuar marrëdhëniet e shqipes dhe të nënës së saj me të gjitha ato gjuhë, që kanë lënë gjurmë të dukshme në të, siç janë greqishtja e vjetër, e mesme dhe e re, latinishtja dhe gjuhët romane, gjuhët sllave dhe turqishtja. Vëmendje të posaçme u ka kushtuar ai marrëdhënieve të shqipes me rumanishten, sepse sqarimi i tyre ka të bëjë jo vetëm me problemin e prejardhjes së shqipes, por edhe me shpjegimin etimologjik të një numri të konsiderueshëm fjalësh të përbashkëta, që ndeshen në këto dy gjuhë. Dhe ndihmesat e Çabejt në fushën e marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera po i nisim pikërisht me studimet e tij për bashkëpërkimet midis shqipes dhe rumanishtes.

8. Siç dihet, kundërshtarët e tezës së prejardhjes ilire të shqipes kanë vënë në dukje edhe se prania e një numri të konsiderueshëm fjalësh të vjetra të përbashkëta në shqipe dhe në rumanishte (shih për këtë § 9) dëshmon se stërgjyshërit e shqiptarëve janë shpërngulur nga vise më lindore të Ballkanit dhe janë vendosur në trojet e tyre të sotme në brigjet e Adriatikut në kohë relativisht të vona.<sup>1</sup> Prandaj marrëdhëniet e vjetra midis shqipes dhe rumanishtes ai i ka shqyrtuar në një varg punimesh, madje u ka kushtuar edhe një studim të posaçëm me titull *Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare* botuar së pari gjermanisht në *Revue Roumaine de Linguistique* 1965/1-3 dhe më pas shqip në *SF* 1975/1 Në këtë studim dhe në punime të tij të tjera ky dijetar jo vetëm ka marrë në shqyrtim një varg problemesh që

1) Shih për mendimet e këtyre gjuhëtarëve Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, 150-156.



dalim nga prania e bashkëpërkimeve midis këtyre dy gjuhëve të lashta të Ballkanit, por ka shtuar edhe elemente të reja nga kjo fushë.<sup>1</sup> Por ajo që duhet theksuar më fort në këtë rast, është qëndrimi objektiv ndaj pikëpamjeve të shprehura nga gjuhëtarë të tjerë para tij si edhe argumentimi shkencor i mendimeve të tij.

9 Siç dihet, prej kohësh është vënë në dukje nga gjuhëtarë të ndryshëm<sup>2</sup> se midis shqipes dhe rumanishtes ka një varg bashkëpërkimesh sidomos në fushën e fjalorit.<sup>3</sup> Ata edhe janë përpjekur ta sqarojnë historikisht praninë e këtyre bashkëpërkimeve. Por vështirësitë e vetëkuptueshme të këtij problemi dhe ndonjëherë edhe paragjykimet e disa gjuhëtarëve kanë bërë që burimi i këtyre bashkëpërkimeve të shpjegohet në mënyra të ndryshme. Disa prej tyre burimin e fjalëve të përbashkëta të shqipes dhe të rumanishtes e kanë kërkuar te një gjuhë e lashtë e Ballkanit (hipoteza e substratit). Disa të tjerë e kanë kërkuar burimin e këtyre fjalëve (ose të shumicës së tyre) te gjuha shqipe, nga e cila kanë depërtuar në rumanishte në një kohë kur kontaktet midis shqipes dhe rumanishtes nuk ishin ndërprerë ende nga dyndjet e sllavëve në Ballkan (shih § 16). Siç u vu në dukje edhe në § 8, disa gjuhëtarë e kanë paraqitur praninë e këtyre bashkëpërkimeve si një argument për të vërtetuar se shqipja e ka burimin te një gjuhë e lashtë e Ballkanit Lindor, përkatësisht Qendror, e cila ishte shumë e afërt me trakishten, përkatësisht me dakishten. Si rrjedhim, ata kanë mbrojtur hipotezën se stërgjyshërit e shqiptarëve janë shpërngulur nga vise më lindore të Ballkanit dhe janë vendosur në trojet e tyre të sotme në kohë relativisht të vona.<sup>4</sup>

1) Ndër këto po përmendim këtu vetëm disa, si: *brisk, rum, bršča*, «brisk xhepi, biçak» *brushtull* «shqopë, urth, lerth»; rum. *brusture* «rrodhe, rrodhëz», *petk/petëk*, rum. *petic, petec* «copë pëlhure, lëkure a letre», *pikë* «cirkë, gjerbë e shtëpisë», rum. *pic* «pikë, cirkë» etj. (shih SF 1/1975/57 v.).

2) Nga këta duhen përmendur sidomos B. J. Kopitari (1829), Fr. Miklošiči (1861), të cilët i vunë në dukje të parët këto bashkëpërkime. Pas tyre me këtë çështje janë marrë një varg gjuhëtarësh të tjerë.

3) Bashkëkërkime midis këtyre dy gjuhëve ka edhe në fushën e fonetikës, të morfologjisë e të sintaksës.

4) Mendimet mbi kohën e një shpërnguljeje të tillë të pretenduar

## *Eqrem Çabej*

10. Këto shpjegime kanë ndeshur në kundërshtimin e atyre dijetarëve që kanë mbrojtur tezën e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe. Një nga këta ishte edhe Çabej, i cili ka parashtruar këto arsyetime kundër shpjegimeve të mësipërme.

1. Substrati, i cili është i lidhur me një ndërrim gjuhe, mund të pranohet për rumanishten «me romanizimin e vendit oë u krye aty, por nuk mund të pranohet patjetër edhe për truallin e shqipes».

2. Nga gjuhët e vjetra jogreke të Ballkanit na kanë mbetur shumë pak elemente. «Në të tilla rrethana është gjë jo vetëm praktikisht e vështirë, po edhe metodikisht e dyshimtë. oë t'u vishen atyre gjuhëve fjalë dhe trajta fjalësh që ato më të shumtën pas gjase as nuk i kanë pasur fare ndonjëherë.»

3. «Me kontaktet që kanë zgjatur pa ndërprerje shekuj me radhë midis dy popujve.<sup>1</sup> ka pasur shkëmbime të gjata midis tyre, prandaj është afër me të mendohet që në të parë që aty duhen dalluar elemente më të vjetra dhe elemente më të reja.»<sup>2</sup>

Praninë e bashkëpërkimeve të vjetra midis shqipes dhe rumanishtes Çabej në studimin e tij e ka shpjeguar me fqinjësinë e moçme midis stërgjyshërve të shqiptarëve dhe të rumunëve. Sipas tij «degët e skajit më verilindor të etnosit shqiptar . . . në mesjetën e hershme, pas gjase në një kohë ende para dyndjes sllave, kanë qenë në një fqinjësi të pandërmjetme. fqinjësi kontakti, me degët e skajit më jugperëndimor të etnosit rumun, dhe kjo lidhje u ushqye më tej edhe me anën e transhumancës së barinjve shtegtarë. Duke gjykuar nga dëshmitë gjuhësore, ky kontakt duhet të ketë qenë mjaft intim, dhe vise-vise ka shkuar mbase gjer në simbiozë. Sipas tij, ky kontakt gjatë së ashtuquajturës periudhë të rumanishtes së përbashkët gjan të ketë vazhduar për disa shekuj me radhë, me siguri gjer në shkëputjen e aromunëve prej trungut rumun të përbashkët dhe në shtegtimin e tyre për nga jugu, shtegtim që u krye vonë-vonë (jo më vonë se) gjatë shekullit X. Në këtë periudhë mund të vendosen ato marrëdhënie të rumanish-

---

ndryshojnë nga një gjuhëtar te tjetri. Sipas gjuhëtarit jugosllav H. Bariç ajo ka ndodhur para ardhjes së sllavëve në Ballkan, kurse disa të tjerë e kanë paraqitur atë shpërngulje si një ngjarje më të vonë.

1) Është fjala për shqiptarët dhe rumunët.

2) Shih *SF* 1/1975/54.

tes me shqipen që shfaqen në mbarë degët dialektore të rumanishtes.»<sup>1</sup>

Por ai nuk shprehet më tej për marrëdhëniet e moçme midis këtyre dy gjuhëve. Me sa kuptohet, ai anonte më fort nga huazimet e ndërsjella midis shqipes dhe rumanishtes.<sup>2</sup> Por, ndërkaq ai vëren se «në parim është e mundur patjetër që nga elementet që kanë të përbashkët rumanishtja me shqipen, disa të burojnë prej një gjuhe indoevropiane jogreke të Ballkanit të lashtësisë, prej të ashtuquajturit substrat, gjuhë e papërcaktueshme më afër. Raporti gjenealogjik i shqipes ndaj kësaj gjuhe substrati mund të ishte atëherë i krahasueshëm me raportin e irlandishtes së sotme ndaj keltishtes kontinentale që është zhdukur, prej së cilës rrjedhin fjalët me burim prej substratit kelt, që gjenden në gjuhët romane perëndimore, dhe pozita e rumanishtes në këtë mes do të ishte analoge me atë të gjuhëve (romane) motra me të, që fliten në Perëndim.»<sup>3</sup>

E. Çabej ka vënë në dukje edhe bashkëpërkime të tjera midis shqipes dhe rumanishtes, si p.sh., zhvillimin, krahas nyjave të prapme, edhe të nyjave të përparme,<sup>4</sup> krijimin e përemrave të pacaktuar (dhe të ndajfoljeve gjegjëse) me ndihmën e një trajte të ngurosur të foljes «dua». Është fjala për ndërtimet e tipit *cineva, careva, ceva, undeva, cindva, cîtvă, cumva* të rumanishtes, të cilave «nga mënyra e kompozimit

1) SF 1/1975/52 v.

2) Në veprën *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Fonetika historike e shqipes* (1959) f. 76 v. E. Çabej pohon: «Rumune fjalët e këtij grupi nuk janë, sepse paraqiten të izoluar në këtë gjuhë, nuk gjejnë shpjegim bindës brenda sistemit të saj». Dhe shton se një pjesë e mirë e fjalëve të këtij grupi në gjuhën shqipe «nuk janë të izoluar, po paraqiten si misat e një familjeje leksikore». Dhe aty ai përmend fjalët *hamës* (rum. *hameş*), që lidhet me foljen *ha, këlbazë* (rum. *gâlbează*) që lidhet me *kalb, avull* (rum. *abur*) që lidhet me *valë, flutur* (rum. *fluture*) që lidhet me *fluturoj* e me *fletë, gropë* (rum. *groapă*) që lidhet me *gërmoj, moshë* (rum. *moş* «plak») që lidhet me *mot, shtrungë* (rum. *strungă*) që lidhet me *shtroj; thërrime* (rum. *fărîma*) që lidhet me *ther, vjedhull* (rum. *viezure*) që lidhet me *vjedh* etj.

3) Shih E. Çabej, SF 1/1975/53 v.

4) Për këto shih sqarimet e dhëna nga Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, 326 v.

## Eqrem Çabej

dhe e rendit të pjesëve përbërëse u përgjigjen kryekrerjet *kushdó, cildó, çdó, kudó, kurdó, sadó, sidó* të shqipes, veçse me këtë ndryshim në punë të kuptimit, që fjalët e rumanishtes duan të thonë përkatësisht «dikush», «dicili», «diçka», «diku», «dikur», «disa, ca» «disi» ...» Ai shton më tej se fjalët e shqipes pigen për nga kuptimi me ato ndërtime të rumanishtes që kanë në fillim trajtën e ngurosor *ori*, si *oricine, oricare, orice, oriunde*, etj.<sup>1</sup>

11. Lidhur me pyetjen a ka huazime nga greqishtja e vjetër në gjuhën shqipe. Çabej<sup>2</sup> bashkohet me mendimin e A. Thumbit, i cili arriti ta vërtetonte praninë e një numri huazimesh të tilla në gjuhën shqipe.<sup>3</sup> Pra, edhe për Çabejn të tilla huazime jo vetëm që nuk mungojnë, «porse janë më të shumta nga c'mendohet, duke përfshirë nja tridhjetë fjalë, përveç disa elementeve më pak të sigurta. sidomos atyre që duhet të kenë hyrë me anë të latinishtes. Është gjë e shënueshme që ndër huazimet prej greqishtes së vjetër disa janë të tipit dorik-grek veriperëndimor, si: *brukë* «Tamarix gallica» nga *myrike, drapën, drapër* nga \**drapanon* për *drépanon* (khs. *drápáne* sot në Kefaloni, në Kretë e në cakonishten, ku G. Hatzidakis për mendimin tim me të drejtë gjen një mbeturinë të dorishtes,<sup>4</sup> pastaj dhe *trapana* në Italinë Jugore,<sup>5</sup> *kumbull*, nga *kokkymalon*, fonetikisht *kokkúmalon*. *merimagë* nga *mýrma-kos* te Teokriti, *mokën, mokër* nga *mākhanā*. *mollë* nga *mālon*, *qull* nga *klýlos khylós* fonetikisht *klūlos khūlós*, *shkop* nga *skāpos* «degë». *trumzë* «Thymus» nga *thrémba thrymbē*. khs. sot *thrumba* në Kefaloni e në Ródos, *trúmba trómba* në greçitetin e Italisë jugore.<sup>6</sup> Edhe të tjera elemente greke të vjetra mundet që rrjedhin prej dorishtes, veçse nga forma e tyre

1) Shih SF 1/1975/56.

2) Shih sidomos *Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe* SF 4/1972/21 v.

3) Shih A. Thumb, *Altgriechische Elemente des Albanischen*, IF 26 (1926); shih edhe H. Mihăescu, *Influenta, grecească asupra limbii române* (București 1966), f. 63; po ai, *Linguistika dhe etnogjeneza e shqiptarëve*, SF 3/1982/57 v.

4) *Einleitung in die Geschichte der neugriechischen Sprache*, 104,

5) G. Rohlf, *Etymologisches Wörterbuch der unteritalischen Gräzität*, 571, *Lexicon graecanicum Italiae inferioris*, 131.

6) G. Rohlf, *Etymologisches Wörterbuch...* 796, *Lex. graec.* 181.

nuk mund të shihet me siguri një përkatësi të ky dialekt. Këto dorizma janë me rëndësi në lidhje me problemin tonë, ngaqë në këtë mes del pyetja se nga i mori shqipja dhe ku i mori. Me pranimin e një vatre ballkanike qendrore ose edhe më lindore të kësaj gjuhe, rruga e përvetësimit të këtyre huazimeve do të mbetë e pashpjeguar. Mendimi që këto të jenë sjellë ndër viset e brendshme me anë të tregtisë së kolonistëve doras, ndesh në faktin që mokra dhe bimët e kuzhinës zakonisht nuk janë mall tregtie. Aty do të mbetë pa përgjigje edhe pyetja pse këto lloj fjalësh i mungojnë rumanishtes, çështja e elementeve greke të vjetra të së cilës paraqitet përgjithësisht e vështirë. . .»

Dhe më poshtë, autori sqaron se këto huazime greke të vjetra depërtuan te të parët e shqiptarëve nëpërmjet kolonive greke (dorase) të bregdetit Adriatik dhe nëpërmjet kontakteve me fiset dorase, që banonin në trevat veriperëndimore të Greqisë së lashtë, pra «me rrugë bregdetare dhe kontinentale». Ai shton se fjalët e huazuara greke «që përmbajnë një -u- rrjedhin prej një kohe më të vjetër të huazimit, kur në greqishten përdorej ende një shqiptim me u, i cili në ballë ka qenë i përgjithshëm dhe në kohë historike ishte ende i gjallë në shumë dialekte.»<sup>1</sup>

Për më tepër, ai ka vënë në dukje se «në lidhje me elementin grek të vjetrin është për t'u vënë re edhe kjo, që ndikimi i tij në gjuhën shqipe ka zgjatur më se një mijë vjet. Që gjatë një periudhe kaq të gjatë ka pasur faza të ndryshme në marrje të huazimeve e paralelisht me këtë edhe ndryshime në trajtimin fonetik të tyre, kjo është një gjë që ta afron mendja që më parë. Kështu del vetvetiu një lloj periodizimi përbrenda këtij elementi, një herë në vija të trasha, një ndarje dysh në greqishte të vjetër të lashtë e në greqishte të vjetër të vonë. . .»<sup>2</sup>

12. Gjuhëtari ynë ka vënë në dukje edhe huazime nga fazat më të vona të greqishtes, ashtu siç ka vënë në dukje edhe një varg fjalësh që kanë hyrë gjatë shekujve nga shqipja në gjuhën greke. Për këtë çështjen e fundit ai në artikullin

1) SF 4/1972/22. Të kihet parasysh se në ndonjë huazim të shqipes nga greqishtja e vjetër ka ndodhur edhe evolucioni i lashtë (paralatin)  $\acute{a} > o$ , si p.sh. te *mákhana*  $> mokën/mokër$ .

2) BUSHT, SSSH 4/1962/131.

Shqipja dhe gjuhët fqinje, pasi vë në dukje se G. Majeri (*Neugriechische Studien* II, 64-71) ndikimin e shqipes mbi greqishten e re e çmoi me diçka më shumë se gjashtëdhjetë fjalë, vazhdon: «Këtë numër gjurmimet e mëpastajme e kanë shtuar. Po t'u hidhet një vështrim veprave leksikore që u botuan më vonë, shihet se ky ndikim përfshin edhe të tjera fjalë, si të mbarë gjuhës, si dialektore. Ndër ato që deri më sot dihen më pak, mund të përmenden p.sh. *μπότης μπότι...* prej shqipes jugore bot «enë e baltë me qafë të ngushtë për të mbushur e për të mbajtur ujë, shtamë», e cila hyn te botë «dhe, baltë, deltinë», *ροῦδε «κατελθε»* prej *rusem* «zbres. varem poshtë», *λέρα «zhul, zdral»*, nga *lerë* po me këtë kuptim, një postverbal i *lyej*, një emër që ka shkuar edhe në rumanishten, *κοῦλμπερι κοῦρμπένο κοῦρμπένια*, emra llojesh të ndryshme të kulprit, nga *kulpër kurrpën*, e cila ka depërtuar edhe në rumanishten dhe aromanishten: *Βένια «dëllinjë»*, nga *venjë «Taxus baccata, tis, bërshë; juniperus, lloje dëllinjash»* (pranë *enjë «tis»*), e cila ka shkuar edhe në serbokroatishten; prej pjesëzash mund të përmendim *ντότι...* prej shqipes *dot*, në ndërtime të tilla si *δέν ἔρχομαι ντότι «nuk mund të vij»*, sipas shprehjes *nuk vij dot* të shqipes. Këto dhe elemente të tjera të kësaj gjuhe kanë hyrë në greqishten pjesërisht me anë të dialekteve të Shqipërisë Jugore e pjesërisht nëpërmjet ishujve gjuhësorë shqiptarë të themeluar prej shekujsh në Greqi».<sup>1</sup>

13. Edhe për huazimet latine të shqipes Çabej e ka argumentuar më tej mendimin e disa gjuhëtarëve para tij se në gjuhën shqipe ka një shtresë shumë të vjetër huazimesh të tilla. Lidhur me këtë çështje ai ka vënë në dukje, ndër të tjera: «Në pikëpamje sociale-historike, ky ndikim, në kundërshtim me rumanishten, ka karakter më fort qytetar se fshatar. Kjo shihet, ndër të tjera, edhe nga analiza e leksikut përgjithësisht e sidomos e gjuhës kishtare. Kjo gjuhë në pjesën mbizotëruese është e burimit latin, për një pjesë më të vogël e burimit grek. ndërsa elementet sillave mungojnë krejt. një rrethanë kjo që është me rëndësi për historinë kulturore të vendit në kohën parasllave dhe sllave të hershme. Lidhur me kronologjinë, duhet shënuar që ndikimi i latinishtes mbi shqipen, sikundër shihet nga mënyra e reflektimit fonetik të fjalëve, nis që me kohët e lashta dhe vazhdon pa ndërprerje gjer

1) *SF* 4/1973/101.

aty nga mbarimi i perandorisë edhe përtej asaj kohe, gjersa ia zë vendin italishtja. Me këtë vazhdim të gjatë, edhe aty, ashtu si tek elementi grek i shqipes, shtrohet nevoja e njëfarë periodizimi. Kështu, p.sh., trajtimi i *Diana: zana* tosk. *zëra*, me asiblimin e dentalit të saj, i përket një shkalle kohore më të mëtejme se *diabolus: djall*; fjala e parë ka hyrë historikisht në kohën pagane, e dyta në kohën kristiane. Më anë tjetër, huazimi i *laurus: lar, causa: kafshë* etj. ka ndodhur në një kohë para reduktimit të lat. *au* në *o*, i cili, përkundrazi, na paraqitet në italishten *alloro* e *cosa* dhe në frëngjishten *chose*, të cilat rrjedhin po nga ajo fjalë latine. . .»<sup>1</sup>

14. Lidhur me praninë e një shtrese të lashtë ndër huazimet latine të shqipes, ai ka përmendur edhe faktin e vënë në dukje së pari nga Majer-Lybkeja,<sup>2</sup> që ndër huazimet e hershme latine të kësaj gjuhe *k*-ja e ndjekur nga një *-e* ose *-i* nuk është palatalizuar në *q*- dhe shton: «Me këtë dhe me trajtimin e *ki*-së, elementi latin i shqipes, sipas fjalëve të Majer-Lybkes, paraqet një stad gjuhësor më të mëtejme se çdonjëra nga gjuhët romane. Kësaj vjen e i shtohet dhe kjo, që shqipja edhe në reflektimin e *tj*-së latine, largohet nga rumanishtja. Ndërsa ky reflektim në rumanishten, sipas S. Pushkariut,<sup>3</sup> hyn në karakterin e mbarë gjuhëve romane, i përket pra në çdo rasë shekullit III të erës sonë, mënyra e trajtimit që ka shqipja, sikundër vëren N. Jokli<sup>4</sup>, na çon në një kohë më të lashtë, dukuri kjo sigurisht me rëndësi për historinë e gjuhës. Po të kemi parasysh edhe elementet leksikore, qëndrimin ndërmjetës të shqipes në lidhje me to, . . .pra më një anë afrimet me rumanishten, më anë tjetër me dalmatishten edhe me gjuhët romane perëndimore, është e pamundur të mos shihet se në këtë qëndrim përveç faktorëve të kohës kanë pasur pjesë edhe faktorë të hapësirës: Ndërsa ky karakter arkaik i elementit latin të shqipes shpie në një periudhë, që është përpara romanizimit të Dakisë. këto dukuri, së bashku me lëndën toponomastike, tregojnë në mënyrë të prerë që rumanishtja dhe shqipja janë formuar në treva të ndryshme të Gadishullit Ballkanik».<sup>5</sup>

1) Shih SF 4/1973/102.

2) Shih *Mitteilungen des Instituts für rumänische Sprache Wien I* (1914), 32.

3) *Locul limbii române între limbile romanice* (1920), 27.

4) *Arhiv za arbanaska starinu I*, 43.

5) Shih: SF 4/1972/22 v.



15. Siç del edhe nga kjo paraqitje e përmbledhur, çështjen e prejardhjes së gjuhës shqipe E. Çabej e ka shqyrtuar nga disa këndvështrime, duke mbajtur një qëndrim kritik objektiv ndaj mendimeve të pambështetura të disa gjuhëtarëve të huaj dhe duke sjellë edhe argumente të tjera në të mirë të tezës së prejardhjes ilire të shqipes. Dhe pas këtij shqyrtimi të shumanshëm, ai arrin në këtë përfundim: «Rezultati i kërkimit tonë është ky, që shqipja është formuar në përgjithësi në trevën e sotme gjuhësore me përfshirje edhe të bregdetit, që kjo trevë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim qenësor gjatë kohëve. Dardania dhe Shqipëria Veriore bashkë me krahinën e Matit duhet të shikohen si pjesë të trevës së kryehershme, jo si kjo vetë; mendimi i përkundërt është shikuar tepër ngushtë. Përmbyllja që del nga teoria e Matit<sup>1</sup> që area gjuhësore e sotmja është një trevë ekspansioni, është për të rishikuar edhe nëpërmjet të të dhënave historike. Do menduar edhe mos paraqet area e sotme më fort një trevë restriksioni. . .»<sup>2</sup>

Pra, Çabej e ka kundërshtuar mendimin për praninë relativisht të vonë të shqiptarëve në viset bregdetare. Ja si shprehet ai për këtë çështje në një studim kushtuar Pjetër Budit dhe gjuhës së tij, ku bën fjalë, ndër të tjera, edhe për një traditë shkrimi të shqipes relativisht të vjetër: «Çështja e traditës përveçse për literaturën është me rëndësi edhe për historinë shqiptare. Ajo lidhet me çështjen se që kur mund të flitet për praninë e elementit shqiptar në bregdet të Adriatikut. Mbi dëshminë e disa dokumenteve historike, një lagje historianësh e gjuhëtarësh të shquar mendojnë se disa nga qytetet kryesore të bregdetit gjer aty nga shekulli XIII-XIV kanë qenë ba-

---

1) Është fjala për mendimin e shprehur nga Shtadmyleri (G. Stadtmüller-i), sipas të cilit treva jetësore e popullit shqiptar për kohën romake bizantine të hershme, do venduar po në trevën e sotme, veçse vetëm në një pjesë të kësaj, d.m.th. në katërkëndëshin midis fushës bregdetare të Shqipërisë së ulët, luginës së Shkumbinit, luginës së Drinit të Zi dhe luginës së Drinit të Bardhë, me krahinën e Matit si qendër të tij (shih: SF 4/1972/10).

2) SF 4/1972/23.



nuar prej «latinësh», pasardhës të provincialëve romakë e të afër me elementin roman të bregdetit të Dalmacisë. Këtë çështje, që përbën një problem shkencor për etnografinë e për historinë, ne e çekim këtu jo për të marrë në analizë, po për ta lidhur me katër pyetje, dy të karakterit gjuhësor e dy të karakterit historik: Si pajtohet me këtë *communis opinio* thujse aksiomatike fakti që toponimia e re e kësaj treve rrjedh nga e vjetra vetëm nëpërmjet ligjeve fonetike të shqipes? Ku janë gjurmët gjuhësore të kësaj popullsie «latine» në gjuhën shqipe, siç janë ato të dalmatishtes në serbokroatishten? Në rast se elementi shqiptar nguli në këto anë vetëm aty nga shekulli XIV, si bëhet që pas një shekulli qe në gjendje të bënte një qëndresë në shkallë kombëtare, e cila tërhoqi vëmendjen e asaj kohe? E si shpjegohet që pas dy shekujsh, bash në këto anë, na shfaqet një literaturë në gjuhë të vendit? Këto e disa të tjera rrethana e bëjnë të nevojshme që kjo çështje të rimerret me një shqyrtim objektiv nga ana e historisë dhe e gjuhësisë. Përfundimet ku mund të arrihet, besojmë se nuk kanë për të qenë pa rëndësi në punën e hetimit të lidhjeve historike të elementit shqiptar me botën romane, me botën bizantine e me popullsitë sllave në trevat perëndimore të Gadishullit të Ballkanit.»<sup>1</sup>

16. Në punimet e tij kushtuar historisë së gjuhës shqipe një vëmendje të posacme u ka kushtuar Çabej edhe marrëdhëniet të shqipes me sllavishten e Ballkanit, e kjo duket qartë jo vetëm nga analiza e huazimeve sllave në studimet e tij etimologjike të shqipes, por edhe nga shqyrtimi që u ka bërë këtyre marrëdhëniet në disa artikuj studimorë.<sup>2</sup> Në shqyrtimin e marrëdhëniet midis shqipes dhe gjuhëve sllave të Ballkanit ai ka dhënë një varg ndihmesash me vlerë, që do të vihen në dukje shkurt këtu poshtë. Këto ndihmesa kanë të bëjnë jo vetëm me saktësimin e mëtejshëm të huazimeve sllave të shqipes, por edhe me fjalët shqipe që kanë depërtuar në gjuhët sllave fqinje.

1) Shih SF 4/1966/147.

2) Nga këta duhen përmendur sidomos: *Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, SF 4/1970/11 v., *Shqipja dhe gjuhët fqinje*, SF 4/1973/104 v.; *Histori fjalësh të sllavishtes e të shqipes*, SF 1/1976/123-134; *Mbi disa izoglosa të shqipes me sllavishten*, SF 2/1976/63-74.

Lidhur me sllavizmat e shqipes, ai ka vënë në dukje se ato janë periudhash të ndryshme, dhe në shumicën e rasteve kanë karakter dialektor. Ai ka sqaruar se sllavizmat më të hershme kanë depërtuar në shqipe në një kohë kur në gjuhët sllave kishte ndodhur metateza e likuidave. d.m.th. pas gjysmës së dytë të shekullit IX të erës sonë.<sup>1</sup> Kështu, p.sh., ai ka argumentuar se fjalët *baltë*, *gardh* dhe *daltë* janë fjalë të trashëguara të shqipes dhe nuk janë huazime sllave, që të kenë depërtuar në shqipe qysh në një periudhë, kur në gjuhët sllave s'ishte vërtetuar ende metateza e likuidave. Nga ana tjetër, duke u mbështetur si në faktet historike dhe në shtrirjen gjeografike të sllavizmave të shqipes, ashtu edhe në trajtat gjuhësore të tyre, ai ka arritur në përfundimin që shumica e huazimeve sllave në shqipe kanë pasur qysh në fillim një përhapje dialektore. Dhe në të vërtetë, është plotësisht e pranueshme që në viset e Shqipërisë Jugore një pjesë e mirë e sllavizmave të kenë depërtuar gjatë pushtimit të asaj treve nga mbretëria bullgare, sidomos gjatë shekujve X-XI. kurse sllavizmat e Shqipërisë Veriore, për një pjesë të mirë, kanë depërtuar gjatë sundimit sllav të dinastisë së Nemanjideve. d.m.th., gjatë shekujve XII-XV.<sup>2</sup> Këto sllavizma, që përbëjnë edhe shtresën më të vjetër të huazimeve sllave, kanë pësuar më shumë ndryshime fonetike se ato që kanë depërtuar më vonë nëpër të folme të shqipes, sidomos të zonave kufitare.

Ai ka vënë në dukje gjithashtu se trajta të tilla, si: *opinqë*, *mezhdë* të Shqipërisë Jugore kanë depërtuar nga bullgarihtia, ndërsa trajtat *opanqë*, *meqje* të Shqipërisë Veriore kanë depërtuar nga serbokroatishtja.<sup>3</sup>

Në studimet e tij dhe sidomos në dy veprat e hartuara në bashkëpunim me Aleksandër Xhuvanin<sup>4</sup> janë vënë në dukje edhe prapashtesat dhe parashtesat sllave që kanë depërtuar në gjuhën shqipe, si: *-ac*, *aç*, *ashkë*, *-ec*, *-icë*, *-nik*, *kolo-*, *po-* etj.<sup>5</sup>

1) Shih SF 2/1976/64 v.

2) Shih E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Fonetika historike e shqipes (Tiranë, 1957), f. 57 v.

3) Shih *po ai*, *po aty* f. 60.

4) Është fjala për *Parashtesat e gjuhës shqipe*, botuar së pari në BSHSH 4/1956 dhe *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962.

5) Shih A. Xhuvani, E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, përka-tësisht *Parashtesat e gjuhës shqipe*.

## Eqrem Çabej

17. Por, nga ana tjetër, ai ka vërtetuar se shumë fjalë të shqipes, që më parë mbaheshin si huazime sllave. në të vërtetë nuk janë të tilla. Ndër këto, përveç emrave *baltë*, *gardh* dhe *daltë*, që u përmendën pak më sipër (sh § 16), ai ka përfshirë edhe një varg fjalësh të tjera, si: *acar*, *bungë*, *groshë*, *rrap*, *treg* etj., disa nga të cilat janë trajtuar si fjalë të trashëguara të shqipes edhe nga Jokli etj. para tij.

Jashtë vëmendjes së Çabejt nuk ka mbetur as rasti i depërtimit të fjalëve shqipe në gjuhët sllave, sidomos në të folmet sllave jugore. Nga këto po përmendim, sa për shembull, huazimet më të vjetra, si: *bajgë*, *buzë*, *oushë*, *karpë*, *magar*, *vatër* etj. Përveç këtyre, ka një varg fjalësh të tjera që kanë depërtuar në zonat sllave të Ballkanit dhe që pjesërisht janë vënë në dukje edhe nga autorë të tjerë para Çabejt, si: *zhallë/zhalo* < *zall*, *brina* < *vend brinjë*, *shkrava* < *shkrep*. etj.<sup>2</sup>

18. Me interes është edhe ndihmesa e Çabejt në fushën e studimit historik të turqizmeve të shqipes. Duke u mbështetur sidomos në të dhënat që mund të nxirren nga të folmet e arbëreshëve të Italisë dhe nga veprat e shkrimtarëve të vjetër veriorë (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani etj.), ai ka bërë një shtresim kohësor të huazimeve turke të kësaj giuhe. Në këtë mënyrë ka arritur të veçojë turqizmat që kishin hyrë në shqipëri para valëve të ndryshme të mërgimit arbëresh në Itali (shekujt XV-XVIII) dhe para botimit të veprave të shkrimtarëve tanë veriorë.<sup>3</sup> Në bazë të këtyre kritereve ai ka vecuar, ndër të tjera, edhe shtresën më të vjetër të huazimeve turke, si: *bea/bej*, *daulle*, *dufek*, *duf*, *fital*, *gajtan*, *nerënxë*, *pexher*, *tel* etj., që ndeshen edhe në të folmet arbëreshe të Italisë.<sup>4</sup> Ai ka vënë në dukje, sic u tha edhe pak më sipër, edhe huazimet turke që ndeshen te shkrimtarët e vjetër veriorë, që ishin të besimit katolik. Kështu, te Buzuku ai ka vënë re turqizma të tilla, si: *harami* «cuba. hajdutë», *kallauz*, *cohë*, *dollamë*, *tepsi*, *turk* e ndonjë tjetër. Kurse në të tri veprat e Budit ka vecuar

1) Shih edhe Xh. Ylli, *Çështje të marrëdhënieve të shqipes me gjuhët sllave në studimet e prof. E. Çabejt*, SF 3/1988/113.

2) Shih E. Çabej, *Histori fjalësh të sllavishtes e të shqipes*, SF 1/1979/123 v.v., *Shqipëria dhe gjuhët fqinje*, SF 4/1973/104 v.

3) Shih për këtë sidomos studimin e tij *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*, SF 4/1975.

4) Shih SF 4/1975/81 v.

## Eqrem Çabej

turqizmat: *cohë*, me *dertunë* «vajtoj, ankohe» (prej turqishtes *derd* «dert»), *hesap*, *maskarí* (prej turqishtes *maskarâ*), *pajë* «*hatër*», *hajde*, *pazar*, *raki*, *sengjir* «*zinxhir*», *shend* «*gëzim*» taminqar «i matur» (prej *tahmin*), *temel* e *themel*, *terezi* e *ndojnë* tjetër.<sup>1</sup>

Mbi bazën e lëndës së shqyrtuar Çabej ka arritur në përfundimin se «ndikimi turk mbi gjuhën shqipe u ushtrua shumë më fort në jetën e qytetit se në të fshatit. Këtë e dëshmon vetë rrethana që terminologjia e bujqësisë dhe e blegtorisë e kësaj gurre është shumë e vogël në krahasim me pjesën që ka turqishtja në leksikun e rretheve qytetare. Dhe ai shtjellon më tej se në cilat fusha të fjalorit ka ndikuar më fort turqishtja.<sup>2</sup>

Do pasur parasysh gjithashtu se Çabej në shkrimet e tij si edhe në studimin monografik *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, të hartuar në bashkëpunim me Aleksandër Xhuvanin, ka vënë në dukje edhe prapashtesat turke të shqipes, të cilat kanë hyrë bashkë me fjalët e prejardhura prej asaj gjuhe dhe në përgjithësi kanë mbetur në përdorim vetëm në huazimet turke të shqipes, si: *merak-li*, *namus-li*, *aga-llëk*, *budalla-llëk*, *araba-xhi*, *kurbet-çi*, *hajdu-çe* (<*hajdut-çe*), *tur-çe* (*turk-çe*) etj. Disa prej këtyre prapashtesave janë shtrirë edhe te disa fjalë prej burimi joturk.<sup>3</sup>

19. Në studimet e tij E. Çabej është marrë edhe me çështje të tjera të historisë dhe të parahistorisë së gjuhës shqipe dhe të popullit që e ka folur atë në rrymë të shekujve. Ai nuk mund të mos mbante parasysh faktin e njohur që si stërgjyshërit e shqiptarëve, ilirët, ashtu edhe popujt e tjerë indoevropianë që ishin fqinjë me ta, kanë zbritur në Gadishullin Ballkanik nga vise të tjera në një periudhë të caktuar, që sipas disa dijetarëve nuk i kapërcen njëzet shekuj para erës së re. Përsa i takon djepit paraballkanik të stërgjyshërve të shqiptarëve, ai bashkohet me mendimin e atyre dijetarëve, që ata i bien të ardhur nga Veriu. Ja si shprehet ai për këtë: «Mbi dëshminë e lidhjeve të ngushta të shqipes me disa gjuhë të

1) Shih SF 4/1975/83 v., ku jepen edhe turqizmat që ndeshen te Bardhi, Bogdani etj.

2) Shih SF 4/1975/84.

3) Shih për këtë Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, 127. v.

## Eqrem Çabej

Evropës Veriore (baltosllavishtja, gjermanikishtja, keltishtja), këtë djep, nga sa duket, me të drejtë e kanë lokalizuar në Evropën Veriore. Norbert Jokli sidomos, duke marrë në shqyrtim dhe disa huazime të lashta që ka shqipja më një anë prej iranishtes, më anë tjetër prej finougrishtes, këtë djep e ka vendosur në një mënyrë më të prerë në një trevë të Evropës Verilindore.»<sup>1</sup>

Përsa i takon vendit që zë shqipja në rrethin e gjuhëve indoevropiane simotra, E. Çabej në përgjithësi pajtohet me mendimin e shprehur nga F. Bopi (F. Boppi) qysh më 1854 se kjo gjuhë «në elementet e saj themelore me asnjërën nga gjuhët motra sanskrite [= indoevropiane] të kontinentit tonë nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë, ose, aq më pak, ndonjë lidhje derivacioni, burimi». Ndërkaq, ai ka shoshitur në mënyrë kritike mendimet e disa gjuhëtarëve para tij mbi bashkëpërkimet e vjetra (parahistorike) të shqipes me gjuhët simotra.<sup>2</sup>

---

1) Shih *BUSHT*, *SSHS* 4/1962/118.

2) Shih *po aty*, f. 118. v.

### KREU III

## Studimet etimologjike

1. Emri i E. Çabejt është i lidhur ngushtë, në radhë të parë, me studimet etimologjike në fushë të shqipes. Dhe një gjë e tillë është e kuptueshme, po të mbahet parasysh se ky gjuhëtar i talentuar, gjatë tërë jetës së tij i ka kushtuar një vëmendje të posaçme çështjes së sqarimit etimologjik të fjalorit të gjuhës sonë dhe, me gjithë vështirësitë e mëdha të kësaj fushe studimesh, këtu ai ka arritur edhe sukseset më të rëndësishme. Për më tepër, kjo fushë studimesh, e cila kërkon një përgatitje të gjerë dhe një analizë të shumanshme të fakteve gjuhësore, i ka dhënë mundësi atij të japë ndihmesa me vlerë edhe në fusha të tjera gjuhësore, siç janë fonetika dhe morfologjia historike (shih kreun IV), si edhe vetë historia e gjuhës shqipe (shih kreun II).

2. Siç dihet, studimet etimologjike paraqesin një varg vështirësish të mëdha edhe kur është fjala për gjuhë me një dokumentim shkrimor të hershëm, siç janë, p.sh., greqishtja, indishtja e vjetër, latinishtja, gjuhët gjermanike, sllave etj., të cilat kanë tërhequr prej kohësh edhe vëmendjen e shumë gjuhëtarëve të shquar. E këto vështirësi janë pa krahasim më të mëdha në rastin e një gjuhe me një dokumentim shkrimor të

## Eqrem Çabej

vonë dhe me një evolucion të madh historik të sistemit të saj gjuhësor, siç është shqipja. Për më tepër, gjuhëtarët që janë marrë me studime etimologjike të mirëfillta në fushë të shqipes, si gjatë shekullit të kaluar ashtu edhe në shekullin XX, kanë qenë shumë të paktë. Po të përjashtohen rastet e G. Majerit<sup>1</sup>, të Pedersenit<sup>2</sup> e të Joklit<sup>3</sup>, që u kanë kushtuar vëmendje të veçantë problemeve etimologjike të shqipes, ndihmesat e gjuhëtarëve të tjerë në këtë fushë studimesh numërohen me gishta.<sup>4</sup> Dhe në përgjithësi ata kanë qenë gjuhëtarë të huaj, që shqipen e kanë studiuar më fort nga të tjera këndvështrime. Kjo vërejtje vlen në përgjithësi edhe për gjuhëtarët shqiptarë dhe arbëreshë, të cilët për arsye të kuptueshme janë marrë më fort me probleme të tjera të shqipes dhe të historisë së saj.<sup>5</sup> Prandaj mund të pohohet se në të vërtetë te ne mungonte një traditë vendëse për studime etimologjike të mirëfillta.

3. Gjatë punës së tij prej afër gjysmë shekulli në këtë fushë studimesh Çabej është marrë me studime etimologjike dhe jo me hartimin e një fjalori të ri etimologjik të shqipes. Një fjalor të tillë etimologjik ai ndofta kishte menduar ta

---

1) G. Majeri me probleme të etimologjisë së gjuhës shqipe është marrë në disa nga punimet e tij. Por, në mënyrë sistematike, ai është marrë me këto probleme në veprën e tij madhore *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strassburg, 1891.

2) H. Pedersen, i cili është marrë më fort me çështje të fonetikës dhe të morfologjisë historike të shqipes, herë pas here ka dhënë ndihmesa me vlerë edhe për sqarimin etimologjik të një vargu fjalësh të kësaj gjuhe.

3) N. Jokli, gjithashtu, ka dhënë ndihmesa me vlerë për sqarimin etimologjik të shumë fjalëve të shqipes.

4) Ndër këta duhen përmendur Franc Boppi, Franz Miklosiçi, C. Taliavini, St. Mani etj.

5) Ndër gjuhëtarët arbëreshë duhen përmendur Dhimitër Kamarda dhe Marko la Piana. Ky i fundit ka lënë dorëshkrim edhe një fjalor etimologjik të gjuhës shqipe.

Ndër gjuhëtarët shqiptarë kanë dhënë ndihmesa edhe në fushë të etimologjisë së gjuhës shqipe Kostandin Kristoforidhi në Fjalorin e tij dhe Aleksandër Xhuvani në punime të tij të ndryshme. Të kihet parasysh se A. Xhuvani dhe E. Çabej kanë bashkëpunuar në hartimin e monografive *Parashtesat e gjuhës shqipe dhe Prapashtesat e gjuhës shqipe*, ku janë trajtuar edhe çështje etimologjike.

hartonte në një fazë më të vonë të jetës së tij, por vdekja e parakohshme ia ndërpreu punën në mes, kështu që nuk arriti as t'i jepte formën përfundimtare pjesës më të madhe të studimeve të tij etimologjike.<sup>1</sup> Këto ndryshojnë nga disa këndvështrime prej fjalorit etimologjik të Majerit, i cili është një fjalor etimologjik krahasimtar në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Në të autori synon në diktimin e burimit të fjalëve, qoftë ky burim përbrenda gjuhës, qoftë jashtë saj, dhe vetëm rrallëherë ai hyn në shqyrtimin e shkallëve të ndërmjeme të zhvillimit historik të tyre. Një tjetër tipar dallues është që atje nuk merret në shqyrtim përhapja territoriale e fjalëve. Ajo që e shton ndryshimin e këtij fjalori nga punimi ynë, është kjo që ai fjalor, gjithmonë duke mbetur një vepër themelore edhe sot e gjithë ditën, është një fjalor i kohës së autorit, gjë që shihet dhe nga gjithë ndërtimi i tij. . .»<sup>2</sup> Pra, Çabej në studimet e tij etimologjike fjalët e shqyrtuara i analizon jo vetëm për nga burimi, por edhe nga këndvështrime të tjera, që lejojnë të ndiqet si historia ashtu edhe gjeografia (përhapja) e tyre në rrymë të kohës deri në ditët tona. Veç kësaj, do pasur parasysh edhe se në pajtim me karakterin e me qëllimin e punimit të tij «që përmban studime e jo një fjalor etimologjik, në të nuk trajtohen të gjitha fjalët që janë a që kanë qenë në përdorim. Aty studiohet vetëm një pjesë e fjalorit të shqipes. Po edhe përbrenda kësaj pjese zbatohet medoemos një ekonomi, ruhen disa kufij të caktuar. Zënë një vend kryesor fjalët e mbarë gjuhës, në mënyrë më zgjedhëse (selektive) veprohet me fjalët krahinore. Nuk mund të hyjnë në punim të gjitha fjalët e veçanta të shkrimtarëve të moçëm e të mëvonshëm. . . Nga masa e madhe e huazimeve tematikisht hyjnë këtu ato që kanë njëfarë përhapjeje në gjuhë, ose ato që paraqesin një interes të veçantë, që kanë qenë

---

1) Një pjesë e këtyre janë botuar në revistën *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore* nga nr. 4 i vitit 1960 deri më 1964/4 dhe më pas në *SF* 1/1965-3/1968. Këto janë ribotuar në Prishtinë në vëll. I, II të *Studime Gjuhësore* të këtij autori. Ndërkaq, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave në Tiranë ka nisur botimin e plotë të veprës *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, që parashikohet të dalë në gjashtë vëllime. Nga këto kanë dalë deri sot vëllimet I, II, III. Vëllimi IV është në shtyp.

2) Shih E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, 33 v.



## Eqrem Çabej

gjykuar gabim në pikëpamje të burimit të tyre, që janë marrë për fjalë vendi etj. Mbeten jashtë huazimet që kanë një përhapje dialektore shumë të kufizuar, ose që përdoren në një ishull gjuhësor jashtë truallit të shqipes...»<sup>1</sup>

4. Kuptohet vetiu që realizimi i këtyre synimeve (shih § 3) kërkonte që autori të kishte përpunuar një konceptim të qartë për atë që po ndërmerre të bënte dhe njëherazi të zbatonte edhe metodën më të përshtatshme për këtë qëllim. Ja si shprehet ai për këto:

«Duke rrokur tani më për së afërmi mënyrën si e shikojmë ne studimin etimologjik të gjuhës shqipe, kjo pas shqyrtimit të informacionit, d.m.th. të sistemimit objektiv të materialit që u përmend më sipër,<sup>2</sup> përmblihet në dy aspekte. në konceptsinin e objektit e në metodën.

Në konceptsinin tonë, konceptsin i formuar që në krye të punës e i zhvilluar më tej në vijim të saj, e në të cilin pëqemi gjer diku me disa drejtime të reja që janë dukur në këtë fushë kërkimesh, etimologjia nuk është një me hetimin e gurrës së një fjale, e as duhet të ndalet me diktimin e kësaj gurre. Ajo përfshin diçka më tërësore. atë që mund të quhet jeta e fjalëve në një kuptim të përgjithshëm. Objektin e saj e përbëjnë kështu zona e përhapjes sot e dikur të fjalës, mjedisi ku u formua, historia e saj dhe zhvillimi i brendshëm i saj, pjeçlloria e saj në degëzimet e mëtejme në forma e kuptime sekondare, aftësia e saj për të formuar rrjedhoja. kompozita e neologjizma, lidhjet me fjalë të tjera përbrenda leksikut të gjuhës, vitaliteti i saj në të zëvendësuarit e atyre, ose anasjelltas vjetërimi, zhdukja e zëvendësimi i saj me fjalë të tjera. Në këtë mënyrë çështja e burimit të një fjale duhet të bëjë pikënisjen për historinë e saj, e pikëmbërritjen për studimin e kësaj historie. Kjo çështje, pra, duhet të përbëjë shkallën e fundit në shkallaren shumëpjesëshe të kërkimit, si përfundim logjik i kësaj, dhe jo objektin e pandërmjemë me një kapërcim nga gjendja e sotme drejtpërdrejt te gurra primare e fjalës. Kërkimi vetë, në vend që të kapet pas disa elementesh të pakapshme e të përfaqërishme, duhet t'u mbahet elementeve»

1) Shih *po ai, po aty*, 40.

2) Këtu ai ka parasysh materialin leksikor që ka përmendur në faqet e mëparshme të veprës.

që janë të qarta e të sakta. Studimi etimologjik i shqipes duhet, më në fund të jetë i tillë që të paraqesë, qoftë edhe në mënyrë indirekte, edhe një pamje të historisë së formimit të leksikut të saj dhe të rrugëve nëpër të cilat u formua.»<sup>1</sup>

Përsa i takon rrugës (metodës) së ndjekur në studimet e tij etimologjike, shih I/27.

5. Për një autor studimesh etimologjike të gjuhës shqipe ishte e natyrshme t'i kushtonte një vëmendje të posaçme edhe çështjes së huazimeve të kësaj gjuhe nga gjuhët e tjera në rrymë të shekujve. Shqyrtimi i kësaj çështjeje ishte i pashmangshëm qoftë edhe për arsyen e thjeshtë se ajo kishte tërhequr prej kohësh vëmendjen e shumë gjuhëtarëve të huaj, ndonjë prej të cilëve kishte arritur ta tepronte duke e quajtur 'shqipen si «gjuhë të përzier» gjysmëromane.<sup>2</sup> Çabej, me objektivitetin shkencor që e karakterizonte, e ka vështruar këtë çështje në shumanshmërinë e saj. Në radhë të parë, ai ka pasur gjithnjë parasysh faktin e njohur që shqipja, ashtu si çdo gjuhë tjetër, në periudhën postetnike të saj e ka pasuruar vazhdimisht leksikun e vet me fjalë të reja, të krijuara pjesërisht nga fondi i trashëgimit, pjesërisht nga elementi i huazuar.<sup>3</sup> Ai, pra, e ka vështruar leksikun e shqipes në zhvillimin e tij të pandërprerë. Veç kësaj, ai me të drejtë mendon se «ndarja e dikurshme e pasurisë leksikore nga kjo anë në dy grupe, këndeje fjalët e një trashëgimie të lashtë indoevropiane, andej huazimet, nuk mund të mbahet».<sup>4</sup> Ai shton se «midis këtyre dy grupeve qëndron masa e madhe e fjalëve të përfutuara gjatë zhvillimit të brendshëm të gjuhës, me rrjedhime [= fjalë të prejardhura — Sh. D.], kompozita, formime onomatopeike e «elementare», leksikalizime të ndryshme, kryqëzime fjalësh etj., këto të gjitha si prej fjalësh të vendit si prej huazimesh.»<sup>5</sup> Gjithashtu, ai ka parashtruar kërkesën e drejtë që, si për fjalët me burim vendës ashtu edhe për huazimet, të merret parasysh përhapja gjeografike dhe

1) *Po ai, po aty*, 46.

2) Kështu, p.sh., e ka quajtur G. Majeri në artikullin *Die lateinischen Elemente im Albanesischen (Elementet latine në shqipe)*, botuar në *Grundriss der romanischen Philologie* (1888), I, f. 805.

3) Shih E. Çabej, *Studime etimologjike*, I, 69.

4) Shih *po ai, po aty*, 115.

5) Shih *po ai, po aty*, 115 v.

## Eqrem Çabej

denduria e përdorimit. Veç këtyre, ai ka theksuar se duhet bërë dallimi midis një huazimi të mirëfilltë dhe një *kalku* (= përkthimi) gjuhësor, siç është, p.sh., rasti i emërtimit të ditëve të javës e *hënë*, e *diel*, me fjalë të burimit vendës *hënë*, *diell* por në bazë të modelit latin *lunae dies*, *solis dies*.

6. Duke u mbështetur në këto kritere të drejta (§ 5) ai ka arritur në përfundimin se elementi i trashëguar «nga pikëpamja cilësore në historinë e shqipes pa dyshim zë kryet e vendit»;<sup>1</sup> ka vënë në dukje gjithashtu se «sasia e elementit të huazuar dhe sasia e elementit të vendit tregojnë më një anë shkallën e ndikimit të huaj mbi shqipen, më anë tjetër shkallën e rezistencës së kësaj gjuhe.»<sup>2</sup> Dhe, si rrjedhim i shqyrtimit të shumanshëm të huazimeve të shqipes në raport me elementin e trashëguar, duke i vështruar të dyja këto komponente të leksikut të kësaj gjuhe në zhvillimin e tyre historik, Çabej është pajtuar me kritikën e drejtë që i është bërë G. Majerit për mbivlerësimin e elementit të huaj në fjalorin e shqipes. Siç dihet, ky gjuhëtar me origjinë gjermane, i cili ka merita të padiskutueshme në fushën e albanologjisë, duke pasur në dorë një material jo aq të pasur dhe duke mos bërë dallimin e duhur midis huazimeve të mbarë gjuhës dhe atyre me përhapje të kufizuar (sidomos tek arbëreshët e Italisë dhe të Greqisë), arriti në disa përfundime të pasakta,<sup>3</sup> ndaj të cilave edhe E. Çabej, ashtu si edhe disa gjuhëtarë të tjerë para tij,<sup>4</sup> ka mbajtur një qëndrim kritik të drejtë. Por, me këtë nuk duhet kuptuar që gjuhëtari ynë e ka nënvlerësuar ndikimin e huaj mbi leksikun e shqipes. Përkundrazi, ka pasur raste që disa fjalë të mbajtura më parë si fjalë vendi, ai i ka shpërguar si huazime.<sup>5</sup> Por, nga ana tjetër, ai ka argumentuar se

1) Shih *po ai, po aty*, 106.

2) Shih *po ai, po aty*, 113.

3) Nga 5140 fjalë që trajton në Fjalorin e tij etimologjik, ai vetëm 400 dmth. 7.77% për qind i nxjerr me më shumë a më pak siguri trashëgimi indoevropiane, nja 730 të tjerave nuk ua ka zbërthyer etimologjinë dhe tepriçën i nxirrte huazime nga gjuhë të tjera.

4) Mjafton të përmendim këtu mendimin e gjuhëtarit anglez, Stuart Man (1948), sipas të cilit numri i fjalëve vendëse konstatuar prej Gustav Mejerit, së paku mund të pesëfishohet (sh. Çabej, *vep. e cit.* 113).

5) Si të tilla ai përmend, ndër të tjera: *i aftë*, *bagëti*, *binjak*, *borigë*, *i dobët*, *hir*, *kaçile*, *kodër*, *mashën*, *mjerë*, *nofull*, *palaré*, *perëndi*, *qull* etj., etj. (shih *vep. cit.* 116, shën. 1).

mjaft fjalë që janë mbajtur për huazime, në të vërtetë janë ose fjalë të trashëguara, ose zhvillime të brendshme të gjuhës shqipe<sup>1</sup>. Për më tepër, ai ka bërë përpjekje serioze edhe për të ndriçuar më tej se në cilat sfera të fjalorit të shqipes mbizotëron elementi vendës dhe në cilat sfera është më i përhapur elementi i huaj. Dhe këtu po japim një pjesë të përfundimeve, ku ka arritur ai për këtë çështje.

«Nga një vështrim paraprak, po i mbështetur me një studim të gjatë të leksikut të shqipes nga kjo anë, neve na del që elementi i trashëguar mbizotëron në atë pjesë të tij që ka lidhje me një jetë më afër natyrës e me një ekonomi e një kulturë më fort baritore-agrare, elementi i huazuar — në pajtim me vetë karakterin e huazimit — në atë pjesë që i përket një veprimtarie njerëzore më të shumanshme në fushën e kulturës materiale e morale, megjithëse do shënuar që pjesa e leksikut abstrakt e të ideve është në shqipen më e konsiderueshme nga sa mund të mendohet. Nga shqyrtimi i një sasive numerikisht të kufizuar, po që përmban fjalë popullore të një përdorimi më të përgjithshëm, si nga ana e kuptimit si nga e shtrirjes territoriale, ne arrijmë dora-dorës në këtë përfundim: nga nomenklatura e konfiguracionit të terrenit, ndër 51 fjalë na dalin 34 të vendit e 17 huazime, nga ajo e dukurive atmosferike, ndër 44 fjalë — 30 të vendit e 14 huazime, nga ajo e astronomisë popullore, në 13 fjalë — 9 të vendit e 4 huazime, nga ajo e ndarjes së kohës, duke përfshirë aty edhe numrat e ngjyrat, në 78 fjalë — 50 të vendit e 28 huazime, nga fusha e bimësisë, në 113 fjalë — 66 të vendit e 47 huazime, nga ajo e blegtorisë dhe e bulmetorisë, në 108 fjalë — 63 fjalë vendi dhe 45 të huazuara, nga emërtimet e trupit të njeriut dhe e funksioneve të tij ndër 157 fjalë — 90 të vendit e 67 huazime. Sikundër shihet, elementi i trashëguar në këto sfera leksikore del më i madh se ai i huazimit, me 342 përkundrejt 222 në gjithsej 564 fjalë. Mbizotëron përkundrazi elementi i huaj në disa sfera të tjera. Kështu në nomenklaturën e botës shtazore, ndër 145 fjalë gjejmë 70

---

1) Si të tilla ai përmend, ndër të tjera: *arnoj, bërsi, bërthamë, bërrakë, bërryl, bishtaje, bjeshkë, blej, bletë, bli (peshk), bluaj, bollë, borë, brisk, burbuqe, cëril, cingël, cipë, cucë, çun, dallëndyshe, dend, dëllinjë, dërrasë, dhelpër, eci, fshat, fshi, fushë, fyt, gërshërë, etj. etj. (Shih vep. e cit. 108.).*

## Eqrem Çabej

të vendit dhe 75 huazime, në atë që i përket jetës së njeriut (lindje, martesë, vdekje), ndër 98 fjalë — 48 të vendit dhe 50 huazime, në atë të veshmbathjes, të tualetës e të ushqimit, ndër 174 fjalë — 74 të vendit dhe 100 huazime, në atë të banimit e të pajisjeve shtëpiake, ndër 158 fjalë — 43 të vendit dhe 115 huazime, në atë të detarisë, të lundrimit e të peshkatarisë, në 34 fjalë — 12 të vendit e 22 huazime, në atë të bujqësisë, në 81 fjalë 34 të vendit e 47 huazime, në atë të bimëve të kulturës, në 46 fjalë vetëm 6 të vendit përballë 40 huazimeve, nga ajo e mjeshtërive dhe e veglave të tyre, në 100 fjalë — 34 të vendit dhe 66 huazime, nga besimet popullore, në 24 fjalë vetëm 4 të vendit dhe 20 huazime, ndërsa emrat e metaleve janë të gjitha burimi të huaj. Kështu, në këto sfera të shikuara së bashku, ndër 860 fjalë, 325 të vendit qëndrojnë përballë 525 huazimeve. Gjithsej, pra, në 1424 fjalë të marra në shqyrtim, 667 fjalë vendi qëndrojnë përballë 757 huazimeve»<sup>1</sup>.

Në të gjitha rastet e shqyrtuara autori ka pasur parasysh vetëm ose kryesisht fjalët e parme. Po të merren në vështrim edhe fjalët e prejardhura e të përbëra si edhe denduria e përdorimit të çdo fjale të shqyrtuar, shifrat natyrisht do të ndryshonin dhe elementi i brendshëm do të dilte më i pasur.

8. Lidhur me marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera gjatë shekujve, për të cilat u bë fjalë edhe në kreun II, §§ 7-18, E. Çabej është përpjekur t'i shikojë ato në mënyrë sa më të plotë, duke vënë në dukje se edhe gjuhët e tjera, sidomos gjuhët ballkanike, diçka kanë marrë nga shqipja. Megjithëse e ka pranuar që për arsye të ndryshme historike, siç janë, ndër të tjera, pushtimet e gjata të Shqipërisë nga fuqi të huaja, shqipja më shumë ka marrë sesa ka dhënë, ai ka theksuar edhe se «kontributi i shqipes, si një nga gjuhët e lashta të kësaj treve [= të Ballkanit], në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike është një nga temat që meritojnë të studiohen më në thellësi e me një frymë objektive në të ardhmen.»<sup>2</sup>

9. Edhe nga këto shënime të përmbledhura del pak a shumë e qartë se sipas Çabejt, «Nga aspektet e ndryshme të

1) *Po ai, po aty*, 114 v.

2) *Po ai, po aty*, 115. Shih edhe kreun II/17.

## Ëqrem Çabej

një fjale me rëndësi themelore për etimologjinë është historia e saj, sepse me sqarimin e kësaj ane përmbushen shumë herë edhe kushtet për konstatimin e burimit të fjalës. Në njëfarë vështrimi etimologjia nuk është tjetër veçse historia e fjalëve, e shikuar më tutje, d.m.th. histori fjalësh pjesërisht e dokumentuar, pjesërisht e rindërtuar, dhe e gjurmuar si të thuash gjer në fund. Për të ndriçuar këtë anë të jetës së fjalës, para së gjithash, duhet që në kushtet e veçanta të shqipes, me traditën e vonë të shkrimit të saj, për një fjalë që dokumentohet sidomos me dëshminë e teksteve të vjetra, të ndiqet zhvillimi që ka kryer nëpër kohë, duke nisur me vendin e veprës ku shfaqet për herë të parë dhe duke caktuar trajtën dhe kuptimin me të cilat paraqitet aty. Një punë e mëtejme në këtë drejtim është që nga format e kuptimet e ndryshme, me të cilat paraqitet një fjalë e tillë, të shikohet se cilat kanë më gjasë të jenë forma dhe kuptimi bazë për shqipen, pra ajo formë e ai kuptim që mund të arrihen me mjetet e kësaj gjuhe. . . Caktimi i formës dhe i domethënies së kryehershme të një fjale përbën kushtin e parë të një etimologjie rigoroze». <sup>1</sup>

10. Por duhet pasur gjithnjë parasysh se caktimi i formës dhe i domethënies së kryehershme të një fjale të shqipes nuk është baras me formën dhe domethënien, me të cilat ajo paraqitet në dokumentimin e saj të parë. Autori e ka bërë të qartë më se një herë se fjalët e gjuhës shqipe, sidomos ato më të vjetrat, kanë pësuar ndryshime të mëdha formale dhe kuptimore gjatë evolucionit të tyre parahistorik dhe historik. Dhe kjo përbën edhe vështirësinë më të madhe në rastin e gjuhës shqipe, që për arsye të njohura ka nisur të lëvrohet me shkrim relativisht mjaft vonë (shih edhe VI/5). Megjithatë, dija nuk është ndalur edhe përballë një vështirësie të tillë. Veçse kapërcimi i saj kërkonte njohjen e mirë të ligjësave të evolucionit parahistorik dhe historik të sistemit gjuhësor të shqipes.

11. Përsa i takon evolucionit parashkrimor të anës formale të fjalëve të vjetra të trashëguara, një gjë e tillë mund të sqarohet vetëm duke pasur parasysh, në radhë të parë, ligjësitë e evolucionit të sistemit fonetik të shqipes, dmth të dhënat e fonetikës historike. duke i plotësuar këto edhe me të dhënat e gramatikës historike të kësaj gjuhe, përfshirë këtu edhe

---

1) Shih *po ai, po aty*, 53 v.

## Eqrem Çabej

rastet e zhvillimeve analogjike. Kjo është edhe arsyeja kryesore që etimologu ynë i shquar gjatë tërë jetës së tij u ka kushtuar vazhdimisht një vëmendje të posaçme problemeve të fonetikës historike dhe, krahas këtyre, edhe atyre të gramatikës historike të gjuhës shqipe, duke dhënë edhe në këto dy fusha ndihmesa me vlerë (shih kreun IV). Dhe për këtë mjafton të kemi parasysh edhe ç'pohon vetë ai lidhur me këtë çështje:

«Si u zu ngoje edhe më lart (f. 33), një nga kushtet kryesore që një etimologji të jetë e drejtë, është që ajo të përmbushë kërkesat e rregullave fonetike. Etimologjia merr dritë të re nga parimet që zotërojnë në sistemin fonetik e morfologjik të gjuhës, duke përfshirë aty edhe fjalëformimin, po dihet më anë tjetër që etimologjitet e drejta bëhen burimi kryesor për konstatimin e vendosjen e rregullave fonetike dhe për zëvendësimin e rregullave të gabuara me të tjera më të drejta. Për të dhënë ndonjë shembull edhe për njërin anë të çështjes edhe për tjetrën, po përmendim se, kur kompleksi fonetik latin *inv-* në ballë fjale ka dhënë në shqipe *f* në *invitare: ftoj*, nuk ka si ai kompleks të ketë dhënë *më-* ose *mp-* në *mësoj mpsoj* nga një bazë latine *\*invitiare (vitium «ves»)* e ndërtuar mbi dëshininë e rumanishtes *invăta «mësoj» etj.*<sup>1</sup>, prandaj kjo e dyta etimologji nuk është e drejtë.»<sup>2</sup> Autori vazhdon më tej me shembuj të tjerë në mbështetje të mendimit të tij, por ne këtu nuk po i riprodhojmë, për të mos e ngarkuar këtë kapitull pa nevojë. Megjithatë, e quajmë të arsyeshme të riprodhojmë edhe një pjesë tjetër të shkurtër nga arsyetimi i tij, duke qenë se aty ka edhe ndonjë ndihmesë vetjake të tij.

«Duke kaluar në konsonantizëm, në fushën e mbylltoreve (okluziveve) ndërndërrimi (alternimi) *k:s* në refleksat shqiptare të labiovelarit indoevropian *k<sup>u</sup>* vërtetohet edhe me çifte trajtash, si *darkë: darsmë* e *vdekur: vdes*. Te të ashtuquajturat velare të thjeshta një shpjegim më real i grupit ku hyjnë, ndër të tjera, *dergjem, ergjëz, gjej, gjeth*, shpie në një kuptim e formulim të reflektimit të këtyre grykoreve (guturaleve) indoevropiane në shqipe, duke parë te këto fjalë, jo si më parë, reflekse të një serie grykore më vete (velare), po

1) Kështu e shpjegon G. Majeri në fjalorin e tij, f. 276.

2) Po ai, po aty, 78.

formime analogjike të periudhës historike të kësaj gjuhe. Për paraqellzoret (prepalatalet) e sotme *q:gj* dihet se keto pjesërisht reflektojnë grykore të thjeshta (*qas, qesh, gjedh, gjehe* etj.), pjesërisht grupe *kl, gl* (*quaj, qumësht, gjemb, gju* etj.), prandaj gjurmimi etimologjik do të ecë edhe këtu me hap të matur.<sup>1</sup> Konstatimi i një rregulle fonetike të re, që përfshin një grup fjalësh që nisin me *z*, si *zet* (*njëzet, dyzet*), *i zi* fem. *e zezë, ziej, zog*, dhe një shpjegim më i drejtë i disa fjalëve që përmbajnë një *s*, si *nesër, sulem, vise*, shpie në përfundimin që *s, z* përjashtohen si reflekse të qiellzoreve (palatalcve) indoevropiane në gjuhën shqipe, duke mbetur si të tilla vetëm spirantet ndërthëmbore (interdentale) *th, dh* (ose një *d*)...<sup>2</sup>

Siç shihet, në rastin e fundit është fjala për një evolucion fonetik shumë të hershëm, nëpërmjet të cilit shqipja karakterizohet si një gjuhë e tipit *satem*. Pra, kërkesa e autorit tonë është që të mbahen parasysh të gjitha rregullsitë e evolucionit fonetik të shqipes, që nga më të vjetrat e deri te më të rejat.

12. Por gjatë punës së tij shumëvjeçare ai ka vënë re jo rrallë se «disa zhvillime tingujsh nuk janë shkaktuar me rrugë thjesht fonetike, po janë kryer në ngrëthim të strukturës gramatikore, janë kushtëzuar nga fleksioni në kuptimin e gjerë të kësaj fjale, pra lidhen me disa rregulla morfologjike. Në këtë mënyrë etimologjia dhe gramatika historike ndriçojnë njëra-tjetrën».<sup>3</sup> Duke e konkretizuar këtë mendim, ai përmend, ndër të tjera, rastin kur forma e shumësit të një emri ka zëvendësuar atë të njëjësit përkatës, i cili del kështu me një temë ku shfaqet metafoia *a : e* ose «thyerja» *e : i* (shih IV/11), e kombinuar shpesh edhe me formante të shumësit, siç janë *-e, ën, / ër, -(ë)z*, palatalizimi i bashkëtingëllores (grykore, hundore a likuide) etj. Është fjala për forma të tilla shumësash të singularizuar, si: *bredh-i, burbuqe, çerdhe, dele, dem, derr, dirk, enë, eshtë, fije, rreth* etj. (shih edhe IV/15-16.). Ai shton se një veprim i tillë analogjik vihet re edhe te folja, ku ndeshen gjithashtu, forma të tilla metafonike, si: *derdh, erdha* (khs. *ardh-ur*), *ngel, shkel, ther* etj.<sup>4</sup>

1) Khs. edhe Pedersenin, KZ 33, 535 vv.

2) Shih *Po ai, po aty*, 81.

3) Shih *po ai, po aty*, 88.

4) *Po ai, po aty*, 88.



## Egrem Çabej

13. Siç u vu në dukje më sipër (§ 9), E. Çabej me të drejtë kërkon që krahas hulumtimit të formës së kryehershme të një fjale, të bëhen edhe përpjekje për të gjetur kuptimin e kryehershëm. Natyrisht, në këtë fushë hulumtimesh paraqiten vështirësi të mëdha, sidomos për fjalët më të vjetra të trashëguara.<sup>1</sup> Por edhe për kuptimin e kryehershëm të fjalëve të vendit ai ka bërë një punë të madhe. Për të arritur në përfundime sa më të sigurta, ai edhe në këtë rast ka vepruar ashtu si me format e fjalëve. «... edhe aty nuk do të kryhet një shkapërcim nga më e lashta me një hov në të tanishmen; nëpërmjet një rindërtimi historik do të gjurmohen shkallët e zhvillimit dhe do të bëhen përpjekje për të gjetur kuptimin e kryehershëm, gjenetikisht më të moçmin, ndër përdorimet e ndryshme të fjalës. Duke ia nënshtruar fjalët analizës semantike del se, p.sh., tek *ag*, *agon* kuptimi bazë, thelbi kuptimor është errësirë», te *bërryl* është «hark»,... te *erdha ardhur* «ngrihem», të *fal* «ul, përul, përvë», te *fik* «ter, thaj», te *gjej* «godit qëlloj»... te *hime* «krunde të imëta»: «i imtë, bluar hollë» dhe te *imtë* vetë «i hollë si hiri» etj., etj.<sup>2</sup>

14. U ndalëm pak më gjatë në çështjen e rindërtimit të formës dhe të kuptimit të kryehershëm të fjalës. duke qenë se, siç u vë në dukje edhe te §§ 3-4, në punë të hulumtimit të burimit etimologjik të fjalëve të shqipes Çabej i ka dhënë rëndësi më të madhe krahasimit historik të brendshëm dhe kjo rrugë i ka dhënë mundësi atij të arrijë disa përfundime të rëndësishme. Por me këtë nuk duhet kuptuar që ai e nënvleftësonte krahasimin historik të jashtëm. Përkundrazi. jo vetëm në studimet etimologjike. por edhe në shumë punime të tij të tiera me karakter diakronik, ai e ka plotësuar sistematikisht krahasimin historik të brendshëm me krahasimin historik të jashtëm, sa herë që një punë e tillë ka qenë e nevojshme. Dhe këtë punë ai e ka kryer me kompetencë dhe objektivitet shkencor, falë edhe njohjes së mirë jo vetëm të gjuhëve kla-

---

1) Për huazimet kjo punë lehtësohet mjaft nga krahasimi i kuptimit të një huazimi në gjuhën shqipe me kuptimin e tij në gjuhën dhënëse. P.sh., kuptimi më i hershëm i fjalës *ndëgjoj* (nga latinishtja *intelligo*) ka qenë «kuptoj», që del edhe tek autorët e vjetër dhe tek arbëreshët e Italisë; kuptimi i sotëm i kësaj foljeje është më i ri.

2) Shih *po ai, po aty*, 54 v.

sike, por edhe shumë gjuhëve të tjera, si: gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja, rumanishtja, greqishtja etj.

15. Si rrjedhim i natyrshëm i gjithë asaj pune të madhe që bëri ai në këtë fushë studimesh, shumë etimologji të meparshme u saktësuan më tej, u korrigjuan, ose u cilësuan të pasakta. Për më tepër, ai shqyrtoi etimologjikisht edhe shumë fjalë të patrajuara më parë. Këtu do shënuar se ndër etimologjitë e argumentuara si të pasakta përfshihen jo vetëm fjalë që më parë mbaheshin si huazime,<sup>1</sup> por edhe fjalë që janë mbajtur si të gurrës indoevropiane, kurse në të vërtetë janë zhvillime të mëvonshme të shqipes. Të tilla janë, ndër të tjera, fjalët *ban, banesë, barë, (i) bie* «*rrah, godit*», *bisht, blozë, brimë, brumë, bushtër, byk, danë/darë, dështoj, i epër, errët, i imtë, jetë, kallëzoj, kërmill, kthjell, i lashtë, lajthi, lang/lëng, i lum, nesër, nxit, njollë, prehën/prchër, prish, sillë, sipër, i tillë, thëllëzë, thëllim, thënegël, thëni/thëri, thumb, vïc* < *vitsh, vonë, ylber* etj., etj.<sup>2</sup>

Pas këtyre saktësimeve autori vazhdon: «Krahas me këto zbritje ndërkaq, një shqyrtim i ri i materialit, i ndihmuar edhe nga burimet e reja për të cilat u fol më lart, ka sjellë edhe shtime në leksikun indoevropian të shqipes dhe këtë me tri rrugë, për një pjesë me elemente të pavëna re gjer më sot, për një pjesë me një interpretim të ri, të ndryshëm nga i gjer-tanishmi, i elementeve të ditura dhe më parë, për një pjesë me përforcim të disa etimologjive të dhëna prej të tjerësh.<sup>3</sup> Dhe këtu ai rendit një listë të gjatë fjalësh të tilla, nga të cilat po përmendim vetëm disa: *afër, ager me gare e çac* «*pulisht*», *agón, áj/ënjt, ajkë, anë, aq, arbën/arbër arë, anzë/arzë, baltë, bashkë (leshi) bij, bli, bri, buj, curr, dal, daltë, dardhë, dash, dell, des/ vdes, di, djalë, dosë, dre/drë, dritë, druaj, dyllë, edh, end, e enjte, erdha, ethe, ambël/embël, fyell, groshë, grunë/gru-rë, crykë, gjalm, lagje, lamë/lëmë, mang-u, mat-i, mbath, mug, ndal, nder, ndih, ndodh, ngjalë, punë, push, qark, qengj, re, regj, shalë*. etj., etj.

16. Edhe nga kjo paraqitje e përmbledhur e ndihmesave kryesore të Çabejt në fushën e studimeve etimologjike të gjuhës shqipe, del pak a shumë e qartë puna e madhe e tij

1) Për më shumë fjalë të tilla shih veprën e cituar, f. 107-108.

2) Shih *po ai, po aty*, 106 v.

3) Shih *po ai, po aty*, 107.

## *Eqrem Çabej*

në këtë fushë studimesh sa të vështirë aq edhe të rëndësishme. Nëpërmjet ndihmesave të tij të shumta tashti kemi një ide më të saktë e më të plotë për evolucionin historik të fjalorit të gjuhës shqipe në rrymë të shekujve, si për fondin e trashëguar ashtu edhe për huazimet nga gjuhë të ndryshme, me të cilat shqipja ka pasur kontakte pak a shumë të gjata në rrjedhën e historisë së saj shumëshekullore në trevat e veta në brigjet lindore të Adriatikut dhe të Jonit.

## KREU IV

# Fonetikë dhe gramatikë historike

1. Çabej, si etimolog i gjuhës shqipe, nuk mund të mendohet pa ndihmesat e tij të shumta në fushën e fonetikës historike të kësaj gjuhe. Dhe një gjë e tillë është e kuptueshme, po të kihet parasysh fakti i njohur që sqarimi etimologjik i fjalëve të një gjuhe të tillë si shqipja, me një dokumentim shkrimor mjaft të vonë, as që mund të mendohet pa njohur e pa përcaktuar sa më mirë rregullsitë e evolucionit të sistemit fonetik të saj në rrymë të shekujve, duke e vështruar këtë evolucion edhe në lidhje të ngushtë me sistemin fonetik të rindërtuar për një fazë të hershme indoevropiane. Prandaj, gjuhëtari ynë u ka kushtuar vazhdimisht një vëmendje të posaçme çështjeve të ndryshme (kryesore dhe anësore) të fonetikës historike të shqipes. E kjo duket qartë edhe nga numri i madh i studimeve dhe i artikujve, ku ai tërësisht ose pjesërisht trajton probleme të kësaj fushe. Madje, mund të pohohet me plot gojën se është vështirë të gjesh ndonjë artikull gjuhësor, ku ai të mos ketë prekur ndonjë çështje të fonetikës historike ose të fonetikës së shqipes së sotme, përkatësisht të dialekteve të saj. Si rrjedhim, ndihmesat e tij në fushën e fonetikës historike të shqipes janë të shumta. Por këto ndih-

## Eqrem Çabej

mesa mbeten sot për sot të shpërndara nëpër botime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Vdekja e papritur nuk e lejojti atë t'i paraqiste ato në një vepër sintetizuese<sup>1</sup>.

Për të mos e ngarkuar jashtë mase këtë kapitull, këtu po paraqisim përmbledhtas vetëm një pjesë të ndihmesave të shumta të Çabejt në këtë fushë studimi. Dhe po e risim me ndihmesat e tij kryesore për evolucionin e sistemit zanor të shqipes, duke e vështruar atë në ndonjë rast edhe në përqasje me rumanishten. Dhe këtu po ndalemi shkurt në disa mendime të tij mbi theksin, mbi gjatësinë dhe hundorësinë e zanoreve, mbi diftongjet, mbi zanoren ë të patheksuar dhe mbi disa dukuri morfonologjike.

2. Për theksin vlen të përmendet këtu se Çabej ka vënë në dukje se gjuha shqipe ka ruajtur gjurmë të qarta të theksimit nistor të hershëm tek emra të trashëguar si edhe te disa toponime të vjetra. Ja si shprehet ai lidhur me këtë çështje: «Në lidhje me shqipen po lejojmë të përsërisim këtu që theksimi inicial ilir dhe rregullimi mekanik i theksit në gjuhën shqipe me parimin e shpërnguljes për në rrokjen e parafundit, i konstatuar prej N. Joklit, historikisht nuk anulohet, por plotësohet në njëri-tjetrin. Ngulitja e theksit të fjalës mbi këtë rrokje në shqipen na tregon që kjo gjuhë, me bjerrien e shpesh të rrokieve fundore gjatë zhvillimit të saj, ... arriti në theksimin e rrokjes parafundore, duke kaluar nga një ritëm daktilik i fjalës (—VV) në një ritëm trokajk (—V) sikundër dëftojnë më së qarti rasat e tipit *Isammus*: Ishëm.»<sup>2</sup>

3. Një vëmendje edhe më të madhe u ka kushtuar ky dijetar disa çështjeve të rëndësishme dhe ndërprazi të vështira të evolucionit të sistemit fonetik të gjuhës shqipe, siç janë, ndër tjerë, gjatësia (kuantiteti) e zanoreve, zanorja ë e rathesuar dhe e theksuar, hundorësia, diftongjet, bashkëtingëlloret grykore, hundore, lëngëtore (likuide) efi., dhe disa dukuri morfonologjike të nërftuara gjatë evolucionit historik të shqipes. Këtu poshtë po japim shkurt disa nga ndihmesat kryesore të tij për çështjet e nësapërmendura.

4. Për sa u takon zanoreve të gjata të shqipes së dokumen-

<sup>1</sup> Në ftektin për shkollat e larta *Hurje në historinë e gjuhës shqipe, Fonetika historike e shqipes*, hartuar qysh në vitin 1959, është pasqyruar vetëm një pjesë e vogël e këtyre ndihmesave.

<sup>2</sup> Shih SF 4/1972/16 v.

## Eqrem Çabej

tuar, që autorët e vjetër shqiptarë dhe arbëreshë i shënojnë duke u dyfishuar shkronjat përkatëse<sup>1</sup>, autori ynë ka arritur në këtë përfundim: «Mua më duket se në gjuhën shqipe, sado që këtu analogjia e ka fshirë gjendjen e përparme nga shumë anë, gjatësitë e trashëguara nga një e kaluar e lashtë janë ruajtur me besnikëri. Prandaj unë, në kundërshtim me dijen e gjertanishme, besoj se për gjatësinë e shkurtësinë e një zanoreje në gjuhën e sotme nuk peshon aq shumë theksimi i saj, as vendi që ajo ka brenda fjalës, sa peshon një kriter historik, puna nëse kjo gjatësi është vazhdimi i një gjatësie origjinale të hershme apo jo. Kështu unë nuk jam i mendjes që zanoret e fjalëve njërrokëshe të theksuara ose të rrokjeve fundore të fjalëve shumërokëshe janë të gjata *si të tilla*, po ato janë të gjata sa kohë që reflektojnë një gjatësi të mëparme: qoftë kjo që të rrjedhë nga një zanore e gjatë e periudhës para-shqiptare, qoftë që të jetë rezultati i shkrirjes së disa tingujve, e cila u shkaktua sidomos nga zhdukja e rrokjes që vinte pas. Kështu sufiksi i emrave femërorë. si: *zii, njerëzii, mirësi* është i gjatë, sepse ka dalë nga një sufiks autokton *-ija*».<sup>2</sup>

Me këtë rrugë e ka shpieguar ai gjatësinë e zanoreve edhe në një varg fjalësh të tjera të trashëguara i.e. si: *mii, thii, mu-llii, bee, deet* etj., ose të huazuara nga latinishtja, si: *kuut* (<lat. *cubitus*), *mjeek* (<lat. *medicus*) etj.<sup>3</sup>

5. Një vëmendje të posacme i ka kushtuar Çabej edhe zanores ë të patheksuar dhe të theksuar. Ai ka mbrojtur tezën që ë-ja e patheksuar, e cila është përfutur nga reduktimi i një zanoreie tjetër në pozicion jashtë theksit, është një zhvillim historik i mbarë shqipes, dhe që ajo, sidomos në gegërishte, në mjaft raste me kohë ka rënë fare. Ai e ka shqyrtuar historikun e kësaj zanoreje karakteristike të shqipes në pozicion *para* dhe *pas* theksit<sup>4</sup> dhe ka pasqyruar ose rindërtuar edhe faza më të mocme të disa fjalëve që në shqipen e sotme dalin në -ë-, si: *kërp* < *kërëp*, *petk* < *petëk*, *sonte* < *sonëte* etj., ose *Pult-i* < *Pùlët* < *Pùlat*, — *Ishm* < *Ishëm* < *Isamnus* etj.<sup>5</sup>

1) Psh te Buzuku: *maa* e para, *dyy, enbi* (= mbi) etj.

2) Shih *BUSHT, SSHSH* 2/1957/208.

3) Shih *po aty*, 209 v.

4) Shih sidomos studimin e tij *Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe. BSHSH* 1/1956, 123-143.

5) Shih *BSHSH* 1/1956/125 v.

Çabej, gjithashtu, ka vërtetuar se ë-ja e theksuar dokumentohet edhe tek autorët e vjetër veriorë sidomos te Buzuku, te numërori *nje*, që tek ata del edhe me variantin *nja* ose *nji*<sup>1</sup>. Përndryshe, ë-ja e theksuar, e cila është përfutur nga një zanore tjetër e ndodhur para një bashkëtingëlloreje hundore, del vetëm në të folmet e dialektit jugor. Kurse në dialektin verior zanoret e theksuara para bashkëtingëlloreve hundore vetëm janë hundorëzuar, d.m.th. kanë marrë timbër hundor. Dhe lidhur me dukurinë e nazalizmit, Çabej ka mbrojtur tezën, sipas së cilës nazalizmi vështirë të jetë një dukuri ruajtjeje, konservimi, dhe një proces i përgjithshëm i gjuhës, por pas gjase është risim, një inovacion relativisht i ri i gegërishtes, i kryer mbase aty nga mesjeta e hershme.<sup>2</sup>

6. Një tjetër dukuri fonetike që ka tërhequr vëmendjen e Çabejt është edhe ajo e diftongjeve dhe e togjeve zanore të shqipes, që ai i ka bërë objekt studimi në disa punime të tij, sidomos në studimin *Diftongje dhe togje zanorësh të shqipërisë*<sup>3</sup> dhe në studimin *Mbi disa rregulla të fonetikës historike të shqipërisë*.<sup>4</sup> Në studimin e parë ai është marrë me zhvillimin e diftongjeve në shqipen e dokumentuar, duke vene në dukje edhe diftongjet dhe togjet zanore me karakter dialektor. Kurse në studimin e dytë ka trajtuar kryesisht evolucionin e diftongjeve indoevropiane në gjuhën shqipe, duke vene në dukje, ndër të tjera: «Shqyrtimi i reflektimit të diftongjeve indoevropiane në gjuhën shqipe na tregon se ato janë reduktuar këtu qëmoti në zanore të thjeshta. Këndej del si korolar që të gjitha diftongjet e sotme janë sekondare, ato janë përfutur në taza të ndryshme të periudhës postetnike të gjuhës pjesërisht nga segmentimi i një zanoreje, pjesërisht nga ndeshja

1) Do pasur parasysh se një ë e theksuar në gegërishte del edhe në rasën kallëzore të përemrit dëftor *ai/ajo*; trajta *a-të* dëshmohej edhe te Buzuku krahas *a-ta* (shih Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, 467).

2) Shih artikullin *Dy çështje gjuhësore* në rev. *Gjurmime albanologjike, Seria filologjike* (Prishtinë) VII, 1977, f. 27. Për sqarime të tjera lidhur me këtë çështje shih Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, 231 v.

3) Shih *BUSHT, SSHSH* 3/1958/71-85. Këtu ai ka këto raste: a) *ie* (je) b) *ie, ye*; c) *uo, ue, ua*; d) *ui*; e) *oe, ae*.

4) Shih *SF* 2/1970/80 v.

e dy zanoreve, përkatësisht e një zanoreje me një gjysmëzanore. Ky proces i dyfishtë i zhdukjes së diftongjeve të lashta dhe i formimit të diftongjeve të reja, aspektet e të cilit janë në një lidhje fonologjike midis tyre, pas mendimit tim, përbën një nga tiparet fonetike konstitutive të shqipes. Përsa i përket ndërkaq mënyrës si reflektohen diftongjet e veçanta indoevropiane në këtë gjuhë, aty ka mjaft pasiguri mendimesh».<sup>1</sup> Dhe pastaj autori parashtron mendimet e veta mbi këtë çështje, duke mbrojtur tezën që ato diftongje kanë evoluar në zanore të thjeshta dhe duke saktësuar ose korrigjuar me këtë rast edhe disa mendime të shprehura nga gjuhëtarë të tjerë para tij.

7. Në një numër të konsiderueshëm studimesh<sup>2</sup> E. Çabej ka marrë në shqyrtim mjaft çështje të diskutueshme të evolucionit të sistemit bashkëtingullor të gjuhës shqipe, duke bërë në mjaft raste plotësime ose ndreqje të mendimeve të shprehura më parë nga gjuhëtarë të tillë të shquar si Pedersen, G. Majeri etj. Por edhe në këtë rast, për të mos e ngarkuar shumë këtë kapitull, do të ndalemi vetëm në një pjesë të çështjeve të trajtuara prej tij nga kjo fushë e rëndësishme e fonetikës historike të gjuhës shqipe.

Dhe po e nisim me çështjen aq të diskutuar të reflektimit të bashkëtingëlloreve grykore (guturale) indoevropiane. Siç dihet, qysh nga fundi i shekullit të kaluar e deri sot është ndezur një diskutim i zjarhtë lidhur me pyetjen: Sa seri guturalesh janë zhvilluar në indoevropianishte dhe si janë reflektuar ato në gjuhët e ndryshme indoevropiane? Përsa i takon gjuhës shqipe, në përgjithësi është pranuar teza e Pedersenit, sipas të cilit tri seritë e zhvilluara në indoevropianishte kanë lënë gjurmë të qarta në gjuhën shqipe.<sup>3</sup> Siç dihet, Pedersen mendonte, ndër të tjera, se buzore-grykoret indoevropiane

---

1) *SF* 2/1970/80.

2) Nga këto duhen përmendur, përveç studimeve të tij etimologjike, edhe: *Për historinë e konsonantizmit në gjuhën shqipe*, *BUSHT*, *SSSH* 1/1958; *Mbi disa dukuri të historisë së gjuhës shqipe të para në lidhje me gjuhët e tjera ballkanike*, *SF* 4/1979, *Mbi disa rregulla të fonetikës historike të shqipes*, *SF* 2/1970 dhe *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* (Tiranë, 1967).

3) Për më shumë sqarime shih Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, 39 v.



## Eqrem Çabej

(qu, gu) para zanoreve të përparme -i dhe -e kanë evoluar më në fund në -s-, përkatësisht -z-, si, p.sh., *pesë* < *penq<sup>ue</sup>*, etj. E. Çabej, në vija të përgjithshme, e ka pranuar këtë tezë të Pedersenit, por duke i bërë asaj edhe plotësime, e në ndonjë rast ka shprehur edhe ndonjë rezervë. Kështu, ai ka bërë disa plotësime me interes lidhur me reflektimin e buzore-grykoreve indoevropiane para zanoreve të ndryshme, duke shtuar këtu edhe çiftet *darkë* ~ *dars-më*, *vdes* ~ *vdek-ur*. Ai ka shprehur edhe ndonjë vërejtje lidhur me reflektimin e grykoreve të thjeshta para zanoreve të përparme.

8. Një ndihmesë të mirë ka dhënë Çabej edhe lidhur me burimin e bashkëtingëllores *z* të shqipes së dokumentuar. Dhe ai ka vënë në dukje se ky tingull në shqipe mund të ketë gjashtë burime të ndryshme. Përveç rasteve të tipit *zjarm*, *ndez* etj., ku *z* është përftuar nga evolucioni i buzore-grykores *g<sup>u</sup>*- para një zanoreje të përparme, ky tingull është përftuar edhe nëpërmjet pesë burimesh të tjera. 1) Nga evolucioni i gjysmëzanores *i* indoevropiane si te *ziej* -*zet* (njëzet) etj. 2) Nga evolucioni i grupit *di*, si p.sh. te *mâz/mëz*, te folja *mëzej* etj. Një evolucion i tillë është përftuar edhe në huazimet latine, si te *gaz* < *gaudium*, *zanë/zërë* < *Diana*.<sup>1</sup> Ai ka vënë në dukje, gjithashtu, se ky evolucion është relativisht mjaft i vjetër, gjithsesi para diftongimit të -e-së në -je/ja, si te *djeg* < \**degu*, *djalë* < \**del* -etj. 3) Nga evolucioni i grupit *xhv-*, *zv-*, si tek emri *zā/zë*. 4) Nga një -s- midis dy zanoresh si te *gëzof*. 5) Nga sonorizimi i s- para një bashkëtingëlloreje të zëshme, si te *zgjebe*, *zverk*, *zgjoj* etj.<sup>2</sup>

9. Me shumë interes janë edhe të dhënat e nxjerra nga autorët e vjetër dhe nga dialektet për evolucionin e disa bashkëtingëlloreve në pozicione fonetike të caktuara, që Çabej i ka bërë objekt shqyrtimi në studimin *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*,<sup>3</sup> dhe në artikuj të tjerë studimorë. Për të mos e ngarkuar shumë këtë paraqitje, po kufizohemi këtu vetëm në sqarimet e dhëna prej këtij gjuhëtari

1) Të kihet parasysh edhe evolucioni *ti* > *s*, si p.sh. te foljet e tipit *pyes* ~ *pyet* etj.

2) Shih për të gjitha këto SF 2/1970/83 v., 94.

3) Në këtë studim janë trajtuar 1. Okluzivet dhe nazalet. 2. Tingujt l; 3. spirantet. 4. Asimilime në grupe bashkëtingëlloresh.

për tingullin *nj* dhe për evolucionin e grupeve të vjetra të bashkëtingëlloreve *nt*, *nd* dhe *ng*.

Për tingullin *nj* ai shkruan: «*n-j*-ja nistore dhe *n*-ja e butë (*nj*) që ka dalë zakonisht nga të tjerë tinguj, në gjuhën shqipe në pjesën më të madhe të saj kanë dalë në një shteg, kanë dhënë që të dyja *nj*...». Dhe për këtë ai përmend, nga njëra anë, emrin *njer-i*, që vjen nga një trajtë më e vjetër *nier* < \**ner-*, dhe *njerkë* nga lat. *noverca*, dhe nga ana tjetër foljen *njoh*, ku *nj-* ka dalë nga evolucioni i një *gn* indoevropiane. Ai ka vënë në dukje, gjithashtu, se *nj*-ja e dytë është përftuar më herët se e para. Gjithashtu, ka shtjelluar edhe evolucionin e mëtejshëm të tingullit *nj-* në të dy dialektet e shqipes gjatë shekujve të fundit<sup>1</sup>.

10. Për sa i takon evolucionit të grupeve të vjetra bashkëtingëllore *nt*, *nd* e *ng*, Çabej ka arritur në këtë përfundim: «Në kundërshtim me dijen e gjertanishme, unë jam i mendimit që grupet e lashta *nt*, *nd* e *ng* në pozicion ndërzanor (intervokalik), pavarësisht nga vendi i theksit përbrenda fjalës, nëpërmjet shkallës *nn* janë asimiluar në *n*, e cila nga puna e karakterit origjinarisht jo-ndërzanor të saj nuk pësoi zhvillimin më tej në *r* (rotacizmin) të toskërishtes...»<sup>2</sup>. Dhe për këtë ai jep një varg shembujsh si *anë*, khs. indishte e vjetër *ántah*, gotisht *andeis*, gjermanisht *Ende* etj.

Nga ky parashtrim del qartë se ai mendonte që faza e fundit (-*n*) e evolucionit të këtyre grupeve bashkëtingëllore duhet të jetë arritur në një kohë, kur në të folmet jugore nuk kishte nisur dukuria e rotacizmit, d.m.th. kthimi i një -*n*-je ndërzanore në -*r*-. Lidhur me pikënisjen dhe pikëndalimin e kësaj dukurie, ai pohon: «Nga paraqitja e kësaj dukurie në fjalë të trashëgimisë së moçme si dhe në huazimet prej greqishtes së vjetër dhe prej latinishtes, për cakun e fillimit, pikënisjen kohore, nuk mund të thuhet asgjë e sigurt; kjo dukuri mund të jetë shfaqur në një periudhë gjuhësore më të vonë dhe të ketë rrokur përnjëherë të gjitha këto fjalë së bashku. Më anë tjetër, mbi dëshminë e marrëdhënieve të ndryshme të huazimeve me gjuhët fqinje, një cak mbairimi i kohës së zgjatjes së kësaj dukurie të shqipes mund të caktohet në njëfarë mase. Meqë rotacizmi ka përfshirë

1) Shih *BUSHT*; *SSHS* 1/1958/43 v.

2) Shih *SF* 2/1970/90.

## Eqrem Çabej

huazime prej greqishtes së mesme si edhe më të vjetrat huazime prej sllavishtes dhe italishtes, në mënyrë të përgjithshme mund të thuhet që ai ka qenë në fuqi edhe gjatë njëfarë kohe pas vitit 1000 të erës sonë.»<sup>1</sup>

11. Këto pak shënime mbi disa nga ndihmesat e Çabejt në fushën e fonetikës historike të shqipes po i mbyllim me parashtrimin e përmbledhur të mendimeve të tij mbi dukurinë e metafonisë dhe të thyerjes *a : e : i*. Për metafoninë *-a-~e-* në gjuhën shqipe ai i është përmbajtur mendimit të disa gjuhëtarëve para tij që ajo është shkaktuar nga ndikimi asimilues prapavajtës i një *-i-*je fundore, e cila me kohë është zhdukur fare ose ka lënë edhe ndonjë gjurmë tjetër në qiellzorizimin e bashkëtingëllores para saj, khs.: *dash~desh* < < \*dash-i, plak < pleq \*plak-i etj.<sup>2</sup>

Në studimet e tij të ndryshme dhe sidomos në studimet etimologjike ai ka arritur të vërë në dukje edhe gjurmë të tjera të shumta të kësaj dukurie të pavënë re më parë. Nga këto po përmendim këtu vetëm disa:

Fjalën *presh*, huazim nga greqishtja e vjetër *práson*, ai e shpjegon si një shumës të singularizuar, njëjësi i të cilit dikur ka qenë \**prash* dhe shton: «Në të mirë të këtij mendimi flet puna që ky emër përdoret më fort në shumës».<sup>3</sup> Njëpërmjet metafonizimit të hershëm *a:e* i shpjegon ai edhe trajtat e dokumentuara me *-e-* të huazimeve nga latinishtja: *qerr* (< *carrus*), *gjel* (< *gallus*), *dreq* (< *draco*), *qytet* (< *civitatem*), *pushtet* (< *potestatem*), *vullnet* (< *voluntatem*) etj.<sup>4</sup>

Në punimet e tij ai ka arritur të shpjegojë drejt njëpërmjet metafonisë edhe disa trajta me *-e-* sidomos te disa folje si: *derdh* (< *dardh*), *shkel* (< *shkal*), *qelb* (khs. *kalb*), *qeth* (< \**kath*) etj.<sup>5</sup>

Jashtë vështrimit të tij nuk ka mbetur as evolucioni i njohur *e:i*, përkatësisht *a:e:i* në rastet e tipit *breg; brigje; shteg; shtigje; treg~trigje* (te Buzuku), *gardh; gjirdhe* (te Buzuku), *vend~vise etj.*<sup>6</sup>

1) Shih SF 4/1979/55 v, shih edhe Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, 237.

2) Shih Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. 101. v.

3) Shih *Shumësi i singularizuar*, 133.

4) Shih *po aty*, 134 v.

5) Shih SF 2/1970/86 v.

6) Shih *Shumësi i singularizuar*, 147 v.

12. Siç u vu në dukje edhe në I/35, Çabej gjatë veprimtarisë së tij aq të frytshme në fushën e historisë së gjuhës shqipe u kushtoi një vëmendje të posaçme edhe disa çështjeve të rëndësishme të gramatikës historike të kësaj gjuhe. Ndër këto kryet e vendit, për nga rëndësia dhe pesha e ndihmesave, e zënë pa dyshim çështja e nyjave dhe ajo e shumësit të singularizuar në gjuhën shqipe. Këtu po i përmbledhim shkurt mendimet dhe ndihmesat e këtij gjuhëtari të shquar për këto dy çështje të rëndësishme të strukturës gramatikore të shqipes si edhe për nja dy çështje të tjera të kësaj strukture (gjinia asnjane dhe disa përemra).

13. Përsa i takon sistemit nyjor të shqipes, siç dihet, në kohën e veprimtarisë së Çabejt mbizotëronte mendimi i Peder-senit (KZ 36, 311), sipas të cilit nyja shquese e gjuhës shqipe burimisht ka qenë e vendosur para emrit, ashtu si në shumicën e atyre gjuhëve, i, e, që e kanë zhvilluar këtë mjet gramatikor, si p.sh në greqishte, në gjuhët romane, gjermanike etj. Në ato rrethana, të mbroje një tezë të ndryshme për sistemin nyjor të shqipes, ishte një ndërmarrje shumë e guximshme, që kërkonte një njohje sa më të thelluar të strukturës gramatikore të kësaj gjuhe në evolucionin e saj historik si edhe një mprehtësi gjykimi dhe argumentimi, dy cilësi këto që e kanë karakterizuar dijetarin tonë të shquar gjatë tërë veprimtarisë së tij shkencore.

Problemin e nyjave të shqipes ai e ka trajtuar kryesisht në studimin e tij të gjerë: «Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe», botuar në revistën BSHSH 1963/3, f. 69-101<sup>1</sup>. Në këtë artikull shqyrtohet nga këndvështrime të ndryshme raporti kohësor midis nyjave të prapme dhe nyjave të përparme të shqipes. Pasi vë në dukje shkurt mendimin e pranuar nga të gjithë se nga pikëpamja e sistemit morfologjik i.e të dy tipat e nyjave, si e prapmja ashtu edhe e përparmja janë një risi në gjuhën shqipe, ai ndalet gjerë e gjatë në çështjen e raportit kohësor midis njëjës së prapme shquese dhe njëjës së përparme të mbiemrave të nyjshëm, të rreshtorëve etj. Dhe pas një shqyrtimi të mbështetur në një varg argumentesh, ai arrin në përfundimin, sipas nesh të drejtë, që në gjuhën shqipe kanë lindur së pari nyjat e prapme me funksion shques dhe vetëm

---

1) Botuar më parë rumanisht me titullin *Unele probleme ale istoriei limbii albaneze* në «*Studii și cercetări lingvistice*» 4/1959 (București).

## Eqrem Çabej

më vonë janë shfaqur nyjat e përparme nëpërmjet përsëritjes mekanike të formave përgjegjëse të nyjave të prapme të emrave para tyre. Pra, Çabej në këtë rast ka mbrojtur një tezë të përkundërt me atë të Pedersenit, i cili mendonte se nyja e prapme tek emri ka lindur nga anticipimi i nyjës së përparme të mbiemrit pas tij<sup>1</sup>. Me fjalë të tjera, Pedersen mendonte se nga togfjalëshi \**pus i thellë* u përftua \**pusi thellë* dhe vetëm më vonë u rishfaq nyja e përparme te mbiemri (*pusi i thellë*).

14. Tezën e tij mbi vjetërsinë më të madhe të nyjës së prapme në krahasim me nyjën e përparme të shqipes Çabej është përpjekur ta mbështesë në një varg argumentash të karakterit fonetik dhe morfologjik. Këtu po japim argumentet e tij kryesore:

1 Forma nyjore e rasës kallzore njëjës *-në* të emrave mashkullorë e femërorë (si p.sh. *mal-në*, sot *mal-i-n*, *pushë-n(ë)*, ashtu siç e vërtetoi së pari Pedersenit<sup>2</sup>, ka dalë kështu pas evolucionit fonetik të grupit bashkëtingëllor *-nt-* në *-nd-* > *nn-* > *-n-*. Këtu *-n-* ka qenë mbaresa e rasës kallzore (të pashquar), kurse *-t-* ka qenë tingulli nistor i formës nyjore të kallzores njëjës *-t-* (khs. përemrin dëftor *a-të*, pa elementin dëftues *a-* që është shtuar pas krijimit të nyjave të prapme). Në këtë rast Çabej bashkohet me mendimin e gjuhëtarit arbëresh Marko la Piana<sup>3</sup>, sipas të cilit evolucioni i lartpërmendur duhet të jetë kryer para depërtimit të huazimeve latine në shqipe, pasi ndër huazimet latine të kësaj gjuhe grupi bashkëtingëllor *-nt* nuk ka evoluar deri në *-n-*.

2 Format e nyjës së prapme kanë pësuar më shumë ndryshime fonetike se ato të nyjës së përparme: p.sh. të krahasohen në rasat gjinore e dhanore njëjës *mal-i-t* të Dajt-i-t etj.

3. Nyja e prapme «ka diçka të ngulët e të qëndrueshme si nga ana e formës, si nga ana e kuptimit». kurse nyja e përparme, shton ai, tregohet e shumëllojtë në funksionet e saj, e lëvizshme dhe elastike në paraqitje, herë-herë dhe e lëkundshme dhe e paqëndruar. «shpeshherë kalon nga një kategori te tjetra dhe në disa kushte mungon fare. . .»

4. Në togfjalëshat e tipit *thëllëzë mali* para emrit të dytë

1) *Bidrag*, 248 v., KZ 36, 311.

2) *Bidrag*, 249.

3) *Studi linguistici albanesi*, I, 129 v.

## Eqrem Çabej

shfaqet nyja e përparme, në rast se emri i parë përdoret në trajtë të shquar (*thëllëza e malit*).

5. Nyja e prapme është shumë më e ngjitur me emrin para saj sesa nyja e përparme me fjalën pas saj, e kjo dëshmon, sipas Çabejt, për një vjetërsi më të madhe të nyjës së prapme.

6. Nyja e përparme pajtohet në gjini, numër [e rasë — SH.D.] jo me fjalën ndjekëse, po me atë që i prin, khs. *mal-i i Tiranës* ~ *fush-a e Tiranës* etj.<sup>1</sup>

Teza e Çabejt lidhur me raportin kohësor midis nyjës së prapme dhe nyjës së përparme nisët nga parakushti i drejtë që nyja, për të cilën funksioni zanafillës ka qenë ai i shquarsisë, në krye të herës është përfutur pikërisht në klasën e emrave. Edhe argumentet e parashtruara prej tij në të mirë të tezës që mbron, në përgjithësi janë të mbështetura gjuhësisht.<sup>2</sup>

15. Një tjetër ndihmesë me vlerë e Çabejt në fushën e gramatikës historike të gjuhës shqipe është edhe vepra e tij e njohur *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, botuar në Tiranë më 1967. Ky studim monografik u botua më parë gjermanisht në revistën polake *Lingua Posnaniensis* VII(1959) dhe VIII(1960). Në këtë monografi përveç dukurisë së singularizimit të shumësit, që përbën çështjen kryesore, trajtohen edhe çështje të tjera të gramatikës historike të shqipes si shumësi intensiv, sqarimi historik i formimit të shumësit të disa emrave etj.

Përsa i takon singularizimit të shumësit, d.m.th përdorimit të një forme shumësi si njëjës, kjo dukuri në veprën e Çabejt është trajtuar gjerë e gjatë. Aty janë shqyrtuar forma shumësi të singularizuar jo vetëm të mbarë shqipes, por edhe të dialekteve dhe të të folmeve të veçanta, që janë përfutur në periudha të ndryshme historike. Për lehtësi studimi ai i ka shqyrtuar shumëset e singularizuara sipas këtyre grupeve:

1. Përdorëset e veglat, armët e enët. 2. Pjesët e trupit, pet-

---

1) Shih *BUSHT*, SSSH 3/1963/78 v.

2) Në të mirë të tezës së tij për vjetërsinë më të madhe të nyjës së prapme Çabej parashtron edhe argumente të tjera.

Shih artikullin e tij të cituar, si edhe Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, f. 311.

Për sqarime të mëtejshme shih Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*, f. 311, 318, 325, 329, 345.

## Eqrem Çabej

kat e stolitë. 3. Gjellët, ushqimet. 4. Shtëpia e orenditë shtëpiake. 5. Sfera sociale e mendore. 6. Hapësira, trualli, ujërat. 7. Bimësia. 8. Emrat e shtazëve. 9. Dukuritë atmosferike e reshjet. 10. Sistemi gramatikor.

Për sqarimin historik të kësaj dukurie në gjuhën shqipe ai përhon (f. 18): «Kjo dukuri gramatikore është shumë më e shpeshtë në shqipen nga sa është menduar gjer tani. Procesi që ka vepruar në këtë mes në shumicën e rasave ka qenë i dyfishtë. Së pari, është përdorur një emër në shumës, pastaj nga trajta e shumësit është formuar një njëjës i ri, pra është singularizuar shumësi. Ky proces, që shfaqet edhe në të tjera gjuhë<sup>1</sup> ka zënë shpeshherë rrënjë aq të thella, mbulimi i njëjësit të mëparmë nga ana e shumësit ka qenë aq i plotë, sa që njëjësi jo pak herë është zhdukur pa lënë gjurmë dhe duhet aftësia gjurmuese e gjuhëtarit për ta diktuar».

Dhe menjëherë pas këtij pohimi autori bën fjalë për përdorimin e shumësit me funksion intensiv (shih § 17). Dhe nga kjo mund të nxirret përfundimi që ai procesin e singularizimit të shumësit e shihte si pasojë të përdorimit të këtij me funksion intensiv.

16. Nëpërmjet shqyrtimit historik të një pjese të mirë të shumësave të singularizuar Çabej ka dhënë ndihmesa me vlerë edhe për sqarimin e mëtejshëm të një vargu elimologjish. Kështu, p.sh., ai ka vërtetuar ose sqaruar më tej se disa forma njëjësi të shqipes së dokumentuar në thelb janë forma shumësi të singularizuar. Të tillë janë, ndër të tjera, emrat që në temën e tyre të njëjësit kanë një *-e-* të theksuar, kur kjo është përfutur nga metafohia e një *-a-* je të dikurshme, siç është, p.sh., rasti i emrave *bredh*, *dem*, *elb*, *enë*<sup>2</sup>, *gjel*, *qytet*, *shëndet*, *vullnet*<sup>3</sup> etj. Të kihet parasysh edhe rastet e tipit *gjeth e qelb*, ku është vërtetuar edhe qiellzorëzimi i bashkëtingëllores *g-* në *gj-* dhe i *k-* në *q.*<sup>3</sup> Forma shumësi të singularizuara janë, gjithashtu, edhe

---

1) P.sh. në keltishte, në gjermanishte dhe në gjuhët romane (përfshirë rumanishtja), shih për këto faqe 18 (shën. 31). të veprës së Çabejt, me literaturën përkatëse.

2) Për këtë emër dëshmohet edhe sot në ndonjë të folme forma me *-a-*: *án-i*. Të kihet parasysh edhe forma e gjinisë asnjane *anë-të* te Buzuku.

3) Katër emrat e fundit janë huazuar nga latinishtja *gallus*, *civitas/jatis*, *sanit-as/-atis*, *volunt-as/-atis*.

## Eqrem Çabej

trajtat metafonike *rreth, thes, thek*<sup>1</sup>, që në shumës dalin sot me trajtat *rrath-ë, thas-ë, thak-ë*.<sup>2</sup>

Për të pasur një ide më të plotë për ndihmesën e Çabejt për këtë dukuri mjaft të përhapur të shqipes, po riprodhojme këtu një fragment nga vepra e tij (f. 145v), ku bëhet fjalë për moshën e dukurisë në shqyrtim:

«Në lidhje me këtë si më të lashta duhet të merren ato raste, të cilat kanë një shtrirje më të madhe, e sidomos ato që shfaqen që me monumentet e vjetra të shkrimit si edhe në gjuhën e kolonive shqiptare. Formimi i tyre do venduar përgjithësisht përpara kohës së traditës letrare. Këtu hyjnë në radhë të parë format metafonike, si *gjeth(e), rrëshek, thelb, thes, rreth*. . . mjaft e moçme mbase dhe më e moçme është edhe ndonjë fjalë si *shtrep*, e cila me këtë formë na del dhe në rumanishte. Një tjetër tregues të vjetërsisë së madhe të fjalëve e kemi aty ku (si p.sh te *lagje*) njëjësi i mirëfilltë është zhdukur nga përdorimi i përgjithshëm i gjuhës. Në anë tjetër format që kanë një përhapje më të ngushtë, duhet të merren si formime relativisht të reja. Në to bëjnë pjesë dhe ato që nuk dalin në monumentet e vjetra të gjuhës ose në ligjërimet e diasporës, të cilat janë arkaike nga shumë anë. Aty unë vendoj sidomos shumë fjalë nga ato që mbarojnë me *-ën, -ër* e më *-e, qëhën, gjuhën, mashën, kodër, kashër, kalmër, djepe, helle, bote*. megjithëse edhe këtu nuk mungojnë formimet e vjetra, si *lagje* dhe *kurpën*, e cila na rishfaqet në rumanishten *curpen*. Nuk mund të jetë e moçme *fije*, fjalë e kufizuar në gegërishten, sepse Buzuku në vend të saj ka *fill*. . .»

Një vëmendje të veçantë i ka kushtuar Çabej në librin e veprës për sqarimit historik të raportit midis fjalëve *vend* dhe *vise*. Pas një shqyrtimi të hollësishëm të dëshmive të emrit *vise* tek autorët e vjetër dhe në të folme të ndryshme të shqipes, ai ka arritur të vërtetojë se *vis-e* në thelb është një formë shumësi e emrit *vend*<sup>3</sup>.

17. Siç u vu në dukje edhe pak më sipër (§ 15), procesin e

1) Njëjësi i dikurshëm i emrit *gjeth* ka qenë *\*gath*. Edhe njëjësi i emrit *qelb*, që lidhet me foljen *kalb(em)* ka qenë *kalb*.

2) Shih për këto edhe Sh. Demiraj. *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, 244.

3) Shih sidomos f. 153 v. të veprës në shqyrtim.



## Eqrem Çabej

singularizimit të shumësit në gjuhën shqipe Çabej e lidhte me përdorimin e shumësit të emrave edhe me funksion intensiv. Edhe kësaj dukurie të gjuhës shqipe, e cila kishte tërhequr edhe vëmendjen e N. Joklit, Çabej i kushtoi një vend të veçantë në veprën e vet *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*. Këtu (f. 19-29) duke ndjekur kryesisht rrugën e çelur nga Vilhelm Haversi,<sup>1</sup> ai ka renditur e shqyrtuar një numër të konsiderueshëm rastesh të përdorimit të shumësit intensiv nga sfera të ndryshme të jetës, duke e vjelë lëndën përkatëse nga gjuha popullore, nga botimet shqipe (sidomos të autorëve të vjetër), si edhe nga studime të mëparshme të kësaj fushe (kryesisht nga Jokli). Këtu poshtë po rendisim, sa për shembull, vetëm disa nga shumësat intensivë të vënë në dukje prej Çabejt: *mirësitë, liqësitë, marrëzitë, pabesitë* etj. (N. Frashëri), *të keqia!, diekëqia* etj. (Buzuku); *me djersë të mëdha* (Bogdani); *lajkat, të ngje, hurat, nderet, turpet, mëritë*. (veshur në) *të zeza, paçet, helmet, hiret, grykët* (sëmundje) *shyja!, ethet*, (qaj me) *ligje, të tretat, të shtatat, të dyzetat* etj., etj.

Duke sjellë shembuj shumësash intensivë edhe nga autorët e vjetër shqiptarë si edhe nga të folmet arkaike të arbëreshëve të Greqisë e të Italisë. Çabej ka vërtetuar se kjo dukuri është relativisht mjaft e vjetër në gjuhën shqipe.

18. Në veprën në shqyrtim si edhe në botime të tjera, Çabej herë pas here është marrë edhe me çështjen e gjinisë së gjuhës shqipe në evolucionin e saj historik. Nga kjo fushë e morfologjisë historike ai ka trajtuar sidomos çështjen e lëvizjes së gjinisë së disa emrave në rrymë të shekujve si edhe atë të gjinisë asnjësore.

Siç dihet, disa emra sidomos prej burimi latin dëshmohen herë në gjininë mashkullore e herë në gjininë femërore. Është fjalë për raste të tilla, si: *qyte* - *shëndet*, *short* etj. Fjalët e këtij tipi në një fazë më të hershme të gjuhës shqipe dëshmohen si emra të gjinisë femërore. Për përdorimin e tyre si emra femërorë mjafton të hulumtohen veprat e shkrimtarëve tanë të vjetër të Veriut<sup>2</sup>. Madje, disa prej emrave të këtij tipi për-

1) *Festschrift Kretschmer* (1926), f. 39-62, *Handbuch der erklärenden Syntax*, 161.

2) P.sh. te Buzuku: *kurt* ~ *kurt-ja*, *vertyt* ~ *vertyd-ja*, *short* ~ *short-ja*, *mort* ~ *mort-ja*, *shëndet* ~ *shëndet-ja*, *qytet* ~ *qytet-ja* etj.

doren edhe sot si femërorë në disa të folme.<sup>1</sup> Kalimin e emrave të këtij tipi në gjininë mashkullore Çabej e ka shpjeguar drejt nëpërmjet anomalisë formale, që paraqitnin këta emra femërorë me fundoren e temës së tyre në bashkëtingëllore. d.m.th. ndryshe nga emrat e tjerë femërorë në përgjithësi. Kjo anomali u mënjanua ose nëpërmjet kalimit të emrave në shqyrtim në gjininë mashkullore, si p.sh. *qytet-i*, *shëndet-i*, *short-i* etj., ose nëpërmjet shtimit të fundores *-e*, ose *-ë*, karakteristike për temat e emrave të gjinisë femërore, si: *shorte ~ short-ja* (khs. *nuse ~ nusja*), *rrjetë ~ rrjet-a*, (khs. *lugë ~ lug-a*) etj.<sup>2</sup>

19. Çabej në punime të ndryshme ka treguar një interesim të posaçëm sidomos për çështjen e gjinisë asnjënëse, duke dhënë edhe për këtë ndihmesa me vlerë. Në punimet e tij ky gjuhëtar jo vetëm që e ka njohur praninë dhe karakterin indoevropian të gjinisë asnjënëse të shqipes, që disa gjuhëtarë t'u huaj në të kaluarën e kanë kundërshtuar ose e kanë vënë në dyshim,<sup>3</sup> por edhe u ka kushtuar një vëmendje të veçantë problemeve të ndryshme të kësaj gjinie në gjuhën tonë. Duke u mbështetur sidomos në gjuhën e Buzukut dhe të autorëve të tjerë të vjetër shqiptarë (dhe arbëreshë), si edhe në të folmet e ndryshme të shqipes (duke përfshirë edhe ato të arbëreshëve të Greqisë dhe të Italisë), ai e pasuroi mjaft inventarin e emrave asnjënës të dokumentuar të kësaj gjuhe. Ai i ka shtuar inventarit të njohur edhe emra asnjënës të tillë si: *barkë-të*, *djalë-të*, *dru-të*, *gji-të*, *lesh-të*, *petëk-u-të*, *veshë-të*, *vor-të* etj.<sup>4</sup> që në shqipen e sotme përdoren rregullisht si emra mashkullore.

Këtu vlen të theksohet se, për të vërtetuar karakterin indoevropian të gjinisë asnjënëse të shqipes. Çabej është mbështetur jo vetëm në krahasimin e brendshëm, por edhe në krahasimin e jashtëm të kësaj gjuhe me gjuhët e tjera indoevropiane. Midis ndihmesave të tij në këtë fushë do përmendur edhe pohimi i tij se mbaresa e shumësit *-ë* (si p.sh. tek *vesh-ë*

1) P.sh. *qiell-i* por edhe *qiell-a*, *fill-i* edhe *fije-a*, *këshill-i* edhe *këshillë-a*, *portokall-i* edhe *portokalle-ja* etj.

2) Shih *Shumësi i singularizuar*, f. 136.

3) Shih për këto Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, 184 v.

4) Shih për këto sidomos studimin e tij mbi gjuhën e Gjon Buzukut në *BSSH* 3/1955/40 v.

etj.) «na shpie te një -a e gjatë, pra te mbaresa e asnjansëve shumë të temave më -o të indoevropianishtes».<sup>1</sup>

20. Vëmendjen e E. Çabejt e ka tërhequr edhe çështja e burimit të disa përemrave të shqipes. Këtu do të ndalemi vetëm në sqarimet që ka dhënë ai për burimin e trajtave të përemrave *cili* dhe *i tillë*. Për përemrin *cili*, pasi vë në dukje shpjegimin e Pedersenit,<sup>2</sup> sipas të cilit ky përemër «nuk është gjë tjetër veçse një *si* e lakuar», që tingullin *-l-* (khs. *ci-l-i*) e ka marrë nën ndikimin e përemrit *i tillë*, Çabej shton<sup>3</sup>: «Unë mendoj se ky tingull *l-*je ka hyrë aty me tjetër rrugë. Po të sjejmë ndër mend që shumësi *farizëj* ka dhënë te Buzuku *farizëll*, dhe që shumëset *skundinj* e *kërminj* kanë dhënë *skundill* e *kërmill*, mund të mendohet që nga shumësi mashkullor të *sijtë -cilët*», zgjerim me *-j* i *si-së* ashtu si e *sija*, të *sijatë* dhe trajtë e zakonshme e të gjitha burimeve të moçme të gjuhës, u formuan një njëjës i ri *i silli* dhe pastaj dhe *i cili*. Ka mundësi që edhe *i tilli* të ketë ndikuar në atë mes.»

21. Kurse për përemrin *i tillë*, duke kundërshtuar mendimin e Pedersenit, *Albanesische Texte mit Glossar* (1895) f. 200. që e afronte këtë përemër të shqipes me latinishten *talīs* dhe me greqishten *tēlikos*, dhe duke u mbështetur në trajtat e dokumentuara të këtij përemri tek autorët e vjetër etj., Çabej arriti në një përfundim origjinal. Sipas tij, (*Shumësi i singularizuar* f. 175), «Zhvillimi që ka kryer në formën e saj kjo fjalë, është i ngjashëm me atë të përemrit *cili*, *cilli*, të cilin më lart (f. 131 v). e kemi shpjeguar nga shumësi të *cijtë*. Pra, dhe te *i tillë* skema e hershme gjan të ketë qenë *i ti* a *i tij(ë)*: shumësi të *tij*, dhe trajta e sotme me fundor më likuidë të jetë përfutur ashtu si te *kërmill*. . .»<sup>4</sup>

1) Shih BSHSH 3/1955/41.

2) Shih *Albanesische Texte*, 200, KZ 36,316.

3) Shih *Shumësi i singularizuar*, f. 175.

4) Për përemrat e tipit *kushdo* etj. shih II/10.

## KREU V

# Dialektologji

1. Për një njeri që do të merrej me probleme të historisë së gjuhës shqipe dhe sidomos me studime etimologjike të kësaj gjuhe, ishte krejt e natyrshme që të tregonte vazhdimisht një interesim të posaçëm për të njohur e për të studiuar me themel edhe dialektet e saj. Natyrisht, një vëmendje më të madhe ai do t'u kushtonte atyre të folmeve që ruanin ende një gjendje pak a shumë arkaike, sepse të dhënat gjuhësore të tyre, të krahasuara edhe me ato të autorëve të vjetër shqiptarë dhe arbëreshë, mund të ndihmonin për t'u ngjitur sa më shumë në thellësi të shekujve të mëparshëm, për të rindërtuar kështu edhe faza më të hershme të padokumentuara të kësaj gjuhe të lashtë të Ballkanit. Në këtë rast, është fjala sidomos për të folmet e arbëreshëve të Greqisë, të cilët janë shkëputur nga dheu mëmë të paktën qysh nga shekulli XIV<sup>1</sup> dhe për ato të arbëreshëve të Italisë, shtresa më e vjetër e të

---

1) Arbëreshët e Greqisë janë të shpërndarë në fshatra të ndryshme në Atikë, Beoti, Lokridë, Peloponez si edhe në disa ishuj, si Eubea, Hidra, Specia, Salamina etj.

## Eqrem Çabej

cilëve nuk është më e vonë se e shekullit XV<sup>1</sup>. Për më tepër, si ishuj gjuhësorë, të folmet e tyre kanë ruajtur më mirë disa tipare arkaike të shqipes mesjetare (shih § 7).

Prandaj nuk është aspak e papritur që diplomanti i Universitetit të Vjenës, i cili ishte përgatitur nën drejtimin e gjuhëtarëve të tillë të shquar si Paul Kreçmeri<sup>2</sup>, Norbert Jokli<sup>3</sup> etj., hapat e parë në fushën e gjuhësisë i hodhi pikërisht me një studim mbi arbëreshët e Italisë.<sup>4</sup> Për të folmet e arbëreshëve të Italisë dhe për historinë e tyre ai ka vazhduar të interesohet gjatë tërë jetës së tij. Por, njëkohësisht ai u kushtoi vëmendjen e duhur edhe të folmeve të ndryshme të Shqipërisë, për të qëmtuar e për të mbledhur nëpërmjet botimeve me karakter dialektologjik ose drejtpërdrejt nga goja e personave prej visesh të ndryshme gjithçka që paraqiste interes për historinë e gjuhës shqipe dhe për evolucionin e saj historik, si dhe për fushat e tjera të interesave të tij gjuhësore, si: ballkanistika, indoevropianistika dhe gjuha e sotme shqipe.

2. Duke qenë se në studimet e tij të ndryshme gjuhësore Çabej, siç dihet, i jepte një rëndësi të madhe edhe përhapjes gjeografike të fjalëve dhe të dukurive të ndryshme gjuhësore, nuk ishte e papritur që ai të interesohej drejtpërdrejt edhe për probleme me karakter dialektologjik. Kështu, p.sh., më 1943 ai hartoi të parin *Pyetësor për Atlasin gjuhësor shqiptar* në pesë fashikuj me 2578 çështje<sup>5</sup>. Dhjetë vjet më vonë, më 1953, së bashku me Mahir Domin, ai hartoi një pyetësor tjetër dialektologjik, me 63 pyetje të përgjithshme për hetime në të gjitha krahinat dhe 41 pyetje për krahina të vecanta. Ky pyetësor i dytë ndryshon nga i pari si në konceptim, ashtu edhe në metodë, sepse e sheh dialektin si një tërësi me sistemet dhe nënsistemet e fonetikës, morfologjisë, sintaksës dhe të leksikut dhe nuk kufizohet në kërkesa kryesisht për leksikun e gjuhës.<sup>6</sup>

---

1) Ata janë vendosur në shumë fshatra sidomos në krahinat e Kalabrisë, Bazilikatës, Kapitanatës, Puljes, Molizes dhe në ishullin e Sicilisë.

2) Shih I, shën. 4.

3) Shih I, shën. 5.

4) Shih I, shën. 5.

5) Roma, Grottaferrata, 1943.

6) Shih J. Gjinari, *Ndihmesa e prof. Eqrem Çabejt në fushën e dialektologjisë shqiptare*, SF 3/1988/94.

Por një ndihmesë edhe më të madhe ka dhënë Çabej në fushën e dialektologjisë shqiptare nëpërmjet studimeve të tij të shumta. Dhe këtu duhen përfshirë jo vetëm studimet etimologjike (shih kreun III) dhe ato mbi arbëreshët e Italisë, por edhe punime të tij të tjera si *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe* (1967), *Gjon Buzuku* (1955), *Për historinë e zanores ë në gjuhën shqipe* (1956), *Kuantiteti i zanoreve të theksuara* (1957), *Për historinë e konsonantizmit në gjuhën shqipe* (1958), *Diftongje e grupe zanoresh të shqipes* (1958), *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956) dhe *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962)<sup>1</sup>. *Dy çështje gjuhësore* (1977) etj., etj.

Për të mos e ngarkuar këtë kapitull me shumë hollësira lidhur me trajtat dhe dukuritë dialektore që ka vënë në dukje në këto punime, po përmendim këtu vetëm disa forma shumësi me karakter nëndialektor, që ai ka pasqyruar në veprën *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, ku gjejmë, ndër të tjera: *berqe* (bark), *çurep* (çurap = çorap), *çekeltë* (çakal = çakall), *gomerë* (gomar), *kelër* (kalë), *mele* (mal), *moçele* (moçal), *spanej* (spano), *sherqe* (shark), *shqep/shqepe* (shkop), *vergje* (varg) etj.; *trigje* (treg), *hendiqe* (hendek), *bubriqe* (bubrek) etj. të vobigj-të (i vobeg) etj., etj.<sup>2</sup>

3. Edhe më shumë bien në sy ndihmesat me karakter dialektologjik në *Studimet etimologjike* të Çabejt. Në këtë rast kemi të bëjmë jo vetëm me shqyrtimin etimologjik të një numri të konsiderueshëm fjalësh dialektore ose nëndialektore, por edhe me vështrimin e trajtave dialektore a nëndialektore të disa fjalëve. krahas trajtave të tyre më të përgjithshme. Nga grupi i parë po vëmë në dukje këtu shkurt: *abrash*, *acar*, *aa-u*, *aquliçe aj*, *almise*, *amvisë*, *angullin*, *arksh/argsh*, *bablok*, *babune*, *bacë*, *badër/badhër*, *bajkush*, *bajloz* etj., etj. Për një pjesë të mirë të fjalëve të këtij tipi të patrajtuara etimologjikisht më parë, ai ka dhënë sqarime të argumentuara. Mjafton të përmendim këtu analizën etimologjike që u bën ai fjalëve dialektore *arksh/argsh* dhe *bablok*.

1) Këto dy punimet e fundit ai i ka hartuar së bashku me prof. Aleksandër Xhuvanin (shih I. 19).

2) Shih *Shumësi i singularizuar*, f. 151, 147. Do pasur parasysh se trajtat dialektore që ai i ka vënë në dukje këtu dhe në punime të tij të tjera, i ka qëmtuar nga botime autorësh të tjerë ose nga mbledhjet vetjake.

## Eqrem Çabej

Fjala *arksh* (*argsh*, *arksht*, *argsht*) të gegërishtes veriore (Berishë, Mertur, Toplani, *Dushman*) që do të thotë «trinë që mbahet mbi ujë me rrëshqi të fryrë e që shërben për të kaluar lumin», sipas tij, ngjan të ketë lidhje me emrin e shkures *arrç*. Si bazë të fjalës shqipe ai vendos trajtën *ark*, e cila ka korrespondencit e saj në sllavishte dhe në letonishte, d.m.th. sipas tij, «është një konkordancë e veçantë e shqipes me sllavishten e baltishten».<sup>1</sup>

Kurse fjalën *bablok* «njëri i mirë, i pasherr, babaxhan» ai e lidh me fjalën prej burimi turk *baba-llëk*, me zëvendësimin e elementit të dytë *-llëk* me prapashtesën *-lok*. Ai shton se në bazë të etimologjisë popullore është formuar edhe trajta femërore *bablok-e* dhe se, duke u marrë fjala si *babë lok* «babë i dashur», «u sajua me analogji femërorja *nanëloke*». Por ai nuk përjashton mundësinë që *bablok* të jetë formuar nën ndikimin e *nanë loke* «duke u kryqëzuar me *baballëk* në punë të kuptimit».<sup>2</sup>

4. Por ndihmesën më të madhe në fushën e studimeve dialektologjike në kuptimin e ngushtë të këtij termi Çabej e ka dhënë pa dyshim në studimin e të folmeve arbëreshe të Italisë. Siç u vu në dukje edhe më sipër (§ 1), hapin e parë në studimin shkencor të gjuhës amtare shkencëtari i ardhshëm e hodhi me hulumtimin e të folmeve të arbëreshëve të Italisë, të cilat ia mbajtën të ndezur interesimin gjatë tërë jetës. E për këtë dëshmon qartë fakti që vështirë se gjen një punim shkencor (diakronik) të këtij gjuhëtari, ku ai të mos ketë vënë në dukje, ose të mos ketë përmendur edhe të dhëna nga të folmet e arbëreshëve të Italisë. Për më tepër, edhe punimet shkencore kush-tuar atyre të folmeve nuk janë të pakta. Nga këto vlen të përmenden këtu, përveç tezës së doktoratës, edhe këto punime kryesore: 1. *Çështja e prejardhjes së ngulimeve të arbëreshëve të Italisë në dritën kryesisht të ajuhës e të emrave vetjakë*.<sup>3</sup> 2. *Shqiptarët në Itali të mesme dhe në Napoli*<sup>4</sup>, 3. *Nga leksiku*

1) Shih *Studime etimologjike në fushë të shqipes* II, 79. v.

2) Shih po aty, 121.

3) Kumtesë e mbajtur në *Kongresin VIII Ndërkombëtar të Studimeve Onomastike* në Amsterdam (1963) dhe botuar gjermanisht në *Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences*, Paris, 1966, f. 70-81.

4) Botuar në *HD XV* (1939).

## Eqrem Çabej

i dialekteve arbëreshe të Kalabrisë<sup>1</sup>, 4. Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre<sup>2</sup>, 5. Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë<sup>3</sup> etj.

Ai është marrë edhe me studimin e folklorit dhe të letërsisë së arbëreshëve të Italisë, por për këto do të bëhet fjalë në kreun VIII. Prandaj, këtu do të ndalemi edhe pak vetëm në çështje që kanë të bëjnë me të folmet e tyre.

5. Për studimin dialektologjik të të folmeve të arbëreshëve të Italisë ishte e nevojshme që ato të vështroheshin edhe në evolucionin e tyre historik. Një vështrim i tillë ishte edhe më i pashmangshëm për një historian dhe etimolog të gjuhës shqipe, siç ishte E. Çabej. Prandaj ky gjuhëtar në punimet kushtuar të folmeve të arbëreshëve të Italisë është përpjekur që të dallojë ç'është arkaike, e trashëguar nga një fazë më e vjetër e gjuhës, dhe ç'është risi në ato të folme, e përfutur pas shpërnguljes së tyre në trualin italian. Por veçimi dhe studimi i elementeve arkaike në të folmet e arbëreshëve të Italisë e bënin të domosdoshme edhe sqarimin e pyetjes: Nga cilat vise të dheut mëmë janë shpërngulur të parët e arbëreshëve të Italisë? Sqarimit të kësaj pyetjeje, e cila nuk paraqet vetëm interes gjuhësor, E. Çabej i ka kushtuar një vëmendje të posaçme në radhë të parë për të nxjerrë disa përfundime, që në disa raste i kapërcejnë edhe caqet e një studimi të dialektologjisë historike.

6. Sipas Çabejt, zgjidhja e problemit të prejardhjes së ngulimeve arbëreshe mund të arrihet «vetëm me një metodë globale të kërkimit, duke kombinuar dëshmitë gjuhësore me të dhënat e historisë e të etnografisë: trajtat dialektore edhe omrat e familjeve, të vendeve e të shenjtoreve lokale të ngulimeve me dëshminë e dokumenteve, të regjistrave kishtarë të tyre, me traditën gojore të gjallë në Shqipëri e në Itali, me elementet e kostumeve, të dokeve e të zakoneve, me disa motive të përbashkëta të poezisë popullore, e të tjera si këto...»

---

1) Botuar gjermanisht në *Serta romanica, Festschrift für Gerhard Rohlfz zum 75. Geburtstag*. Tübingen, 1968, f. 115-124.

2) Kumbesë e mbajtur në Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike. Tiranë 12-18 janar 1968, vëll. III, f. 107-115.

3) Botuar në *SF* 2/1975/51-69.

4) Shih *Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë*, *SF* 2/1975.



## Eqrem Çabej

Ai shton se në gjendjen e sotme të studimeve mund të pohohet se arbëreshët e Italisë janë të shpërngulur nga vise të ndryshme të Shqipërisë, si edhe nga ngulimet arbëreshe të Greqisë, siç dëshmon për këtë të fundit edhe kënga popullore e njohur që nis me vargjet: «O e bukura More! Si të le e më ngë të pe»<sup>1</sup>. Në të mirë të mendimit që arbëreshët e Italisë janë shpërngulur prej visesh të ndryshme të Shqipërisë, përfshirë këtu edhe vise të Shqipërisë së Mesme dhe Veriore, autori përmend, ndër të tjera, edhe dokumente historike, gojëdhëna si edhe emra familjesh arbëreshe që e kanë burimin tek emra familjesh të vjetra dhe visesh të ndryshme të Shqipërisë, si: *Gazullus, Riolo, Skutari, Span* etj. të Shqipërisë Veriore, *Gramshi, Keta, Manes, Mates, Muzaki, Rolisi, Rada, Skura* etj. të Shqipërisë së Mesme, *Borgia* (= Borshi), *Damis, Dirmi, Dorsa, Dragota, Gropa, Kuçi, Kudes, Likursi, Lopes, Peia, Pilora, Piqerri, Varfi* etj. nga Shqipëria Jugore.<sup>2</sup>

7. Ai ka vënë në dukje, gjithashtu, se ngulimet arbëreshe të Italisë e të Sicilisë nuk janë themeluar në të njëjtën kohë. Shpërnguljet e tyre nga Shqipëria (dhe nga Greqia) kanë vazhduar afërsisht tre shekuj.<sup>3</sup> Veç kësaj, ka pasur herë pas here edhe shpërngulje e përzierje edhe brendapërbrenda vetë ngulimeve arbëreshe. E këto rrethana si edhe konvergjenca e të folmeve të ngulimeve të ndryshme kanë bërë që «arbërishtja e Italisë, me gjithë ndryshimet lokale që ekzistojnë përbrenda saj, paraqitet si njëfarë njësie, si një «*unité dans la diversité*» në mjedis të dialekteve të shqipes, një formë dialektore më vete, e cila nuk është e barabartë me asnjërin ndër dialektet e vendit të burimit».<sup>4</sup> Ai sqaron më tej se karakteri i përgjithshëm i të folmeve arbëreshe, «njëkohësisht i njësishtëm dhe kompleks, paraqitet afërsisht si vijon. Ai përmban tipare të sjella me vete prej atdheut mëmë dhe tipare të fituara në atdheun e ri».<sup>5</sup> Dhe shton: «Në lidhje me elementin e sjellë me

1) «O e bukura More! Si të lashë e më s'të pashë».

2) Shih *Histori gjuhësore...*, SF 2/1975/53 v.

3) Shpërnguljet më të vjetra janë të shekullit XV, sidomos pas vdekjes së Skënderbeut. Shpërngulje sporadike ka pasur edhe më përpara. Shpërngulja e fundit është ajo e vitit 1744, kur u themelua ngulimi arbëresh *Villa Badessa* në Abrucet (Shih SF 2/1975/51 v).

4) Shih *po aty*, 55.

5) Shih *po aty*, f. 55.

vete, i cili përbën fondin kryesor të saj, arbërishtja e Italisë pasqyron një toskërishte të një faze më të vjetër, afërsisht të mbarimit të mesjetës». <sup>1</sup> Dhe më poshtë: «Në tiparet e saj konstitutive, arbërishtja e Italisë, ashtu si dhe arbërishtja e Greqisë, i përket toskërishtes jugore, ose — mund të themi — jugperëndimore, nga pikëpamja etnolinguistike labërishtes e çamërishtes në kuptimin më të ngushtë të këtyre termave, duke vërtetuar kështu gjuha dëshmitë historike e onomastike që u përmendën më sipër. . .» <sup>2</sup>

8. Duke shqyrtuar konkretisht elementet arkaike të trashëguara të të folmeve arbëreshe të Italisë. Çabej ka vënë në dukje disa nga këto elemente, prej të cilave këtu po përmendim kundërvënien e zanoreve të gjata ndaj zanoreve të shkurtra, ruajtjen e disa trajtave fonetike të hershme si edhe disa elemente të vjetra nga fusha e gramatikës dhe e fjalorit.

Lidhur me ruajtjen e kundërvënies zanore të gjata: zanore të shkurtra (në të dy rastet të theksuara), Çabej vëren me të drejtë se arbërishtja e Italisë takohet nga njëra anë me gegërishten <sup>3</sup> dhe nga ana tjetër me toskërishten jugperëndimore. Me këtë të fundit ajo ka të përbashkët edhe evolucionin  $y > i$  (khs. *si* për *sy* etj.), si edhe thjeshtimin e grupit bashkëtingëllor *xv* në *x* (khs. *xerik* për *xverik* etj.). Në të folmet arbëreshe vihen re edhe dukuri fonetike divergjente. Kështu, p.sh., tingulli *-l* pas bashkëtingëlloreve *p-*, *b-*, *f-*, *v-* paraqitet i evoluar në *-j* në të folmet arbëreshe të Kalabrisë Qendrore (khs. *pjot*, *bjej*, *fjamur*, etj) <sup>4</sup>, kurse në të folmet e tjera në përgjithësi paraqitet e ruaj-

---

1) Shih *po aty*, f. 56. Këtu ai vë në dukje se arbërishtja e Italisë paraqet «disa tipare të përbashkëta fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore, më një anë me shqipen e Greqisë. . . , më anë tjetër me gjuhën e autorëve të vjetër të Veriut. . . sidomos me gjuhën e Mesharit të Gjon Buzukut të vitit 1555».

2) Shih *po aty*, f. 56.

3) Të kihet parasysh se autorët e vjetër arbëreshë, si Matrënga, Variboba etj. ashtu si edhe autorët e vjetër të Veriut (Buzuku, Budi etj.) zanoret e gjata i dallonin grafikisht duke ua dyzuar shkronjat përkatëse.

4) Në këtë rast Çabej shënon se një dukuri e tillë ndeshet edhe në trevat gege (më fort të Shqipërisë së Mesme e Lindore) dhe shton: «Atje çon edhe ndonjë formë si *opangë* për tosk. *opingë* në këtë krahinë, dhe *katërdiet* «dyzet» e S. Marcanos në Apuli» (SF 2/1975/59).

## Eqrem Çabej

tur.<sup>1</sup> Edhe grupet bashkëtingëllore *kl, gl, lk, lg* paraqiten të pandryshuara vetëm në disa të folme.<sup>2</sup> Edhe kalimi *ll > gh* në fjalë të tilla si *mogha* «molla», ndeshet vetëm në Hora e Arbëreshëve të Sicilisë dhe në të folmet arbëreshe të Molizes.<sup>3</sup>

2. Nga fusha e morfologjisë si elemente arkaike në të folmet arbëreshe të Italisë, të sjella nga dheu mëmë, Çabej përmend, ndër të tjera, ruajtjen e gjinisë asnjane, ruajtjen e rrjedhores së shquar shumë, disa trajta arkaike pronorësh dhe format e së ardhmes të ndërtuara me foljet ndihmëse *kam* dhe *do*.

Lidhur me ruajtjen e gjinisë asnjane në të folmet arbëreshe, «në kundërshtim me zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës në Shqipëri», në këtë pikë, Çabej ka vënë në dukje se atje janë përfutur edhe «disa asnjane sekondare». Ai ka vënë në dukje, gjithashtu, se në ato të folme përdoren më shumë mbiemrat e emëruar të gjinisë asnjane me vlerën e emrave abstraktë të formuar me prapashtesat *im* dhe *-je*.<sup>4</sup>

Si një tipar arkaik në të folmet arbëreshe të Italisë ai përmend edhe ruajtjen e rrjedhores së shquar shumë me *sh-i-t* khs. *dier-shit*<sup>5</sup> dhe të disa trajtave të vjetra pronorësh si *tu bilj* «bijtë e tu» (te De Rada), qetë *taj* «qetë tuaj» nipi *ij* (= *yj*) «nipi juaj» etj.<sup>6</sup>

10. Edhe për dy mënyrat e ndërtimit të kohës së ardhme në të folmet arbëreshe të Italisë Çabej mendon me të drejtë se të parët e arbëreshëve i kanë marrë me vete nga dheu mëmë. Është fjala për format e së ardhmes të ndërtuara me foljen ndihmëse *kam*, ose me pjesëzën e ngurosor *do*, të ndjekura nga folja themelore në mënyrën lidhore. Sic dihet, të dyja këto forma të së ardhmes dëshmojnë tek ata. Por me kalimin e kohës në të folmet arbëreshe ka mbizotëruar tipi i së ardhmes me ndihmësen *kam*, e cila në të folmet popullore edhe është

1) P.sh. te Dara i Riu gjejmë: *flamur, plak, mbloedhi* etj.

2) P.sh., te Dara i Riu gjejmë *klumëshit, klishë, klaj, gëluhë, e gëlatë* etj.

3) Shih për këto SF 2/1975/59.

4) Shih po aty, f. 59, 61.

5) Khs. në këngën popullore, që e ka shfrytëzuar edhe G. Dara në veprën e tij *Kënga e sprasme e Balës, Gjëmëshit, lumbardhashit* — gjithë jeta më gjëmoi...

6) Shih për këto, *art. cit.*, SF 2/1975/61, 63.

## Eqrem Çabej

përgjithësuar në formën e vetës së tretë njëjës *ka*. P.sh. se *ka* t'ia *japë* plaks, se *ka* më *japë* bishtin. Lazëri ngë [= nuk] *do* t'ju *vdësë* etj.<sup>1</sup>

11. Edhe për ndërtimet e tipit *u jam e t'e jap* «unë jam duke ta dhënë», *isht e bun* te tirkû «është duke thurur çorape» etj., që janë aq të përhapura në të folmet arbëreshe të Italisë. Çabej mendon se në thelb janë «zhvillimi i mëtejme në rrethana gjuhësore të atdheut të ri i një prirjeje të sjellë me vete prej atdheut të burimit». Por në këtë rast ai nuk përjashton edhe ndonjë ndikim të jashtëm nga të folmet rreth e rrotull.<sup>2</sup>

12. Një vëmendje të veçantë i ka kushtuar Çabej edhe shtresës më të vjetër të fjalorit të të folmeve arbëreshe, duke u ndalur sidomos në ato fjalë që paraqitin më shumë interes për historinë e gjuhës shqipe në përgjithësi. Kështu, p.sh., në punimet e tij ka vënë më shumë në dukje disa fjalë të vjetra të trashëguara, që në shqipen e sotme zakonisht nuk përdoren më ose dalin me të tjera kuptime, si edhe turqizmat që ndeshen në të folmet e ndryshme të arbëreshëve të Italisë. Nga fjalët e grupit të parë po përmendim këtu numërorët *trezet*<sup>3</sup> e *katërzet* (krahas *njëzet e dyzet*) në vend të të zakonshmeve *gjashëdhjetë* e *tetëdhjetë*, si edhe fjalët *gjellë* «jetë», *tëtin* «mot i ftohtë, ftohme», *prirem* «kthehem», *shtuara* «më këmbë», etj. Një pjesë e mirë e këtyre fjalëve ndeshen edhe në të folmet e arbëreshëve të Greqisë dhe në disa të folme të vetë Shqipërisë, si edhe tek autorët e vjetër të Veriut. Të tillë janë, p.sh., numërorët *trezet* e *katërzet* që paraqisin një «zhvillim të mëtejme të sistemit vigesimal».<sup>4</sup>

13. Praninë e shtresave të ndryshme turke në të folmet e arbëreshëve të Italisë Çabej e ka shqyrtuar në mënyrë të veçantë në studimin e tij *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes*.<sup>5</sup> Siç kuptohet edhe nga titulli i këtij punimi, për shtresimin kronologjik të huazimeve turke të shqipes ai është mbështetur, ndër të tjera, edhe në shtresimin e këtyre huazimeve në të folmet e ngulimeve të ndryshme arbëreshe. Siç u vu në dukje edhe në § 7, këto ngulime u përkasin

1) Shih *po aty*, 65.

2) Shih *po aty*, 66 v.

3) Ai ka shënuar edhe *trezetedhjetë* «shtatëdhjetë».

4) Shih *po aty*, 59 v.

5) Botuar në *SF* 4/1975.

periudhave që nga shekulli XV e deri në vitin 1744 kur u themelua Villa Badesa në Abrucet nga shqiptarë të shpërngulur prej Piqerasit.

Lidhur me këtë çështje ai shkruan: «Grupet etnike që zënë vend kështu në kohë të ndryshme në trojet e Italisë, sollën me vete secili, në ngulimet e reja ku u vendosën, ato huazime turke që kishin depërtuar në dialektet e atdheut të tyre të vjetër qor në kohën e shkëlqes së tyre për në dhë të huaj. Do të mendojmë kështu që fjalët turke që na dalin në katundet e Molizes, Kapitanatës, Apulisë, Kalabrisë e Sicilisë, patën hyrë në Shqipëri jo më vonë se në shekullin XV. . . Si një shtresë më e vonë, që shkon gjer në rrjedhë të shekullit XVII, do të shikohen elementet turke të ngulimeve arbëreshe të Basilikatës, të cilat gjer më sot mjerisht pak janë studiuar për nga ana e gjuhës. Më në fund, për fjalët turke që përdoren në Villa Badesa, si cak më i vonë i hyrjes së tyre do të merret viti 1744.<sup>1</sup>

14. Duke u mbështetur në materialet e botuara nga studiues të tjerë para tij si edhe në materialet që ka mbledhur vetë, ai përmend huazime turke shtresash të ndryshme kronologjike. Ndër huazimet turke të shtresës më të vjetër ai përmend: *daule*, *dufek*, *filil*, *gajtan*, *jar*, *masur*, *nerënxë*, *orta* «regjiment jeniçerësh etj.» *pexher*, *sakat*, *tel*, *beg* / *bej*, *turk*, *mu-shkumend* «musliman»<sup>2</sup>.

Kurse nga huazimet turke që janë mbledhur në Villa Badesa, ai përmend; *belá berqavre shum* «faleminderit shumë», *birbil*, *deli* — khs. *deli-grua* — grua shumë e mirë), *destemel* «peshqir», *futë* «përparëse», *hakë*, *hashohem* «refuzoj», *inat*, *kalá*, *perdë* «perde», *rraki*, *tepsi* «tepsi e metaltë, si edhe gjella nacionale me oriz të lyrshëm e me copa suxhuku, peshku e mishi, që gatuhet në një tepsi të tillë».<sup>3</sup>

15. Duke u mbështetur në të dhënat gjuhësore të të folmeve arbëreshe të Italisë dhe duke i krahasuar këto me të dhënat e gjuhës së autorëve të vjetër të Shqipërisë së Veriut, sidomos të Buzukut, Çabej më se njëherë ka vënë në dukje se këto të dhëna dëshmojnë se dy dialektet kryesore të shqipes, toskërishtja dhe gegërishtja, dikur kanë qenë më afër njëra-

1) Shih SF 4/1975/80.

2) Shih po aty, 81.

3) Shih po aty, 82.

## *Eqrem Çabej*

-tjetrës në të gjitha pjesët përbërëse të gjuhës. Por gjatë shekujve të mëpastajmë ndryshimet midis këtyre dy dialekteve kanë ardhur duke u thelluar si rrjedhim i evolucionit të mëtejshëm të tyre në rrethanat e mungesës së kontakteve të shpeshta midis popullsisë së viseve të ndryshme të Shqipërisë, pasojë kjo e drejtpërdrejtë e sundimit të huaj disashekullor.

## KREU VI

### Autorët e vjetër

1. Një studiues i shumanshëm i historisë së gjuhës shqipe, siç ishte E. Çabej, nevojën për të njohur sa më mirë gjuhën e autorëve të vjetër shqiptarë do ta ndiente më shumë se kushdo tjetër. Një gjë e tillë është plotësisht e kuptueshme, po të kemi parasysh se veprat e autorëve të vjetër shqiptarë dhe të folmet e arbëreshëve të Greqisë e të Italisë, janë burimet kryesore, që na bëjnë të njohur gjendjen e gjuhës shqipe gjatë shekujve XIV-XVII dhe në këtë mënyrë na ndihmojnë të ngjitemi edhe më lart ndër shekuj. Prandaj ai qysh në hapat e tij të parë dhe gjatë tërë veprimtarisë së tij shkencore u kushtoi një vëmendje të posaçme këtyre burimeve të rëndësishme për historinë e gjuhës shqipe. E kjo duket qartë jo vetëm nga studimet e shumta që u ka kushtuar këtyre burimeve, por edhe nga shfrytëzimi sa më racional i të dhënave të tyre për të argumentuar sa më mirë mendimet e tij mbi evolucionin historik të sistemit fonetik, të strukturës grammatikore dhe të fjalorit të gjuhës shqipe në përgjithësi. Në të gjitha studimet historike të këtij gjuhëtari të dhënat gjuhësore nga veprat e autorëve tanë të vjetër dhe nga të folmet arkaike të shqipes luajnë një rol të pazëvendësueshëm argu-

mentimi, madje në mjaft raste, sidomos në studimet etimologjike, ato përbëjnë burimin kryesor për një argumentim shkencor të paqortueshëm. Mjafton të përmendim këtu, sa për shembull, faktin e vënë në dukje së pari nga ky gjuhëtar<sup>1</sup> që në veprën e Buzukut është përdorur një herë të vetme fjala e vjetër indoevropiane *mang-u*<sup>2</sup> «i vogli, zogu i një shtaze». që i përket rrënjës indoevropiane \**men-*, zgjeruar me *k* \**menk*. ... Këtë fjalë, që është zhdukur prej kohësh, ai e krahason me trajtat gjegjëse të armenishtes, të greqishtes homerike, të irlandishtes së vjetër, të indishtes së vjetër, të tokarishtes B etj.

2. Interesimi i madh dhe i vazhdueshëm i Çabejt për gjuhën e autorëve të vjetër shqiptarë është konkretizuar në një numër artikujsh studimorë, nga të cilët po përmendim kryesorët: 1. *Gjon Buzuku*, në *BSHSH* 1955, Nr. I, II, III, IV; 2. *Trajtimi i zanoreve iniciale te Gjon Buzuku*, *BUSHT*, *SSHSH* I/1957; 3. *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, *BUSHT*, *SSHSH* II/1959; 4. *Disa aspekte të fonetikës historike të shqipes në dritën e gjuhës së Gjon Buzukut*, *BUSHT*, *SSHSH* I/1960; 5. *Pjetër Budi dhe gjuha e tij*, *BUSHT*, *SSHSH* IV/1966; *Meshari i Gjon Buzukut 1555* (botim kritik). *Pjesa e parë — Hyrje dhe transliterim*, Tiranë, 1968. *Pjesa e dytë — Faksimile dhe transkribim fonetik*, Tiranë, 1968 etj.

Interesimi i tij i madh për autorët tanë të vjetër i dha shkas edhe punës së lavdërueshme që bëri ai për ribotimin e librit të Gjon Buzukut që është libri më i vjetër në gjuhën shqipe i zbuluar deri sot. Vlera e këtij ribotimi, që u realizua nën kujdesin e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë më 1968, është e pallogaritshme, sepse në këtë mënyrë breza të shumtë gjuhëtarësh, brenda dhe jashtë Shqipërisë kanë tashti në dorë një botim shkencor në dy vëllime (vëllimi i parë me transliterim dhe i dyti me transkribim) të veprës më të vjetër në gjuhën shqipe, të pajisur me shënime sqaruuese aq të nevojshme dhe të prira nga një studim hyrës i gjerë dhe i shumanshëm.

3. Megjithëse libri i Buzukut ishte rizbuluar<sup>3</sup> qysh në

---

1) *SF* 3/1964/17.

2) «... me këtë mënyrë anshtë i dashuni em, pors i kaprolli o *mangu* i sutësë» (Buzuku, f. LXXXVII=LXXXXVII).

3) Libri i Buzukut, botuar më 1555, ishte bërë prej kohësh i panjo-



vitin 1909 nga dijetari i njohur arbëresh Pal Skiroi dhe, megjithëse ky libër ishte bërë objekt studimi nga vetë Pal Skiroi<sup>1</sup> e të tjerë pas tij<sup>2</sup>, transliterimi dhe transkribimi i tij paraqisnin vështirësi të mëdha, që vetëm një gjuhëtar me përgatitjen e duhur filologjike mund t'i përballonte dhe t'i kapërcente me sukses. Këto vështirësi nuk kishin të bënin vetëm me leximin e saktë të disa shkronjave të përdorura me më shumë se një vlerë fonetike, dhe me ndarjen e drejtë të fjalëve dhe formave të tyre nga njëra-tjetra, por më fort edhe me interpretimin e saktë të disa mënyrave të shkruari, siç janë ndër të tjera, interpretimi i vlerës fonetike të shkronjës *h*, në fillim, në fund e në disa raste edhe në trup të fjalëve<sup>3</sup>, si edhe leximi i saktë i togjeve të përbëra nga një e e ndjekur nga një *-n*, *-r*, *-l'*.

Këtyre vështirësive me karakter filologjik u duhen shtuar edhe ato që rrjedhin nga gabimet e shtypit e në mjaft raste edhe nga të metat e përkthimit të teksteve burimore nga ana e Buzukut.<sup>5</sup>

4. Rizbulimi dhe ribotimi i veprës së Buzukut si edhe studimi gjithnjë e më i thelluar i saj kanë nxjerrë përpara studiuesve një varg problemesh, që kanë të bëjnë jo vetëm me autorin dhe me rrethanat e botimit të saj, por edhe me çështjen e fillimit të shkrimit të gjuhës shqipe në përgjithësi. Për autorin si edhe për rrethanat dhe vendin e botimit të veprës, siç dihet, deri sot nuk ka qenë e mundur të arrihet në disa përfundime të padiskutueshme, për arsye se kopjes së vetme të kësaj vepre i mungojnë si fletët e para, ashtu edhe fleta e

---

hur. Më 1740 ra në gjurmë të një kopjeje të vetme që kishte mbetur. Gjon Nikollë Kazazi prej Gjakove, gjatë një vizite të tij në Romë. Ai kopjoi një copë nga ky libër dhe ia dërgoi Gjergj Guzetës, themeluesit të Seminarit arbëresh të Palermos. Por, edhe pas këtij zbulimi të rastit këtë veper e mbuloi një heshtje e plotë.

1) Ky dijetar arbëresh (1866-1941) punoi tërë jetën mbi këtë veper duke e transliteruar dhe transkribuar, por nuk arriti të botonte prej saj veçse pak pjesë.

2) Shih «Meshari i Gjon Buzukut» I, f. 8, ku E. Çabej përmend një studim të shkurtër të N. Joklit, hulumtimet e M. Roques-ut etj.

3) Shih § 9.

4) Shih § 10.

5) Shih E. Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut*, I, 29 v.

**fundit**, ku mund të gjendeshin të dhënat e nevojshme. Por nga analiza e gjuhës së kësaj vepre prof. E. Çabej ka arritur në përfundimin se «ka indice gjuhësore që dëshmojnë se ai është një bir i malësisë së Krajës, Ljarjes e Shestanit në jugperëndim të liqenit të Shkodrës, një famullitar i dalë prej dioqezës së Tivarit a mbase të Ulqinit. Gjuha e tij, megjithëse e ngritur me vetëdije në një shkallë mbidialektore, përmban elemente që i përkasin asaj ane të Shqipërisë veriore.<sup>1</sup> Më anë tjetër, vihen re në librin e tij disa tipare që flasin qartë për një komponente verilindore e lindore në gjuhë. Këto paraqiten më shpesh përzier me tiparet veriperëndimore... Kjo rrethanë flet për një përzierje dialektesh, në të folët e vendlindjes së tij, ose për një bashkekzistencë trajtash prej dialektesh të ndryshme në të njëjtën krahinë...»<sup>2</sup> Dhe pasi vë në dukje vështirësitë e shpjegimit të një dukurie të tillë, Çabej pohon se në këtë rast «mund të kemi të bëjmë me një burim verilindor të fisit të autorit tonë, ose me një shpërngulje më të madhe e shumë më të mocme». Dhe pasi përmend disa nga tiparet fonetike dhe morfologjike të të folmeve verilindore të shqipës, ai përfundon: «Prandaj autori ynë e gjeti e i mori ato në veriperëndim. Ato janë gjuhësisht verilindore, gjeografsisht veriperëndimore».<sup>3</sup>

Përsa i takon shtypshkronjës, ku u botua libri, Çabej pohon: «Ne vazhdojmë t'i mbahemi mendimit të Mario Rokut (Mario Roque-ut), i cili mbi dëshminë e një radhë indiceve mjaft të qarta e bën të besueshme që shtypshkronja nga dobi ky libër, ka qenë veneciane ose së paku e burimit venecian.»

5. Një çështje me shumë rëndësi që nxjerr përpara librin e Buzukut, është edhe ajo që ka të bëjë me fillimet e shkrimit të gjuhës shqipe. Nga analiza e gjuhës së këtij libri, gjuhëtarë të tillë, si: Norbert Jokli, Marko la Piana etj., kanë arritur në përfundimin se ajo paraqit një fazë të tillë zhvillimi, që

1) Këtu ai përmend disa nga këto tipare të përziera të Buzukut, si: *kon* e *kun*, *lëkondunë* e *të lëkundetë*, *mondonetë* e *munduom*, *orata* e *uruom*, *hipi* e *hypi*, *qish* e *qysh*, *kelqinë* pranë *qengji* e *lëqë*, *ullinsh* e *ullinjet*, *të vin* e *të vinjë*, *ish ardhunë* e *të ketë ardhënë*, *të del* e *të dalë*, *të lëshon* e *të lëshonjë*, *lenë letë* e *lem*, *panë*, *patë* e *pam* etj.

2) Shih E. Çabej. «Meshari» i Gjon Buzukut, Pjesa e parë, 22.

3) Shih *po ai*, *po aty*, f. 22.

4) Shih *po ai*, *po aty*, f. 17.

dëshmon për një traditë më të vjetër shkrimi të gjuhës shqipe. Në këtë përfundim ka arritur edhe E. Çabej, i cili ka vonë në dukje: «I shikuar kështu nga disa anë të ndryshme, karakteri i gjuhës së këtij autori paraqitet më kompleks nga sa mund të dukej në një vështrim të parë. Kemi të bëjmë pikë-sëpari me një gjuhë letrare: prodhim edhe i një zhvillimi të mëparmë të shkrimit dhe i përpunimit nga ana e këtij shkrimtarit, i përpjekjes individuale për të ngritur të folën popullore në një shkallë më të lartë të përdorimit.»<sup>1</sup>

Dhe duke përmbledhur mendimet e tij mbi gjuhën e Buzukut, ai ka rritur në këto përfundime për fillimet e shkrimit të shqipes. «Duke shikuar me një vështrim objektiv këtë tekst, nga gjuha e rrjedhshme që e përshkon fund e majë atë, dhe nga mënyra, me gjithë lëkundjet e shpeshta, mjaft konsekuente e shkrimit, arrin të bindet njeriu se në Shqipëri ka qenë formuar që më parë, së paku që në mesjetën e vonë, një traditë letrare me shkrime liturgjike, me një ortografi gjer diku të caktuar. Kjo rrethanë ndërkaq, që është me rëndësi për historinë kulturore të vendit, nuk mohon që këto të kenë qenë shkrime të vogla e pa ndonjë vlerë letrare në vetvete. Megjithëse prej ndonjë shkrimi të këtij lloji autori ynë mund të ketë marrë ndonjë formulë lutjeje etj., nuk besojmë të jemi gabim, po të pranojmë që ky libër është i pari i llojit të tij në Shqipëri: një vazhdim e njëkohësisht një fillim. Ai është më njëfarë mënyre pjella e kohës, sepse për një vepër me përmasa të kështilla në një kohë më të lashtë në vendin tonë kanë mundur kushtet historike.»<sup>2</sup>

6. Lidhur me këtë çështje të rëndësishme Çabej, në një studim të gjatë kushtuar Gjon Buzukut, është përpjekur ta argumentojë më hollësisht krijimin e një tradite më të vjetër shkrimi të shqipes, që shkrimtarët e vjetër veriorë e zhvilluan më tej. Për këtë ai shkruan, ndër të tjera:

«Në ç'rrethana leu e u formua një normë e përbashkët në shkrim, kjo është një çështje që i përket po aq historisë së kulturës në vendin tonë sa edhe historisë së gjuhës. Hetimi i formimit të gjuhëve literare është përgjithësisht një problem i vështirë, po aq më i vështirë paraqitet ndër ne, ku të vetmet të dhëna që kemi, janë shkrimet e autorëve. Në çdo rastë një

1) Shih *po ai, po aty*, f. 19.

2) Shih *po ai, po aty*, f. 25 v.

gjuhë e tillë edhe te ne nuk mund të ketë qenë puna e një njeriu a e një brezi, por qe sigurisht përfundimi i një brezi më të gjatë. Ne shohim një Gjon Buzuku të përkthejë në shekullin XVI, brenda afërsisht dhjetë muajve, një libër me vëllim të madh për atë kohë e me një gjuhë të rrjedhshme e të kuptueshme mund të thuash për çdo shqiptar që e këndonte. Kjo gjë... na bën të mendojmë që në Shqipërinë e asaj kohe ka ekzistuar një traditë e të shkruarit të gjuhës. Kjo traditë na vërtetohet edhe nga vetë rregullimi i shkrimit, sepse ortografia do një kohë mjaft të gjatë të përdorimit, gjersa të fiksohet mirë në një gjuhë. Shkrimtarët fetarë të Veriut që ne dimë, u zhvilluan brenda kësaj tradite gjuhësore, të cilën ata e gjetën në një shkallë mjaft të formuar. Në këtë formë gjuhe mbidialektore ata shkruan librat e tyre dhe me këto e punuan pareshtur këtë dhe i dhanë kështu nga ana e tyre një ngritje e një zhvillim të mëtejshëm.<sup>1</sup>

Duke u mbështetur edhe në pohimin e Bogdanit, i cili në parathënien e librit të tij thotë se për librin e vet i është dashur që shumë fjalë t'i ndreqë «në dhë të Shkodrës», E. Çabej vë në dukje: «Kështu si Bogdani mund të kenë punuar para tij dhe të tjerë shkrimtarë të Gegërisë, ndër këta edhe Buzuku. Veçse për këtë të fundit çështjen nuk mund ta ndjekim as në përgjithësi, sapo që nuk dimë as rrethanat e përjashtme të jetës së tij, as edhe dialektin nga i cili u nis. Sido që të jetë, të dhënat historike na bëjnë të pranojmë që Shkodra është qendra ku konvergjuan e nga ku rrezatuan të gjitha ato elemente që sollën këtu lindjen dhe zhvillimin e një gjuhe të shkrimit. Këtu ka qenë përqendruar qëmoti jeta ekonomike e kulturore e Shqipërisë Veriore...»<sup>2</sup>. Dhe pasi e shtjellon më tej këtë mendim, Çabej me korrektësinë shkencore që e karakterizonte, pohon: «Në këtë mënyrë ne me rrugë të tjera po dalim në ato përfundime, ku ka arritur Maksimilian Lamberci, i cili është i mendimit që qarku literar i Shqipërisë Veriore qendrën, si më parë si më vonë, e ka pasur në Shkodër».<sup>3</sup>

7. Mendimin që shkrimtarët e vjetër të Veriut janë përpjekur të shkruajnë në «një farë koineje», E. Çabej e ka mbrojtur edhe në punime të tjera të tij. Kështu, p.sh., në studimin

1) Shih BSHSH II/1955/72.

2) Shih BSHSH, II/1955/73.

3) Shih BSHSH, II/1955/75.

*Pjetër Budi dhe gjuha e tij*, ai shprehet shkoqur për këtë, kur pohon: «Me ç'u tha këtu për dialektet e gegërishtes, nuk do menduar se këta autorë kanë shkruar në dialekt. Karakteri i gjuhës së tyre nga kjo anë paraqitet më kompleks dhe meriton të gjurmohet më hollë. Dialekti regjional, prej të cilit rrjedhin, përbën bazën nga ku ata u ngritën në një gjuhë shkrimi mbi-dialektore. Kjo është edhe e natyrshme për ta, sepse ata janë të vetëdijshëm që shkrimet e tyre janë të caktuara për krahina më të hapëta e për shtresa më të gjera të popullit. Kështu gjuha e tyre vërtet ruan disa tipare të një dialekti të veçantë dhe me këtë kallëzon prejardhjen krahinore të çdo autori, po mbetet prapë njëfarë koineje e shkrimit, një gjë e kuptueshme për të gjithë. Këtë karakter të gjuhës letrare e ka determinuar edhe qëndrimi i këtyre shkrimtarëve në krahina të tjera dhe lidhur me këtë edhe njohja e të tjerave dialekte të shqipes...»<sup>1</sup> Dhe këtu ai përmend faktin e njohur që Bogdani, «një bir i Shqipërisë Verilindore», shërben për më se njëzet vjet në anët e Shkodrës. Ai këtu përmend, gjithashtu, edhe faktin që Budi, prej Mati, ka shërbyer për mjaft kohë pranë shqiptarëve të Kosovës e të Maqedonisë.

8. Dhe tashti po ndalemi shkurt në disa nga vështirësitë dhe ndihmesat e Çabejt në ribotimin e veprës së Buzukut. Këto vështirësi dhe ndihmesa kanë të bëjnë kryesisht me transkribimin e veprës, i cili kërkonte, ndër të tjera, edhe interpretimin e saktë të vlerës fonetike të disa shkronjave dhe grupeve shkronjash. Natyrisht, vështirësi kanë dalë edhe në transliterimin e veprës, i cili, siç pohon vetë Çabej, «nuk paraqet një kopjim mekanik të tekstit të fotografuar, një riprodhim të thjeshtë të tij me karakteret e soime të alfabetit. Ai qëndron disi midis këtij dhe transkribimit fonetik. Përligjja shkencore e transliterimit përmbahet këtu, që në distancën që ndan fototipinë nga transkribimi fonetik, ai më një anë ndihmon në leximin e së parës, që është nganjëherë mjaft i vështirë, nga ana tjetër gatit në interpretimin e grafive që jepet te ky i dyti. Përveç kësaj, transliterimi shërben për të parë mënyrën e ndarjes e të bashkimit të fjalëve tek autori ynë».<sup>2</sup>

Edhe nga këto pak rreshta kuptohet qartë se Çabejt i është dashur të kapërcejë vështirësi edhe në transliterimin e

1) Shih SF 4/1966/145.

2) Shih E. Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut*, I, 60.

veprës së Buzukut. Këto vështirësi mund të merren me mend më lehtë, po të mbahet parasysh fakti që sistemi grafik i përdorur nga Buzuku nuk është i thjeshtë. Mjafton të kujtojmë këtu se ai për disa tinguj përdor më shumë se një shkronjë dhe, anasjelltas, disa shkronja i përdor me më shumë se një vlerë fonetike. Kështu, p.sh., tingullin *sh* ai e jep me shkronjat *s*, *ss*, *sc*, e ndonjëherë edhe me *ε*, kurse shkronjën *s* e përdor jo vetëm për *sh*, por edhe për tingujt *s*, *z*, e ndonjëherë edhe për tingullin *zh*.<sup>1</sup>

9. Por, siç u vu në dukje edhe pak më sipër (§ 8), vështirësi më të mëdha paraqiste transkribimi fonetik i veprës, duke qenë se ky nxirrte një varg problemesh, që pjesërisht nuk dalin për veprat e autorëve të tjerë pas Buzukut. Çabej, me përgatitjen e mirë filologjike dhe me punën e tij të madhe, në përgjithësi ia ka dalë mbanë që t'i kapërcejë vështirësitë e transkribimit, por në ndonjë rast ai ishte i vetëdijshëm se mund të bëhej edhe ndonjë tjetër mundësi interpretimi.<sup>2</sup>

Siç pohon edhe vetë ai, «mbase më i rëndi problem që na shtron grafia e këtij teksti, është shkrimi i një *h*-je në mbarim të një fjale me mbaresë zanore, po edhe në ballë të fjalës para një zanoreje, si edhe në mes të saj, në kundërshtim me ortografinë e sotme, e kjo pothuajse në gjithë kategoritë e fjalëve...»<sup>3</sup> Dhe më poshtë vazhdon: «Këtu çështja kryesore është të dimë: A kemi të bëjmë me një shqiptim real apo

1) Shih më hollësisht *po aty*, 46 v., 57 v.

2) Ja si shprehet ai për këtë gjë: «Puna qenësore e një transkribimi është interpretimi fonetik sa më i drejtë i shenjave grafike. caktimi i vlerës fonetike të tyre. po kjo në librin tonë përbën edhe vështirësinë më të madhe. Vështirësitë rrjedhin në radhë të parë prej sistemit grafik të komplikuar që është përdorur në të. Polisemia e një radhë shenjave të shkrimit... bën që për disa kategori fjalësh e për mjaft fjalë të veçanta puna e shqiptimit, e pra edhe e transkribimit, nuk mund të caktohet në një mënyrë të prerë. Një shteg do të celte këtu krahasimi i tekstit me dialektin e gegërishtes që përbën bazën e gjuhës së tij, po duke qenë kjo një çështje edhe e pazgjidhur mirë, një i tillë krahasim drejtpërdrejt në gjendjen e sotme të njohurive tona nuk mund të bëhet, aq më shumë kur të kemi parasysh që dialektet kanë ndjekur zhvillimet e tyre në këtë varg shekujsh» («Meshari» i Gjon Buzukut» I, 64).

3) *Po aty*, f. 55.



## Eqrem Çabej

me një shenjë konvencionale me vlef të thjeshtë grafike përndonjë funksion shqiptimi të caktuar? E në rasën e parë, a shënon kjo shenjë një tingull *h*, apo na dëshmon përpjekjen e autorit për të shprehur disi grafikisht një tjetër tingull apo mënyrë shqiptimi, fonetiki të vështirë? A kemi përpara nesh një fonemë të thjeshtë apo një tingull fonetiki kompleks? Këto janë pyetje të cilave nuk mund t'u jepet një përgjigje e prerë, sa kohë që kemi të bëjmë me një fazë gjuhësore të kapërcyer dhe nuk dimë me siguri se ç'fshihet prapa këtyre gjërave».<sup>1</sup>

Dhe pasi jep mendimet e dijetarëve të mëparshëm mbi vlerën e shkronjës në shqyrtim, ai parashtron interpretimet e veta për këtë çështje, «e cila është mjaft komplekse dhe në gjendjen e sotme të njohurive tona duket e pazgjdhshme». Nga analiza e përdorimeve të kësaj shkronje në veprën e Buzukut, ai ka arritur në përfundimin se *h*-të nistore dhe atë fundore të këtij teksti «nuk duhet medoemos të jenë të së njëjtës natyrë e gurrë. Ato, përkundrazi, duket të jenë disa llojesh, prandaj edhe shënimi i tyre grafik do të ketë arsye të ndryshme.» Sipas tij, një nga këto arsye duhet kërkuar në mënyrën që në të folmen e vetë Buzukut *h*-ja nistore zakonisht nuk shqiptohet e kjo do ta ketë bërë atë që ta shtojë këtë edhe atje ku rregullisht nuk ka një tingull të tillë.<sup>2</sup>

Edhe për *h*-në fundore, shpjegimi i së cilës paraqitet edhe në i vështirë, Çabej, pasi përmend mendimet e Joklit e të Vajgandit, mendon se Buzuku atë e ka përdorur për qëllime të ndryshme: për një shqiptim më të qartë të zanores fundore në fjalës, për ndarjen e fjalëve etj.

Dhe vërejtjet e tij mbi vlerën e shenjës grafike *h* te Buzuku, ai i mbyll me shënimin se nga analiza e saj në veprën e Buzukut «del me mjaft gjasë», që ajo aty nuk është përdorur për të shenjuar gjatësinë e zanoreve, siç kanë pohuar disa gjuhëtarë të tjerë para tij.<sup>3</sup>

10. Një tjetër problem i vështirë, me të cilin është ndeshur Çabej në transkribimin e veprës së Buzukut, ka qenë ai

1) *Po aty*, f. 55.

2) Shih *po aty*, 56. Këtu ai parashtron edhe arsye të tjera për *h*-në nistore te Buzuku, si p.sh. përdorimi i saj për ndarjen e fjalëve etj.

3) Shih *po aty*, 56 v.

## Eqrem Çabej

i interpretimit fonetik të grupeve nistore *en, er, el*, para një bashkëtingëlloreje. Është fjala për raste të tipit *embarë* (= mbarë), *enprehunë* (= mprehunë), *endeer* (= ndër), *erdhii* (= rdhi < hardhi), *elter* (= lter < altar) etj. Ai vë në dukje se në raste të tilla shkrimtarët e mëvonshëm «kanë përgjithësisht grafinë e sotme». Prandaj mënyra e të shkruarit të Buzukut në këto raste, sipas tij, përbën «një nga tiparet gjuhësore të moçmat. që ruhen në grafinë e këtij libri». <sup>1</sup> Ai shton se në këtë mënyrë të shkruarit, te Buzuku «pasqyrohet një shqiptim real, i gjallë në dialektin e autorit në kohë të tij, dhe i gjallë edhe sot në ndonjë krahinë periferike si Rugova. Veçse interpretimi fonetik përbën një çështje të vështirë. Në këtë rast ai bashkohet me Joklin në interpretimin e këtyre grafive si *m, n, r, l*, sonantike, d.m.th. rrokjeformuese, dhe shton se shkronja *e*, në këto grafi «nuk shënon një zanore as *e* as *ë*». Dhe këtë interpretim përpiqet ta argumentojë nëpërmjet faktit se në veprën e Buzukut para grafive të tilla, në shumicën dërrmuese të rasteve, nuk ndodh elizioni i zanores *-ë* të patheksuar para tyre, ashtu siç ndodh zakonisht në raste të tjera. Dhe për këtë ai rendit shembuj të tillë si: a) *të më ngjallnjësh, për të mbëljedhunitë, të lterit*, b) *për t'ardhunit, të m'apë, m erdh* etj.

Çabej shtjellon më tej se te Buzuku në raste të tilla ruhet një fazë e ndërmjetme, që është përfutur pas rënies së zanores së patheksuar të dikurshme. Më vonë, shton ai, gjuha e reduktoi sonanten në një bashkëtingëllore të thjeshtë, khs. *Andreas: Endrec* (= Ndr-) te Buzuku: sot Ndre etj. <sup>2</sup>

11. Një tjetër problem që i ka dalë Çabejt në punën të transkribimit të veprës së Buzukut, kishte të bënte me interpretimin fonetik të shkronjave zanore të dyfishuara. Siç dihet, një dukuri e tillë del edhe tek autorët e tjerë të vjetër shqiptarë dhe arbëreshë. Gjatë transkribimit të Buzukut, Çabej i ka interpretuar këto zanore grafikisht të dyfishuara si zanore të gjata. Ai ka pranuar kështu kundërvënien zanore të shkurtër ~ zanore të gjata për gjuhën e Buzukut dhe të autorëve të tjerë të vjetër shqiptarë dhe arbëreshë. Duke pasur parasysh këtë rrethanë si edhe të dhëna të tjera dialektore <sup>3</sup>, ai e ka parë

1) Shih *po aty*, 54 v.

2) Po *aty*, 54 v. Ai vë në dukje se grafia *en* (krahas më të përdorshmes *n*) ndeshet aty-këtu edhe te Budi, Bardhi dhe Bogdani.

3) Shih *BSHSH H/1955/83 v.*



të nevojshme të ndalet edhe për ta shpjeguar historikisht prarinë e zanoreve të gjata në një fazë më të vjetër të gjuhës shqipe. Pasi përmend shkurt mendimet e shprehura nga gjuhëtarë të tjerë para tij mbi këtë dukuri, ai ka arritur në këtë përfundim:

«Nga një analizë e materialit të sotëm e të vjetër të gjuhës unë besoj të kem gjetur rregullën e përgjithshme. Kemi zanore të gjata, kur kjo të jetë refleksi i një zanoreje të gjatë të periudhës parashqiptare, ose rezultat i një kontraksioni të brendshëm të shqipes, i shkrirjes së disa tingujve, e cila rrodhi sidomos nga zhdukja e rrokjes që vinte pas zanores. Kështu shpjegohen disa opozicione fjalësh, megjithëse këto përmbajnë të njëjtët tinguj në të njëjtat pozita mii [mī] .. përkundrejt *mbi*, *përmbi*...; *deet* [= dēt] nga një \**deub-eto-*, përkundrejt *mbret* nga lat. *imperator*. rumanisht *impërat*; *mjeek* [= mjek] nga lat. *medicus*, përkundrejt *shtek*...; *kuut* [= kūt] nga lat. *cubitus*, përkundrejt *lus*, *lut*, *peendothem* [= pëndohem] nga lat. *poenitere*, përkundrejt *mendothem*, e rasa të tilla, si *liroj* [= liroj] nga *liberare*, *beekoj* [= bēkoj] nga *benedicere*, *shpirt* [= shpirt] nga *spiritus*, fjalë që në Veri, ashtu si *deet*, *mjeek*, *kuut*, *peendothem*, shqiptohen me zanore të brendshme të gjatë».<sup>1</sup>

12. Ribotimi i veprës së Buzukut dhe studimi i saj dhe i veprave të tjera të vjetra të autorëve shqiptarë dhe arbëreshë i kanë dhënë rast Çabejt të ndalet edhe në çështje të tjera të fonetikës historike të gjuhës shqipe. Për të mos e ngarkuar shumë këtë paraqitje, po përmendim këtu shkurt vetëm edhe një dy gjëra lidhur me zanoren *ë*.

Duke u mbështetur në gjuhën e Buzukut dhe të autorëve të tjerë të vjetër veriorë, Çabej ka vënë në dukje se gegërishtja e kohës së Buzukut njihte edhe një *ë* të theksuar, ashtu si toskërishtja sot, dhe pikërisht në fjalën *një* — te Buzuku shkruar [*gneh* = *njeh*], e cila te Budi del në trajtat *një*, *nja*, *nji*, te Bardhi *nië*, *nja*, te Bogdani etj. *nji*. Ai shton: «Forma e dëshmuar prej Buzukut më duket me rëndësi për historinë e kësaj zanoreje të mesme dhe ajo na vërteton një mendim të Joklit për ekzistencën e këtij tingulli në një gegërishte më të hershme».<sup>2</sup>

1) Shih BSHSH II/1955/84 v.

2) Shih BSHSH II/1955/85.

Gjithnjë duke u mbështetur në gjuhën e Buzukut dhe të autorëve të tjerë veriorë pas tij, Çabej ka vënë në dukje se në kohën e këtyre shkrimtarëve në të dy dialektet e shqipes, pra edhe në gegërishte, ruhej ende zanorja *ë* e patheksuar, e cila është përfutur rregullisht nga reduktimi i një zanoreje tjetër në pozicion jashtë theksit. Dhe në të mirë të këtij mendimi ai përmend një varg shembujsh nga Buzuku e të tjerë autorë veriorë, si: *vëneshtë, shpënesënë, anëmikut, të dërejte* etj. (Buzuku); *tue mbetunë, të shëtundenë* etj. (Budi) etj.<sup>1</sup>

13. Studimi i veprës së Buzukut dhe i autorëve të tjerë të vjetër shqiptarë dhe arbëreshë i kanë dhënë rast Çabejt të ndalet edhe në disa çështje të rëndësishme të gramatikës historike të gjuhës shqipe. Ndihtmesat e tij kryesore në këtë fushë studimesh u trajtuan në IV/12-21. Këtu do të ndalemi vetëm në disa gjëra nga kjo fushë, që lidhen me gjuhën e Buzukut. Te ky autor, siç ka vënë në dukje Çabej, numri i emrave asnjans, të dokumentuar të shqipes del i konsiderueshëm dhe kjo është e kuptueshme, po të kemi parasysh faktin e njohur që gjinia asnjansë, e cila kishte nisur procesin e dizintegritimit qysh shumë shekuj para Buzukut, ka ardhur duke u dobësuar gjithnjë e më shumë gjatë këtyre shekujve të fundit.

Çabej ka vënë në dukje se te Buzuku dalin si asnjans edhe mjaft emra që përndryshe dëshmohen në gjini të tjera sidomos në gjininë mashkullore. Mjafton të përmendim, ndër të tjerë, emra të tillë si: *bark-të, djalë-të, faj-të, frujt-i-të, gji-të, gjyq-i-të, muoj-të, penk-të, petëk-u-të, prehën-i-të, shenj-të, shtrat-të* etj.<sup>2</sup>

14. Për gjuhën e Buzukut Çabej ka vënë në dukje edhe disa trajta shumësi të veçanta, që pjesërisht ndeshen, sipas tij, edhe nëpër të folme të Veriut. Të tilla trajta shumësi të veçanta janë ndër të tjera: *kujdes:kujdis-e, treg:trigj-e, krah:krih, gardh:gjirdh-e, kruo:kroe-na; bri:brie-na, lumë:lumë-na, viç:vjet-a*.<sup>3</sup>

Në studimin e tij mbi gjuhën e Buzukut ai është ndalur edhe në sqarimin historik të disa formave rasore të lakimit të shquar, siç janë forma e së ashtuquajturës rasë vendore të

1) Për ndihmesa të tjera të E. Çabejt në fushën e fonetikës historike të gjuhës shqipe, shih IV/2-11.

2) Shih BSHSH III/1955/40 v.

3) Shih BSHSH III/1955/45 v.

shquar me *-t* (si ndë *misal-t*, ndë diellët etj.) dhe të rrjedhores së shquar shumë me *-sh-i-t* (si *n së shkruomeshiu* etj.), forma këto që ndeshen edhe tek autorët e tjerë të vjetër pas tij si edhe tek arbëreshët e Italisë etj. Ai ka vënë në dukje edhe disa trajta arkaike mbiemrash të nyjshëm pa prapashtesën *-të* (*si i lū, i djathë*), si edhe raste përdorimi arkaik të nyjës së përparme të krahas formës nyjore *e* të kohëve më të reja (khs. të shtatë psalmat të pëndësëvet, krahas gjithë *kafshëtë e nfshehuna*).<sup>1</sup>

15. Çabej, në studimet e tij mbi gjuhën e Buzukut e të shkrimtarëve të tjerë të vjetër të Veriut ka bërë vërejtje me interes edhe për fjalorin e tyre. Kështu, p.sh., për gjuhën e Buzukut ai vëren me të drejtë se «për një vepër kaq të madhe si vëllim u desh edhe një pasurim i visarit të fjalëve, sidomos i atyre të sferës së kulturës». Ai shton se «nuk është e mundur të çitet me siguri në çdo rasë të posaçme se gjer ku shkon këtu puna personale e shkrimtarit dhe ç'gjeti ky gati në gjuhën kishtarë. Paturimi u arrit më një anë duke marrë fjalë të huaja ashtu të gjalla siç ishin, p.sh., *cedri, centurioni, cimbali, pelikani, unguent, gamile* «deve», *nava* «anie», më anë tjetër me përkthim të fjalës së huaj, zakonsht latine (calque linguistique), si ndër të tjera *urt-a* «sapientia», *bās-i* «factor, creator», *shpërbles-i* «redemptor», *përrallës-itë* «fabulatores», *gjindeni* «impietas» (pas *gentiles*), *i pabesim* «incredulus», *i pāmort* «immortalis», *i pāmasë* «immensus», dhe ai verbi i bukur *përndjek...* që më duket ta ketë krijuar shkrimtari vetë, fjalë për fjalë pas latinishtes *persequi...*<sup>2</sup>

Çabej ka vënë në dukje, gjithashtu, se fjalori i veprës së Buzukut paraqit mjaft interes edhe për praninë e një numri të konsiderueshëm fjalësh, që dikur kanë qenë të mbarë shqipës, por që sot ose s'ndeshen më fare, ose përdoren vetëm në disa të folme, sidomos në ato të arbëreshëve të Italisë dhe të Greqisë. Të tilla janë, ndër të tjera: *manq-u* «mashkull» (shih edhe § 1), *ager, agërinjë, gare* «gomar, gomaricë», dy fjalë këto që nuk përdoren më gjëkund; *bëruo* «bari» (e ka edhe Budi). Të kihen parasysh edhe fjalët e mëposhtme që ndeshen ende në disa të folme, si *bjerr, zbjerr* «humbas», *dirgjem* «zbres», *gjegjem* «dëgjoj», *prirem* «kthehem», *ngalkoj*, «shkoj

1) Shih për të gjitha këto BSHSH IV/1955.

2) Shih BSHSH II/1955/77.

kaluar», *shtuom* «në këmbë, shtuara», *shërbes* «shërbim, punë» etj.<sup>1</sup>

16. Siç u vu në dukje edhe pak më sipër (§ 15), vëmendjen e E. Çabejt e ka tërhequr edhe fjalori i autorëve të tjerë të vjetër të Veriut, sidomos ai i Budit në studimin *Pjetër Budi dhe gjuha e tij*<sup>2</sup>. Edhe në këtë rast ai ka vënë në dukje ndonjë fjalë që ndeshet vetëm te ky shkrimtar, si *kuor kor-i* «herë, kohë, rend. zakon, masë», prej nga janë formuar *i përkormë* «që ka masë» dhe *i pakorë* «që s'ka masë», që ndeshen edhe tek autorët e tjerë të vjetër. Veç kësaj, ai ka nxjerrë një numër mjaft të madh fjalësh me interes gjuhësor, që dëshmojnë për herë të parë në veprat e Budit. Nga këto po përmendim këtu vetëm disa: *i arësyeshëm, damëtonj, dashëkeq, diç, fjalëkëqí, gojëplotë, grykësi-a, gjukatë, hulli, kaptonj, kundërshër, kundrështí, mundështonj, i ndritshim, nkrijuos-i, peranduor, përbëhem, i përvnershim, i përzjarmshim, shortëti, vobëzi* etj., etj.<sup>3</sup>

---

1) Shih E. Çabej, *Gjoni Buzuku dhe gjuha e tij*, Nëntori, 1955/3.

2) SF, 4/1966/139 v.

3) Shih *po aty*, f. 143. v.

## KREU VII

### Për shqipen e sotme

1. Siç u vu në dukje edhe në I/38, megjithëse gjatë veprimtarisë së tij shkencore u është përkushtuar më fort çështjeve të ndryshme të historisë së gjuhës shqipe. Çabej gjatë tërë asaj veprimtarie është marrë edhe me çështje të rëndësishme të shqipes bashkëkohore. Dhe nuk mund të ndodhte ndryshe me një gjuhëtar, i cili i kishte vënë vetes si qëllim që evolucionin historik të shqipes ta studionte për të shpjeguar e për të zgjidhur sa më mirë edhe problemet që paraqiste vështirimi sinkronik i kësaj gjuhe. Nga ana tjetër, studimi i evolucionit historik të një gjuhe nuk mund të jetë i plotë pa njohur mirë fazën e fundit, d.m.th. gjendjen sinkronike të saj. Interesimi i tij i shumanshëm për çështjet e studimit sinkronik të shqipes kushtëzohet edhe nga kërkesat që paraqiste procesi i vendosjes së një shqipeje letrare të njësuar, e cila, siç dihet, u bë e mundur vetëm pas fitores historike të popullit shqiptar mbi armiqtë e ndryshëm në vitin 1944. E një gjuhëtar i tillë si Çabej nuk mund të qëndronte indiferent ndaj atyre kërkesave. Prandaj, sidomos qysh nga viti 1945 e këtej (por edhe më parë), ai ka punuar dhe ka dhënë ndihmesa të rëndësishme për kapërcimin e vështirësive të shumta që nxirrte standardi-

zimi dhe zhvillimi i pandërprerë i shqipes letrare, e cila në kushtet e reja shoqërore-politike po shkonte drejt njësimi të saj.

Si rrjedhim, është fare e natyrshme që emrin e Çabejt e gjejmë në të gjitha veprat kolektive. që në një mënyrë a në një tjetër lidhen me standardizimin dhe me pasurimin e shqipes së sotme letrare. Kështu, p.sh., atë e gjejmë si pjesëmarrës aktiv në grupet e punës për njësimin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe,<sup>1</sup> për përpunimin e terminologjive të shkencave të ndryshme,<sup>2</sup> për hartimin e fjalorit shpjegues të gjuhës shqipe të vitit 1954<sup>3</sup> etj.<sup>4</sup> Gjithashtu, ai hartoi, së bashku me prof. A. Xhuvanin, dy monografi të rëndësishme mbi *Parashtesat e gjuhës shqipe* (1956) dhe *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962). ku këto mjete të rëndësishme të fjalëformimit shqyrtohen si në rrafshin bashkëkohor (sinkronik), ashtu edhe në rrafshin historik (diakronik) (shih § 8). Në të gjitha këto punime kolektive ndihmesa e Çabejt ka qenë e një rëndësie të madhe. Por në paragrafët e mëposhtëm, në përputhje me rrugën e ndjekur edhe në kapitujt e tjerë të këtij libri, do të ndalemi shkurt vetëm në disa nga mendimet e këtij gjuhëtari në lidhje me rrugën e zhvillimit të shqipes letrare dhe të drejtshkrimit të saj.

2. Përsa i takon gjuhës letrare të përbashkët, Çabej më parë përkrahte tezën e Komisionit Letrare Shqipe të Shkodrës<sup>5</sup>,

---

1) Është fjala për *Udhëzuesit drejtshkrimorë* të vjetëve 1949, 1951, 1953 dhe 1956, që u hartuan nën drejtimin e prof. Aleksandër Xhuvanit.

2) Ai ka marrë pjesë në grupet e punës për hartimin e *Fjalorëve të terminologjisë tekniko-shkencore* (1. *Botanikë*, 2. *Matematikë dhe mekanikë teorike*, 3. *Energji atomike*, 4. *Termodinamikë*, 5. *Optikë*, 6. *Akustikë*, 7. *Elektromagnetizëm*, 8. *Mekanikë*, 9. *Elektroteknikë*, 10. *Kimi*, 11. *Gjeologji*, 12. *Arkitekturë*) si edhe për *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes* (projekt 1967) dhe *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* (1973).

3) Ky fjalor u hartua nga një komision i përbërë nga Kostaq Cipoja (krvetar), Eqrem Çabej, Mahir Domi, Anton Krajni dhe Osman Myderrizi.

4) E. Çabej bënte pjesë (bashkë me S. Dancetoviqin, Aleksandër Xhuvanin dhe Kostaq Cipon), në komisionin redaktues të *Fjalorit serbo-kroatisht-shqip*. Tiranë, 1947.

5) *Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës* (1916-1917), ku bënë pjesë L. Gurakuqi, H. Mosi, A. Xhuvani, S. Peci, M. Logoreci, Gj. Pekmezi.

që djepi i saj të kërkohej «në Shqipëri të Mesme, ku gegërishtja e toskërishtja duke u përpjekur zbutin veçoritë e tyre dalluese... Së pari duhen studiuar dialektet e Shqipërisë së Mesme. Këto përgjithësisht dhe pas një selektimi do të japin bazën e gjuhës në fonetikë dhe në format gramatikore. Në thesarin e fjalëve (leksikun) do të kontribuojnë edhe dialektet e tjera shqiptare».<sup>1</sup>

Por, më vonë ai u bashkua me mendimin e përgjithshëm që u konsakrua në *Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe* (1972), ku u vendos gjuha letrare e njësuar, e cila po përdoret sot edhe nga shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi etj. Në atë kongres ai mbajti kumtesën *Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes*.<sup>2</sup> Synimi i tij kryesor në këtë rast ishte që brenda caqeve të një kumtese të vinte në dukje se zgjidhjet e vendosura për drejtshkrimin e njësuar të shqipes letrare ishin në përputhje edhe me traditën e hershme të shkrimit dhe të drejtshkrimit të kësaj gjuhe. Kështu, p.sh., qysh në fillim të kumtesës ai vë në dukje se edhe Komisia Letrare e Shkodrës kishte vendosur që togjet zanore *ie, ue, ye* dhe togjet bashkëtingëllore *mb, nd, ngj*, të shkruheshin të plota, ashtu siç u vendos edhe në *Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*. Me këtë rast ai shton se edhe autorët e vjetër veriorë (Buzuku, Budi etj.) kështu i shkruanin këto toge.<sup>3</sup>

3. Ai vë në dukje më poshtë se «gjuhët e përbashkëta të shkrimit e të literaturës zakonisht ndërtohen mbi një bazë dialektore të caktuar. Kjo ndërkaq përbën pikënisjen për një zhvillim të mëtejshëm, nuk merret e gjitha ashtu siç është, në tërësinë gjuhësore konkrete të saj. Shpeshherë asimilohen në atë mes edhe elemente të ndonjë dialekti tjetër ose dialektesh të tjera, ndonjë nga tiparet fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore të tyre, të cilat vijnë e integrohen në sistemin e gjuhës së përbashkët, ose përndryshe shërbejnë si model për të modifikuar ndonjë tipar të kësaj, që si tepër i veçantë ndihet nevoja t'i shtrohet një reformimi».<sup>4</sup>

N. Mjeda etj. mendonte që shqipja letrare e përbashkët të bazohej në variantin letrar të Shqipërisë së Mesme.

1) Shih *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, f. 19.

2) Shih *SF* 1/1973/97-107.

3) Shih *po aty*, f. 97.

4) Shih *po aty*, f. 98.

Pasi flet shkurt për faktorët që e kanë kushtëzuar formimin dhe zhvillimin e gjuhës letrare shqipe, ai pohon: «Një gjuhë e përbashkët, përtej caqeve shtetërore, mbetet shprehja e një njësie nacionale dhe e një shkalle të caktuar të kulturës të bashkësisë që e flet. Përpjesëtimi aty është i karakterit të drejtë, në mënyrë që sa më e fortë ajo njësi, sa më e ngritur ajo shkallë kulture, aq më e formuar paraqitet gjuha e përbashkët, si në të folur dhe sidomos në shkrim. Një gjuhë e tillë qëndron kështu përmbi dialektet, është një madhësi mbidialektore, në njëfarë vështrimi, emëruesi i përbashkët dhe sinteza e tyre. Ajo paraqet një realitet dhe njëkohësisht rezultatin e njëfarë abstrakcioni të formuar gjatë kohës, në mënyrë që nuk përputhet krejt me një dialekt territorial të caktuar, as edhe me dialektin që përbën bazën e saj. . .»<sup>1</sup>

4. Duke bërë fjalë për rrugën e zhvillimit të shqipes së shkruar, ai pohon se ajo «paraqitet me një vijë zhvillimi, e cila karakterizohet nga një aksiomatikë e caktuar». Dhe këtu ai rendit tri «aksioma». Sipas tij, aksioma e parë është thjeshtimi i vazhdueshëm i saj në trajtat e sistemit fonetik e gramatikor dhe pasurimi i fjalorit të saj. Aksioma e dytë është konvergjenca në rregullat e drejtshkrimit. Dhe aksioma e tretë «përmban njëkohësisht edhe një rregull, gjuha e shkrimit ka dalë në analizë të fundit prej gjuhës së gjallë të popullit. Në pajtim me këtë, edhe rregullat që përcaktojnë përdorimin e saj, duhet të dalin nga të dhënat e këtij realiteti gjuhësor».<sup>2</sup>

Pas këtyre parashtrimeve teorike ai pohon se në shkrimin e shqipes «janë arritur rezultate të mira, disa pika të qëndrueshme. . . në drejtim të thjeshtimit e të konvergencës». Dhe pasi vë në dukje se në përcaktimin e normave drejtshkrimore të shqipes është pasur parasysh edhe përhapja tokësore e një trajte të dhënë, ai rendit disa nga normat drejtshkrimore, që janë vendosur për shqipen e njësuar letrare.

Në fund të kumtesës ai shtron me forcë edhe nevojën për pasurimin e shqipes letrare me fjalë të gurrës popullore ose «të farkuara prej burimit të saj», si edhe për mënjanimin e fjalëve të huaja të panevojshme.<sup>3</sup>

5. Por për këto çështje ai është ndalur më shumë në një

1) Shih *po aty*, f. 101.

2) Shih *po aty*, f. 101 v.

3) Shih *po aty*, f. 106.



artikull të gjatë me titull *Për pastërtinë e gjuhës*, të botuar së pari në gazetën *Mësuesi* më 1979 dhe të ribotuar në revistën *Gjuha jonë* I/1981.

Në këtë artikull, pasi vë në dukje se «gjuha është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj» dhe se «shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture», autori thekson: «Një ndër detyrat kryesore të gjuhësisë shqiptare, krahas kërkimeve teorike, është edhe mbetet pasurimi i gjuhës me elemente të gurrave vetjake dhe spastrimi i saj prej masës së fjalëve të huaja, që kanë vërshuar së jashtmi dhe që po vazhdojnë edhe në ditët tona». <sup>1</sup> Me këtë rast ai vë në dukje se në këtë punë të dyanshme ka një traditë të mirë, që dëshmohet qysh tek autorët e vjetër, duke nisur me Gjon Buzukun dhe autorët e tjerë veprorë pas tij, në veprat e të cilëve gjejmë të përdorura fjalë të tilla, si: *derëtar, gjukësi, gjuhëtar, këshilltar, kopështar, madhështi, mjeshtëri, i përbrendshëm, përndjek* (= persekutoj), *vetëmi, vjershëtar* etj. <sup>2</sup> Pastaj ai përmend edhe një varg fjalësh abstrakte që janë krijuar nga disa autorë arbëreshë dhe shqiptarë të shekujve XVIII dhe XIX dhe të fillimit të shekullit XX, duke përfshirë ndër këta të fundit edhe Kristoforidhin, dy vëllezërit Frashëri, Luigj Gurakuqin, Aleksandër Xhuvanin, Mati Logorecin etj. <sup>3</sup>

Dhe pasi vë në dukje se gjuha e shkrimit dhe e bisedës që përdoret sot, i ka rrënjët në gjuhën popullore të përpunuar giatë kohëve, ai thekson se do të ishte me interes të hetohet se tek cili autor apo në cilin shkrim dalin për herë të parë fjalët e «leksikut abstrakt-mendor» të gjuhës shqipe. Dhe shton se nga një punë e tillë do të dalë në dritë «që një pjesë e mirë e leksemave të këtij lloji janë më të vjetra nga ç'mund të kujtohet, dhe që një pjesë i ka pasur qëmoti edhe gjuha popullore». <sup>4</sup> Dhe pasi rithekson se gjuha shqipe është e pasur «edhe në fushën e fjalëve të sferës abstrakte-mendore», Çabej nxjerr përfundimin: «Nuk është i drejtë mendimi i disa dije-tarëve të huaj se shqipja qenka e pasur vetëm në fjalë të sferës barifore, as mendimi se shqiptarët paskan qenë një po-

1) Shih *Gjuha jonë* 1/1981/36 v.

2) Shih *po aty*, f. 38.

3) Shih *po aty*, f. 39 v.

4) Shih *po aty*, f. 41.

pull barinjsh nomadë, shtegtarë. Një mendim i tillë nuk për-  
ligjet as me të dhënat e ekonomisë politike historike.»<sup>1</sup> Dhe  
këtu ai rendit një numër jo të paktë fjalësh të gjuhës popu-  
llore (të sferës abstrakte), që kanë zëvendësuar ose që mund  
të zëvendësojnë terma të huaja të shkencave të ndryshme, në-  
përmjet specializimit të kuptimeve të tyre ose nëpërmjet for-  
mimeve të reja mbi bazën e tyre. Nga këto po përmendim  
këtu vetëm disa, sa për shembull: *likurishtë* = polipi i detit;  
*zbutoj* (një pemë me anë të shartimit); *rrënjëzohet* = zë rrënjë  
bima; *mizon* = bie borë e imët; *kodërvorre* = tuma të lashta;  
*tjerrtore* = filaturë; *përmidora* = shpina e dorës; *lentoj* (nga  
lej) = krijoj dhe *lentim* = krijim etj.

Pastaj ai rendit një numër të madh fjalësh të huaja që  
mund të mënjanohen nga përdorimi, duke u zëvendësuar me  
fjalë vendi ose me fjalë të përfutuara mbi bazën e fjalëve të  
vendit, si: *abuzoj*, *abuzim*, *adaptoj*, *adaptim*, *apikulturë*, *apro-  
voj*, *aprovim* etj., etj.<sup>1</sup> Dhe në lidhje me këtë punë të madhe,  
së cilës thotë ai. «duhet t'i përvishemi me një rrugë tërësore,  
sistematike e të organizuar mirë që në ballë, në mënyrë para-  
prake do dalluar qartë ç'është huazim (frëngj. *emprunt*) e  
ç'është fjalë e huaj.»<sup>2</sup> Ai sqaron se fjalët e huaja të tipit *abuzoj*  
etj. «nuk janë huazime të mirëfillta. të tilla që të kenë hyrë  
lashtërisht në gjuhë të popullit, të jenë bërë mish e asht i saj.  
Janë mish i huaj depërtuar në gjuhë nëpërmjet shtresave in-  
telektuale kryesisht në këta brezat e fundit dhe nuk kanë  
arritur të hyjnë thellë në strukturën leksikore të gjuhës. Prandaj  
edhe zëvendësimi i tyre me brumë vendi. me kusht që të mos  
cenohet saktësia kuptimore, në përgjithësi nuk paraqitet i vësh-  
tirë.»<sup>3</sup> Dhe pasi vë në dukje, gjithashtu, se depërtimi i fjalëve  
të huaja nuk për- ligjet as me karakterin gjuhësor të shqipes,  
ai pohon: «gjuha shqipe nuk është një gjuhë romane as gjys-  
mëromane. si ka qenë pohuar dikur dhe vazhdon të pohohet  
vise-vise edhe sot e gjithë ditën.»<sup>4</sup>

6. Më tej autori vë në dukje se puna e zëvendësimit të  
fjalëve të huaja të panevojshme duhet të mbështetet në disa

1) Shih *po aty*, f. 41.

2) Shih *po aty*, f. 43.

3) Shih *po aty*, f. 43 v.

4) Shih *po aty*, f. 44.

parime. Një ndër parimet kryesore, shton ai, duhet të jetë *maturia*, d.m.th. të mos kalohet në ekstrem, siç është vepruar në disa gjuhë, ku edhe termat shkencorë ndërkombëtare janë zëvendësuar me fjalë vendi. Term ndërkombëtar, sipas tij, «nuk mund të quhet një term shkencor që e kanë përgjithësisht vetëm gjuhët romane. gjuhët bija të latinishtes. ato vetvetiu e kanë marrë e do ta marrin prej saj.»<sup>1</sup> Dhe shton se term ndërkombëtar mund të quhet një term shkencor, që përveç gjuhëve romane, e kanë në përdorim edhe gjuhët gjermanike, sllave etj. Të tillë janë, p.sh., termat *kimi*, *fizikë*, *botanikë*, *zoologji etj.*, por jo edhe *acid*, *levë*, *presion*, *leguminoze etj.*, që mund të zëvendësohen fare mirë me terma të gjuhës shqipe. Dhe pasi thekson edhe një herë se në degë të ndryshme të dijes dhe të shkencave të ndryshme «ka një mori fjalësh të vendit që pa dëm kuptimor janë në gjendje t'ua zënë vendin fjalëve të huaja», ai vë në dukje se fjalët e vendit, si terma janë më të kuptueshme nga një masë e gjerë njerëzish, duke përfshirë këtu edhe nxënësit e moshave të vogla. Por, nga ana tjetër, thekson ai, nuk duhet kaluar në skajin tjetër, duke shqipëruar edhe ata terma shkencorë ndërkombëtarë, që përdoren sidomos në rrethe të ngushta specialistësh. Ai vë në dukje, gjithashtu, se një rëndësi më të madhe merr çështja e srastrimit të fjalëve të huaja në degët e leksikut shoqëror, d.m.th. në ato raste kur kemi të bëjmë me fjalë të përdorimit të gjerë, si: *ambient*, *eksperiencë*, *esenciale*, *fenomen*, *influenca*, *preferoj etj.*<sup>2</sup>

7. Autori pastaj ngre edhe çështjen e mënjanimit të disa ndërtimeve sintaksore të huaja, që kanë depërtuar në shqipe, si p.sh. *gjuha greke dhe ajo latine*, *kategoritë emërore dhe ato foljore*, në të gjitha fushat kryesisht në ato politike e ushtarake etj. Në vend të ndërtimeve të tilla sintaksore, që kanë depërtuar kryesisht nën ndikimin e italishtes, ai këshillon të thuhet e të shkruhet p.sh., *kategoritë emërore dhe kategoritë foljore*, ose *kategoritë emërore dhe foljoret etj.*<sup>3</sup>

Pasi tërheq vëmendjen për mënjanimin e ndikimit të huaj edhe në fushën e fjalëve të urta,<sup>4</sup> Çabej propozon që, për t'ia

1) Shih *po aty*, f. 44.

2) Shih *po aty*, f. 45.

3) Shih *po aty*, f. 45 v.

4) Për këtë ai jep si shembull përdorimin e shprehjes *i hedh pluhur syve* në vend të shprehjes shqipe *i hedh hi syve*.

arritur sa më mirë qëllimit për pastrimin e fjalëve dhe të shprehjeve të huaja dhe për pasurimin e shqipes me fjalë të burimit vendës, të formohet një komision specialistësh dhe të botohet një organ i posaçëm me emrin *Gjuha jonë*, ose *Gjuha shqipe*<sup>1</sup>.

8. Siç u vu në dukje edhe në § 1, E. Çabej hartoi së bashku me A. Xhuvanin, dy monografi të rëndësishme mbi parashtesat dhe prapashtesat në gjuhën shqipe. Në këtë rast është e vështirë të jepet një mendim i argumentuar se ku mbaron ndihmesa e njërit dhe ku fillon ndihmesa e tjetrit, aq më shumë kur dihet se që të dy bashkautorët janë marrë me çështjet e fjalëformimit në gjuhën shqipe si në rrafshin bashkëkohor (sinkronik), ashtu edhe në rrafshin historik (diakronik). Në këto rrethana është më e arsyeshme të pranohet që ata, edhe kur për ndonjë çështje mund të kenë pasur pikëpamje të ndryshme, më në fund kanë gjetur një gjuhë të përbashkët. E këtë gjuhë të përbashkët ata e kanë gjetur edhe për rrugën e ndjekur në trajtimin e këtyre dy mjeteve të rëndësishme të fjalëformimit. Siç dihet, në të dy monografitë e tyre vështrimi diakronik dhe vështrimi sinkronik i parashtesave dhe i prapashtesave të gjuhës shqipe janë shkruar në mënyrë të tillë që plotësojnë njëri-tjetrin. Për më tepër, për të dhënë një pasqyrë sa më të plotë të rolit që kanë luajtur këto dy mjete fjalëformuese në zhvillimin dhe pasurimin e fjalorit të shqipes, bashkautorët e kanë gjykuar të dobishme që të marrin në shqyrtim edhe disa parashtesa e prapashtesa, që në vështrimin sinkronik nuk janë më të veçueshme nga termi i fjalës.<sup>2</sup>

Në lidhje me këto dy monografi, që janë të parat e këtij

---

1) Pas këtij artikulli u formua një komision i posaçëm pranë Kryeministrisë (më pas pranë Akademisë së Shkencave) për spastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e huaja të panevojshme dhe për pasurimin e saj me fjalë të gjuhës popullore ose të ndërtuara në bazë të gjedheve të njohura të gjuhës shqipe. Gjithashtu që nga viti 1981 filloi të dalë revista *Gjuha jonë*.

2) Është fjala për parashtesa e prapashtesa të tilla si: bër- (p.sh. bër-buç), dë- (p.sh. dë-boj), f- (p.sh. f-shij) etj., -all (p.sh. rrem-all), -anë/ ërë (p.sh. gërsh-anë/ gërsh-ërë) etj.

## *Eqrem Çabej*

lloji për gjuhën shqipe,<sup>1</sup> këtu do të ndalemi vetëm në disa çështje me karakter të përgjithshëm, që janë trajtuar në parathëniet e këtyre dy monografive, duke qenë se parashtrimi i mendimeve të shprehura për parashtesa dhe prapashtesa të veçanta do të zinte shumë vend, do t'i kapërcente së tepërmi caqet e parashikuara të këtij libri.

9. Për hartimin e këtyre dy monografive autorët kanë shfrytëzuar një lëndë shumë të pasur, të nxjerrë nga botime të ndryshme gjuhësore (gramatika, studime etj.), ose të vjelë drejtpërdrejt prej tyre gjatë një periudhe shumëvjeçare. Bie në sy edhe larmia e madhe e lëndës së shfrytëzuar, duke përfshirë këtu edhe të dhëna nga dialektet e arbëreshëve të Greqisë e të Italisë si edhe nga autorët e vjetër shqiptarë dhe arbëreshë. Bashkautorëve u është dashur shpesh të mbajnë qëndrim për interpretimin e saktë të rasteve të diskutueshme. Është fjala sidomos për ato raste, kur veçimi i parashtesave apo i prapashtesave paraqiste vështirësi, pasi ato prej kohësh kanë pushuar së qeni prodhimtare në gjuhën shqipe, ose kur tema, së cilës i është shtuar parashtesa «nuk ekziston më, ka humbur, dhe ka mbetur vetëm forma e pajisur me parashtesë, ose krahas me këtë shumë-shumë ruhet fjala e formuar me një parashtesë që jep kuptimin e përkundërt».<sup>2</sup>

10. Përsa i takon metodës së studimit të parashtesave dhe të prapashtesave, autorët pohojnë se kanë synuar të ndjekin përgjithësisht «kriterin e bashkimit të përshkrimit të fakteve me shikimin e tyre historik». «Jemi të mendimit — shtojnë ata — që sistemi i gjuhës do vështroar jo vetëm si një gjendje aktuale, po njëkohësisht edhe si një proces e si rezultati i një zhvillimi; me këtë rrugë besojmë se jo vetëm se vërehen dhe përshkruhen dukuritë, po edhe mund të arrihet në shpjegimin e tyre. Kombinimi i të dyja metodave jep një pamje më të plotë të dukurive gjuhësore».<sup>3</sup>

Lidhur ngushtë me metodën e ndjekur ata i kanë shqyrtuar parashtesat dhe prapashtesat e shqipes edhe për nga prodhimtaria në shqipen e dokumentuar dhe sidomos në shqi-

---

1) Më parë janë botuar më fort artikuj të shpërndarë kryesisht në për të përkohshme për parashtesa e prapashtesa të ndryshme.

2) Shih *Parashtesat e gjuhës shqipe*, BSHSH 4/1956/66.

3) Shih *po aty*, f. 67.

pen e sotme. Për këtë qëllim ata kanë vënë edhe shënimet përkatëse në shqyrtimin e tyre.<sup>1</sup>

Një tjetër dëshmi e interesimit të tyre për rolin e këtyre mjeteve fjalëformuese në shqipen e sotme, është edhe kujdesi i vazhdueshëm që ata kanë treguar për të vënë në dukje rastet kur fjalët e formuara me një prapashtesë kanë dy vlera morfologjike (shërbejnë edhe si emra, edhe si mbiemra). P.sh. *Arbëresh* dhe fik *arbëresh*, *beratas* dhe kokosh *beratas*, *shkodran* dhe dasmë *shkodrane*, *vlonjat* dhe kumbull *vlonjate*, *verore* (emër) dhe dardhë *verore*, *shqiptar* dhe *gruaja shqiptare*, *ilir* dhe fiset *ilire* etj.<sup>2</sup>

11. Një kënd vështrimi ku mplekset shqyrtimi sinkronik me analizën diakronike, vihet re në trajtimin e disa prapashtesave të përbëra nga bashkimi i dy ose më shumë formanteve. Lidhur me këtë çështje ata pohojnë: «Me këtë mjet është pasuruar sistemi i derivacionit. Ky proces nuk ka marrë fund. ai po vazhdon dhe sot e gjithë ditën. Ka rrasa, ku shihet edhe sot se si disa fjalë si grup me përhapjen e formës së tyre po bëhen model për formim fjalësh të tjera, e kështu japin shkas për lindjen e një prapashtese të re. Nga kjo rrjedh që në gjendjen e sotme të gjuhës ka disa formante si *-acán*, *-acár*, *-acél*, *-acúk*, *alósh*, *anáak*, *-anjós*, *arák*, *-arí*, *-arísh*, *aták*, *-atár*, *-atinë*, *-atór*, *-cak*, *-çar*, *-çkë*, *-(ë) rimë*: *-ë (rinë)*, *-(ë)risht*, *-(ë)sisht*, *-(ë) sor*, *-(ë) zor*, *-imisht*, *-lënë*, *-neshë*, *-orës*, *-orí*, *-shi*, *-shti*, *-tajë*, *-tarí*, *-ti*, *-tinë*, *-tirë*, *-uckë*, *-ullí*, *-ullím*, *-urina*, *-ushkë*, për të cilat është vështirë të thuhet a kemi të bëjmë me një prapashtesë të ditur të zgjeruar me një tjetër (a me dy të tjera), a me një infiks, apo me një prapashtesë të përbërë të tipit të ri. Zhvillimi i mëtejshëm, një produktivitet më i madh a më i kufizuar, do të jetë vendimtar në të ardhmen për të dhënë një gjykim më të prerë në rrasa të tilla».<sup>3</sup>

12. Në shqyrtimin diakronik të parashtesave dhe të prapashtesave të shqipes autorët kanë vënë në dukje se disa nga këto kanë depërtuar nga gjuhët e huaja, me të cilat shqipja ka pasur kontakte historike gjatë shekujve. Por ata kanë vënë

1) Mjafton të përmendim këtu, sa për shembull, shënimet që ata kanë vënë gjatë shqyrtimit të parashtesave *a-k(ë)* të përemrave dëftorë *a-i*, *k-y*, dhe të ndajfoljeve përemërore *a-ty*, *kë-tu* etj.

2) Shih *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, 4.

3) Shih *vep. cit.* 4.

në dukje gjithashtu se ka raste që disa prapashtesa të huaja «kanë ndeshur në formante të vendit, të ngjashme me to nga trajta e nga kuptimi, dhe janë përzier me këto në truall të shqipes»<sup>1</sup>. Gjithsesi, ata kanë arritur të vërtetojnë se një numër i mirë parashtesash e prapashtesash të shqipes janë të trashëguara nga një fazë e vjetër indoevropiane ose janë përftuar gjatë zhvillimit historik të saj. Nga shqyrtimi i këtyre mjeteve gjuhësore ata kanë arritur në përfundimin se në formimet me parashtesa dhe prapashtesa në gjuhën shqipe «na del edhe këtu po ajo pamje që dihej dhe më parë nga fusha e leksikut të saj: një gjuhë indoevropiane më vete dhe njëkohësisht gjuhë ballkanike, e cila gjatë kohëve ka marrë vërtet disa formante nga gjuhët me të cilat ka pasur të dhënë e të marrë, po që edhe në këto rrethana ka ruajtur fondin e vet edhe në elementet formative».<sup>2</sup>

---

1) Shih *po aty*, 4.

2) Shih *Parashtesat e gjuhës shqipe*, BSHSH. 4/1956/66.

## KREU VIII

# Folklor - Letërsi

1. Duke qenë se E. Çabej njihet në radhë të parë si gjuhëtar, ndoshta nuk janë të shumtë ata që e dinë se ai është marrë mjaft edhe me kulturën popullore dhe me letërsinë. Në këtë rast nuk është fjala vetëm për studimin e krijimeve popullore dhe letrare, sepse një gjuhëtar, sidomos një historian i gjuhës, duhet t'i kalojë ato disa herë nëpër duar, për të nxjerrë që andej lëndën e nevojshme për studimet e tij gjuhësore. Në rastin e gjuhëtarit tonë është fjala jo vetëm për njohjen e mirë të folklorit dhe të veprave të letërsisë së shkruar, por edhe për studime mbi probleme të kulturës popullore dhe të letërsisë shqiptare, në mjaft raste të vështruara edhe të krahasuara me ato të popujve të tjerë, sidomos të popujve të Ballkanit. Madje, mund të pohohet se në vitet e para të veprimtarisë së tij Çabej është marrë pothuaj në një masë të barabartë si me probleme të gjuhësisë ashtu edhe me probleme të folklorit dhe të letërsisë, sidomos të folklorit. Kështu, p.sh., qysh në doktoratën e tij universitare (1933), ai ka përfshirë një kapitull me tekste dialektore, ku ka renditur edhe përralla si edhe *Ballada e Kostandinit të vogël* dhe *Ringjallja e Lazërit* (shih edhe I/5). Po kështu në tekstin *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe* (1936) ai u ka kushtuar shumë vend kriji-



meve popullore dhe letrare, duke shprehur hapur edhe vlerësimin e tij të madh për to.<sup>1</sup> Të kihen parasysh edhe monografia e tij *Për gjenezën e literaturës shqipe* (1939) ku shqyrtimi i shumanshëm i poezisë popullore zë vendin kryesor, si edhe artikujt e tij *Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare* (1934) dhe *Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut* (1937) (shih për këto § 8 dhe § 7). Edhe në periudhën e mëvonshme, kur iu përkushtua me aq zell problemeve të historisë së gjuhës shqipe, ky dijetar humanist vazhdoi të tregonte një interesim të madh si për folklorin ashtu edhe për letërsinë artistike, por në mënyrë të veçantë për folklorin. Ai ishte i bindur se gjuhësia dhe folklori «janë dy fusha shkencore që duhet të ecin krah për krah dhe rezultatet e njërës dije i hyjnë në punë edhe tjetrës».<sup>2</sup>

2. Edhe nga një lexim i shpejtë i studimeve, artikujve dhe kumtesave kushtuar kulturës popullore dhe letërsisë shqiptare njeriu nuk e ka të vështirë të kuptojë se edhe në këto fusha studimesh Çabej ka dhënë ndihmesa me vlerë. Por, edhe në këtë rast, ashtu siç u veprua në kapitujt e mëparshëm, do të ndalemi vetëm në disa prej këtyre ndihmesave dhe pikërisht në disa nga mendimet e tij mbi poezinë popullore dhe mbi disa figura legjendare të asaj poezie, si edhe mbi burimin e figurave mitologjike të zanave. Për çështje të tjera të kulturës popullore, të trajtuara nga ky dijetar, të interesuarit mund të studiojnë artikujt e tij që janë përfshirë në Bibliografinë në fund të këtij libri.

3. Përsa i takon poezisë popullore. E. Çabej në studimin *Për gjenezën e literaturës shqipe*<sup>3</sup> ishte i mendimit se ajo para-

---

1) Kështu, p.sh., në f. 61 të këtij botimi ai shkruan, ndër të tjera: «Poezia popullore është një nga thesaret më të çmuara të jetës shpirtërore të popullit tonë. Nga ajo poetët tanë kanë gjetur dhe mund të gjejnë burime të pashterura frymëzimi». Dhe më poshtë (f. 62): «Interesi i literaturës sonë popullore shtohet, po të studiohet kjo në lidhje me literaturat e popujve të tjerë të Ballkanit. Atëherë mund të gjenden marrëdhëniet e poezisë sonë me poezinë greke të vjetër, lidhjet e këngëve toske me këngët greke të mesme të reja, afërsitë e poezisë së malësorëve me këngët sllave jugore, afrimet shqiptare me poezitë popullore rumune e veçanërisht arumune».

2) Shih: *Histori fjalësh të sllavishtes e të shqipes*, SF 1/1976/132.

3) Ky studim është botuar në HD (*Hylli i Dritës*) 12/1938 dhe 1,2

qet vetëm një pjesë organike, sado që njerëzisht më të lartë, të jetës së popullit e të manifestacioneve të saj të përditshme. Ai shton se nuk mund të kuptohet poezia jonë popullore pa njohur jetën shqiptare të vjetër dhe pa mos e kuptuar këtë poezi «si produkt e si funksion të kësaj jete».<sup>1</sup> Duke u mbështetur në radhë të parë në të dhënat e vetë poezisë popullore shqiptare si edhe në mendimet e shprehura mbi të nga studiues të tjerë para tij, gjithë duke theksuar rëndësinë e vështrimit të kësaj poezie së brendshmi, d.m.th. si produkt dhe si pasqyrim të jetës së vetë popullit shqiptar në rrymë të shekujve, ai ka vënë në dukje edhe nevojën e krahasimit të saj, sidomos me poezinë popullore të vendeve të tjera të Ballkanit, për të parë afritë dhe ndryshimet midis tyre dhe për të zbuluar faktorët që u kanë dhënë shkas këtyre afrive dhe ndryshimeve.<sup>2</sup>

Në studimet dhe artikujt mbi poezinë popullore shqiptare ai ka vënë në dukje dhe ka shqyrtuar gamën e gjerë të motiveve të kënduara në vargjet popullore, ku pasqyrohen aspektet e ndryshme të jetës shqiptare, dhe ka dhënë mendime me vlerë edhe mbi meloditë me të cilat ato këndohen në vise të ndryshme të Shqipërisë si edhe mbi ritmin dhe mënyrën e ndërtimit të tyre. Për më tepër, ky historian i shquar i gjuhës shqipe nuk mund të mos shfaqte mendime edhe mbi vjetërsinë dhe shtresimin kohësor të këngëve popullore shqiptare dhe pikërisht për këtë çështje po japim shkurt mendimet e tij.

4. Për praninë e një shtrese të vjetër paraturke në folklorin shqiptar ai është mbështetur më fort dhe me të drejtë në të dhënat e poezisë popullore të arbëreshëve të Italisë,<sup>3</sup> të cilët janë shpërngulur valë-valë nga Shqipëria dhe nga Moreja. Ata kanë ruajtur jo vetëm disa trajta gjuhësore arkaike, por edhe një shtresë të vjetër këngësh popullore, që i morën me vete stërgjyshërit e tyre, kur u detyruan të braktisin trojet e vendlindjes. Në këngët epike historike, që përbëjnë edhe shtresën

---

dhe 3-7/1939. Në këtë studim trajtohen 10 çështje. Çështja e nëntë, poezia popullore, trajtohet më gjerë, (shih HD 2 dhe 3-7/1939).

1) Shih HD 2/1939/93.

2) Shih HD 3-7/1939/156 v.

3) Shih *Shqiptarët në Itali të Mesme dhe në Napoli*, HD 3-7/1939/175 dhe *Poezia popullore e arbëreshëve të Italisë*, *Arsimi Popullor* 10/1961/73 v.

më të vjetër të poezisë popullore arbëreshe, ruhen ndër të tjera edhe emra heronjsh legjendarë dhe historikë, si: *Nik Peta*, *Pal Golemi*, *Milo Shini*, *Radovani*, *Pjetër Vojvoda*, *Badheri* (Ballabani) etj. Në këngët arbëreshe të kësaj shtrese të vjetër këndohen me ngjyra të gjalla luftërat e para të shqiptarëve kundër pushtuesve turq. Gjithashtu, shtresës së vjetër të poezisë popullore arbëreshe i përkasin edhe disa këngë legjendare, si ajo e *Kostandinit të vogël*, e *Garentinës* etj. Për vjetërsinë e këtyre këngëve dijetari ynë ka parashtruar edhe argumente të ndryshme. Kështu, në të mirë të vjetërsisë së tyre dëshmon sidomos fakti i vënë në dukje së pari nga Dh. Kamarda, që këto vjersha janë kënduar si nga arbëreshët e Kalabrisë, ashtu edhe nga ata të Sicilisë, megjithëse kanë qenë të izoluar dhe nuk kanë pasur kontakte midis tyre.<sup>1</sup> Veç kësaj, Çabej ka vënë në dukje edhe faktin që vargjet e këtyre këngëve nuk janë ndërtuar me rimë dhe me një numër të caktuar rrokjesh, si vargjet e poezisë popullore italiane, por mbi parimin e ritmit, d.m.th., mbi vendosjen e theksit në rrokje të caktuara të vargut dhe mbi alternimin e rrokjeve të gjata me të shkurtërat. Edhe melodia e rëndë, e përmallshme bizantine e këtyre këngëve është një tjetër dëshmi, sipas Çabejt, për moshën e vjetër paraturke të tyre. Gjithashtu, një dëshmi të vjetërsisë së këtyre këngëve Çabej e ka parë edhe në faktin që disa nga këto këngë të vjetra arbëreshe këndojnë motive, që ndeshen edhe në disa këngë të vjetra të Shqipërisë<sup>2</sup> (shih §§ 6-8).

5. E. Çabej është shprehur edhe për moshën e vjetër të këngëve epike të Veriut (cikli i *Mujit dhe i Halilit*, *Gjergj Elez Alia* etj.), ku ai, krahas disa elementeve të reja siç është, ndër të tjera, islamizimi i emrave të personazheve, ka vënë në dukje edhe disa tipare të moçme, siç janë, ndër të tjera, emrat tripjesësh (si *Gjergj Elez Alia*), *Destar Osman Aga*, *Hake Vrak Shabani* etj.)<sup>3</sup>, që ndonëse pjesërisht ose tërësisht të islamizuar, pasqyrojnë një traditë të vjetër shqiptare. e cila ndeshet edhe në jug (khs. *Muslim Gjoleka* < *Gjon Leka*, *Metat Gjolligu* < *Gjon Ligu* etj.) Në këtë rast ai ka vënë në dukje edhe vjetërsinë e mënyrës së të kënduarit individual të këtyre këngëve, që shoqërohen me lahutë. Për meloditë e këtyre

1) Shih *Arsimi Popullor* 10/1961/78.

2) Shih *po aty*, f. 80.

3) Shih *HD* 3-7/1939/161.

këngëve të malësorëve të Veriut ai mendon se janë «gjurma tingëllore e fundit e shtresës primare të kulturës shqiptare», «simboli muzikal i shtëpisë së vetmuar, i ekzistencës së vetmuar» të malësorit. Dhe më tej shton se për nga burimi, «këto melodi nuk janë tjetër veçse thirrma e britur dhe e dëgjueshme që larg, të cilën e ndeshim në gjithë popujt malësorë. Por në rastin tonë mund të kemi të bëjmë me thirrjen e kasnecit, e cila në kanunin tradicional të këtyre viseve luan një rol të rëndësishëm në pikëpamje sociale-ushtarake.»<sup>1</sup>

Ai ka prekur edhe problemin e diskutueshëm të burimit të këtyre këngëve epike, që ndeshen, natyrisht me ngjasime edhe ndryshime, edhe ndër bosnjakët etj. Në këtë rast, ai ka vënë në dukje, ndër të tjera, jo vetëm rolin dhënës të eposit shqiptar, por edhe evolucionin që kanë pësuar këngët e këtij cikli në rrjedhë të kohës, sidomos gjatë sundimit otoman. Po, megjithë këto ndryshime të kuptueshme, thelbi i motiveve të këtyre këngëve është i lashtë. Ja si shprehet ai për figurat e Mujit e të Halilit. «Mua te Muji e Halili më pëlqen të shoh analogjinë shqiptare të lashtë e ndofta ilire të atij çifti vëllë-zëriish trima, që na ndeshen te Grekët (dioskurët), keltët, gjermanët dhe indët, si edhe në epopenë heroike armene: Sanazar dhe Aslimelik, të bijtë e mbretit Senekerim.»<sup>2</sup>

6. Dijetari ynë është shprehur, ndonëse shkurt, edhe për burimin e melodisë së vjetër të këngës labe. Lidhur me këtë ai shkruan se kjo melodi me burim baritor të kujton melodinë e përftuar nga tringëllima e këmborëve. «Sikurse këtu tingulli i rëndë e i thellë i këmborëve të deshve — zgjedhja e të cilave në të kumbuar ka prandaj rëndësi për barinë — dallohet prej kumbimit të përgjithshëm të zileve të shumta e të zakonshme të dhenve, kështu shquan te kënga labe zëri i lartë i atij që ia merr dhe zëri i thellë, i dredhur si këmbora, i atij që ia kthen këngës, nga kori i këngëtarëve të tjerë që vete e rrjedh i plotë, monoton e i gjerë. Nuk besoj të gabojmë, po të themi se ky popull barinjsh e ka krijuar këngën e vet duke u mbështetur, pa e ditur, në zërin e dashur e të zakonshëm të këmborëve.»<sup>3</sup>

7. Siç u vu në dukje në § 1, Çabej në studimet e botuara

1) Shih *po aty*, f. 169 v.

2) Shih *po aty*, f. 160 v.

3) Shih *po aty*, f. 173.

## Eqrem Çabej

mbi folklorin është marrë edhe me tema konkrete të poezisë sonë popullore. Një nga këto studime, që është botuar në *HD* 1938, Nr. 2-3, mban titullin *Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut*. Këtu autori e shqyrton në mënyrë të krahasuar temën qendrore të këngës popullore arbëreshe. Në këtë këngë, siç dihet, Kostandini, pas tri ditë dhëndërie, detyrohet të largohet për në luftë. Ai i kërkon nuses së re që ta presë nëntë vjet e nëntë ditë dhe, në rast se nuk kthehet brenda kësaj kohe, të martohet me një tjetër. E shoqja e mbajti besën e dhënë, por, si kaloi koha e premtuar, vendosi të martohej me një tjetër. Në atë kohë Kostandini sheh një ëndërr të keqe. prandaj kthehet menjëherë në vendlindje dhe ia beh në kishë, ku po vihej kurora e re. E shoqja e njuh nga një nishan dhe atëherë Kostandini e rrëmben nga mesi i krushqve.

Çabej në studimin e vet pajtohet me mendimin e shprehur para tij mbi praninë e një kënge të tillë edhe në Shqipëri, por me emrin e heroit tashmë të islamizuar, *Ago Ymeri* apo *Imeri /Ymer Ago*. Por ai shkon edhe më tej duke e lidhur motivin qendror të kësaj kënge me kthimin e Odiseut në Itakë, ku e priste e shoqja, Penelopa, e cila, kur iu kthye i shoqi papritmas, e njohu atë nga një nishan në trup. Autori i studimit rendit gjashtë pika takimi midis legjendës së Odiseut dhe asaj të Kostandinit:

1. Si Odiseu edhe Kostandini nisen të rinj për në luftë dhe lënë nuset e tyre besnike në shtëpi.
2. Pas një kohe të gjatë (20 vjet për Odiseun dhe 9 vjet për Kostandinin), Penelopës i mbliidhen rrotull një tok kandidatësh që kërkojnë nga ajo të martohet me njërin prej tyre, ndërsa të shoqen e Kostandinit e shpien ta martojnë me një tjetër.
3. Si Odiseun, ashtu edhe Kostandinin në fillim nuk i njohin, kur kthehen nga lufta.
4. Si Odiseun ashtu edhe Kostandinin gratë e tyre i njohin nga një nishan që ata kanë në trupat e tyre.
5. Odiseu lufton kundër rivalëve të tij, ndërsa Kostandini kërkon që të mos bëhet gjakderdhje.
6. Lokalizimi i mitit të Odiseut në Itakë do të thotë se ai është një hero i Greqisë Veriore, pra i një vendi që ka qenë në kontakt me fiset iliro-shqiptare.<sup>1</sup>

Pastaj autori ndalet në çështjen e diskutuar të origjinës së Odiseut, të cilin disa studiues e nxjerrin me prejardhje jogreke, por epirote.<sup>2</sup>

1) Shih *HD* 2-3/1938/80-82

2) Shih *po aty*, 82 v.

## Eqrem Çabej

8. Një tjetër këngë legjendare që ka tërhequr vëmendjen e Çabejt, është ajo e Dhoqinës a Garentinës, për të cilën ai ka shkruar artikullin *Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare*.<sup>1</sup> Kjo këngë e vjetër, motivi i së cilës këndohet edhe ndër popuj të tjerë të Ballkanit, është ruajtur si ndër arbëreshët e Italisë ashtu edhe në Shqipëri. Madje Çabej ka botuar në këtë artikull edhe dy variante të saj, një nga Vunoi i Himarës<sup>2</sup> dhe një tjetër nga Berisha e Pukës,<sup>3</sup> veçse në këtë të fundit vihen re edhe shenja islamizimi. Kjo këngë legjendare, siç dihet, bën fjalë për besën e dhënë motrës së vetme, Dhoqinës a Garentinës nga vëllai më i vogël i nëntë vëllezërve, Kostandini, se do të shkonte ta merrte në dhë të largët, ku ajo duhej të martohej. Duke qenë se të nëntë vëllezërit u vranë në luftë, në variantin e Veriut vdiqën nga murtaja, Kostandini, për të mbajtur besën, ngrihet nga varri dhe shkon e e bie të motrën tek e ëma, e cila e befasuar nga një ardhje e tillë e papritur, vdes menjëherë bashkë me të bijën.

Në këtë artikull autori vë në dukje afritë dhe ndryshimet midis të dy varianteve të mbledhura prej tij. Por ajo që ka më shumë rëndësi në këtë rast, është interesimi i tij për të nxjerrë në dritë dy variante të panjohura të kësaj kënge të vjetër legjendare.

9. Nga fusha e kulturës popullore vëmendjen e E. Çabejt e kanë tërhequr edhe disa figura të besimeve popullore. Për këto ai ka botuar, ndër të tjera, edhe artikujt *Diana dhe Zana*<sup>4</sup> dhe *Disa figura të besimeve popullore shqiptare*.<sup>5</sup> Në artikullin e parë, pasi trajton gjerë e gjatë kultin e perëndeshës Diana në Evropën Juglindore në kohën romake, ai ndalet në përshkrimin e zanave, sidomos të Shqipërisë Veriore, dhe shton se këto figura mitologjike nuk kanë qenë të panjohura edhe në pjesën jugore të vendit, siç dëshmon trajta toske *zër-a* (me rotaciz-

---

1) Botuar në rev. *Normalisti*, 6/1934.

2) Kumtuar atij nga ish-nxënësi i Shkollës Normale të Elbasanit. Dhimitër Grillo, i cili më vonë ka shërbyer si arsimtar.

3) Kumtuar atij nga bariu Vad Marashi. Siç dihet, në variantin verior, heroi i këngës del me emrin Halil.

4) Botuar në *HD (Hylli i Dritës)* 1942, Nr. 1-2, 3-4, 5-10.

5) Botuar në *Gj. Alb. (Gjurmime albanologjike — Folklor dhe etnologji)* (Prishtinë) 2/1972.

## Eqrem Çabej

min e njohur të të folmeve jugore). Ai bashkohet me mendimin e dijetarëve të tjerë që emri *zanë/zërë* rrjedh nga latinishtja *Diana*, por sqaron më tej se «Diana romake u shtri në Iliri përmbi një perëndeshë të vendit, e cila i përngjante asaj dhe i dha me kohë emrin e vet».¹

Nga figurat e besimeve popullore të trajtuara në artikullin e vitit 1972² po përmendim këtu shkurt atë të viganit me një sy në ballë, që del në përrallat shqiptare si edhe të popujve të tjerë të Ballkanit dhe jashtë këtij gadishulli. Është fjala për figurën e atij qiklopi që ha njerëz dhe që tek Odiseja e Homerit del me emrin Polifem. Në përrallat e Shqipërisë së Veriut ky div paraqitet me emrin Katallan, emër që ka mbetur qysh nga fillimi i shekullit XIV, kur një kompani mercenarësh nga Katalonja e Spanjës, në shërbim të perandorit bizantin Androniku II e pastaj si kusarë deti, bënë plaçkitje për disa kohë në Gadishullin Ballkanik, pra edhe në Shqipëri. Ashtu siç arriti Odiseu me zgjuarsinë e tij t'i shpëtonte qiklopit Polifem, ashtu edhe Dedalia në përrallën shqiptare arrin t'ia hedhë Katallanit dhe të shpëtojë prej tij. Çabej shënon se kjo figurë divi, që ka qenë e njohur edhe tek arbëreshët e Italisë deri në shekullin e kaluar, del edhe në Labëri dhe në krahinën e Korçës dhe shton se në Labëri ai «mban një emër vendi e quhet Siqënhenjeri» d.m.th. «syqen që ha njerëz».³

10. Dhe së fundi po ndalemi pak në artikullin *Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrim gjuhësor* të vitit 1977.⁴ Këtu, në bazë të materialit gjuhësor, Çabej trajton disa çështje themelore të historisë së kulturës popullore shqiptare lidhur me vendbanimin, ushqimet dhe veshjet duke i vështruar këto në lidhje të ngushtë me emërtimet përkatëse në gjuhën shqipe. Nga shqyrtimi i këtyre emërtimeve ai ka nxjerrë përfundimin se një pjesë e tyre janë fjalë të huazuara nga gju-

1) Shih *HD* 1942, nr. 5-10, f. 231.

2) *Disa figura të besimeve popullore shqiptare*, botuar në *Gj. Alb. (Gjurmime albanologjike — Folklor dhe etnologji)*, II/1972 (Prishtinë 1974) f. 156.

3) Shih *Gj. Alb. — Folklor dhe etnologji*, II/1972/156. Figurat e tjera të besimeve popullore të trajtuara në këtë artikull janë: *paladinjtë* a *xhiqantitë* te *Buzuku*, *xhuxhët*, *shtatë -pllamë-mjekër -e -tri pllamë-shtat*, *Vitoreja*, *E bukura* e dheut etj.

4) Shih *SF* 2/1977.

## Eqrëm Çabej

hët e popujve të tjerë, me të cilët stërgjyshërit tanë kanë pasur kontakte historike, si romakët, turqit etj. Por në të njëjtën kohë ai ka vënë në dukje se një numër i konsiderueshëm i këtyre emërtimeve janë fjalë vendi, si p.sh. nga emërtimet e vendbanimeve *Arbën/arbër, Lug Lugje, Mrizet, Mollas, Përrrenjas, Dukát, Luzát, Bishaj, Delaj, Lekaj, fshat, katund, lagje* etj., etj. Po kështu nga emërtimet e ushqimeve *dhallë, gjizë, hërrë, bukëvale, valë, përvëlak, përshesh, gjellë, darkë, drekë* dhe nga sfera e veshmbathjeve: *shark, bërruc* (nga *berr*), *tirq* (nga *tjerr*), *kezë*, (tek arbëreshët e Italisë — nga *krezë* <krye), *vegjë, vegël, plaf, pëlhurë, end, mbath, z bath* etj.<sup>1</sup>

Duke u mbështetur në këto materiale, autori e kundërshton tezën e disa shkencëtarëve të huaj, sipas të cilëve stërgjyshërit e shqiptarëve kanë qenë vetëm barinj endacakë. Përkundrazi, materialet gjuhësore, vë në dukje ai, dëshmojnë se ata kanë banuar jo vetëm nëpër fshatra, por edhe nëpër qytete, dhe janë marrë jo vetëm me blegtori, por edhe me bujqësi dhe zejtori.<sup>2</sup>

11. Një studiues i historisë së gjuhës shqipe si Çabej nuk mund të mos ndiqte me vëmendje edhe zhvillimin e letërsisë në këtë gjuhë, sidomos për ato vepra që paraqisin më shumë interes për evolucionin historik të shqipes. Në këtë rast nuk është fjala vetëm për veprat e autorëve të vjetër shqiptarë, si Buzuku, Budi, etj., por edhe për ato të shkrimtarëve arbëreshë të Italisë, që nga Matrënga e deri në ditët tona. Të gjitha këto botime ai i ka shfrytëzuar me shumë dobi në studimet e tij gjuhësore. Mirëpo nga sa del jo vetëm prej veprimtarisë së tij të parë, por edhe nga botimet e mëvonshme, ai ka treguar interesim edhe për anën thjesht letrare të veprave të shkrimtarëve shqiptarë dhe arbëreshë. Madje, duke gjykuar nga disa prej shkrimeve të tij, mund të pohohet se, po t'i ishte përkushtuar letërsisë, me siguri do të na kishte lënë studime kritike me shumë vlerë dhe ndoshta edhe krijime letrare të vetat.

12. Duke i hedhur një sy veprimtarisë së shumanshme të E. Çabejt, bie në sy se artikulli i parë i botuar prej tij më 1929 në moshën 22 vjeç i kushtohet Lasgush Poradecit (shih § 17). Në vitin 1936 në librin *Elemente të gjuhësisë e të letërsisë shqipe* (për shkollat e mesme), ai jo vetëm që ka dhënë

1) Shih *SF* 2/1977/14 v.

2) Shih *po aty*, f. 25 v.



## Eqrem Çabej

informata dhe mendime për një numër të konsiderueshëm shkrimtarësh shqiptarë dhe arbëreshë, por ka përfshirë edhe shumë pjesë të zgjedhura nga krijimtaria e tyre letrare. Për më tepër, më 1938-1939 ai botoi edhe një studim të gjatë *Për gjenezën e literaturës shqipe*, ku trajtohen çështje të ndryshme,<sup>1</sup> ndër të cilat vendin kryesor e zë poezia popullore. Për sa i takon letërsisë shqipe, ai aty ndalet shkurt, por shënon se zhvillimin e saj do ta trajtonte më gjerë në një pjesë të dytë, që nuk dimë ta ketë botuar gjëkund. Në atë pjesë të shkurtër që ka botuar, autori trajton disa çështje me karakter të përgjithshëm, si ndikimi i poezisë popullore mbi letërsinë artistike të popujve të Ballkanit, ngjyra politike e këtyre letërsive dhe ndarja a klasifikimi i veprave të letërsisë shqipe.

Përsa i takon çështjes së parë, Çabej ka shprehur mendimin se poezia popullore ka ushtruar një ndikim të madh mbi shkrimtarët e vendeve të ndryshme të Ballkanit. Madje, ai pohon se «përgjithësisht këtu poetët kanë dalë prej tokës së natyrshme të poezisë popullore».<sup>2</sup> Por në të njëjtën kohë ai ka vënë në dukje edhe se krijimet e letërsisë artistike «janë bërë shpeshherë këngë thjesht popullore».

Ngjyrën politike të krijimeve artistike të shkrimtarëve ballkanas autori e shpjegon me «fatet e posacme socialkulturore» të vendeve të tyre. Ai shton se «Poetit si një prijësi shpirtëror i ka rënë këtu zakonisht edhe barra e apostullit nacional, atij këtu i është dashur shpeshherë të ndërroië pendën me pushkën, ka edhe poetë që kanë ditur t'i përdorin mirë të dyja armët...»<sup>3</sup>.

Përsa i takon ndarjes së letërsisë shqipe, autori mendon se ajo nuk duhet të bëhet në bazë të periudhave historike, por në bazë të «qarqeve kulturore dhe letrare». Në bazë të këtij kriteri ai ka dalluar katër qarqe kulturore e letrare: *Qarku*

---

1) Në këtë monografi të botuar në HD 12/1938, 1, 2, 3-7/1939, janë trajtuar këto çështje: 1. Gjeografia dhe karakteri i vendit. 2. Emri i popullit. 3. Fuqi centrifugale në historinë dhe karakterin e popullit shqiptar. 4. Rryma centripetale të huaja (shkurt). 5. Shqipëria midis perëndimit dhe lindjes (shkurt). 6. Fiset (shkurt). 7. Karakteri konservativ i zonave malësore të anëve. 8. Njësia e kombit dhe shpirti i kombit. 9. Poezia popullore (shih §§ 3-6). 10. Literatura.

2) Shih HD 3-7/1939/177.

3) Shih *po aty*, f. 173 v.

*katolik i Shqipërisë Veriore, Qarku italo-shqiptar, Qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore dhe së fundi Literatura kombëtare e shekullit XIX.*<sup>1</sup>

13. Çabej ka shkruar edhe disa zëra për një numër autorësh shqiptarë dhe arbëreshë në Enciklopedinë Kroate (1942)<sup>2</sup>. Por edhe më vonë, kur iu përkushtua në mënyrë intensive studimeve gjuhësore, ai herë pas here ka dhënë shenja të qarta të interesimit për letërsinë artistike si edhe të ndjeshmërisë letrare. Për ndjeshmërinë e tij letrare dëshmon qartë edhe shqipërimi i bukur i disa vjershave nga poetë të huaj të njohur dhe i një libri për fëmijë (shih § 19).

14. Duke ndjekur kriterin e zbatuar edhe në kapituj të tjerë të këtij libri, këtu poshtë po ndalemi pak vetëm në disa nga shkrimet letrare të këtij dijetari dhe pikërisht në ato ku ai bën fjalë për Naimin, Çajupin, De Radën, Lasgushin dhe Fan Nolin.

Për Naimin dhe Çajupin ai nuk ka pasur rast të na lerë ndonjë shkrim më vete. Por, në librin *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe* ku bën fjalë shkurt edhe për autorë të tjerë shqiptarë dhe arbëreshë, për Naimin dhe Çajupin ka dhënë disa mendime dhe vlerësime, që na u duk me interes t'i përmbledhim këtu shkurt. Kështu, për poemën *Bagëti e Bujqësi* të Naimit ai pohon, ndër të tjera, se aty poeti i mërguar këndon i përmalluar nga larg bukurinë natyrore të Shqipërisë, blegtorinë dhe bujqësinë e saj. Gjuha, forma dhe përmbajtja e kësaj vepre përbëjnë një njësi të përsosur arti. Prandaj, ajo konsiderohet kryevepra e poetit tonë.<sup>3</sup> Më poshtë ai vë në dukje se në veprën e Naimit «apostulli dhe poeti janë një. qëllimi i shumë veprave të tij ka qenë kombëtar. Kështu është vështirë të ndahet artisti nga patrioti...»<sup>4</sup>

Më poshtë ai pohon si Naim Frashëri është një bir i vonë i romantizmit dhe se romantizmi në shkrimet e tij, ashtu si edhe në shtetet e tjera të vogla të Evropës lindore e juglindore, u bë një faktor me rëndësi për ringjalljen kombëtare. Autori e përfundon parashtrimin e tij mbi Naimin duke pohuar se

1) Shih *po aty*, f. 180.

2) Shih dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore V* (Prishtinë, 1975), f. 333 v.

3) Shih f. 46.

4) Shih *po aty*, f. 47.

## Eqrem Çabej

ai «pasqyron tipikisht zhvillimin shpirtëror shqiptar pas influencës së gjatë osmane. Nami është një poet romantik i Ballkanit»<sup>1</sup>.

15. Për Çajupin Çabej thotë se nga analiza e veprave të tij, e sidomos e Baba Tomorit, del se «ky është një poet popullor në kuptimin e vërtetë të fjalës»<sup>2</sup>. Ai shton se në vjershat e Çajupit vihen re «ritmi e metri i poezisë popullore të Zagorjesë, shprehje e lehtë dhe e rrjedhshme krejt popullore, fraza e mënyra të thëni të marra nga goja e popullit të tij. Edhe përmbajtja e vjershave është më shumë e marrë nga jeta e popullit vetë...»<sup>3</sup>.

16. Për De Radën, siç u vu në dukje edhe në I/6, interesi i Çabejt ka nisur që kur ishte student 22-vjeçar në Austri. Në një artikull të pabotuar me titullin *Një shkrim i panjohur i De Radës*<sup>4</sup>, pasi vë në dukje se «edhe sot e gjithë ditën shpirti pavdekëtar i këtij kolosi arbëresh lufton me veshin e shurdhët të kohës për famën më të madhe që i përshtatet», ai përmend një punim të panjohur të poetit të madh arbëresh. Është fjala për përkthimin e novelës IX të ditës I të Dekameronit të shkrimtarit të njohur italian të shekullit XIV, Giovanni Boccaccio. Ky përkthim i De Radës, në të folurën e katundit të tij, Makjit si edhe 11 (njëmbëdhjetë) përkthime të tjera në të folme të ndryshme arbëreshe, janë botuar në faqet 659-677 të veprës së Giovanni Papanti-t. *I parlari italiani in certaldo*. Në këtë vepër të botuar në Livorno të Italisë më 1875 me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Giovanni Boccaccio-s janë përfshirë «nja 700 përkthime në dialektet e ndryshme italice e në gjuhët e huaja që fliten në Itali të novelës IX të ditës I prej Dekameronit...» Sipas Çabejt, për përkthimin në të folurën e Makjit nga De Rada ka vënë shënimin përkatës vetë G. Papanti.

Për De Radën Çabej ka mbaitur edhe kumtesën *Vatra dhe bota në poezinë e De Radës*<sup>5</sup>. Pasi vë në dukje veprimtarinë e shumanshme (si shkrimtar, gjuhëtar, folklorist, mësues i shqi-

1) Shih *po aty*, f. 48.

2) Shih *po aty*, f. 49.

3) Shih *po aty*, f. 50.

4) AqSH, f. 295, d. 124, v. 1929.

5) Botuar në vëllimin *Jeronim de Rada* (me rastin e 150-vjetorit të lindjes) Tiranë, 1965.

## Eqrem Çabej

pes, patriot), që përmblihdhet «në figurën e një apostulli të idesë nacionale», Çabej ndalet në disa nga karakteristikat e poezisë së këtij poeti të madh arbëresh. Kështu, p.sh., ai vë në dukje se De Rada në veprën e tij *Rapsoditë e një poeme shqiptare* është mbështetur mjaft në rapsoditë popullore arbëreshe. «Kjo vepër, — shkruan ai, — në përmbajtje të saj, në stil, në gjuhë, në trajtën e brendshme, në krahasimet, në frymëzimin e saj, në përshkrimin e atmosferës ku lëvizin heronjtë, na paraqitet shumë e ngjashme, shpeshherë e njëjlojtë me rapsoditë popullore, ajo duket sikur të ishte një vazhdim i këtyre rapsodive». Dhe pasi përmend edhe disa ngjashmëri të tjera në anën e jashtme (metrike etj.) dhe në disa emra personazhesh, përfundon: «Ndërkaq me këto ndikime nuk do menduar se poeti nuk bëri gjë tjetër veçse imitoi ku mundi poezinë popullore. Ai mori prej saj frymëzimin e përgjithshëm dhe shumë elemente që meritojnë të hetohen në të ardhmen, po jo pa i ngritur këto në një sferë poetike më të lartë. Poezia popullore që për të një pikënisje, nga e cila mori hovin për të krijuar një botë poetike më vete...»<sup>2</sup>

Natyrisht, ashtu si shumë studiues të tjerë para tij, ai nuk mund të mos vinte në dukje në krijimtarinë poetike të De Radës edhe ndikimin e shkollës romantike evropiane, si edhe disa gjurmë të klasicizmit. Veç këtyre, ai vuri në dukje edhe një tjetër ndikim, të pavënë re më parë. «Për të mbushur skenat luftarake me figura burrash e grash të Orientit, që duhej të dilnin aty në lagjen e osmanëve, poeti pati idenë të merrte disa motive dhe emra nga poezia klasike e Indisë». Dhe këtu ai përmend disa nga këto motive dhe emra.<sup>3</sup>

Ai thekson se «burimet e poezisë popullore shqiptare e të literaturës botërore e pasuruan krijimin poetik të De Radës, po kjo në qenësi mbetet piella e frymëzimit të tij». Dhe në fund ai vë në dukje se ndër veprat poetike të De Radës, kryet e vendit e zë pa dyshim «Milosaat» dhe shton: «Kjo poemë idilike e me frymëzim romantik, e përshkuar fund e krye me poezinë naive-arkaike të rapsodive shqiptare të Italisë, për karakterin e ngjeshur që ka, mbetet një nga ato fort të pakta ve-

1) Shih *Jeronim de Rada*, f. 52.

2) Shih *po aty*, f. 53.

3) Shih *po aty*, f. 54.

4) Shih *po aty*, f. 54.

## *Eqrem Çabej*

pra të literaturës shqiptare që e bëjnë këtë të përfaqësohet në literaturën botërore. . . »<sup>1</sup>

17. Siç u vu në dukje në § 12, i pari shkrim i botuar i Çabejt është artikulli mbi poezinë e Lasgush Poradecit, botuar në *Gazeta e re* më 22 shkurt 1929, f. 3, d.m.th. në një kohë që ai ishte ende student, 22 vjeç. Në këtë artikull, që është mbështetur mbi krijimet poetike të deriatëhershme të Lasgush Poradecit, i riu Çabej i bën një analizë dhe vlerësim të lartë krijimtarisë së këtij poeti të talentuar. për të cilin shkruan. ndër të tjera: «Lasgush Poradeci na hap portën e një jete të re në poezinë shqiptare. . . : lind e rritet në poezinë shqiptare një stil i ri, të cilin do ta kërkosh më kot ndër poetët e tjerë shqiptarë, po më kot edhe ndër shkrimtarët e huaj nga shkaku i origjinalitetit që shquan këtë poet djalosh.»<sup>2</sup>

Në këtë artikull për Lasgush Poradecin bien në sy edhe kultura e gjerë edhe thellësia e mendimit letrar të Çabejt. Aty ai përmend shkurt disa nga shkrimtarët më të shquar të letërsisë moderne gjermane, franceze, italiane, ruse etj. Më tej, duke karakterizuar poezinë e Lasgushit, ai shkruan. ndër të tjera:

«Një tjetër send karakteristik për të: ky nuk është poet lirik në kuptimin më të vërtetë të fjalës: nuk do të gjesh të ëmbla e të buta melodi: më shpesh vjershat e tij janë drama dhe shumë prej syresh tragjedi të vogla. shquan prologun. aktin e parë të dramës, kulmin e dramës. pastaj. si vala e detit e «Këngës pleqërishte», bie, bie, bie, pasi pat luftuar shpirti i munduar, i munduar më kot. . . »<sup>3</sup>

Pastaj Çabej ndalet shkurt edhe në çështjen e thellësisë së poezisë së Lasgushit dhe ngre lart «magjinë» e gjuhës së tij poetike.

18. Shkrimi më i bukur i E. Çabejt në fushën e letërsisë, mbetet pa dyshim kumtesa e shkurtër, por aq e ngjeshur, aq e mprehtë dhe aq e ndjerë, kushtuar veprimtarisë letrare të Fan Nolit.<sup>4</sup> Në këtë kumtesë. ku paraqit shkurt punën e madhe të Fan Nolit si shkrimtar dhe si shqipëruet kryeveprash botërore, Çabej e ka shprehur aq bukur dhe me aq ndjeshmëri gjykimin dhe vlerësimin e tij për atë shkrimtar të talentuar.

1) Shih *po aty*, f. 54 v.

2) *Gazeta e re* 22.II.1929, f. 3.

3) Shih *po aty*.

4) *Fan Noli ynë*, botuar në revistën *Nëntori*, Nr. 4/1965.

## Eqrem Çabej

Sipas Çabejt «Kudo në këto vepra — në krijimet e veta e në përkthime — është përdërdhur fryma komplekse e shkrimtarit. Ai i ka jetuar ato, ka jetuar ai vetë nëpër to, në figurat e heronjve. Kudo në këto na shfaqet, ku më çelët, ku më mbyllur, shpirti i autorit të tyre. Ai na del pa dashur si te Bruti, ashtu edhe te Hamleti, te Don Kishoti ashtu si tek Omar Khajami, te profeti Moisi ashtu si te Galileasi, te Prometeu i mbërthyer e tek Armiku i popullit, që në të vërtetë është miku i vërtetë i tij. Revolucionarë e profetë, poetë e dashamirë aktivë të njerëzimit janë po aq mishërime të unë-s së tij, nëpër ta shprehët ai vetë. Në këtë vështrim edhe shqipërimet në një kuptim më të thellë janë krijime të tij».<sup>1</sup>

Dhe më poshtë, duke bërë fjalë për formimin poetik dhe shprehjen gjuhësore të Fan Nolit, ai shton: «Ai nuk është poeti i lartësive eterike, por është shkrimtar i plisit të dheut. Është një Ante i literaturës sonë, që i merr fuqitë prej mëmës tokë... Në fushën e kësaj literature ai nuk është një fill bar, që sot bleron e nesër thahet; nuk është as lule, që sot shkëlqen e nesër veshket. Ai na paraqitet si një lis i moçëm e plot gdhenj: lis i vetmuar, po me rrënjë ngulur mirë në të thellat e dheut. E këtyllë mbetet edhe gjuha e tij. Në këtë nuk ndihet ömbëlsia e filladit të verës sesa furia e murrërit të dimrit. Ajo nuk ka aromën e luleve, por ka erën e shëndoshë të dheut...»<sup>2</sup>

19. Sic u vu në dukje te § 13, interesimi i Çabejt për letërsinë duket edhe nga disa sprova shqipërimi vjershash nga poetë të njohur. Është fjala për tingëllimën e Dantes kushtuar Beatrices dhe për vjershat: *Kënga e mbrëmjes* e H. von Fallersleben. *Një fletë e blerët*, *Hie të rënda*, *Dorë e gruas* të Th. Storm.<sup>3</sup> Shqipërimi aq i goditur i këtyre vjershave në përputhje me rregullsitë e metrikës së gjuhës shqipe dëshmon qartë edhe për një ndjenjë të hollë poetike të shqipëruetit.

E. Çabej ka përkthyer nga gjermanishtja edhe romanin për fëmijë *Bambi* të shkrimtarit austriak Feliks Salten.

Ky roman i shqipëruar me dorë të sigurt, i botuar së pari më 1960, është ribotuar më 1989.

1) Shih *Nëntori* 4/1965/21.

2) Shih *po aty* f. 22.

3) Tingëllima kushtuar Beatrices, e shqipëruar nga Çabej, u botua së pari në revistën *Nëntori* 4/1959. Ajo u ribotua në të njëjtën revistë (4/1989) bashkë me vjershat e poetëve H. von Fallersleben dhe Th. Storm.

# Selectae<sup>1</sup>

## 1. NGA «STUDIME ETIMOLOGJIKE NË FUSHË TË SHQIPES»

Emri: *arbër-arbën*.

*arbër*, *arbën*, *arbëresh*, *arbënësh*, *arbëror* *arbënuer* «shqiptar», *Arbër Arbën*, m., *Arbëri Arbëni* f. edhe emri (i vjetruar) i vendit, «Shqipëri» *arbërisht* *arbënisht* «shqip». Emër me burim të diskutuar. G. Meyeri 14 nuk shprehet për këtë: vetëm se te emri *lab* *Labëri* gjen një metatezë të një \**alb* \**Albëri* e të *Ἀλβανοί*, që del së pari te gjeografi aleksandrin Ptolemeu (III 13) si emri i një populli ilir të Shqipërisë së Mesme në shek. II. të erës sonë, metatezë sipas tij kryer pas ligjeve fonetike të sllavishtes. Kështu edhe Skoku (Starohrvatska prosvjeta, N. S. 1. 1927, 71 = IJ XIII VII 170).

Në kundërshtim me mendimin e shumë dijetarëve, vetë G. Meyeri më parë (Nuova Antologia 50, 1885, f. 587) për më të vjetër sheh trajtën *arb-të* shqipes. Edhe Pedersen (KZ 33, 551, sh. edhe KZ 36, 299v) merr për primare *arb-* gjen aty një emër *arbër* që duhet të jetë medoemos i lashtë te shqiptarët dhe mendon për një afrim të *arbën-it* me gr. ὀρφάνος «jetim», duke parë aty në thelb emrin e një fisi të shkukur nga viset e tij,

---

1) Në këtë libër autori ka përfshirë edhe disa pjesë të zgjedhura nga krijimtaria e shumanshme e Eqrem Çabejt. Siç mund ta ketë ndier vetë lexuesi në kapituj të ndryshëm, ato, duke qenë thjesht një prezantim i kontributeve të E. Çabejt, njëherësh janë vazhdim dhe pjesë integrale e kësaj vepre.

Jokli (Reallex d. Vorg. I 86) sheh këtu një emër paraindoevropian. Hahni I 262 e pas tij Tomascheku (Mitt. d. Georg. Ges. Wien 23, 1880, 504 e te Pauly-Wissowa I 1307) e afronte këtë emër me disa emra antikë të Ballkanit Perëndimor dhe me emrin e ishullit *Arbe (Rab)* të Adriatikut Verior, po kështu edhe Šufflay Ungar. Rundschau V. 33 vv Furikis (Ἀθηναί 43,3 vv: 46,9 vv; III<sup>me</sup> Congrès intern. des ét. byz. Compte-rendu 120-123) e lidh me atë të *Alpeve*, të ishullit *Arbe* të Dalmacisë, të qytetit *Arbona* të Ilirisë, të *Alba Longa-s* etj., Haupti (Lg. I, 16 vv) me të *Albanëve* të Kaukazit. Me Kaukazin e afrojnë edhe Hüsingu me Bleichsteinerin (sh. Joklin IJ VIII VII 24 e 6). Për paraindoevropian, nga një *alb-* e merr këtë emër edhe Trombetti Arhiv III 1 vv., dhe Bertoldi ZrPh 56. 179, v.; sh. edhe Tagliavinin 71 v., Hubschmidin Alpenwörter 44. Popovićin Përparimi II (1956) Nr. 3-4 f. 189. Ndërkaq krahasimin me një temë *alb-* me kuptim «mal» dhe afrimin me toponomet *Alba-të* Italisë i kanë menduar që nga fillimi i shekullit të kaluar: veçanërisht Arndti e Leaku, sh. Xylanderin 289: te krahasimi me *Arbe-n* e Dalmacisë kthehet edhe Treimeri Ethnogenese d. Slawen 23. Po ashtu dhe A. Mayeri. II 4, i cili të dy emrat i krahason më tej me gr. ὄρβυός «i errët» nord. e vj. *iarp* «i errët, i mbyllët», rus. *rjab* «laraman», etj. Logoreci (f. 8. Cirka III 264 vv), mbi dëshminë e shprehjes *mal* e *arbën* «mal e fushë, mal e val» të anëve të Kurbinit, te ky emër gjen — mbase me të drejtë — një fjalë me kuptimin e rrafshit e të fushës, duke pasur parasysh konkretisht fushën midis Matit e Erzenit. Që *Arbën* quhet gjithë jallia midis grykave të Matit e të Erzenit e gjer në Tiranë, duke përfshirë ndër të tjera edhe Prezën e Ishmin me Kopin e Rodonit, dhe që malsorët e ipeshkvisë së Lezhës, kur ulen në këto fusha, thonë «vemi në Arbni», këtë e gjejmë së pari te Hahni Reise Drin-Wardar I. 13. 15. II 85 v.

Fjalë e mbarë gjuhës, sh. edhe Joklin IJ XI VII 194. Del për të parën herë te Buzuku (XVIII/2b): *Gjithë popullinë ndër Arbanit ata n mortajet largo*, pra si emër i vendit, kurse për gjuhën ai përdor *shqip*. Për vendin e ka *Arbënë-n* edhe Budi. DC 223b *ke nd Arbënë shtiu leqtë*, sh. edhe DC 226a, 229a, SC 36 (*Ëneshkëpi cë Arbënit*), 408, kurse i *arbëneshë* e ka për «shqiptar, shqip, shqipe». *Priifti lëtinë, e j Arbëneshë, të Popullit Arbëneshë, ndë gjuhu të Arbëneshë*, RR. 17, 40, 327, 360. Ashtu edhe Bardhi Albania, Epirus *Arbëni*, 196 *Emënatë e Gjytetevet, e të kështjelet Arbënit* «nomina Urbium nonnullarum,



## Eqrem Çabej

atque Castellorum, ad eam partem Macedoniae spectantium, quae Epirus, sive Albania dicitur», 197 *Kulshedra e botëse Arbënit* «Epiri Draco» (për Gj. Kastriotin), 22 e 218 *Epirota I Arbëneshtë*, 189 *Epirotice Arbënisht*, 223 *gjuhënë e Arbëneshe*. Edhe Bogdani (Të primitë, I, 18, 27, 180, 181, II, 46, 2, I, 95, 32) *dheu i Arbënit Regjënia e Arbënit* «il Regno di Albania», ndenë gjytet të Durëcit nd'Arbënë «sotto la Città di Durazzo in Albania», *mbë male të Arbënit* «nei monti di Albania». *Jo veçë t'Arbëneshtëtë me xanë Italianisht, po ende këta Arbënisht; gjuha jonë, e arbëneshtë, ende Arbënisht me u veshunë, këso fjalëje pente, qi, Gerqisht, e Arbënisht do me thanë pensë»* «da questa voce pente, che in Greco, et Albanese significa cinque», khs. edhe *Kuvendi i Arbënit* 1706 ku (f. 7, 23, 31, 39, 57, 58, 76, 77) pranë *i arbëneshti* del (shpeshherë) *Arbëni*, dhe në dallim nga kjo *t'Albanit*, po (f. 105) edhe *gjuhë e Shqipëtarëvet*; për emrin sh. edhe da Lecce. Për shtrirjen e përdorimin e emrit në botën shqiptare brenda e jashtë Atdheut, në burimet historike të mesjetës si edhe te popujt fqinj. khs. sidomos Thunmannin 240 v e 318, Malte-Brunin Geogr. univ. IV 339. Hobhousin *Journey through Albania* 128, A. Bouënë *La Turquie d'Europe* II 147, Hahnin I 230, 271, 311 (edhe kundra Thunmannit), Diefenbachun I 26 vv. Kretschmerin *Einleitung* 262, Tomashekun te Pauly-Wissowa I 1 1307, Spitzerin *MRIW* I 334, Jirečekun *Die Romanen in der Städten Dalmatiens* I 43 e III. — alb. Forsch. I; 66. Šufflayn (*Acta, Alb. I*, 37, *Ungar. Rundschau* V 3 v.: *Städte u Burgen* 7 shën. 8, 18 v., *Arhiv* II 210, *Srbi i Arbanasi* 24 vv. *Serbët dhe shqiptarët* 4, 35, 36 v., 24 vv.). L. v. Szégun *Ungar. Rundschau* V. 62. Jorgn Helmolt's *Weltgeschichte* VIII 435., Skokun (*Starohrvatska prosvjeta*, N. G. 1, 1927, 71 = IJ XIII VII 170, *Glasn. Skopsk. N. Dr. III*, 265. *Leksikol. studije* 1948 f. 79 v., *ER* I 54 vv., me literaturë), Joklin *IJ XII VII* 84. XXI VII 87, XXIV VII 26 (kundra Dabinovićit) e 137, *Arch. Rom. XXIV* f. 17 v. e botimit të veçantë, *Krahen GN* 12. 15 e *PN* 145, I. 97, M. Roques *Le dict alb. de 1635* f. 3. 45, 50 v., 52, *Treidlerin* te Pauly Wissowa I 1 1307 e *ZslPh* V 416, *Mustillin Riv. d'Albania* I 287, *Stadtmüllerin Forsch.* 160 vv., tani Ölbergun *Innsbrucker Beitr. z. Kulturwiss.* 13, 64. Nga shqiptarët e Shqipërisë khs. ndër të tjerë Xhuvanin. *Kritikë mbi fjalorë të shqipes* 17, vërejtjet tona për gjenezën e lit. shqipe 4 vv., *Leipz. Vierteljahrsschr. f. Südoesteuropa* IV 90 vv., *BUST SSS XVI* Nr. 4. f. 123 e 139. *SA* I 1 75 v., *Ashtën* 109 v. Për arbërishten e

## Eqrem Çabej

Greqisë sh. Fallmerayerin Das alb. El. in Griechenland II, 31 Reinholdin Glosari 31, Kupitorin 'Αλβ. μελέται 19 vv., Kulluriorit Abetari 152, G. Meyerin AS V 56, 62 e 64 (*turqisht e arbërisht*), Laographian II 112, Furikin në viset e cituara, Haeblerin 19, 45, 114, pas hetimeve tona *arbërishte* «gjuhë shqipe» edhe në anët e Tëbës (Thivës); për të Italisë sidomos Kamardën I 10, 21, 30, Lambertzin KZ 53, 67 e 283 e Giordanon, veçanërisht për *arbror* e *arbër* «shqiptar» te Kolë Keta prej Sicilie sh. Skiròin (të riun). Nga këto të dhëna shikuar së bashku rezulton se kemi të bëjmë me emrin e lashtë të vendit e të popullit, emër më i moçëm se *shqip shqiptár Shqipëri Shqipni*, të cilat mbi-zotërojnë sot. Në Shqipëri *Arbën- Arbër-* është i gjallë ndërkaq edhe sot, nga Veriu gjer në Jug. Për trevën fushore të Arbën-it në përdorim kryesisht te malsorët e anëve të Kurbinit (e të Kthellës, shtojmë ne) sh. më sipër. Për shtrirjen e emrit gjer në Kosovë dëshmon një këngë popullore e asaj ane, me vargun *Dalin zogat arbëneshë*. Përhapjen nga veriperëndimi e tregon katundi *Arbënësh* i Krajës, emri i të cilit rishfaqet në *Arbënësh* (Borgo Erizzo) të Dalmacisë. Në vise të ndryshme të Shqipërisë së Mesme gjer në Shpat e më në jug *arbën arbër* si emër etnik shënon shqiptarin në dallim nga popujt e tjerë, sidomos nga vllahu e nga jevgu, sh. pas vërejtjeve tona edhe Tasen 102, e Illyrinë 21.I.1936 f. 8, ku shënohet se në Berat me *arbër* është quajtur dikur banori (shqiptar) i Myzeqesë; për Bërzeshtë BIS II 1948, Nr. 1, f. 55. Në anët e Tomorit *arbër* përdoret për në Shqipëri të Mesme shënon fushën e Elbasanit me Polisin e rrethina të tjera; *Arbana* katund afër Tiranës. Në krahinat jugore *Arbëria* shënon sipas vendeve treva të ndryshme të Labërisë fshatare ç'mban prej Vlore e gjer afërsisht në Delvinë: khs. për këtë, para Hahnit, Pouquevillin, Voyage I 24 vv., pas Hahnit sidomos M. Urbanin Die Siedlungen Südalbaniens, hartat f. 136, 198. Krahas me *Arbëri*-në në atë anë përdoret edhe e thjeshta *Arbër*, në një këngë labërishte *Kardhiq pesëqind shtëpi ç'të pat Arbëri zili*. Është për të vënë re që në purishten, gjuhën e fshehtë të mjeshtëurve (muratorëve) t'Oparit, *arbër* përdoret për «bari». Teza e Hahnit, i cili Albanopolin e Ptolemeut e lokalizon alternativisht në Zgërdheshin e sotëm në juglindje të Krujës, paraqitet mjaft bindëse. Indice janë germadhat e këtij mesvendi, dhe toponimet e tij *Kroi Arbanës, Prroi Arbanës, Kodrat e Albanës*, pas hetimeve tona të gjalla edhe sot e gjithë

ditën; *Prroi Albanës* edhe te Ceka BUST SSS XIII Nr. 1. f. 148. Një katund *Arba*, me gjurmë gjer në ditë të sotme, ka pasur dikur edhe në Mat, M. Skura e St. Gaspari, te Zamputi Relazione II 44 v., 63 (9). Gjurmë të këtij emri ka edhe sot në Dukagjin të Matit. Në këto rrethana lokalizimi i Arbënit mesjetar në Elbasan a në anët e atij qyteti (Leake 256, Fallmerayer 9) nuk është fort afërmendsh; ashtu qëndron puna dhe me lokalizimin në luginën e epër të Shkumbinit te Ducellier, Centre de recherche d'histoire et civilisation byzantines. Travaux et mémoires 3, 1968, 353 vv. Në hetimin e kësaj çështjeje një nga burimet shkencore e përbën përhapja e këtij emri në krahinat e sotme sidomos të trevës geqe.

Historikisht, mbi dëshminë e burimeve perëndimore e bizantine të mesjetës, ka të ngjarë që Arbën-i i përkiste në thelb trevës që u përmend më sipër, afërsisht prej Kurbini e Krujë e gjer në det, me gjithë viset përreth të Shqipërisë së Mesme, sh. pas Hahnit dhe Philipponin Zur Ethnographie des Peloponnes (Petermanns Mitteil 1890, f. 7), Carabellesen Carlo d'Angio 44 v., tani rishmë Babingerin SA I 140. Me këtë pajton dhe përshkrimi i Anonimit të vitit 1308 te Gërka, Anonymi descriptio Europae orientalis 1916 f. 25 vv. (= IJ VI VII 9): «Est enim (hec) albania regio satis lata et magna, . . . quatuor fluuiis magnis tota hec regio irrigatur, videlicet ersenta, mathia, Scumpino, Epasa. . .» (Epasa = Apsus, Semeni sipas Hahnit), përshkrimi ku shihet zgjerimi i përdorimit gjeografik të emrit në shek. XIV. Ky që në kohën para Skënderbeut ishte shtrirë mbi gjithë vendin duke u zhvilluar nga një emër fisi a krahine në emrin nacional të popullit. Kjo shtrirje e emrit për nga Jugu, mbi dëshminë e emrit topik *Albeigne* për viset te Bishti i Pallës dhe *Albanie* për anët e Vlorës në një version të dytë të Këngës së Rolandit, kishte nisur që në kohën e luftimeve të Bizantit me Normanët, dhe vazhdoi në kohën e Anjouvet në Shqipëri, K. Luka Konfer. e dytë albanologjike. II. 156. Për përdorimin e emrit gjer në anët e Janinës e të Nartës dëshmon edhe shfaqja e tij në kronikën e derës së Tocco-ve të kohës rreth vitit 1400, khs. për këtë kronikë Skirò, Byzantin XXXII 207. Me këto rrethana pajton që atë emër muarën me vete edhe ata që u shkulën në shek. e XIV e të XV për në Greqi e Itali, të cilët nuk e njohën më emrin *shqiptár*, *Shqipëri*, *Shqipni* etj. që shihet se është më i ri dhe se lindi ose u përgjithësua në Shqipëri pas shpërnguljes së tyre. Për shtrirjen që heret edhe

## Eqrem Çabej

nga Veriu jep dëshmi arqipeshkvi provencal i Tivarit Guillelmus Adae (alias Brocardus), i cili me 1332 thotë se shqiptarët (*les Albaniens*) përdorin në librat e tyre shkronjat latine. Emri i vjetër, sikundër shihet, u ruajt më një anë në diasporën shqiptare, më anë tjetër në Shqipëri vetë në disa vise të izoluara (area isolata e M. Bartolit), në toponomastikë e në disa përdorime të caktuara. Zhdukja e zëvendësimi i tij me emrin shqipmbase ka lidhje me zbërthimet etnike që u kryen me ardhjen e osmanëve. Për historinë e popullit shqiptar dhe autoktoninë e tij është me rëndësi që të *Arbën* vazhdon të rrojë i pakëputur; Ἄλβανοί i Ptolemeut, e ky jo vetëm si emër në vetvete, po edhe si përcaktim vendi, gjeografi aleksandrin e lokalizon këtë emër etnik bashkë me qytetin Ἄλβ.ανόπολις midis Orestis e Almopërvet, që është afërsisht midis Durrësit e Dibrës e në lindje të Leshit. Me këtë përcaktim gjeografik të antikitetit pajton, si u pa, edhe vlera e *Arbën*-it në mesjetë, te bizantini Georg Akropolita në shek. e XIII. Arbëni midis Ohrit e Durrësit. Të mosshfaqurit e emrit gjatë periudhës nga Ptolemeu gjer në shekullin e X, shpjegohet me faktin që fiset shqiptare gjatë asaj periudhe nuk kishin arritur në një formim shtetëror e përgjithësisht në një rëndësi politike të shënueshme, sh. vërejtjet tona Revue de Ling. X 105. Po me këtë m'anë tjetër piquet dhe përhapja dialektore e mënyrës së formimit të fjalës. Emrat e banorëve më *-esh* fem. *-eshe* sipas gjurmimeve të A. Ketës janë specifike për krahinat Bendë e Tomadhë (rreth Krujës e Tiranës): *Babrrû: Babrrësh, Brrar: Brrarësh Baranësh. Cudhî: Cudhnësh, Dom: Domësh, Korrë: Korrësh, Mënér, Mënarësh, Mërçinë: Mërçinësh, Tujan: Tujanësh, Tiranësh'e vogëlo* në një këngë popullore. Aty hyn dhe ndonjë emër familjesh, si *Gjeleshi* në Shupenzë të Dibrës. Për mendimin tonë, formimet me këtë sufiks, të cilin Jokli (edhe IJ XXIV VII 137) e bie të ardhur nga lat. vulgare *-esis* (lat. klasike *-ensis*), duke u nisur prej kësaj vatre krahinore kanë marrë një përhapje më të gjerë, duke dhënë emra vendesh, arash, kullotash etj., të sotme e të hershme, shpeshherë nga emra banorësh: *Aratësh (arat), Barkanësh, Betësh, me Livadhet e Biteshit, Bradashësh, Branësh (Bran), Bulçësh (pranë Bulçar, Bulqizë, bulq), Bushnësh, Cikallësh (pranë Cikath), Dobrësh, Façësh, Fravësh, Gërdhësh, Gixavësh, Godolësh, Grëbllesh, Gjurmësh (gjurmë), Hotësh, Jatësh, Javaçësh, Kapësh, Katësh, Kollagjësh, Koto-dësh, Kurbnësh, Kurpnësh (Kurpën), Laktësh, Lamarësh, Li-*

*kësh, Madhësh (i madh), Martanësh (Martín, Mërti) Martjësh, (Rrapi Martjeshit, Kodra e Rrapit Martjeshit), Mirësh, Mollagjësh, Ninësh, Papatësh, Pashkashësh, Pashtrësh (pranë Pashtran), Petrësh, Përcëllësh (përcëllimë) Pështjësh, Prapësh (prapa), Qyqësh (qyqe), Radovësh, Radhësh, Rralleshet (livadhe), Spanësh (Span), Trapësh (trap) Ungjësh, Xibrësh, Zdesh, Zelësh, Zgërdhësh (gardh) etj. sh. edhe Xhuvani — Cabej 73 v* Gjeografikisht ky sufiks përfshin një zonë të gjerë të Shqipërisë së Mesme Veriore që prej Kurbinit, Matit e Krujës e gjer në Martanesh e në anët e Peqinit, të Elbasanit e të Dibrës. Aty hyn gjeografikisht e formantikisht edhe *Arbën: Arbënësh*. Morfologjikisht ky emër, ashtu si dhe të tjerët etnonimë, përdoret (dhe në Itali) pa e me një të parme, *i Arbënesh, i Arbëresh*. Nga format e tjera të emrit, *Arbëni, Arbëri* është edhe kjo një rrjedhojë mjaft e lashtë, meqë shfaqet dhe në diasporën shqiptare, e më anë tjetër te Buzuku. Në krahasim me *Arbënësh, Arbëresh* ndërkaq gjan të jetë më e re dhe e formuar në një fushë më të gjerë, në kohën pas përgjithësimit të *arbën-it* në truallin gjuhësor të shqipes. Formimi i saj do të ketë lidhje me prirjen për të dalluar më mirë vendin nga populli, meqë *arbën*, si u pa i përfshinte të dyja. Në Okshtun të Dibrës *arbní* është «dimër i fortë». Ruhet emri topik dhe në poezi popullore, në Kurbî faqe t bardhë i la *Arbnís* (Albania VII 131), në Labëri *Shahin -be, o kokë-mollë, mos e pendehë Devollë? Këtej i thon' Arbëri, që të zënë ty si mi* (Mitko 134). Me *-uer -or* është formuar emri e mbiemri *arbënuer arbëror* (khs, ndër të tjera *nusja jonë arbërore* në një këngë dasme të Gjirokastrës, *janë veshur arbërore* në Lunxheri për krahinën e afërme të Rrëzës); me *-isht* — ndajfolja *arbënisht, arbërisht*. Në lidhje me çështjen se nga dy kuptimet e *arbën arbër-it* (emër. vendi, emër populli) cili është primari, në kundërshtim me një mendim tonin të mëvonshëm (LP VIII 85v., ShS 98. v), i mbahemi mendimit të mëparmë që ky në krye të herës ka qenë emri i vendit. Në këtë drejtim dëshmojnë më një anë përdorimi i emrit në literaturën e vjetër tonën, ku *Arbënë* shfaqet vetëm si emër i vendit, e si emra etnike shërbejnë *Arbënësh* e *Arbënor* (sh, më sipër), më anë tjetër reflekset e tij në gjuhët fqinje: lat, mesjetare *Arbanum Albanum* (vendi) përkundërit *Albane* (n) sis it. Albanese (banori), greq. bizantine "Ἀρβανον, Ἀλβανον edhe si shumëς τὰ Ἀρβανα,

## Harrem Cabej

përkundrejt emrit etnik 'Αλβανοί e 'Αρβανίται. 'Αλβανοί e 'Αρβανίται, skr. *Arbanas*, *Arbānasin* (që në shek. e XII) pranë toponimit *Раѣнь* me *rabanski*, me bullg. *Arbānasin*, rum. e vjetër *Arbānas*, arom. *Arbinés* shm. *Arbinesi*, të gjitha zgjerime sufiksale për të dhënë emrin e popullit. Gabim e kanë shpjeguar sll. *Arbanas* me mjete sillave, e te BER I 14 prej gr. ἄρβανος ἄλβανός, e sila, në pajtim me kohën e këtij huazimi të pretenduar, nuk mund të kish dhënë tjetër veçse një emër me *arv-*; kjo *Arbanas-* rrjedh nga një zgjerim, sot i zhdukur, i shqipes me *-as*, formant për emra banorësh, si në *vendas*, *Beratas*, sh. Joklin Arch. Rom. XXIV 19 v., Popovićin ZslPh 26, 321, Shokun ER I 54 v. Këndej pas mendimit tonë dhe rum. *Arbānas*, me ndërrim të sufiksit *-as* në *-as*. Jo prej lat. *Albanensis* as arom. *Arbinés* shm. *Arbinesi* (Papahagi 193, më parë Acad. Rom. Memor, Sect. ist. Ser. III t. 3. f. 131 vv.); pas mendimit tonë prej shq. *Arbënësh*, nga një periudhë e shqipes ku nuk kish nisur të vepronte rotacizmi në dialektet jugore, khs. gr. e re, γραμμένατa ng: παραίωνα e tosk. *grëmëratë*. Ky *arbën(ë)* i dëshmuar kështu si emër vendi u përdor me kohë edhe për popullin, kalim kuptimor mjaft i shpeshtë në gjuhën shqipe khs. *Kurveleshi po lëftojnë; Mblidhi o Tërbaç ku ini?* (Dine 201, 215). *Brataj mo mbeçi të gjullë*. Morfologjikisht *arbën(ë)* paraqitet si një shumë me *-ën -ër* (më e moçme *-ënë; -ërë*), i krahasueshëm si i tillë me kategorinë e pasur *Bishtna, Fëndëna, Karpën. Lisna, Ndërjanëna, Shtiqën*, që jepen në LP VIII 84, ShS 97, sht. tani edhe emrin Περόνια të Atikës (te Σάρρης, Αθηνά 40, 141, Jokli IJ XIV VII 178), pas mendimit tonë prej shm. *përronj*. Kështu afërsisht edhe Furiki niset nga *Arbëna* si shumësi i një «*arbë*». Ndërsa *Arbën, arbën* morfologjikisht është e qartë përbrenda shqipes, është vështirë të përcaktohet raporti i formantit të saj ndaj atij të 'Αλβανοί të Ptolemeut. Krahe (PN 145) gjen këtu, në një mënyrë gjuhësisht dhe gjeografikisht mjaft bindëse një sufiks *-ano* të ilirishtes. Më pak afërmendsh është mendimi i Gšlābovit (Ling. balk. VI 78) që emri etnik i Ptolemeut të përmbajë sufiksën *-eno/ -ano* të trakishtes.

Puna e burimit të fjalës lidhet me çështjen se nga dy

1) Duke qenë pra *Arbënë* në thelb një emër vendi, s'është nevoja të mendohet 'Αλβανών e 'Αλβανόπολις në 'Αλβανών e në 'Αλβανα Πόλις si vepron Furikiss në 'Αθηνά 43,20 vv.

trajtat e saj *arb-* e *alb-*, cila është primarja. Do të pranojmë me G. Meyerin e Pedersenin që trajta e mirëfilltë e emrit ka qenë me *arb-*, mendim i miratuar dhe nga të tjerë dijetarë. Ashtu paraqitet emri në shqipen vetë, *albrësh albrisht* e Italisë është ndikuar nga it. albanese e nga një disimilim me *-r-* në e rrokjes fundore. Me *arb* — paraqitet ky emër dhe në latinishten mesjetare, më parë *Arbanenses* (1166) dhe *Arbanum* (1204, 1250) dhe vetëm prej kohës së Anjouvet (1271) e këtej më fort *Albanenses* e *Albania*, nga të cilat rrjedhin trajtat e gjuhëve romane e prej andej edhe të gjuhëve të tjera. Me *arb-* e *alb-* (fonetikisht *arv-*, *alv-*) shfaqet emri në fillim, në shekujt e XI e të XII, dhe te bizantinët (Mihail Attaliatis, Anna Komnene), dhe vetëm prej Georg Akropolitit (shek. i XIII.) e tëhu me *alb-*, d.m.th. *alv-* si te Ptolemeu, «grekët e kanë shndërruar emrin sipas një asociacioni të paqartë me të tjerë emra gjeografikë». Gjithashtu me *arb-* paraqitet emri në gjuhët ballkanike popullore, që në mesjetë, si u pa dhe më sipër; prandaj bie edhe mendimi i një rrjedhe sllave të emrit shq. *lab*, *Labëri*, të përfutur kinse prej *alb-* me metabezë likuidesh të sllavishtes: kur vetë gjuhët sllave kanë vetëm *arb-* ose *rab-*, do të ishte një mrekulli që një krahinë shqiptare të ketë zhvilluar edhe ruajtur një *lab* sllave që nuk del gjëkund me këtë kuptim në sllavishten popullore. Nga këto të dhëna del që *arbën* nuk mund të jetë latino-roman (se do të ishte *alb-*), as grek (do të ishte *arv-*), as sllav- (do të ishte *rab-*). Kështu edhe *per exclusionem* do të pranohet një burim vendi i emrit. Duke u nisur nga *arb-* siç del në *arb-* *-ën(ë)* nga një më e lashtë *\*arb-an*, e duke e çuar atë te një formë bazë *\*arv-e* kohës antike e mesjetare të hershme, me betacizëm *rv*: *rb* si te *korb* nga lat. *corvus*, mund të afrojmë këtë fjalë me lat. *arvum* «arë, tokë e punuar, fushë» umbr. *arvamen* «in arvam», gr. ἀρούρα «arë, tokë buke», irl. e mesme *arbor* shm. *arbanna* «drithë», arm. *haravunk'* «tokë buke»; aty Pedersenin KG I 63 vendon ndër të tjera dhe sll. e vj. kishtarë *ravъno* «i rrafshhtë», po pa gjetur miratim të përgjithshëm. Me këtë mënyrë të dhënat gjuhësore, historike dhe territoriale tregojnë që emri *arbën arbër* është më fort me gurrë indoevropiane, një *alb-paraindoevropiane* duke u përjashtuar vetvetiu me dëshmitë historike, të brendshme e të jashtme. Kuptimi i parë i fjalës rezulton të jetë kështu: «arë, fushë, rrafshinë», khs. *u dynd mal e arbën* që u përmend më lart. Emërtimi analog me atë

## Ëqrem Çabej

!ë Polonisë, me emrin e ishullit *Arbe*, te Plini *Arba*, te Ptolemeu "Αρβα, te Tabula Peutingeriana *Arva*, dhe me atë të qytefit ilir» 'Αρβῶν që jep Polibi me Stefan Bizantinin, është e mundur. Grafitë "Αρβα e 'Αρβῶν të autorëve grekë, për kohën kur paraqiten, te β mund të përmbajnë një *v*; ndërrimi *b : v* nëpër dialektet greke vërtetohet që në kapërcellin e epokës së re sh. Schwyzerin I 207. v., 233. Kjo gjë vlen dhe për 'Αλβανοί 'Αλβανόπολις të Ptolemeut. — Betacizmi, ndërrimi i *v*-së në okluzivin *b*, në grupin *rv* konstatohet dhe në emra visesh antike të trevave në veri të Shqipërisë, në Dalmaci e gjetkë, ndër to pikërisht dhe në *Arva*, *Arba*, sot *Arbe*, A. Mayer IF 44, 196 v.



## 2. FJALA E MBAJTUR MBI VARRIN E BAJO TOPULLIT<sup>1</sup>

Në emër të Djalërisë, vinj t'i thom Bajo Topullit lam-tumirën e fundit.

Jo me lot grarie do t'a varrosim. se sot nuk është dita për zi. Ne do t'a varrosim si burra.

Sikundër thotë i madhi Leonardo da Vinçi: Sikurse njeriu gëzon muzgun e mbrëmjes pas një dite me punë, ashtu dhe vdekja është lumtëri në fundin e jetesës, pas një jete të përdorur mirë; ashtu dhe ti, o shpirt bujar, derdhe tërë gazin e jetës për këtë Shqipëri dhe tani, hero. re dhe do të flësh në këtë tokë që ti e deshe gjithë jetën më tepër se shpirtin. Dhe brezave të ardhme që do udhëtojnë andej nga varri. varri yt do t'u ngrihet madhështor prej atij bregu dhe do t'u thotë: Ja burri që dha jetën për Atdhe!

Veprat e tua janë të njohura dhe s'duan komente. Për to flet mjaft çlirimi i Shqipërisë, frukti i vuajtjevet dhe mërgjimevet tuaja. Për to do flasin faqet e historisë gjakplotë të Kombit. Emëri i Bajo Topullit do rrojë sa rron giaku i Arbërit.

Por edhe në këto kohë, natyrisht kaotike për shtetin tonë të ri, ti ndrite fanar i bardhë nëpërmes korrupsioneve dhe dobësive që s'i kanë shkundur të tjerët. Ti do rrosh simbol i burrërisë dhe i atij karakteri shqiptar. Se burrëri ti pate, karakter, karakter, për të cilin tash kemi nevojë më se për çdo gjë tjetër.

Ti ndonjë djalë nuk le që t'a ngjanj më mirë Bajo To-

---

1) Botuar në gazetën «Demokratia» të Gjirokastrës, më 26 korrik 1930. Originali ruhet në Muzeun e Gjirokastrës. (Shën. i Red.)

*Eqrem Çabej*

pullin. Por ne, Djalëria, e kemi për nder të quhemi djemt e  
idesë sate. Ti, o i rrëzuari lis, si atë lisa që ngrihen ndër  
malet tona! Ti mësues e edukator i kaqë bresave shqiptare!

Bajo, prehu pra! Dergje trupin tënd te balta e jote. Për  
Atdhenë që e bërë dhe na i le trashëgim mos ki frikë! Ne  
Djalëria betohemi këtu para trupit tënd se ç'fitove ti ne do  
t'a ruajmë qoftë edhe me gjakun tonë. Flas për lirinë e kom-  
bit.

Bajo, lamtumirë! O shpirt i pavdekshëm, bekona! Lamtu-  
mirë!

*Eqrem Çabej*

### 3. MBI POEZINË E LASGUSH PORADECIT\*

#### I

Poezia e Lasgush Poradecit ka shumë vjet që tingëllon në veshin e shqiptarit; po e ngadalshme e si nga larg, si harpa e Eolit; vetëm në kohët e fundit, me rastin e sëmundjes së tij të rëndë, vetëdija kombëtare u zgjua, dhe fletoret janë plot me artikuj për të dhe për ndihmat materiale që i mblidhen.

Po sa di vetë, gjer tani kurrkush nuk është marrë estetikisht me poezinë e Lasgush Poradecit.

Nga shqiptarët që kam pvetur më të shumëve u pëlqejnë do vjersha idilike si «Kroi i Poradecit», kurse shumë të **paktë** i shijojnë thellësitë moderne të tij; një shenjë e cektësisë së shijes shqiptare të sotme.

Duke hedhur një vështrim mbi literaturën e Shqipërisë së re, do të shohim së pari si në gjithë rrjedhën e jetës së saj, të gjithë përfaqësuesit e saj i përshkon një frymë etike (morale), një shenjë kjo mjaft karakteristike. Kjo frymë kapercen në shumë raste në zonat e reungjonit.

Së dyti, ajo ndahet natyrisht në dy periudha: e para përmbledh ata vjershëtorë, në jetën dhe veprën e të cilëve, midis të tjerave, një ide kryesore është flaka e madhe që i ndez për lirin e Atdheut: flasim për De Radën dhe Naim Frashërin, Doemos ideja e tyre merr forma të ndryshme në të dy: e huaitur te De Rada, ati i vjershës shqiptare, në format e ngadalshme e madhështore të klasicizmit, te Naimi më e djegur, shfaqet më direkte. Po në thelb ideja është gjithë ajo. Dhe

\*) Marrë nga «Gazeta e re», 22 shkurt 1920, f. 3.

## Eqrem Çabej

religjioziteti i tyre bie dendur në rigatën e misticizmit katolik te De Rada e te Naimi misticizmë orientale.

Periudha e dytë është ajo në të cilën ideja kombëtare i lë udhën idesë njerëzore: Atdheu është duke u liruar, ëndrra e përvëlur e shkrimtarëve të parë ishte duke u bërë realitet. Kështu syri i poetit u hap për horizonte më të gjera, vegime më të thella. Po të marrim në dorë veprat e Asdrenit, do të shohim të shfaqur atje fillimet e kësaj periudhe të dytë, e cila mund të quhet periudha moderne e poezisë shqiptare, dhe gjen vazhdimin e saj në vjershat e Lasgush Poradecit. Shenjë modernizmi e Asdrenit është dhe fakti se, i pakënaqur me pasurinë e fjalëve të gjertanishme, për të endur ndjenjat e vegimet e tij në gjithë stërhollësinë e tyre, ky në fillim e pasuron thesarin e gjuhës me xhevahire të çmueshme, fjalë e mënyra foljeje të reja, delikate e stërmagjike. Po, i ikur që prej djalërisë prej Atdheut, e duke mos mundur nga ana tjetër të ngrihej në një ide universale, vepra e tij nuk mundi të dalë e plotë dhe duket të vërtetohet fjalën e gjermanit Theodor Storn: Asnjë poet i madh pa atdhe (Kein grosser Dichter ohne Vaterland).

## II

Lasgush Poradeci na hap portën e një jete të re në poezinë shqiptare, një «frisson neuf» sic pat thënë V. Hygoi për vjershat e Bodlerit, lind e rritet në lëmën e këngës shqiptare në stil i ri, të cilin do ta kërkosh më kot ndër poetët e tjere shqiptarë, po më kot dhe ndër shkrimtarët e huaj nga shkaku i origjinalitetit që shquan këtë poet djalosh. Këtu ndjenja e mendime që nuk kishte guxuar e s'kishte arritur kurrkush ndër shqiptarët e pendës t'i shfaqte, këtu një stil i mundur, i cili ndryshon nga shkrimi i një Naimi... si bie fjala një pjesë beethoveniane nga një mozartiane. Ky, pra, është stili modern, stili i Lasgush Poradecit.

Ç'e ndryshon nga të parët, është thellësia... Është vjershëtori më i thellë që ka shkruar në shqipëri; në qoftë se ky nuk është vënë re gjer tani, shkaku është se më të shumtët nuk e kuptojnë poezinë e tij, e cila me fjalë e mënyra foljesh fare të thjeshta, e shumë herë popullore, arrin të koncentrohet aq sa mundet të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat

## *Eqrem Çabej*

më labirintike, idetë më të larta. Dhe po të këndohet Lasgushi me dashurinë, do të vërtetohet thellësia e tij e pashoqe. në mos sot, nga brezat që do të vijnë.

Poezia moderne në Evropë: Në Gjermani është çudi se ka qenë një shkrimtar i lindur që më 1770, Hëlderlin, i cili në jetën e tij letrare fort të shkurtër ka nxjerrë harmoni që u afrohen këtyre të sotmeve. Në kohët e fundit Rilke, Stefan George e disa të tjerë janë përfaqësuesit e vjershës moderne gjermane. Në Francë filloi fryma e re me disa vjersha të V. Hygoit; e lulëzoi me Bodler (Fleurs du mal), Verlen, Malarmé, Rembo, Valér etj. Në Itali, D'Anunzio e Paskoli e rritën përmën e re të vjershës moderne të mbjellë prej Karduçit. Në Rusi, prozatorët e së cilës kanë influencuar në të gjithë Evropën, nga vjershëtorët ai që mori më famë në kohët e fundit është djaloshi i vdekur Sergej Jesenin. Ja, pra. poetët që janë produkt i kohës moderne, bir i së cilës është dhe Lasgush Poradeci.

Një tjetër send karakteristik për të: ky nuk është poet lirik në kuptimin me të vërtetë të fjalës: nuk do të gjesh të ëmbla e të buta melodi; më shpesh vjershat e tij janë drama dhe shumë prej syresh tragjedi të vogla: shquan prologun, aktin e parë të dramës, kulmin e dramës, pastaj si vala e detit e «Këngës pleqërishte». bie. bie. bie, pasi pat luftuar shpirti i munduar, i munduar më kot.

Pasi pat luftuar më kot për të gjetur lumtërinë jashtë kësaj bote, për t'iu avitur idealit të paarrtshëm.

Po, mor mik, lëre këtë botë! Në qoftë se nuk vret veten. hidhu në ideal e mbushe shpirtin plot me të! Një fuqi elementare mund të krijojë një botë... Po, ah, janë të gjitha përralla! Largoju më mirë dhe ruaje jetën si murg, i vdekur, i pakallur. Të paktën do të ndjesh atëherë. «Ç'ëndërrim krijoi truri».

### **Më çdo varg prej pikash lot**

Kur dridhesh nga hidhërimi dhe jeta në të është natë, mos u ngroh në mishin e gruas!... Përpara syrit të shpirtit tënd të avitet forma ideale: «Me flokë përmbi supe».

**Me rroba gjer përdhe**

Këtë të patruptën, pushtojë «me një magji të re». Ja qëndrimi i Lasgush Poradecit kundrejt dashurisë, ku duken aq zotësia ashtu dhe vetitë e një vjershëtori.

Disa nga vjershat e tij nuk kuptohen, ose me shumë zor: Kush e njeh Lasgush Poradecin për së afërmi, di se ai është një adhurues entuziast i kulturës latine, i qartësisë latine, një armik i obskurantizmit gjerman. Një paralelë: Nietzsches, armikut më të rreptë të «besties blondi», të muzikës së Vagnerit, i pëlqente muzika latine e Bizetit, poezia latine e Horacit, mendimet latine e stili latin i Montenjtit: Po të paktë të mëdhenj kanë qenë aq të munduar nga demoni i mendimeve kaotike sikurse Niçe. Shpjegimin na e jep një dialog i Platonit: «Njeriu dëshiron atë që nuk e ka vetë». Edhe Lasgush Poradeci është larg nga të qenët një njeri «latin».

Po moskuptimi i lehtë, të themi errësira e disa vjershave të tij, nuk është një e metë, përkundrazi një element i gjithë shkrimeve të thella në botë që prej poemave indiane, e, nëpër Kurandin, gjer më sot. Fundi i fundit, çdo thellësi është e errët. Dhe faji s'është aq i gjeniut sa i publikut mendjeshkurtë. Dante, tek i cili gjinden disa verse jo aq të qarta, ka s'asconde Sotto il velame delli versi strani.

Po sikundër nër komponistët e një stili të rëndë, ziplot, nganjëherë ndihen tingëllimet e këndshme të një «Skerzoje» ashtu dhe nëpër poezitë e këtij, të gjera e plot gremina, që janë tablotë e një fati. shfaqet diku (sa rrallë!) një nënqeshje sublime në trioletin e lehtë si një grumbull rrezesh dielli të mëngjesit në një odë të zezë:

*Këto kopshte ku fryn era!  
Muar ngjyrën e floririt.  
Se ç'i shkel baluke-prera  
Këto kopshte ku fryn era!*

Kush nuk mundet nga magjia e kësaj gjuhe? Djalëri shqip-tare, këndo Lasgush Poradecin, e pastaj vdis!

Këto vërejtje le t'i shërbejnë kuptimit të poezisë së Lasgush Poradecit, të këtij djaloshi, të cilin një fat i mirë duket

## *Eqrem Çabej*

~~sikur ia ka falur Shqipërisë, që të bëhet ai shkrimtar, të cilin Shqipëria do t'ia falë njëherë botës. Po si do të zhvillohen punët, kush mund ta dijë? Lasgush Poradeci ka mjaft kohë që nuk shkruan. Periudha e djalërisë i kaloi, tash do të vinte krijimi i burrërisë. Po një sëmundje e rëndë dhe e pamëshirshme lufton që ta shtypë...~~

Ky kapitull i sëmundjes së tij është tepër tragjik, aq sa nuk mund të zgjatemi më tej. A është sëmundja shkak i vuajtjeve të tij, apo vuajtjet e tij të para qenë shkaqet e sëmundjes, këto janë probleme tepër të koklavitura. Fakti është se literatura shqiptare do të fitonte shumë, ose do të humbiste shumë me Lasgush Poradecin.

Ne dëshirojmë të parën. Po fati e ka në dorë!

Edhe shqiptarët. Duhet sakrificat të mëdha që ai të mund të mbarojë misionin e vet...

«E pastaj le të ronitem, le të qaj e le të vdes».

*G r a z, shkurt 1929.*

#### 4. DY FJALË PËR GJUHËN E PETRO LUARASIT\*

Mësues i popullit me kuptimin e vërtetë të fjalës, nxënës i denjë i Koto Hoxhi Qestoratit e (shok idesh) i denjë i Papa Kristo Negovanit. Petro Luarasi gjithë energjitë e tij i shkriu për një ide e një punë kryesore. Kjo ishte përpjekja për përhapjen e shqipes në shkollën shqiptare e përtej kësaj edhe si gjuhë e shkrimit të përditshëm dhe e literaturës. Ai mbase më shumë instinktivisht zbatoi aty si parim fjalët e një gjuhëtari të njohur, që thotë se gjuha dhe historia e një populli përbëjnë konceptin e nacionalitetit të tij. Në shërbim të këtij ideali të jetës së tij për të ndihmuar me sa mundet në realizimin e tij, ai vuri gjithë përpjekjet për pastrimin e shkrimit shqip, për zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë vendi. Këtij qëllimi të lartë ai u mundua t'ia arrinte më një anë duke shtënë në përdorim fjalë të rralla e me një përhapje të kufizuar, më anë tjetër duke sajuar disa neologjizma me brumë të vendit. Gjejmë kështu në përshkrimet e tij, më një anë fjalë të tilla si *bastër*, «orë e keqe që than bimët në të arrirë», të cilën e ka me një kuptim të afërt dhe Veriu e *kokëfyell*. «*kryezbrazët*», fjalë që tregon se kuptimi i parë i fyellit ka qenë «zgarvër, i zgavërt», prandaj dhe Gjon Buzuku më 1555 ka *fyell mjalti* për, «hual mjalti». Ndënjë fjalë si maston «mjafton» e ka marrë prej shkrimeve të Veriut. Meritojnë në anë tjetër edhe sot vëmendjen e gjuhëtarit *çaponj*, «eci», *çmërrenj* «mohoj», *çpërfill*, «nuk përfill, shkel», *flakërit*, «hedh poshtë»: *çartë*, «grindje». *vdier*, «prish». Fjalë popullore që shtie ai në qarkullim. Një përdorim të ri, shpeshherë në kundërshtim me gjuhën sot, u jep ai disa fjalëve të qena edhe më parë.

\*) «Petro Nini Luarasi» (artikuj, studime, kujtime) botim i Inst. i Stud. ped., Tiranë 1974.



## Ëqrem Çabej

Kështu ka, *kallëzon* për «akuzon», i mbaruar për «i përsosur», ngreh për «themeloh» *përdredh* për «shtrembëroj», (një fakt, etj.), ruaj për «rezervoj», *vështroj* për «konsideroj», dhe përdor shprehje si *i ngulte frikë, nuk është e qenë*, «nuk ekziston», *vë re*, marr parasysh, e të tjera si këto.

Në neologjizmat e tij Petro Luarasi nuk ka qenë kurdoherë dorëmbarë, ai këtu ka pasur më fort fatin e Papa Kristo Negovanit. Nga fjalët e farkuara prej këtyre dy apostujve të idesë shqiptare, shumica nuk kanë zënë vend në gjuhë. Megjithatë, edhe aty shihet dëshira e madhe për të shprehur mundësisht çdo gjë, çdo koncept me mjetet e gjuhës amtare. Përveç kësaj do pasur parasysh se ka fjalë të farkuara prej tij që janë të goditura si të tilla, po që s'kanë pasur fatin të hyjnë në përdorimin gjuhësor, gjë që na bën të shpresojmë që me një përdorim më racional, të paktën pjesërisht, mund të hyjnë në të ardhmen në gjuhë. Nga fjalët që përdor Petro Luarasi dhe që i formoi ai vetë ose i gjeti nga më të parët, të tilla si *padijë*, «ignorancë», *përvojë* «eksperiencë», e *tipare* janë bërë pronë e përbashkët e gjuhës. Po gjejmë tek ai edhe plot të tjera krijime fjalësh. ndër të tjera *blerës* për «klient», *hytonj* për «adhuroj» (nga *hyj*, «hyjni», që del së pari te Bogdani 1685), *jesë* për «ekzistencë», (nga *jes-jeta* «mbetem», ku hyn edhe emri *jetë-a*), *këndimtar* për «lexues», *kundërflas* për «kundërshtoj me fjalë, kundërthom», *lajmësi-a* për «informatë», *mallëkues*, *himn mbivarrimtar* për «himn funebër», *nëpërkëmb* për «marr nëpër këmbë», *njeri-jattrash* për «reciproke», *të parçmuara*, «të preferuara», *pasruajtje* «rezervë», *pashtekje* «qorrsockak», *përfolje*, «akuzë», *përformonj*, «transferoj» i *përgardhosur*, «ekskluziv», *përgjurmonj*, «kontrolloj», *i përlindur* «i rilindur». Nga këto fjalë. Petro Luarasi ndonjë e gjeti tek paraardhësit e tij, po shumicën i farkoi ai vetë. Kuptohet se këto lloj fjalësh në pjesën më të madhe janë kalke, sajime fjalësh pas modelit të gjuhëve të huaja, po me brumin e gjuhës amtare.

Në historinë e formimit e të zhvillimit të shqipes si gjuhë shkrimi Petro Luarasi zë një vend më vete. Ai ka vënë një gur, megjithëse të vogël. në ndërtesën e gjuhës letrare. Prandaj përpjekjet që janë bërë në këtë fushë, si prej tij, si prej shokëve të tij, më të njohur e më të panjohur. meritojnë dhe duhet të studiohen e të vlerësohen me thellimin e duhur. Aq më shumë, kur këta burra. idesë për të cilën luftuan i bënë fli gjithçka, deri jetën e tyre.

## 5. FAN NOLI YNË\*

Në këto çaste, në mes të kaq shkrimtarëve, një njeri që s'është shkrimtar e ka vështirë të thotë një fjalë të vetën për një personalitet shkrimtari me një format të tillë siç është Fan Noli.

Në qoftë se fjala që vepra e një shkrimtari është pasqyra më e vërtetë e forma mentis dhe e shpirtit të tij është e drejtë, atëherë vjershat që shkroi ky poet dhe veprat e shqipëruara, që na ka lënë, përfaqësojnë në kuptimin e tyre simbolik, që në krye e gjer në fund, një konfesion të vetin, kredon e një njeriu e të një jete. Në këtë kuptim nuk është një gjë gand e e rastit që Fan Noli mori e përktheu një varg tragjedish nga të Shekspirit, në të cilat përpjekjet për liri sociale e politike dhe konfliktet e brendshme shpirtërore janë ndërthurur në një mënyrë si moskund në literaturën botërore, që ai shqipëroi disa drama të Ibsenit, *Don Kishotin* e Servantesit, *Rubajetet* e Omar Khajamit, disa vjersha të Edgar Poes, Bodlerit e të tjera, dhe që në kohën e qëndrimit të tij si emigrant politik në Manern afër Vjenës, pas fjalëve të mikut të tij, Norbert Joklit, u mor për një kohë të gjatë me planin e përkthimit të *Faustit* të Gëtes, duke studiuar dhe disa nga komentaret e kësaj vepre. Nuk është gjithashtu një gjë gand e e rastit që ai shkroi *Historinë e Skënderbeut* dhe ato vjersha që shkroi. Kudo në këto vepra — në krijimet e veta e në përkthime është përderdhur fryma komplekse e shkrimtarit. Ai i ka jetuar ato, ka jetuar ai vetë nëpër to, në figurat e heronjve. Kudo në këto na shfaqet, ku më çelët, ku më mbyllur, shpirti i autorit të tyre. Ai na del

---

\*) Marrë nga «Nëntori», nr. 4/1965, Tiranë.

## Eqrem Çabej

na dashur si te Bruti, ashtu dhe te Hamleti, te Don Kishoti ashtu si te Omar Khajami, te profeti Moisi ashtu si te G. lileasi, te Prometeu i mbërthyer e te Armiku i popullit, që në të vërtetë është miku i vërtetë i tij. Revolucionarë e profesorë poetë e dashamirë aktivë të njerezimit janë po aq mishërime të unë-s së tij, nëpër ta shprehet ai vetë. Në këtë vështrim dhe shqipërimet në një kuptim më të thellë janë krijime të tij.

Fan Noli si për formimin e tij poetik, si për shprehjen gjuhësore qëndron më vetë në literaturën shqiptare. Ai nuk është poeti i lartësive eterike, po është shkrimtari i plisit të dheut. Është një Ante i literaturës sonë, që i merr fuqinë prej mëmës tokë. Ai ka të vetën diçka demonike, e cila mbase është vetia e parë e njeriut krijues, cilësia e mirëfilltë e furoz poeticus, e marrëzisë së poetit të vërtetë. Në fushën e kësaj literature ai nuk është një fill bar, që sot bleron e nesër thahet, nuk është as lule, që sot shkëlqen e nesër veshket. Ai na paraqitet si një lis i mocëm e plot gdhënj: lis i vetëmuar, po me rrënjë ngulur mirë në të thellat e dheut. E këtillë mbetet edhe gjuha e tij. Në këtë nuk ndihet ëmbëlsia e flladit të verës sesa furia e murrërit të dimrit. Ajo nuk ka aromën e kuleve, po ka erën e shëndoshë të dheut. Ka dhe diçka prej pikash të rënda e të idhëta, në të shprehet ana e rëndë e jetës shqiptare. Në këtë poezi shihet se mund të jetë gjuha shqipe e ashpër e e vrazhdë, dhe e fortë në ashpërsinë e saj.

Me zhdukjen e këtij njeriu të rrallë një valë pikëllimi përshkoi anembanë botën shqiptare, kudo ku i thonë bukës bukë, e ujit ujë. Po kjo nuk është një valë dashpërimi. Fan Noli nuk është një madhësi efemere. Fjala e tij nuk është nga ato që i merr era. Në këtë botë shqiptare, të cilën ai e deshë me të gjitha fijet e zemrës, ai mbetet i gjallë ndër ne, si sot, si në ditët që do të vijnë.

1965

## 6. DY FJALË KUJTIMI PËR PROFESOR ALEKSANDËR XHUVANIN\*

### Humanist, ndjekës i idealeve më të larta të njerëzimit

Profesor Aleksandër Xhuvanin e kam njohur prej kohësh dhe e kam çmuar gjithmonë si një studiues të dalluar të gjuhës sonë amtare. Po bashkëpunimi me të fillon pas Çlirimit të vendit. Që në vitet e para të pasçlirimit, ne të tre, prof. Xhuvani, prof. Kostaq Cipo dhe unë, iu përveshëm punës së hartimit të një punimi të hapët që përfshinte rregullat e drejtshkrimit të shqipes. Parimi që na udhëhoqi në këtë punim, i pari i këtij lloji që kur ekziston një shtet shqiptar, ka qenë ky, që me një anë t'i rrimë sa më besnikë shqiptimit të fjalës në ligjërimin popullor, më anë tjetër të synohet në një konvergjençë, në një afrim të dallimeve dialektore në një njësi të përbashkët e më të madhe. Si i tillë, ky punim, i cili u botua së pari në vitin 1943, në formë më të plotë më 1951, dhe u ribotua edhe më vonë në bashkëpunim me disa shokë të tjerë, përbën një bazë për punimet që u ndërморën më vonë te ne në fushë studimesh. Nën udhëheqjen e prof. Xhuvanit, së bashku me të e me disa shokë të tjerë, në atë kohë kemi punuar dhe në hartimin e dy fjalorëve dygjuhësh, të cilët u botuan njëri më 1947 dhe tjetri më 1953.

Studimet gjuhësore në atë kohë sa kishin nisur të mëkëmben te ne. Kuadrot ishin të paktë, porse sa vinin po sht-

---

\* Marrë nga «Mësuesi» nr. 12 (918), 19 mars 1975, Tiranë.

heshin. Duke u thelluar, me përpjekje të përbashkëta, më tej në studimet shqiptare, në vitet e mëpastajme kam pasur nderin të bashkëpunoj me prof. Xhuvanin kryesisht në fushën e fjalëformimit të shqipes. Më 1956 botuam punimin «Parashtesat e gjuhës shqipe». Pas atij punimi doli libri «Prapashtesat e gjuhës shqipe», ky në vitin 1962, pak kohë pas vdekjes së profesorit të nderuar. Edhe në lëngimin e fundit, ai interesohej dhe më pyeste si shkonte shtypi i këtij libri, të cilin ndërkaq nuk arriti ta shihte të botuar. Mbledhja e materialit për këto dy punime na pat kushtuar mjaft mund dhe një kohë të gjatë. Të dyja punimet kanë një synim të dyfishtë, teorik-shkencor dhe praktik njëkohësisht. Në planin teorik aty vihet në dukje pasurimi i shqipes popullore në rrjedhë të shekujve me anë formimesh të reja të dala prej fjalësh rrënjë. Përtej çaqeve të këtij plani, ndërkaq, aty shihen dhe mundësitë që ka gjuha jonë të pasurohet me fjalë të reja, të formuara në pajtim me rrugët që ka ndjekur lashtësisht gjuha popullore.

Sa rëndësi ka hetimi i këtyre rrugëve dhe i këtyre mundësive të shqipes në punën e pasurimit të gjuhës letrare e të gjuhës së shkrimit, sot dhe në kohën që do të vijë, kjo besoj se nuk ka nevojë të shtjellohet më tej. Ajo veçse që do theksuar këtu, është kjo që për Aleksandër Xhuvanin pasurimi i gjuhës shkon hap më hap edhe tretet më një në mënyrë të drejtë me *pastrimin* e gjuhës. I shtyrë prej dashurisë për gjuhën amtare, ai me dëshirë të flaktë e me përpjekje të ngulët e të pandërprerë, u mundua të pastrojë gjuhën shqipe nga byku i fjalëve të huaja dhe i ndërtimeve të huaja. Gjer në ditët e fundit të jetës së tij ai nuk pushoi së mbledhuri fjalë të visarit të leksikut popullor nga cdo anë e vendit, me synimin njëkohësisht që këto të përhapen në masat dhe të zëvendësojnë me kohë lëndën gjuhësore që vërshonte e që vazhdon të vërshojë së jashtmi. Këtë rrugë gjuhësia jonë, mendoj, se pas shembullit të tij, e ka për detyrë ta ndjekë më me ngulm edhe në të ardhmen. Metoda e punës që them se do ndjekur në këtë lëmë me rëndësi për gjuhën tonë të shkrimit e të literaturës, mbetet ajo që ka zbatuar ky dijetar me qëndrimin e matur që e ka karakterizuar gjithmonë. Me një anë marrja e fjalëve të përdorimit popullor dhe ngritja e tyre në një nivel cilësor më të lartë, domethënë në përdorimin e tyre në fushën e leksikut të sferës abstrakte-mendore. Më anë tjetër, formim fjalësh të reja qoftë edhe me anë përkthimi, pas një gjedheje (modeli) të huaj, veçse gjith-

herë në pajtim me frymën e gjuhës shqipe. Në marrjen e fjalëve të huaja, e cila ndonjëherë, në parim e në praktikë, paraqitet e nevojshme në kushtet e teknologjisë moderne, do të shikohet në çdo rasë të veçantë mos ka mundësi që në vend të tyre të shtihet në përdorim ndonjë leksemë që ekziston në gjuhë, ose që të lentohet (krijohet) një term i formuar prej brumit vetjak të kësaj gjuhe. Aty do të rrihet një rrugë e mesme, të cilën e ka rrahur dhe prof. Xhuvani: as një purizëm i tepruar, një parapëlqim me çdo kusht i elementit të vendit, me përjashtim a priori të fjalës a të gjedhës së huaj; asnjë ksenofili e tepërt, një përrulje e verbër ndaj kësaj. Shqipja, e cila jo vetëm në leksikon e lëmit material, po edhe në atë të fushës abstrakte-mendore është më e pasur nga sa mund të kujtohet, ka mundësi të pasurohet në të ardhmen me mjetet e lëndës vetjake dhe degët e disiplinave të ndryshme shkencore.

Përtej punës së detyrave zyrtare me prof. Xhuvanin kam pasur rast shpeshherë të bisedoj mbi çështjet që kanë lidhje me problemet e shqipes, të shkëmbej mendime e të këshillohem me të. Këto biseda kanë lënë kujtime të paharruara tek unë. Sidomos të shpeshta kanë qenë diskutimet tona rreth çështjeve të historisë së shqipes dhe të marrëdhënieve të saj me gjuhët e tjera, veçanërisht me ato të Ballkanit. Të shpeshta kanë qenë dhe bisedimet rreth fjalëve të gjuhës sonë, përhapjes së tyre në dialektet e saj, si dhe problemit të burimit të tyre. Ai ishte një njeri që në dialektikën e bisedës jo vetëm jepte mendimin e vet, po dëgjonte me durim e vëmendje edhe mendimin e tjetrit. Këtë e kam vënë re sidomos gjatë punës shkencore të përbashkët, prandaj dhe bashkëpunimi me të nuk ka qenë kurrë i vështirë. Për këtë arsye, edhe bisedimet shkencore me të kanë qenë për herë të frytshme për ne të tjerët. I gatshëm e i pakursyer për çdo ndihmë, ai ka dhënë një kontribut të vlefshëm edhe në ato punime të kuadrove tanë ku nuk shfaqet emri i tij, si bie fjala në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 1954. Si në jetën private, edhe në fushën shkencore ai, nga sa kam parë, ka qenë i parimit që është më bukur të japësh se sa të marrësh. Në këtë mënyrë interesi personal tek ai edhe në lëmin e dijes ka mbetur gjithë kohën shumë mbrapa interesit të përgjithshëm.

Prof. Aleksandër Xhuvanin gjatë një bashkëpunimi prej shumë vjetësh kam pasur kështu mundësinë edhe nderin ta njoh më për së afri. Kam nderuar gjithmonë në personin e tij

*Eqrem Çabej*

jo vetëm dijetarin, por edhe njeriun. Një humanist i vërtetë, ai ka qenë një njeri përparimtar në kuptimin më të mirë të kësaj fjale, një ndjekës i idealeve më të larta të njerëzimit. Punëtor metodik e i palodhur gjer në fund, ai i ka kushtuar një jetë njeriu arsimit kombëtar edhe kulturës së gjuhës amtare, të cilën e ka dashur mbi të gjitha. Për këto merita vepra e tij është vlerësuar lart. Ai mbetet një nga ata burra që kanë venduar nga një gur themeltar në ndërtesën e studimit të gjuhës shqipe nga ana e shqiptarëve, në ndërtesën e një gjuhësie shqiptare.

## 7. NË 30-VJETORIN E VDEKJES SË NORBERT JOKLIT\*

Norbert Jokli lindi më 25 shkurt 1877 në Bzenec të Moravisë Jugore, në Çekoslovakinë e sotme. Studioi së pari drejtësi dhe shërbeu në Vjenë si praktikant juridik me shërbim gatitor për karrierën e avokaturës. Pas një kohe të shkurtër, duke ndjekur një prirje të tij të kahershme, ai i kthye degës së gjuhësisë. Studioi indoeuropianistikë të krahasuar te P. Kreçmer, romanistikë te G. Majer-Lybke, gjermanistikë te R. Muh dhe sllavistikë te W. Vondrak e V. Jagiç. I shtyrë nga ky i fundit, Jokli që më 1907 iu përvesh studimit të shqipes.

Ky është përfaqësuesi gjer tani i fundit në radhën Miklosiç-Gustav Majer-Pedersen-Jokl, një radhë dijetarësh, të cilët janë marrë me gjuhën shqipe drejtpërdrejt dhe vazhdimisht. Jokli në këtë lëmë arriti një mjeshtri të madhe, solli këtu një frymë të re në gjerësi e në metodë dhe zgjeroi e thelloi qenësisht (esencialisht) njohjen gjuhësore të shqipes. Metoda e tij del në shesh që me titullin e së parës vepër më të madhe albanistike *Studien zur albanesischen. Etymologie und Wortbildung*, (*Studime mbi etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes*), me të cilën u habilitua më 1911 në Universitetin e Vjenës. Etimologjia dhe morfologjia janë qenësisht përpjekjet e gjurmimeve të tij në fushë të leksikut të shqipes. Qëllimi i kërkimeve të tij rreth historisë së fjalëve është më fort ky, që të mos mjaftohet vetëm me hetimin e burimit etimologjik të një fjale, po të japë një pamje sa më të plotë të fjalës, të formimit dhe të historisë së saj, ta ndjekë këtë fjalë në të gjitha fazat e zhvillimit të

\*) Marrë nga «Mësuesi», datë 25.10.1972.



saj. Në pikëpamje stilistike kjo metodë shfaqet në këtë që Jokli një paraqitjeje sistematike të thatë i parapëlqen traktatin monografik. Prandaj, vlerat vetjake të veprave të Joklit janë thellësia dhe pushtimi i objektit nga të gjitha anët. Një vend me rëndësi në veprat e tij zë dhe konsiderimi i elementeve të kulturës materiale: Fjalët dhe sendet, drejtimin e gjuhësisë që shpalli për të parën herë Jakob Grimi dhe që themeloi kryesisht Rudolf Meringer domethënë që krahas me fjalët të kishen parasysh edhe sendet përkatëse, edhe këtë drejtim e përvetësoi Jokli dhe e vuri në zbatim në lëmë të shqipes. Kjo vërehet hap më hap si në artikujt e tij, sidomos në kryeveprën e tij të vitit 1923, e cila mban titullin *Kërkime gjuhësore-kulturohistorike nga fusha e gjuhës shqipe*. Me këtë mënyrë veprat e tij kanë rëndësi edhe përtej qafeve të linguitikës, në lëmë të etnografisë shqiptare. Materialin etnografik Jokli e ka nxjerrë sidomos nga veprat e F. Nopcsas, shumë herë edhe në bisedime private me këtë njohës të shquar të kësaj disipline shkencore.

Përsa i përket caktimit të karakterit gjuhësor të shqipes, Jokli është një pasardhës i Gustav Majerit. Ky i pat shënuar kësaj gjuhe vendin e një gjuhe satem (indoeuropiane lindore) me karakter verior. Për periudhën antike të shqipes ka rëndësi fakti që Jokli pas hullisë sidomos të H. Pedersenit — e uli pjesën që i bie latinishtes në formim të leksikut të shqipes, pjesë që Gustav Majeri e bashkëkohësit e tij e kishin çmuar tepër lart. Po më anë tjetër bash Jokli është ai që ka zbuluar huazime latine të pavëna re më parë në gjuhën shqipe, si për shembull edhe në të drejtën zakonore të Shqipërisë së Veriut, në Kanun të Lekë Dukagjinit, si edhe në fushë të toponimisë. Në çështjen e lidhjeve të afërisë së shqipes me gjuhët indoeuropiane motra, dijetari ynë e ka vërtetuar dhe thelluar rrugën që pati rrahur G. Majeri domethënë që shqipja ka lidhje të ngushta sidomos me gjuhët baltike, dhe që të parët e shqiptarëve, duke zbritur nga vise më veriore ngulën në brigjet e Mesdheut.

Krahas me këto dy çështje: lidhjet e afërisë që ka shqipja me gjuhët motra, djepi paraballkanik i shqiptarëve, del dhe një pyetje e tretë, shqipja nga cila gjuhë ballkanike jogreke e kohës së vjetër ka dalë? Sikundër dihet, aty ka dy teza, të cilat rrinë përkundrajt njëra-tjetrës, njëra, që është e bazuar dhe historikisht e gjeografikisht në shqipen, sheh vazhdimin

e ilirishtes (Tunman, Difenbah, Falmerajer, Han, Nibur, Bonfai, Miklošić, G. Majer, Kreçmer, Ribeco e të tjerë), tjetra (Hirt, Vajgand, Utmon, Bariç e të tjerë), shqipen e ndan prej ilirishtes dhe sheh në të bijën e trakishtes, në këtë kjo tezë mbështetet rumanishten. Në këtë kontroversë Jokli rreh një rrugë të tretë: shqipja është e afërt si me ilirishten, si me trakishten. Një zgjidhje e drejtë e këtij problemi, i cili ka rëndësi për etnografinë e mbarë gadishullit të Ballkanit, bëhet e vështirë ngase ilirishtja me trakishten shumë pak njihen. Në themel teza e Joklit do të jetë e drejtë, sepse gjurmë trake në Adriatik kishte diktuar që më parë K. Paç; edhe Nopça kishte shprehur mendimin që ilirët ishin shtruar si mbishtresë përmbi një nënshtrësë trake. Prandaj, do të kthehem te mendimi i Tunmanit (1774), që në formimin e kombësisë shqiptare kanë pasur pjesë edhe trakët. Veçse, si mund të gjykojmë sipas gjendjes historike e gjeografike që na paraqitet, fondin themelor të popullit shqiptar pas gjase e përbëjnë ilirët.

Vepra gjuhësore e Norbert Joklit, megjithëse me zhdukjen tragjike të tij mbeti e pambaruar, paraqitet diçka tërësore në vetvete, tematika e saj është shumë më e gjerë se ajo e paraardhësve të tij. Në fushë të fonetikës, për periudhën parahistorike të shqipes, ai hapi shtigje të reja në punë të apofonisë, si edhe në reflekset e likuidave silabike. Në konsonantizëm ai vuri re, ndër të tjera, reflektimin e *sk*-së indoeuropiane edhe me ç në shqipen në fjalë të tilla si çel, dhe pasqyrimin e grupit *zd(h)* indoeuropian me *dh(th)*, në fjalë të tipit *gjeth*. Në çështjen e guturaleve ai mbrojti gjer në fund teorinë e Holger Pedersenit, sipas së cilës shqipja është e vetmja gjuhë indoeuropiane që ruan tri seri guturalesh të dalluara njëra nga tjetra gjer në ditët e sotme. Nga periudha historike e gjuhës ai ndoqi diftongimin e zanores *o* në *ua*, *ue* në fjalë si *krua krue*, *duar duer* nga *dorë*, duke e gjurmuar atë në fazat e ndryshme të zhvillimit të tij (*ou uo* etj.) mbi dëshmitë e dialekteve të dokumenteve të vjetra të shkrimit dhe të marrëdhënieve të shqipes me gjuhët fqinje të Ballkanit. Në punë të theksimit ai përcaktoi rregullimin mekanik të theksit në pajtim me parimin e theksimit të rrokjes parafundore. Në morfologji ai vërejti përdorimin e një kallëzoreje të moçme si emërore, sinkretizimin (përtjerjen) e rasave dhe ndërrimin e gjinisë së emrit. moshën mjaft të lashtë të nyjës së sprasme dhe dha sqarimin

përfundimtar të disa trajtave të përemrit pronor, si *juaj juej* e *taj tuaj* të autorëve të vjetër të Veriut e të ligjërimeve arbëreshe të Italisë. Në sistemin foljor ai gjurmoi trajtat e foljeve kauzative e denominative dhe ndër të tjera edhe historinë e përhapjes së paskajores. Vrojtime të reja i detyrohen atij edhe në lëmë të fjalëformimit, ndër të tjera në gjurmim të kolektivave e të deminutivave, në mënyrë të veçantë në hetimin e kompozitave të gjuhës popullore e letrare. Sintaksës nuk i është kushtuar ndonjë punim i veçantë, po vrojtime mbi dukuri të ndryshme të kësaj fushe gjinden gjithandej në punimet e tij.

Në veprën e këtij dijetari vendin e parë ndërkaq, si u tha, e zë historia e fjalëve dhe etimologjia. Në kundërshtim parrimor me dijen e përparme, e cila e pat trajtuar visarin leksikor të shqipes më fort nga ana e huazimeve, të marra prej gjuhësh të tjera, ai gjatë gjithë veprimtarisë shkencore të tij është përpjekur ta rrokë këtë gjuhë së brendshmi. Shihet kështu që në studimet e tij leksikut të trashëguar të kësaj gjuhe i përket një vend më i rëndësishëm se elementit të huazuar, megjithëse për hir të së vërtetës do thënë se ai edhe kësaj pjese të visarit leksikor i kushtoi vëmendjen e duhur. Në gjurmimin etimologjik të fjalëve ai zhvilloi me kohë dhe një metodë kërkimi të vetën, në pajtim me kushtet e veçanta të shqipes. Pikë së pari ai gjurmoi e solli për krahasim gjithë format e fjalës që çojnë peshë në punë të historisë së saj. Përveç kësaj ai kreu një analizë të thelluar të strukturës morfologjike të fjalëve që studioi, një tipar metode që mund të thuhet se është karakteristik për punën e këtij dijetari. Afrimi i të dhënave etnografike dhe të kulturës materiale në gjurmimin gjuhësor, ndjekja e drejtimit shkencor, «Fjalët dhe sendet», u përmend dhe më sipër.

Interesat shkencore të Norbert Joklit ndërkaq nuk u drejtuan vetëm nga historia e lashtë e gjuhës shqipe. Ai i kushtoi vëmendje edhe zhvillimit të mëpastajmë të saj, si gjuhë e shkrimit dhe e literaturës. Në artikullin «Një studim përreth librit të Buzukut», të vitit 1930 ai gjurmoi rrethanat historike në të cilat u hartua vepra, nga sa dihet, e para e literaturës shqiptare, dhe elementet e alfabetit që përdori autori i saj. Në një punim të hapët të vitit 1925, ai mori e studioi veprën e Naim Frashërit kryesisht nga pikëpamja e pasurimit të gjuhës letrare nga ana e tij, më një anë duke hedhur në përdorim

të shkrimit fjalë të ligjërimin popullor, më anë tjetër duke krijuar fjalë të sferës mendore e të kulturës me anë përkthimesh, kalkesh, nga gjuhë të huaja, në radhë të parë prej frëngjishtes. Dijetari ynë pati lidhje të pandërprerë edhe me shkrimtarët, arsimitarët e të tjerë intelektualë shqiptarë të kohës së tij, jo më në fund dhe me studentët shqiptarë të asaj kohe në Austri, të cilët të gjithë pasuruan njohuritë e tij rreth visarit leksikor të shqipes dhe të dialekteve të saj. Nga fusha dialektore do përmendur një punim i tij rreth ligjërimin të Rapshishtit në rrethet e Gostivarit, punim që me sa duket mjerisht do t'u ketë bjerrë.

Sikundër po shihet nga kjo skicë. Jokli është përpjekur ta pushtojë problemin e shqipes në tërësi dhe në të gjithë aspektet e tij. Prej këtij problemi ne prekëm këtu disa anë më fort të natyrës historike. E njëjta gjë duhet thënë edhe për anën gjeografike të kësaj çështjeje, sepse mënyra historike dhe gjeografike e vështrimit të problemit janë të thurura ngushtë me njëra-tjetrën. Jokli historinë e gjuhës shqipe me çështjet fonetike dhe leksikore të sajat, nuk e ka studiuar në një mënyrë të njëanshme e të izoluar, duke u kufizuar brenda cageve të shqipes, po e ka trajtuar duke pasur përhera parasysh gjendjen si na paraqitet te gjuhët që janë fqinje me shqipen. Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit janë një anë me rëndësi në metodën jokliane, përhera në të mbahet parasysh çka marrë hua shqipja prej greqishtes (greqishtja e vjetër, e mesmja, e reja), prej serbokroatishtes, bullgarishtes e rumanishtes, dhe më anë tjetër ç'u ka dhënë kjo atyre gjuhëve dhe dialekteve të tyre. Kështu gjurmimet e tij nuk i përkasin vetëm albanistikës, ato marrin karakterin e një vështrimi panballkanik, në kuptimin e Kristian Sandfeldit dhe në njëfarë vështrimi edhe të Gustav Majerit.

Në pikëpamje bibliografike do përmendur këtu «Vjetari indoevropian» (Indogermanisches Jahrbuch). ku Jokli ka redaktuar vit për vit pjesën që referon përmbi botimet e reja të albanistikës, seksioni VII që nga vëllimi IV, 1917, e gjer te XXIV, 1940. Duke marrë si qëndrim me vërejtje të shkurtra e shpeshherë edhe mjaft të shtjella, ndaj tezave të ndryshme të dijetarëve të tjerë, kjo punë bibliografike mund të themi se na paraqet gjendjen e albanistikës së këtyre dhjetë vjetëve të fundit gjer në vitin 1938.

Albanologu i madh mjerisht është zhdukur nga rrethi ynë.

## *Eqrem Çabej*

I përndjekur nga regjimi nazist për idetë e tij demokratike, ky, siç duket, u zhduk në maj të vitit 1942 prej këtij regjimi, në Vjenë, veçse hollësitë e vdekjes së tij nuk dihen. Me këtë dijetar albanistika humbet një përfaqësues të madh, atë që e pat zgjedhur studimin e shqipes për mision të jetës së tij. Përtej çaqeve të dijes, dhe populli shqiptar humbet një burrë, i cili, duke rrahur me frymë objektive ravën shkencore, u bë njëkohësisht dhe indirekt një mbrojtës i të drejtave tona nacionale. Mjerisht, si u tha, puna e këtij dijetari të shquar mbeti e pakryer. Sidomos nuk u krye dot vepra që do të kishte qenë kurorëzimi i punës së jetës së tij *Fjalori etimologjik i shqipes dhe Gramatika krahasimtare e kësaj gjuhe*. Në këtë vepër të madhe Jokli ka punuar vazhdimisht: nuk dimë gjer ku ka arritur sa ishte gjallë. Disa dorëshkrime të tij gjinden në Bibliotekën Nacionale të Vjenës, ndër to mbase dhe dorëshkrimi i *Fjalorit etimologjik*, ose ndonjë pjesë e tij a e skedave përkatëse.

## 8. PAUL KREÇMER\*

Më 9 mars 1956 vdiq në Vjenë, në një moshë gati nëntëdhjetë vjeç, Paul Kreçmer, profesor i gjuhësisë indoevropiane të krahasuar në Universitet të Vjenës dhe anëtar i Akademisë Austriake të Shkencave e i shumë shoqatave shkencore të tjera.

Paul Kreçmeri lindi në Berlin më 2 maj 1866. Si u habilitua në universitetin e atij qyteti më 1891, më 1897, u emërua profesor i gjuhësisë indoevropiane të krahasuar në Universitetin e Marburgut mbi Lahn, e më 1899 në Universitetin e Vjenës, katedër që ai e mbajti gjersa u emeritua.

Nxënës i Johan Shmidit, Kreçmeri e nisi karrierën shkencore me librin *Mbishkrimet greke të studiuara nga ana e gjuhës së tyre*.<sup>1</sup> Po ajo që e vendosi atë menjëherë në radhën e parë të gjuhëtarëve qe *Hyrja në historinë e gjuhës greke*.<sup>2</sup> Në këtë vepër paraqiten mendime të reja përreth lidhjeve të afërisë që kanë gjuhët indoevropiane në mes të tyre, e sidomos disa nga nëngrupet e gjuhët e veçanta ndër to. Njëkohësisht autori i saj na paraqitet këtu, mund të themi, si i pari që gjeti se në Greqi të vjetër përpara nguljes së elementit helen ka pasur një shtresë të lashtë jogreke, të afërt etnikisht e gjuhësisht me popullsitë e moçme të Azisë së vogël, materialin vërtetues të kësaj teze dijetari e gërmoi dhe e gjeti kryesisht në

\*) Marrë nga «Nëntori» nr. 2, 1957, Tiranë.

1) Die griechischen Vasenschriften in ihrer Sprache untersucht Gütersloh 1894.

2) Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache, Göttingen, 1896.

toponominë e Greqisë së vjetër, në radhë të parë te emrat me *-nthos* e *ssos (-ttos)* të tipit Korinthos, Parnassos, Hymettos etj. Kjo ide ka bërë epokë në gjuhësinë historike të këtyre dy brezave të fundit. Ajo u tregua pjellore edhe në të tjera fusha gjuhësore përveç greqishtes, sepse gjuhëtarët që kanë gjurmuar në gjuhët e vjetra indoevropiane veçanërisht të Evropës jugore mbeturina shtresash paraindoevropiane, në këtë punë, me vetëdije ose jo, kanë ecur në hullinë e çelur nga ai. Në këtë rrugë studimesh Kreçmeri vetë vijoi për gjithë jetën e tij, duke e shtrirë fushën e kërkimeve përmbi gjithë pellgun e Mesdheut, po duke lidhur në mënyrë të veçantë studimet greke me gërmimet gjuhësore në truallin e Italisë antike e të Evropës juglindore të vjetër. Zbulimi i hetitshes dhe i karakterit indoevropian të kësaj si dhe të disa të tjerave gjuhë të Azisë së vogël kishte hapur ndërkaq horizonte të reja në gjuhësi. Këto rrethana e vunë në gjendje dijetarin e shquar të konkretizojë përfundimet e tij të mëparme, gjatë një pune shumëvjeçare të pareshtur, duke mbajtur qëndrim ndaj zbulimeve të reja dhe duke i shpurë përpara ato, me një numër të madh botimesh të ndryshme. Në këtë fushë, ai me kohë arriti në përfundimin që para nguljes së popujve indoevropianë nëpër vendet mesdhetare, në këto anë ishte derdhur një shtresë më e lashtë e këtij fisi («Shtresa protindoevropiane»), kjo u tret me popullsinë autoktone, po jo pa lënë disa gjurmë të dukshme në gjuhët e mëpastajme.

Gjurmimet e Kreçmerit pushtojnë gjuhët indoevropiane të dy kontinenteve, duke i përfshirë ato që nga keltishtja në perëndim e gjer te gjuha e Hindit në lindje. Po fusha kryesore e kërkimeve të tij mbetet studimi i të dy gjuhëve klasike dhe i idiomeve përreth tyre të kohës prehistorike e të antikitetit. Ky drejtim studimesh gjeti shprehjen e tij dhe në librin «Gjuha».<sup>1</sup> Në këtë botim, të caktuar në radhë të parë për filologët klasikë, po që u përket dhe gjithë dishepujve të gjuhësisë, jepet një pasqyrë e kthjellët e koncize e gjendjes aktuale të gjuhësisë historike, e periodave të ndryshme të zhvillimit të saj, e problemeve që shtron dhe rezultateve ku ka arritur. Veprimtaria e Kreçmerit në këtë lëmë shprehet dhe me themelimin e së përkohshmes *Glotta* «revistë për gjuhën greke e latine»,

1) Sprache. Në serinë Einleitung in die Altertumswissenschaft, prej Grecke-Norden, Leipzig-Berlin 1910, botimi i tretë 1923.

në vitin 1907. Këtë ai e drejtoi së pari me Fr. Skuç, e pas vdekjes së këtij nga viti 1914 e këtej, me V. Krollin. E vijoi punën së fundi me revistën *Gjuha*<sup>1</sup> të cilën e themeloi më 1949 bashkë me V. Haversin e me V. Çermak dhe e drejtoi gjer në vdekje të tij.

Përsa i përket veçanërisht greqishtes, Kreçmeri historinë e kësaj gjuhe e ka hetuar në të gjitha periudhat e saj, që nga fillimet prehistorike e gjer në fazën e sotme. Kërkimet e tij kanë kontribuar mjaft në zbulimin e shtresave të ndryshme në dialektet e Greqisë së vjetër. Në një polemikë të frytshme me Albert Tumbin, veprimtaria shkencore e të cilit shtrihet pothuajse mbi të njëjtat fusha si ajo e Kreçmerit, ky me veprën *Gjeneza e Koinesë*<sup>2</sup> përcaktoi rrethanat historike në të cilat u përftua Koineja greke. Edhe zhvillimin e mëtejshëm të greqishtes gjer në periudhën bizantine dhe në të renë ai e ndoqi me vëmendje të palodhur. Në veprën *Dialekti i sotmë i Lesbosit i krahasuar me ligjërimet e tjera të greqishtes veriore*<sup>3</sup> studiohet nga të gjitha anët një dialekt i greqishtes moderne; ky studim u bë model për shumë monografi që kanë dalë pastaj në lëmin e dialektologjisë greke. Po interesi shkencor i Kreçmerit po kalonte ndërkaq edhe në truallin e folklorit e të literaturës popullore. Fryti i kësaj është botimi gjermanisht i *Përrallave neogreke*,<sup>4</sup> me një hyrje që ka mbetur e famshme me të drejtë.

Kreçmeri është një historian i gjuhës, dhe metoda e ndjekur prej tij shprehet me termin e linguistikës historike. Ky orientim kërkimesh ndërkaq nuk e ndaloi atë, po përkundrazi e shtyu të bëhet dhe një nga pionierët e gjeografisë gjuhësore, një degë e gjuhësisë, që qysh nga Gilieronit e këtej dihet se ka marrë hov dhe është treguar shumë pjellore në studimet e gjuhës. Për këtë veprimtari të tij dëshmon vepra *Gjeografia e fjalëve në gjermanishten e lartë të rëndomtë*.<sup>5</sup> Këtë vepër autori

---

1) Die Sprache. Zeitschrift für Sprachwissenschaft. Vjenë.

2) Die Entstehung der Koine. Vjenë 1900 (botim i Akademisë së Vjenës).

3) Der heutige lesbische Dialekt verglichen mit den übrigen nordgriechischen Mundarten. Vjenë 1905.

4) Neugriechische Märchen. Jena 1919.

5) Wortgeographie der hochdeutschen Umgangssprache, Göttingen, 1916-17.



## *Eqrem Çabej*

vetë e quan «përppjekjen e parë për konstatimin e ndryshimeve gjeografike», në njërën nga gjuhët e mëdha të Evropës së sotme, duke u dhënë kështu një shembull gjuhëtarëve, sesi këta në kërkimet që bëjnë nuk duhet të lënë pas dore problemet aktuale të gjuhës amtare.

Në shqiptarët kemi plot arsye për të kujtuar këtë dijetar të madh. Në veprën e tij *Hyrje në historinë e gjuhës greke*, në kapitullin VIII («Fiset ilire») ky i afrohet dhe studimit të shqipes. Aty hiqen qartë vijat e filiacionit që lidhin gjuhën tonë me ilirishten e vjetër. Si vihet në dukje përhapja e kombit ilir nga jugu përtej kufijve të Ilirisë së vërtetë në Greqi dhe kombësia jогреке e popullsisë së Epirit, të Akarnanisë e të Etolisë në kohën e vjetër theksohet me të drejtë kontinuiteti i elementit ilir në botën shqiptare në një sasi emrash vetjakë, që rrojnë, përkatësisht gjejnë shpjegimin e tyre në gjuhën shqipe. qofshin këto emra personash si Bardyllis: *i bardhë*, Bato: *Batush*, qofshin emra vendesh, si *Delminium Dalmatia: delme*, *Ulcinium: ulk*, *Dardania, dardhë*, *Dimallum: mal* etj. Përcaktohen sidomos në një mënyrë përfundimtare pikat e afërisë së shqipes me ilirishten e japiçëve e të mesapëve të moçëm të Italisë jugore në disa karakteristika shumë esenciale (vokale, diftongje, konsonante, leksik). Këto dy gjuhë ai i përfshin në degën dialektore të një ilirishtje jugore, ndërsa venetishtes si dialekt verior i caktohet me të drejtë një vend më i largët. Për maqedonishten e vjetër ravizohen tiparet e një gjuhe më vete, e jo dialekt i greqishtes, siç mendojnë disa të tjerë. Grumbullohen në një dhe konkordancat parciale (pjesore) të shqipes me greqishten e vjetër, një arë që u lëvrua pastaj më shumë prej Norbert Joklit. Në çështjen e burimit të gjuhës shqipe Krecmeri mbron dhe përforcon mendimin e Gustav Mejerit, që thotë se shqipja paraqet fazën më të re të njerit nga dialektet e moçme ilire. Dihet se në këtë çështje të rrahur nxehtësisht dhe të pazgjidhur gjer më sot, Herman Hirt shpërtheu në një polemikë kundër Krecmerit, dhe se ai dijetar me G. Vajgandin, Uotmon, Bariçin e të tjerë mendojnë për origjinën trake të shqiptarëve e të gjuhës së tyre; edhe Hans Krahe përjashton gurrën ilire për gjuhën shqipe. Të mendimit të Majerit e të Krecmerit janë në arë tjetër gjuhëtarë si Majer-Lybke, Tumb, Feist, Shvicer, Bartoli, Ribeco, Kapitan, historianë të mëparmë si Fallmeraiër, Hahn, Hertberg, e në ditët tona N. Jorga; ndërsa Karl Paçi

zbuloi gjurmë trakësh dhe në brigjet lindore të Adriatikut. dhe Jokli pranon që përveç ilirëve dhe elementi trakas ka pjesë në përbërjen e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, dhe edhe Nopça mendon për një sintezë të të dy teorive. Po bëhen dyqind vjet që kur historiani i Halles Johan Tunman e kishte rrokur këtë problem si duhet, dua të them në lidhje të gjuhësisë me historinë, duke i treguar kështu dijes rrugën që duhet të kishte ndjekur më vonë. Ne mendojmë se toponimia historike e Shqipërisë dhe e krahinave përreth dëshmon në një mënyrë të prerë për autoktoninë e shqiptarëve në truallin e tyre të sotëm gjë që vërteton implicite burimin e tyre nga ilirët. Kreçmer mendimit të tij i ndenjtji besnik gjer në fund. Ai iu mbajt atij dhe në botime të mëpastajme rreth prehistorisë gjuhësore të Ballkanit.

Kështu shprehet ai dhe në libërthin *Ditunija gjuhësore indogjermane*. Ky studim, i hartuar nergut për arsimtarët shqiptarë, nën shtysën e Paçit që përuroi një seri botimesh albanistike në Sarajevë, doli së pari shqip, më 1923, në Tiranë. U botua pastaj dhe gjermanisht<sup>1</sup>, e më vonë dhe në spanjisht.<sup>2</sup> Kreçmeri edhe nëpër artikuj të ndryshëm është marrë disa herë me problemet e shqipes, në lidhje sidomos me historinë e greqishtes. Vendoset kështu afëria e fjalës, *bar* me gr. *pharmakon* ajo e *det-it* me gr. *dybris*, «thalassa», ajo e *ditë-s* me *Titan* si «hyjni e dritës», burimi i emrit të malit *Malevos* në More nga shq. *maleve* etj.

Gjuhëtar i lindur, Kretçmeri ka qenë i caktuar për këtë degë të dijes me anë të një gatitjeje solide e të shumanshme. Me njohuri të gjera në fushat e gjuhëve më të ndryshme dhe i pajisur me një fuqi kombinacioni jo të zakonshme, ai ka ditur të ushtrojë në anë tjetër një gjykim të mprehtë në gjithë kërkimet e tij, dhe të japë një ndriçim të gjithanshëm të çështjeve që ka rrahur. Shkrimet e tij, të bazuara dhe në një material të pasur, shquhen kështu për një gjerësi horizonti, një qartësi e një frymë objektive të rrallë. Ai mbetet një nga klasikët e gjuhësisë, një nga ata dijetarë që kanë formuar një sistem dhe që në punën e tyre kanë arritur në rezultate që do të mbeten.

1) Die indogermanische Sprachwissenschaft. Eine Einführung für die Schule, Göttingen, 1925.

2) P. Kretschmer y N. Hrozny, Las Lenguas y los pueblos Indoeuropeos, Madrid, 1934.

## 9. MAKSIMILIAN LAMBERC NË 75-VJETORIN E DITËLINDJES\*

Më 27 korrik të këtij viti, dijetari gjerman Maksimilian Lamberc kremton 75-vjetorin e ditëlindjes së tij.

Bashkë me shkencën përparimtare gjermane, 75-vjetorin e M. Lamercit e kremton edhe shkenca shqiptare, sepse në studimet e tij bota shqiptare mund të themi se ka zënë gjithë kohën vendin e parë.

Lamerci i është afruar fushës së studimeve shqiptare duke ardhur nga bota klasike. Kërkimet e tij tregojnë një përzjerje të lumtur të gjuhëtarit, të folkloristit e të letrarit. Në këtë mënyrë ato na dalin përpara të shumanshme e të plota, si dëshmia e një njësie mendore të veçantë. Prandaj ato janë bërë tërheqëse për qarqe shkencore të gjera dhe kanë zgjuar interesin e kërkimtarëve të fushave më të ndryshme të albanistikës.

Nuk është vendi këtu dhe as që është në kompetencën tonë, të rrokim tërë veprimtarinë e këtij dijetari të shquar. Përsa i përket gjuhësisë shqiptare, gjurmimet e tij përfshijnë më pak etimologjinë e gramatikën historike se sa më fort sintaksën, leksikografinë e sidomos dialektologjinë. Pa mundur këtu as të çekim studimet e tij në këtë fushë, nga sintaksa mjafton të përmendim monografinë *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe*,<sup>1</sup> një punë pionieri në një truall aq të papunuar. Kërkimet dialektologjike të Lamercit përfshijnë jo vetëm Shqipërinë, po edhe kolonitë shqiptare. Ato janë me vlerë të

---

\*) BSHSH, 2/1957, f. 127-130.

1) Die hypothetische Periode in Albanischen. Indogerm. Forschungen 34(1914/15), 44-208.

madhe për këtë degë të dijes, sepse nuk janë fryti i një pune në tryezë, po kanë dalë prej hetimesh të palodhura në terren. Në punimin e tij, *Kumtim për studimet e mia linguistike në Shqipëri nga mesi i muajit maj gjer në fund të gushtit 1916*, botuar nga Akademia e Shkencave të Vjenës<sup>1</sup>, hiqen tiparet kryesore të disa ligjërimeve të Shqipërisë veriake, aty ravizohen për të parën herë edhe vijat e një ndarjeje të gegërishtes në nën-dialektet e saj. Një interes të veçantë paraqesin kërkimet e tij rreth historisë edhe gjuhës së kolonive arbëreshe të Italisë mbeturinat e gjalla të toskërishtes së moçme. Këtyre ai u ka kushtuar një varg studimesh. Në këto trajtohet të folurit e tyre, e gjurmohen këto nga ana e ndërtimit gramatikor dhe e leksikut, duke sjellë përveç kësaj dhe disa copë, të panjohura me parë, të poezisë së tyre, mbledhur drejtpërdrejt nga goja e popullit.<sup>2</sup> Pasi ishte marrë kaq vjet me dialektet e shqipes, ai në kohët e fundit na ka falë dhe një vështrim të përgjithshëm të këtyre, duke vizatuar tiparet që i karakterizojnë këto dhe ato që i veçojnë njërin nga tjetri.<sup>3</sup> Në punimet albanistike të këtij dijetari nuk mund të lihen pa përmendur pastaj një radhë librash hartuar me qëllimin praktik të mësimit të shqipes, disa nga këto në bashkëpunim me të tjerë dijetarë.<sup>4</sup> Duhej të hynte këtu edhe «*Libri i leximit të shqipes*», hartuar më 1949<sup>5</sup>: po këtu thellimi i çështjeve dhe artikujt e veçantë që janë ngjitur si shtesa bëjnë që kjo vepër dy blësh t'i kalojë caqet e një libri të leximit e të bëhet një vademekum për gjithë ata që duan t'i hyjnë mësimin të gjuhës e të literaturës sonë. Fja-

---

1) Bericht über meine linguistischen Studien in Albanien von Mitte Mai bis Ende August 1916. Anzeiger der Kais. Akademie der Wissenschaften. Phil. — histor. Kl. 1916.

2) Albanische Mundarten in Italien. Indogerm. Jahrbuch. II (1915) 1-30 Italoalbanische Dialektstudien. Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung 51 (1922) 259-290; 52 (1923) 43-90; 53 (1925) 66-79, 292-307.

3) Die Mundarten des Albanischen. Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa 7 (1943) 123-160. Ribotim i ndryshuar te Alb. Lesebuch I 12-31.

4) P.sh. Lambertz-Pekmezi, Lehr-und Lesebuch des Albanischen, 1913.

5) Albanisches Lesebuch. Mit Einführung in die albanische Sprache, 1948.

lori shqip-gjermanisht tani së voni<sup>1</sup> i pasur me lëndë të re e me frazeologji, nuk synon plotësi, po u hartua me qëllimin e caktuar për të kuptuar shkrimet literature të shqipes. Në këtë drejtim punimesh hyn më në fund edhe pjesëmarrja e puna e tij gjatë Luftës së Parë Botërore në «Komisinë letrare të Shkodrës», e cila, sikundër dihet, vuri themelet e ortografisë së shqipes.

Në veprimtarinë shkencore të Maksimilian Lambercit një vend kryesor zënë botimet rreth folklorit e, veçanërisht, rreth poezisë popullore në vështrimin më të gjerë të kësaj fjale. Me këtë punë në përgjithësi, ky dijetar pa dyshim zë kryet e vendit në këtë lëmë studimesh. Shkrimet e tij edhe këtu nuk janë përfundimet e shpejta të kërkimeve të rastit, ato janë pema e pjekur e përpjekjeve shumëvjeçe e me dashuri të madhe për lëndën. Monografia *Poezia popullore e shqiptarëve, një studim hyrjeje*,<sup>2</sup> doli së pari te gazeta *Posta e Shqipnis* e pastaj si libër më vete. Është i pari botim përmbledhës që kemi për këtë temë. Në të trajtohen farët e ndryshme të këngëve. si këngë trimash, këngë dashurie, këngë dasme, këngë e vargje femijësh, ligje e vajtime, gojëdhëna etj. Shqyrtohen ndër të tjera metrika e këngëve dhe mënyra e recitimit të tyre nga ana e këngëtarëve. Folklorit në prozë i kushtohet botimi *Përralla shqiptare e të tiera tekste të folklorit shqiptar* botuar më 1922.<sup>3</sup> Kjo vepër është themelore për njohjen e përrallës popullore shqiptare. Si shtrohet bibliografia e plotë e botimeve rreth përrallave tona gjër në atë kohë, përshkruhen e shpjegohen figurat që dalin në këto përralla, paraqiten temat që janë trajtuar në to, bashkë me motivet e vecanta. Jepet një pasqyrë e formës së përrallës, e mënyrës si nis e si mbaron, vëzhgohen dhe veçoritë gjuhësore. Viojnë pastaj tekstet origjinale, mbledhur prej autorit nëpër krahinat e ndryshme të vendit tonë. Me mënyrën krahasimtare si është shikuar lënda në të. Ky libër mund të thuhet se i kapërcen caqet e shqipes. ai ka vlerë të qëndrueshme edhe për studimin e përrallave

1) Lehrgang des Albanischen. Teil I. Albanisch-deutsches Wörterbuch, 1954.

2) Die Volkspoesie der Albaner. Eine einführende Studie, 1917.

3) Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde. Schriften der Balkan-Kommission der Akademie der Wissenschaften, Wien, 1922.

të mbarë popujve të Ballkanit, si një burim kryesor për vëzhgime të mëtejme. Lamberci fillin e përrallës shqiptare nuk e këputi me kaq. Ai e ndoqi më tej: me librat gjermanisht *Midis Drinit e Vjosës, Përralla prej Shqipërie* (1922), *Nga Briri i artë. Përralla greke të mesjetës* (1922), *Motra me krahë dhe të Errëtat e dheut* (1925), e me të tjera botime.<sup>1</sup>

Në kohët e fundit ky dijetar i ka kushtuar një monografi të gjerë ciklit të Mujit e të Halilit, këngëve të kreshnikëve që këndohen në Veriun tonë.<sup>2</sup> Ky studim shquhet për paraqitjen e gjallë të atmosferës ku lëvizin figurat epike. Më anë tjetër, të habit analiza e thellë e gjithanshme që i bëhet mjedisit shqiptar nga kanë dalë këto këngë, mjedis që autori e njuh më së miri. Karakteristika e heronjve, rrëmbimi i grave, ditët e martesës, gostitë, atllarët, të dalët në çetë, bejlegjet, armët, zakonet e lashta shqiptare, premtimet, vrasjet, vëllamia (probatinia), kumbaria, lahuta, kuvendi i pleqve, gjaqet, dashuria motër e vëlla e vëlla me vëlla, besa e pabesia e grave, pritja e mikut, vajet, kullat, qendrat gjeografike, bjeshkët, tartari, motivet e këngëve, zogu si lajmës, shtazët si ndihmëtare, qeniet e mbinatyrshme të besimit popullor si orë e zana, tradhtia, mrekullitë, simbolika e numrit, bukuria e vashave, motivi i dredhisë, hiperbolat, hyritë marrë nga natyra, forma e metrika e këngëve, rima, ndërtimet emfatike, prolisiteti, përsëritjet, gjuha e stili, krahasimet, betë, formulat stereotipe, këto janë disa nga elementet kryesore që merren në shqyrtim në këtë vepër. Asgjë që të jetë qenësore nuk ka mbetur pa u rrahur në të. Kështu kjo përbën trajtimin gjer sot më të plotin të këtij kapitulli të poezisë sonë popullore, e bashkë me përrallat shqiptare paraqet gjer më sot kryeveprën e këtij dijetari. Krahasimet me poemat epike të popujve të tjerë të Evropës ia shtojnë vlerën asaj. E përkthimi gjermanisht i 19 rapsodive, që jepet në pjesën e dytë, i jep mundësi botës së jashtme të njihet drejtpërdrejt me eposin popullor shqiptar. Kështu,

---

1) Zwischen Drin und Vojussa. Märchen aus Albanien, 1922, Vom goldenen Horn. Griechische Märchen aus dem Mittelalter, 1922. Die geflügelte Schwester und die Dunklen der Erde, 1922.

2) Die Volksepik der Albaner. Der Zyklus von Mujo und Halil I, II, Wissenschaftliche Zeitschrift der Karl-Marx-Universität. Leipzig 4. Jahrgang 1954-55. Gesellschafts- und sprachwissenschaftliche Reihe. Heft 3, 4, 5.

pra, me anë të këtij studimi poezia epike shqiptare hyn e zë vendin e saj brenda poezisë së popujve të tjerë të Evropës.

Krahas me poezinë popullore Lamberci ka ndjekur me vëmendje të paprerë edhe zhvillimin historik të literaturës sonë artistike. Edhe këtu ai ka hapur rrugë të reja. Në librin *Midis Drinit e Vjosës*, si dhe në një artikull të mëvonë të tij<sup>1</sup>, gjeneza e zhvillimi i literaturës shqiptare vështrohet në një mënyrë origjinale në prizmin e disa qarqeve më vete, para se të arrihet në një literaturë nacionale. Kjo literaturë ndiqet pastaj hap për hap gjer në ditët tona.

Në krestomatitë *Libri i leximit të shqipes. Mësimi i shqipes II Krestomati e Shqipëria rrëfen* botuar tani së fundi.<sup>2</sup> jepen copë të zgjedhura nga të literaturës popullore e artistike — të vjetër e të re — shpeshherë me komentare. Nga prodhimi literar i arbëreshëve të Italisë, *Gjella e Shën Mëris Virgjër* e Jul Varibobës (1762) e ka tërhequr prej shumë vjetsh dijetarin tonë. Veprës së këtij poeti ai i ka kushtuar një punim të veçantë.<sup>3</sup>

Me rastin e 75-vjetorit të ditëlindjes së tij redaksia e «Buletinit për shkencat Shoqërore», në emrin e saj e të punonjësve të shkencave shoqërore i uron Maksimilian Lambercit jetë të gjatë e pleqëri të bardha, fuqi pune të palodhur si gjer tani, që t'i falë dijës. e albanistikës veçanërisht. edhe të tjera studime me horizonte të reja. Në Shqipëri përfundimet e veprës së tij shkencore janë një farë që ka rënë në një tokë pjellore, që jep, e që nesër ka për të dhënë edhe më shumë pemë. në të mirë të studimeve albanistike te ne.

---

1) Das Werden der albanischen Literatur, Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa 7 (1943) 160-174. Ribotim i ndryshuar e Alb. Lesebuch I 373-387.

2) Lehrgang des Albanischen, Teil II. Albanische Chrestomathie, 1955. Albanien erzählt, 1956.

3) Giulio Variboba, Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung 74 (1956), 45-122, 185-224.

## 10. KËNGA E LENORËS NË POEZINË POPULLORE SHQIPTARE\*

Kënga popullore që rrëfen se i vdekuri për të vënë në vend fjalën e dhënë për së gjalli, ngrihet nga varri e vete merr të gjallën, quhet në literaturën popullore kënga e Lenorës. Emrin kjo e ka marrë nga vjersha e famshme Lenorë e poetit gjerman Byrger (1747-1794). Mbi përhapjen e saj në këngët popullore të popujve të Ballkanit flet Karl Krumbacheri në *Historinë e literaturës bizantine* f. 831. Shiko edhe Talviñ, *Këngë popullore të serbeve*, 1 295 (Jelica dhe të vëllezërit). Dozonin, *Chansons populaires bulgares*, 130, Leskienin dhe Brygmanin, *Këngë popullore dhe përralla lituane*, 497, Psiharin *La ballade de Lénore en Grèce*, Paris, 1884, Fauriel-Müller, *Këngë popullore greke*, II, 65 dhe 96. Një studim të thellë e të imët mbi variantet e kësaj kënge në poezitë popullore të Ballkanit e ka kryer dijetari bullgar Shishmanov në revistën *Indogermanische Forschungen* 4 412-48. Në këtë skicë të vogël të *Normalistit* do të merremi me këngën dhe variantet e ndryshme të saj në poezinë tonë popullore. Maksimilian Lamerci e ka trajtuar këngën e Lenorës gjerë e gjatë në veprën e tij themelore, *Përralla shqiptare*, f. 70-73. Mbasi ky dijetar siç thotë vetë, nuk mundi e gjeti ndonjë variante të këngës në Shqipëri vetë, vërejtjet e tij pra i bazon në variantet e kolonive shqiptare të Italisë. Këto versione gjinden te Jeronim de Rada, *Rapsodie d'un poema albanese* 29 e te Dhimitër Kamarda, *Appendice alla grammatologia comparata sulla lingua albanese* 98 vv, me dy variante. Do shtojmë tani dhe një variante të re prej Piana dei Grecit në Sicili, të botuar prej Zef Skiroit në veprën e tij

---

\*) Marrë nga *Normalisti*, Nr. 6/1934, Elbasan.



monumentale *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia* 1923, f. 44-50.

Variantet italo-shqiptare që përmendëm, rrëfejnë se një nënë pat nëntë djem, më i vogli u quhej Kostandin, dhe një bijë me emër Garentinë, te Skiroi Doruntinë. Mbas dëshirës së Konstandinit Garentinën e martojnë larg e larg, e ai i zotohet s'ëmës se në çdo rast do t'ia sjellë Garentinën në shtëpi. Mirëpo në një luftë që bëhet, i vdesin asaj nënë të nëntë bijtë, dhe ajo, e mbetur dhe pa bijë, shkon te varri i Kostandinit dhe i përflet këtij besën e dhënë. Natën çohet Kostandini nga gropa, vete merr të motrën dhe ia shpie s'ëmës. Ai futet prapë nën dhe. Nënë e bijë piqen e vdesin të dyja në një përçafim të fundit nga malli dhe nga helmi.

Emri i motrës, Garentina, është, sipas Lambercit f. 71. një formë e ndryshuar e emrit të motrës në këngët greke të vëllait të vdekur, ku ajo quhet Areti (virtyt), dhe Garentina është nominativi i shquar i trajtuar prej akusativit grek Aretin. Shton Lamberci se në një version në prozë që ndodhet te *Bleta Shqiptare* e Thimi Mitkos, f. 189, motra nuk ka emër, vëllai quhet Kostandin si ndër italo-shqiptarët.

Lamberci vëren dhe disa karakteristika të përbashkëta që kanë variantet italo-shqiptare me ato greke e bullgare. Numri i vëllezërve është nëntë (te Skiroi — dymbëdhjetë). Thotë dhe G. Vajgandi (*Aromunët* II 130) se numri nëntë luan në besimet e popujve të Ballkanit një rol aq të madh sa dhe te gjermanët. — Në variantet që njeh Lamberci nuk është murtaja që rrëmben vëllezërit sikurse në variantet greke thanatikó-ja. po lufta. E ëma nuk e mallkon të birin, as e lë djerrë varrin e tij, sikurse në variantet greke e bullgare. po përkundrazi, në ditën e të vdekurve ajo në varrin e gjithë bijve ndez nga një qiri dhe derdh nga një vajtim, te varri i Kostandinit ndez dy qirinj e derdh dy vajtime. Në ndryshimin e gurit të varrit në një kalë dhe të hekurave të varrit në një fre, tekstet shqiptare bashkohen me shumicën e teksteve të tjera të Ballkanit.

Lamberci përsërit në veprën e shënuar porosinë e Shishmanovit që duhet kërkuar përhapja e gojëdhënës në Shqipëri e sidomos në krahinat që pihen me viset sllave e greke. Me të vërtetë, balada jonë këndohet edhe sot në shumë anë të Shqipërisë. Në gazetën *Ora e Maleve* (1924) gjendet një variant nga Zagorjeja e Përmetit, në *Hyllin e Dritës*. në një numër që dora-dorës nuk mund ta përcaktoj. është një variant prej Ve-

riut, si dhe në *Lekën*, prill 1933, me emrin Alija i Vogël. Pothuaj gjithë krahinat shqiptare e mbajnë të gjallë këtë këngë. Mbi një anketë që bëra ndër nxënësit e klasave të epërme të Normales së Elbasanit, nxënësi z. Dhimitri Grillo pati mirësinë e më dha një variante të këngës si këndohet në katundin e tij Vuno të Himarës:

«*Qe një mëmë,  
Kish nëndë djem,  
Mori nëndë nuse,  
E vdiqën të nëndë diemtë  
E iknë të nëndë nuset  
Qaj<sup>1</sup> mëma djemtë:  
«Ikë bushtrë e murtajë  
Që më përmise nëndë djepë  
E më humbe nëndë dyfeqe  
E më kërreve nëndë nuse,  
Mos u treç, o Koço,  
Martove Dhoqinëë  
Lart e lart e në Misir,  
Dëshëroj ta sho me sy»  
Pshoj Kost i vogëlë,  
Një shqelm i dha dërrasesë  
E vate lart e në Misir,  
Tek luan Dhoqina valle.  
«Miserdhe, o im vëlla».  
«Mirsetëgjeç, o ime motrë».  
«Në më erdhe për të mirë  
Të nisem si arçë nuse.  
Në më erdhe për të keqe  
Të nisem si kallogrinjë».  
«Nisu motrë si zu hera  
E mos ajde të kërkosh të tjera».  
Shkoj Kosta përpara.  
Erdh' e erdhë përmes udhe:  
«Shko motro përpara».  
Këndon një zog xulluverdhë<sup>2</sup>*

1) Qaj = qante, thuhet dhe në Piana dei Greci në Siçili.

2) Xhulluverdhë = xullufe-verdhë, xullufe: Një koco flokë në tëmblat, xhufkat e kallinjvet, Gustav, Meyer Fjalor 442.

*Eqrem Çabej*

«Ecën i gjalli me të vdeknë».

*Vate bija në shtëpi:*

*«Ape nëno derënë,*

*Se jam Dhoqina e vetëmë».*

*«Ik, o bushtrë e murtajë*

*Që më shove nëndë dyfeqe,*

*Më përmise nëndë djepe*

*E më kërreve nëndë nuse».*

*E tëk e me të hapurë*

*E tëk e me të puthurë*

*E tëk e me të plasurë.*

Në këtë variant duhen bërë këto vërejtje: Rrëfimi e përshkrimet janë mjaft lakonike, kënga duket të jetë e shkurtuar. Numri i djemve është nëntë, dhe këta vdesin nga murtaja si në variantet greke dhe në një variante aromune prej Krushevo botuar te Weigandi *Aromunët II*, 158-162. Djali quhet Koço. Kostë, emër i shkurtuar, hypokoristik i Konstandinit. Emri i vajzës është Dhoqinë, e ky emër është femërorja e adjektivit grek *dhókimmos* «i zoti, i aftë, i shquar», sikurse Garentina vjen prej greq. *Aretí*, «virtyt». Dhoqina martohet «lart e lart e në Misir». Vërejmë edhe këtë se si në variantet bullgare e greke, nëna e mallkon te varri të birin, («mos u treç, o Koço») të mos tretet në dhe. — Dialogu i shkurtër midis motrës e vëllait është si në variantet italo-shqiptare e greke. Në dialogun nënë e bijë, në besimin e nënës që s'është e bija që trokëllet te dera, po vdekja, në përçafimin e përmallshëm nënë e bijë, variantja jonë e Himarës afrohet me ato të De Radës. Kamardës e Skiròit prej Italie. Shpjegimi qëndron në afrimet që ka Himara me shqiptarët e Italisë në pikëpamje folklori dhe dialektore. Së fundi është për të vërejtur te kjo variante e Himarës dhe afërsia me sferën e poezisë fqinje të grekëve. Për këtë flasin murtaja e jo lufta si shkak i vdekjes së vëllezërve, flasin emrat Konstandin e Dhoqinë, mallkimi i Kostës së vdekur nga e ëma, dhe motivi i zogjve që këndojnë rrugës.

Varianti i dytë që paraqesim më poshtë m'u këndua nga bariu Vad Marashi prej Berishe në Pukë:

*Nan vllazën in pa kan*

*E kin pas ni motr pr mall.*

*Vllau i mall ç'ja paska than*

## Eqrem Çabej

Nan dit larg motrën m'e dhanë  
Çka ka than Halili i nrmjemi:  
«Hajt moj motr e mos ki dert:  
Kur t'i mushish i muëj<sup>1</sup> dit e net  
Vjen Halili e m'tparn ty t'merr».  
Kur jam mush i muëj dit e net  
Shikjon motra prej vilatit<sup>2</sup> s'vet.  
Besa-besë kurrkush s'i erdh.  
Po del motra po bërtet.  
Po del motra fort po kqyr,  
Tek p'e shen<sup>3</sup> ni zog pr'qiell:  
«Amanet mori korbi i zi,  
Kur të shkojsh në vilatin tem,  
Thuëj Halilit hajde me m'marr.  
Thuëj Halilit hajde me m'marr,  
Ku kie<sup>4</sup> besën si<sup>5</sup> ma kie dhan?»  
Ç'at-here zogu a fillue,  
Nan cop bjeshk i ka kalue.  
M'gur tuk vorri i paska çue:  
«Motra jote fjal t'ka çue.  
Motra jote ça ka than;  
«Ku e kie besën si ma kie pa dhan?»  
Iz tu zoti te ka marr,  
Izen Zoti se i ka dhan  
Besn e Zotit mos me e lan,  
Besn e Zotit mos m'e harrue,  
Shpejt e shpejt e m'kam a çue:  
Shtrëngoju gjokun, asht fillue,  
Nan cop bjeshk i ka kalue,  
Bash tuk miku paska shkue:  
«Çou moj motr me u shtrëngue».  
«Prit bre vlla i kafe me e 'rdhnue».

---

1) Diftongu geg *ue* shqiptohet këtu si *uë*. në Kastrat midis *uo* e *ua*, në fund të versit, si ç'shihet, shqiptimi është *ue*.

2) *vilat-i* Vadi ma shpjegoi = gjind, d.m.th. njerëzit e vajzës. Fjalë turke.

3) *shen* = sheh.

4) *kie* = ke, i shqiptohet pak.

5) *si*: përemër relativ = që, qi. Si dhe në disa nuham të Shkodrës, si dhe në Malësi.

## Eqrem Çabej

«Jam pâgrêshim e kafe s'due».  
Kan marr rrugën e jan fillue.  
«Hajt Halil ni her me knue».  
«Shuj<sup>1</sup> moj motr zoti t'vraft,  
Se muë zani m'u ka çart».  
«Ç'ka kan zojt Halil si po flasin<sup>2</sup>  
Thon: «Qysh hec i vdekni me t'gjallin?»  
Shuj moj motr Zotyn të vraft,  
Nuk kan zojt tjetër zanat.»  
«Shka kan kullat Halil si jan vrugnue?»<sup>3</sup>  
«Shuj moj motr Zoti të vraft,  
Se nân vllazën si jena kan  
Nan pal dāzēm n'te kem bâ,  
Se nân nuse i kena marr,  
Treqint krushq miku<sup>4</sup> na i pruni.  
T'bardhen li me ta e pruni.  
E bardha li kân ka kân.  
Kemi nan vllazën, na ka myt te tan.  
Besn e Zotit s'e kiesh lân.  
Besn e Zotit s'e kiesh harrue.  
Fillo motr n'shpi me shkue,  
N'baçe gjokun duë m'e çue».  
Kur dul motra (tha) n'shtek t'oborrit  
Na i duël nana në shkall të kullës.  
«Ti bij qyqe me ka ke ardh?»  
«Shuj moj nân, u qyqja mos kosha,  
S'un kam ardh me Halilin tem».  
«Aj Halil bij qyqja ka dëk,

---

1) hesht = shuk te Rosi, G. Majer, Fjalor. 419. Vjen prej thirrjes sht!

2) fl. pl. dl bëhen fj. pj. bj në Pukë, Dibër, Mirditë, ndofta dhe gjet-kë. Këtë nderim e gjejmë dhe te shqiptarët e prov. Gozenza, Kalabri.

3) «pjuhne» (Vad), d.m.th. pluhurosur.

4) miku = d.m.th. ana e nuses. Fjala «mik» për anën e nuses shpjegohet nga natyra agnatike e familjes shqiptare. Shiko Jokl Li-ku. Unters. 16.

*Eqrem Çabej*

*Sojd i mushi pjot tet vjet».  
Kan marr shkallën tu u gjit prpjet.  
Ngryka ngryka nân e bij kan dek.*

Vërejtje: Emri i vëllait është Halil, ky emër është marrë sigurisht hua nga cikli i Mujit e i Halilit. Ai nuk është vëllai më i vogël, po i mesmi, «i nrmjemi».

Numri i vëllezërve është nëntë; nëntë palë dasmë bëhen dhe nëntë nuse merren. Numri nëntë përshkon gjithë këngën, nëntë ditë larg martohet motra, zogu lajmëtar kalon nëntë copë bjeshkë sa arrin te varri i Halilit, nëntë copë bjeshkë kalon dhe Halili kur vete e merr të motrën.

Vdekja e të nëntë vëllezërve shkaktohet jo nga lufta si në variantet italo-shqiptare, po nga e bardha li që e prunë të treqind krushqit e dasmës.

Një ndryshim i rëndësishëm i kësaj variante nga të tjerat shqiptare, është ky, që roli i nënës këtu humbet krejt. Jo kjo e zgjon Halilin nga gjumi i rëndë i vdekjes, po motra është ajo që i dërgon lajm të vëllait të vijë ta marrë. E lajmëtari është kërbi i zi; ky merr rolin e mëmës e vete e çon Halilin nga varri.

Dialogu motër e vëlla është i gjatë. Ajo i ofron këtij kafe pas zakonit, e rrugës e lut «ni her me knue», si ç'është zakoni që këndojnë malësorët kur udhëtojnë këmbë a mbi kalë. Po ai refuzon e i përgjigjet se iu ka «çart zâni». Këtu përsëritet motivi i zogjve që këndojnë rrugës, ashtu si në variantet e Vunoit, të Mitkos dhe te grekët. Së fundi motra e pyet Halilin pse muret janë «vrugne», janë mykur e pluhurosur, ashtu si e pyet motra Kostandinin në rapsoditë e De Radës. Atëherë Halili i rrëfen gjithë të vërtetën e vdekjes së vëllezërve.

Nuk kam në dorë ndonjë këngë serbe të Lenorës, prandaj nuk mund të them se a ka ndonjë lidhje kënga jonë e Pukës me këngë sllave. Në një kohë të afër rezervoij ta studioj edhe një herë e më imtas këngën e Lenorës, këtë pjesë interesante të poezisë sonë popullore.

**Shënimi:** Emri Dhoqinë është trajta akusative e emrit Eudokja.

## 11. KOSTANDINI I VOGËLITH DHE KTHIMI I ODISEUT.\*

Një nga këngët më të përmallshme të shqiptarëve të Italisë dhe një nga pjesët më interesante të poezisë popullore ballkanike të krahasuar është kënga e Konstandinit. Konstandini i vogëlith duhet të niset, tri ditë dhëndër, në luftë. Pasi merr uratën e prindërve, ky porosit të shoqen ta presi nëntë vjet e nëntë ditë. Perënduar nëntë vjet e nëntë ditë, kjo është e lirë të mar-tohet me tjetër. E shoqja e pret; por pasi shkojnë vitet dhe ditët, kjo vete në kishë të vërë kurorë të re. Konstandini sheh një ëndërr të keqe dhe kthehet me vrap në vendin e tij. Ai rend në kishë dhe e gjen të shoqen tek po vë kurorë me burrë tjetër. Ay e rrëmben të shoqen nga mesi i krushqve dhe këtu mbaron kënga e Konstandinit.

«Kjo balladë», thotë L a m b e r c i në veprën e tij «Përralla shqiptare f. 67 «ka marrë karakter ritual ndër Shqiptarët e Italisë jugore. Këndohet në çdo martesë. Pas gostisë ngrihen prej tryezës gjithë dasmorët, burra e gra, formojnë një rreth, vënë në mes të rrethit dhëndërin me nuse, dhe duke ardhur rreth çiftit, këndojnë këtë *valle*, si ç'thuhet në shqip vallja bashkë me këngën që e përcjell. Është një lavdërim poetik i besës së gruas së martuar.

Konstandini është heroi kryesor i poezisë popullore të italo-shqiptarëve. Ay është edhe sot i gjallë nëpër rrëfësat e tyre. Te Hora e Arbreshve (Piana dei Greci) në Sicili dëftojnë edhe sot në kishën e vjetër të Shën-Gjergjit një vend të gro-puar në një gur të shkallës, ku ka shkelur thundra e kalit të

---

\* Marrë nga *Hylli i Dritës* vjeti XIV, 1938, nr. 2-3.

Konstandinit, kur ky hyri në kishë për të marrë sërish të shoqen.

Dihet se kënga e Konstandinit të vogëlith ekziston me të njëjtën përmbajtje edhe në Shqipëri. I ndjeri prof. Xhuzepi Skiro ka qenë i pari që konstatoi këtë paralelë. Në viset veriore shqiptare heroit quhet Aga Ymeri, në Lumë — Imer Aga; në Toskëri Ymer Ago, në jug, me shqiptimin të *y*-së dhe të *i*-së në *i*, Imer Ago janë epiteti, i rrjedhur nga titulli social turk aga, titull që u jepej oficerëve duke filluar prej majorit, si dhe disa funksionarëve civilë.

Titulli aga është i lidhur ndër ne me një pasuri tokësore ose me një gjendje ekonomike përgjithësisht të mirë të atij që e mban këtë titull. Që emri Ago i Ymer Agos nuk është tjetër veçse titulli aga, kjo dëshmohet edhe nga një vers i varianteve toske, ku thuhet: «Pshërëtimi Ymer Agaj»!

Afërsia që lidh Konstandinin e vogëlith me variantet e Shqipërisë është e madhe sidomos midis varianteve italo-shqiptare dhe versioneve toske. Kjo shpjegohet nga origjina më shumë toske e italo-shqiptarëve. Kjo afërsi është aq e ngushtë, sa nuk kufizohet në disa vija paralele të përgjithshme, por shtrihet dhe në detaje. Kështu shohim gjer verse identike te kënga e Konstandinit dhe te kënga e Ymer Agos.

Ndryshime themelore pra nuk gjenden as në figurën e heroit e as në përmbajtje të këngës. Ndryshimet janë ndryshime kronologjike dhe kulture. Në emrat Konstandin i vogëlith dhe Aga Ymer me titullin Aga ne shohim influencën turke islame: gojëdhëna e vjetër vazhdon të jetojë, por emri i heroit islamizohet. Heroi vesh rrobën osmane dhe quhet Ymer Ago. Ky emër duhet të jetë më i ri se Konstandin i vogëlith.

Përsa i përket tashti Konstandinit të vogëlith të italo-shqiptarëve, *Lamberci* f. 48 v. vëren që, «personi Konstandinit është një reminishencë e Mikros Konstandinos. Konstandinos o Mikros. d.m.th. Konstandin i vogël, i këngëve popullore greke: këtë e morën pra italo-shqiptarët me vete. me kalimin e tyre prej Moresë për në Itali. Mikros Konstandinos është i biri i perandorit Andrenikos, i kënduar shpeshherë në këngët e Digenis Akritas. Meqenëse dhe i ati i Digenis Akritas quhet Andrenikos dhe meqë poezia popullore greke i ngarkon Konstandinit po ato aventura si dhe heroit Digenis Akritas, qëndron afër mendsh që Konstandini i vogëlith i ynë të



jetë një *akritikòn tragùdhi*, një këngë e ciklit të Digenis Akritas. Shqiptarët e Moresë që e prunë në Itali, bënë me të vërtetë disa modernizime: p.sh. Konstandinin e bëjnë të luftojë në shërbim të sulltanit» etj.

Në duam pra të përmbledhim shkurtazi ndryshimin midis Konstandinit dhe Ymer Agos, do themi që Konstandini i italo-shqiptarëve është një emër i sferës kulturore greko-bizantine. Ymer Agoja i Shqipërisë një emër i sferës Osmane. Që ka dhe paralele të tjera midis poezisë italo-shqiptare dhe greke-bizantine, shpresoj ta tregoj me një rast tjetër.

Zöuluam pra dy shtrete kronologjike të këngës, një më të vjetër grek-bizantin (Konstandin i vogëlith) dhe një më të ri turk-islamit (Aga Ymeri, Ymer Ago). Pyesim tani a mund të kënaqemi bashkë me Lambercin, duke vënë barazimin Konstandin i vogëlith Digenis Akritas, d.m.th. duke shikuar burimin e këngës italo-shqiptare në poezinë popullore greke-bizantine të kohës së mesme. Pyesim mos është Konstandini i vogëlith vetëm një veshje e krishterë e një figure të vjetër të kohëve pagane, ashtu siç është Ymer Agoja rroba islame e heroit të krishterë. Pyesim, pra, në mund të gjejmë ndonjë formë më të vjetër të kësaj figure.

Për mua një lidhje e këngës së Konstandin-Ymer Agos me mitin e kthimit të Odiseut në Itakë më qe prej kohe i qartë. Tani së fundi shoh te *P e t r o t a*. *Popolo, lingua e letteratura albanese*, f. 134 se i ndieri prof. Skiro e paska bashkuar këngën e Ymer Agos me këngën greke moderne, *Të njohurit*, ku gruaja njihet të shoqin e kthyer nga lufta tamam nga dy shenja të trupit të tij. Këtë këngë greke Ampère e Tomaseo e patën konsideruar si një kujtim të mbetur të kthimit të Odiseut.

Homeri rrëfen në librin e 23-të të Odisesë se si ky pas Luftës së Trojës dhe pas peripecive të tij të shumta kthehet më së fundi në atdheun e tij në Itakë. Midis kthimit të Odiseut dhe kthimit të Konstandin-Ymer Agos, ka, besoj, mjaft pika kontakti:

1. Odiseu nisët si burrë i ri për në luftë dhe lë në shtëpi gruan e tij të re e besnike Penelopën. Konstandin—Ymer Aga nisët si dhëndër i ri për në luftë dhe lë të shoqen besnike në shtëpi.

2. Pasi Odiseu 20 vjet me radhë nuk kthehet, Penelopës i mbledhen rreth një tok kandidatësh duke insistuar që të marrohet me njërin prej sish. Nusja e Konstandin—Ymer Agos e

pret të shoqin nëntë vjet e nëntë ditë dhe së fundi e shpëton ta martojnë me një tjetër.

3. Odiseu kthehet nga lufta, në fillim i panjohur prej njerëve të tij. Konstandin — Ymer Agua kthehet nga lufta dhe nuk e njohin as prindërit e vet.

4. Odisenë e njeh së pari mëndesha e tij; kjo pas zakonisht grek i lan këmbët mikut të huaj dhe atëherë e njeh Odisenë nga një shenjë që i kishte lënë në kofshë një derr i egër në një gjah. Gjithashtu, Penelopa i thotë të birit, Telemakut se: «Në goftë se ky është me të vërtetë Odiseu, dhe kjo shtëpia e tij, ne të dy do ta njohim më mirë njëri-tjetrin. Kemi disa shenja, të fshehura për gjithë të tjerët, që ne vetëm i dimë». Kështu e njeh e shoqja Konstandinin, dhe kur e njeh «e lotët m'iu rrukullisën sumbula, sumbula faqes kuqe, pikë pikë gjirit bardhë». Edhe Ymer Agën e njeh e shoqja nga një «nishan» që kishte në trup.

Vërtet që ky motiv i rinjohjes nga shenja e trupit është një motiv i përhapur pothuaj në përrallat e gjithë popujve; e gjejmë gjer te poema e vjetër ind *Ramajana*. Por kjo paralele midis Odiseut e Konstandin — Ymer Agos është aq më e shënuarshme kur të marrim parasysh dhe pikat e tjera të kontaktit që përmendëm më sipër dhe më poshtë (1, 2, 3, 5, 6).

5. Odisenë e tallin rivalët e tij dhe s'duan t'ia lëshojnë Penelopën. Ky fillon një luftë të egër me ta dhe i mbytet gati të gjithë në gjak — Konstandini u kërkon të shoqen krushqve në kishë. Kur këta ia refuzojnë i drejtohet shën-Mërisë, të mos e lerë, «të bëjë maqilë, të vrasij gjak e gjëri». Pra, ç'vepron Odiseu, Konstandini dëshiron të evitojë. Duhet vrojtur se situacioni psikologjik është këtu i njëjtë te të dy heronjtë.

6. Më rëndësi se sa pikat e mësipërme ka ky fakt gjeografik: Lokalizimi i mitit të Odiseut në Itakë do të thotë se Odiseu është më tepër një hero i Greqisë veriore, pra i një vendi që ka qenë në kontakt të përhershëm me fiset ilire-shqiptare. Paul Krecmeri, në veprën e tij: *Hyrja në historinë e gjuhës greke (Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache)*, f. 280, vv. është i mendimit se ata që shpunë emrin e Odiseut në Itali, kanë qenë fiset ilire. Helbig u kërkoj burimin e mitit të Odiseut te fiset barbare ose gjysmë barbare të Greqisë perëndimore. Edhe Krecmeri e pat peshuar një gjë të tillë. Ky dijetar thotë f. 281; «Odiseu kishte një orakël te Eyrutanet që nuk ishin grekë: mbi lidhjet e tij të ngushta me thesprotët dhe

mbi rolin e rëndësishëm që duket të ketë luajtur miti i tij në Epir të brendshëm, mbi këto ka tërhequr vërejtjen Wilamowitzi. Përralla e flakëve është epirote, se Skëria, prej skëros = continens, do të thotë, «kontinent», pra është sinonim me Epeiros. Një qytet i Kaonisë quhej *Baiake*, emër i trajtuar ashtu si *Itake*, me *b* të huaj për greq. *ph.* (*Phaiake, Pheake*). Për mua, bashkë me Eduard Majerin më duket vështirë të pranoj që një nga figurat më të gjalla të mitologjisë greke të ketë buruar nga popujt barbarë, sidomos kur grekët vetë nuk dinë gjë për një origjinë të tillë, grekët të cilët, p.sh., nuk e patën harruar kurrë origjinën trake të kultit të Dionizit».

Me këtë rast po përmendim se lufta rreth origjinës së errët të mitit të Odiseut është ndezur rishtas në vitet e fundit në një polemikë të ashpër midis Sigmund Faist dhe të ndjerit gjermanist të Vjenës Rudolf Muh, zhvilluar në të përkohshmen, *Wörter und Sachen*. I pari e deklaroi Odiseun shkurt një hero ilir, i dyti lufton për origjinën helene. Ne, pa i dhënë fund çështjes, theksojmë vetëm këtë se teoria e Faistit nuk na duket absurde, po të marrim parasysht zotësinë e madhe të frymës greke në të përkultur, të përvetësuar e të helenizuar, të kulleve të huaja. U-përmend më sipër se kultit i Dionizit është i origjinës trake.

Për dy nga perënditë që ne sot i shohim si greke tipike, për Apollon dhe Pellas Athenen, dyshohet origjina helene. Atëherë mundet që dhe Odiseu të ketë qenë i një origjine të huaj. Sidoqoftë një lidhje e afërt e kësaj figure me fiset ilire të Epirit nuk mohohet. Një provë janë dhe paralelet që besojmë se zbuluam midis Odiseut dhe Konstandin — Ymer Agos.

Përmbi vleftën dhe përkufizimin e mitologjisë së krahasuar mendimet janë të ndryshme, për arsye se nuk ekzistojnë kufi etnikë në krahasim të miteve të përbashkëta (Kreçmer). Midis popujve më të largët ekzistojnë shpeshherë analogji spontane ndër përralla e legjenda. Shoh se vepra e cituar e Kreçmerit f. 85 ka një gjasë të çuditshme midis mitit të Odiseut dhe të Orendelit në Gjermani, në të dy vendet një heró, i cili pas udhëtimit të gjata me det kthehet në shtëpi. te e shoqja, që e kanë rrethuar rivalë të këqij: kthehet i panjohur dhe i veshur si lypës, vret rivalët dhe bashkohet rishtas me të shoqen.

Një paralele më të çuditshme si me Odisenë dhe me Konstandin—Ymer Agon na e jep poezia popullore ruse: Në një

*byline* (këngë e vjetër epike) djaloshi Dobrynia, merr, tamam si Konstandini i vogëlith, uratën e s'ëmës dhe nisët për aventura luftarake. Para se të nisët, i thotë së shoqes Pamelfa Timofejevna që ta presë gjashtë vjet, pastaj pesë, e pastaj një vit, në vitin e tretë po të dojë le të martohet. E shoqja e pret dhjetë, pastaj martohet me Aleks Popoviçin. Me ta marrë vesh Dobrynia, kthehet me vrap në shtëpi. E ëma së pari nuk e njeh, por e njeh vetëm atëherë, kur ky, si Odiseu dhe Ymer Aga, i tregon nishanin që ka në këmbë të majtë. Dobrynia vete në dasmë të së shoqes së vet dhe gjen këtë në mes të krushqve, ashtu si Konstandin—Ymer Agoja të shoqen. Dobrynia e merr sërish të shoqen nga dasma dhe i fton krushqit në një gosti si ç'bën Konstandin Ymer Agoja ynë.

Nuk është këtu vendi të thellohemi mbi këtë argument. Vetëm duam të theksojmë këtë që poezia popullore shqiptare është aq e pasur në motive të vjetra, sa mund të hedhë dritë jo vetëm në mitologjinë e stërgjyshëve tanë paganë, por dhe në mitologjinë e krahasuar të popujve të vjetër e të rinj të Ballkanit.

Këto radhë ishin shkruar prej kohe, kur më ranë në dorë dy artikuj, të cilët merren dhe me temën tonë.

Në artikullin e tij, *Vom heutigen Stand der Illyrierforschung (Gjendja e sotme e studimeve ilire)* në *Revue Internationale des études balkaniques*, II<sup>eme</sup> annés, Tome I-II (314) në f. 27, dijetari hungarez Karl Kerenji shënon se prehistoriani i dëgjuar gjerman Karl Shuhard shikon te Odiseu «ilirin e vërtetë» sepse ky mbretëron mbi ishuj që janë të sferës ilire dhe dallohet me urtësinë e me gjakun e ftohtë të tij, prej heronjve të Iliadës «Gjithçka (te Odiseu) është detari, gjithçka luan në Mesdheun perëndimor, gjithçka është mënyrë jetese dhe legjendë ilire». Këtyre fjalëve të Shuhardit Kerenji u shton dhe disa argumente filologjike në f. 28 të së përkohshmes në fjalë.

Gjithë te kjo revistë e në të njëjtën numër merret me Odiseun edhe Milan Budimiri në artikullin *Vorgriechischer Ursprung der homerischen Haupthelden, (Rrjedhja paragreke e heronjve kryesorë të Homerit)* f. 195-215. Nga trajtat e emrit të Laertiadit, Odiseus dhe Odyxeus, Budimiri merr për më të vjetër trajtën Odyseus me *ks*, si formë të Greqisë veriperëndimore, prej nga rrjedh dhe heroit vetë. «Rrënjën — *dyx* — të Odyxeut mundim ta bashkojmë patjetër, në lidhje me karakterin krejt maritim të Laertiadit, me fjalën epirote — *daksa det*

## *Eqrem Çabej*

(te Hesyku), kështu që për Odiseun na jepet vetvetiu kuptimi i një apelativi, «detar».

**Përfundim:** Dijetarë të disiplinave të ndryshme, prehistorianë, historianë e linguistë, duke iu përveshur zgjidhjes së problemit të Odisesë, seicili me metodën e vet dhe ndryshe e pavarësisht nga njëri-tjetri, kanë marrë seriozisht ndër sy origjinën ilire të heroit të Homerit. Na vjen mirë të shënojmë se poezia popullore shqiptare mund të kontribuojë edhe kjo në zgjidhjen e disa problemeve homerike.

## 12. VATRA DHE BOTA NË POEZINË E DE RADËS\*

Duke kremtuar sot 150-vjetorin e ditëlindjes së De Radës, kombi shqiptar përkujton me këtë jo vetëm një nga njerëzit më të lartë të elementit arbëresh të Italisë, po njëkohësisht një nga ata burrat e rrallë që kanë vënë nga një gur themeltar në ndërtesën e kulturës shqiptare.

Jeronim de Rada e ka pasuruar literaturën tonë me një botë të re, me një tufë motivesh e figurash origjinale, të cilat kanë ringjallur një nga epokat më të lavdishme të historisë së popullit shqiptar, po mbi të gjitha me një poemë si *Milosaat*, një nga margaritarët e literaturës sonë. Ndërkaq, personaliteti i De Radës, për temperamentin e formimin e tij mendor e për disa kushte historike e sociale të veçanta, i kalon caqet e shkrimtarit. Ai përveç se poet i frymëzuar ka qenë dhe folklorist, gazetar, gjuhëtar, mësues, patriot në kuptimin më të lartë e më aktiv të fjalës. Shkurt, veprimtaria e tij ka diçka tërësore. Ajo përmbledhet në figurën e një apostulli të idesë nacionale, ide që gjatë shekullit XIX, përshkoi si një frymë e re popujt e Evropës, e në mënyrë të veçantë popujt e Evropës lindore e juglindore. Për të kuptuar këtë veprimtari në tërësinë komplekse të saj duhet shikuar prandaj personaliteti i poetit në hapësirë e në kohë, në mjedisin ku jetoi e u zhvillua dhe në shekullin që e leu e që e mori.

Arbëreshët e Italisë, të shkukur prej krahinash të ndryshme të Shqipërisë e të Moresë në një nga periudhat më dramatike të historisë shqiptare, kryesisht për të shpëtuar nga zgjedha e osmanëve, me atë ngulm në ruajtjen e dokeve të të

---

\*) Marrë nga J. de Rada, Tiranë 1965 (f. 50-55).

## Eqrem Çabej

parëve që karakterizon popullin tonë, kanë mbajtur të gjalla gjatë shekujve mbiemrat e familjeve, besimin, kostumet, vallet e këngët e lashta, gjithë tiparet etnografike që patën sjellë shtegtarët e parë në dhe të huaj, po mbi të gjitha gjuhën, e cila është tek ata një toskërishte e një tipi më të vjetër. Ata edhe sot, me gjithë se gjatë kohës të asimiluar nga shumë pikëpamje, paraqesin një pjesë bote ballkanike mu në mes të jetës latine. Është e natyrshme që kjo botë ku lindën e u rritën poetët e këtyre kolonive, u mbrujti shpirtin atyre dhe që për ta gurra kryesore e frymëzimit. Kjo është vatra shqipitare, është jeta patriarkale e katundeve arbëreshe, jeta e përditshme nëpër fusha e ara, nëpër bregore e vreshta, me skenat idilike ndanë kroit. Katundin e vet këta shkrimtarë shpirtërisht e morën me vete, edhe kur vanë e jetuan, më shkurt o më gjatë, nëpër qytetet e mëdha të Italisë.

Krahas me vendin e me traditat popullore, një faktor me rëndësi në formimin e këtyre shkrimtarëve që koha në të cilën jetuan. Nuk është një gjë e rastit që tek arbëreshët në shekujt e parë të ngulimit të tyre në atdheun e ri lindën vetëm autorë shkrimesh me përmbajtje fetare, në prozë e në poezi qoftë si: Matranga, Brankati, Kolë Filja, Variboba; dhe se Jeronim de Rada, Anton Santori, Zef Serembe, Gavril Dara, Zef Skiroi, shkrimtarë laikë e njerëz përparimtarë. Jetuan e punuan kryesisht në shekullin XIX. Ata janë pjella e këtij shekulli. Është koha kur në fushën mendore kishin depërtuar në Evropë kudo parimet e iluminizmit, e në fushën politike e sociale idetë e revolucionit frëng, me kërkesën e lirisë, të barazisë e të drejtave të njeriut. Në fushë të poezisë, mbledhja e këngëve të popujve të Evropës në veprën e Herderit *Këngët popullore* (1778-79) çeli rrugën e zbulimit të një poezie të re, të poezisë popullore dhe romantizmi e bëri të veten këtë ide. Ai zgjoi, sidomos te popujt e vegjël të kontinentit, dashurinë për gurrat e freskëta të kësaj poezie dhe me të bashkë edhe dëshirën për të mbledhur visaret e saj kudo të ishin. Kjo rrymë letrare ndërkaq, te popujt sidomos të Evropës juglindore, më fort se tipin e poetit romantik të mënjanuar prej botës, krijoi tipin e këngëtarit luftëtar, të shkrimtarit bartës e përhapës të idesë nacionale. Kështu pra në këtë trevë idealet e poezisë e të lirisë politike u shkrinë në një njësi më të ngushtë se në viset e tjera të Evropës.

De Rada bëri të vetat edhe motivet e jetës së katundit ar-

bëresh dhe idetë e botës së jashtme e të kohës së tij. Këto elemente jeta shqiptare dhe frymëzimet e jashtme, vatra edhe bota, u bashkuan tek ai në një njësi organike e të pandarë.

Ai e nisi karrierën e tij si folklorist. Shkoi e mbledhi nëpër katundet arbëreshe të krahinës së Kozencës këngët e vjetra popullore, të cilat në atë kohë ruheshin në gojë të popullit. si: në Kalabri, në Siceli e në krahina të tjera të Italisë jugore. Shqiptarët që u shkulën për në Itali gjatë luftës epike të popullit me osmanët, nën flamurin e Skënderbeut e në kohën e parë të pushtimit të huaj, morën me vete një visar të pasur këngësh të asaj kohe, këngë heroike e lirike. Në këto poezi që botoi De Rada te *Rapsoditë* e që pjesërisht janë ruajtur të gjalla gjer më sot, ndihet një jehonë e asaj periudhe të mesjetës shqiptare, e cila ka hyrë në histori me emrin *Manifestacioni shqiptar*. Në këtë më të vjetrën poezi popullore shqiptare që mund të datohet, na paraqiten format e jetës së Arbërit në epokën bizantine e format më të reja, e disa të egërsuara të kohës së parë turke të vendit, prandaj këto këngë janë njëkohësisht dhe një dokument i historisë shqiptare. Titulli që u dha poeti këtyre këngëve në mbledhjen që botoi, *Rapsoditë e një poeme shqiptare*, tregon se ai mendonte që këto përbënin mbeturinat e një eposi popullor të gjallë në Shqipëri në kohë të Skënderbeut. Ky mendim nuk qe i drejtë, sikundër e vërtetoi që në atë kohë folkloristi arbëresh Dhimitër de Grazia. Po ajo që ka rëndësi është kjo që De Rada e jetoi këtë poezi dhe gjeti në të ushqimin e tij. Ajo formoi bazën e natyrshme të veprës së poetit. Kjo vepër në përmbajtje të saj, në stil, në gjuhë, në trajtën e brendshme, në krahasimet, në frymëzimin e saj, në përshkrimin e atmosferës ku lëvizin heronjtë, na paraqitet shumë e gjashme, shpeshherë e njëjlojtë me rapsoditë popullore, ajo duket sikur të ishte një vazhdim i këtyre rapsodive. Kjo vihet re dhe në trajtën e jashtme, në metrikë; si atje, dhe këtu gjejmë të njëjtat vargje pa rimë, masa e të cilave nuk është numerike si në poezinë italiane, po në mënyrë thjesht shqiptare, ritmike, determinuar nga mëshimi i akcentit e nga alternimi i gjatësive me shkurtësitë. Si në poezinë popullore, edhe në atë të De Radës është i shpeshtë kalimi i pandërmjëmë nga tregimi në dialog, si të thuash nga poezia epike në dramatikën. Po edhe emrat e heronjve janë marrë nganjëherë prej këngës popullore, si Millo Shini e Radavani, i cili është një nga heronjtë kryesorë në punimin e dytë të poemës së *Serafina Topisë* që



## Eqrem Çabej

mban titullin italisht, *Uno specchio di umano transito*. Ka dhe mjaft motive, mjaft skena e episode në veprat e tij, që i gjej-më më parë në rapsoditë popullore, e të cilat nuk është vendi të përmenden këtu. Ndërkaq, me këto ndikime nuk do mendoar se poeti nuk bëri gjë tjetër veçse imitoi ku mundi poezinë popullore. Ai mori prej saj frymëzimin e përgjithshëm dhe shumë elemente që meritojnë të hetohen në të ardhmen, po jo pa i ngritur këto në një sferë poetike më të lartë. Poezia popullore që për të një pikënisje, nga e cila mori hovin për të krijuar një botë poetike më vete. Kjo botë është një pasqyrim i kohës paraturke dhe i kohës së parë turke të Shqipërisë. gjallëruar e mbushur me figura historike e me figura të sajuara prej tij, figura nga dyert e zotërinjve feudalë (Zakaria, Dukagjini. Topia, Arianiti e të tjerë) e të shtresave popullore të Shqipërisë mesjetare, duke marrë që prej Kotori e gjer në Artë të Prevezës. Në këto poema, paraqitja e figurave të heroinave na del shpeshherë e përsosur. De Rada është i pari poet i psikës femërore në literaturën shqiptare.

Për të rrokur veprën e këtij poeti në një mënyrë më tërësore, nuk do lënë pas dore ndërkaq dhe kjo rrethanë. që ai — sikundër na e thotë dhe vetë — gjeti burime frymëzimi edhe në literaturat klasike e moderne. Ai, si e vuri re së pari V. Gualtieri, u ndikua nga poezia romantike e kohës, si shumica e poetëve të atëhershëm të Evropës. e si më vonë dhe G. Dara në Sicili. Ndërkaq, te De Rada shihet një horizont letrar edhe më i gjerë. Kështu mendoj se në disa figura e motive të poemave të tij vihen re gjurmët e poemave italiane të Rilindjes, sidomos të Ariostit e të Tasos. I shumë literaturave evropiane është dhe motivi i dashurisë fatkeqe të një çifti që rrjedh prej dy familjesh armike, motiv që te poeti ynë na del në figurat e Bozdar Strezit e të Serafina Topisë në Artën e kohës së Skënderbeut. Heronjtë turq Almazore e Algazile, që dalin te *Skanderbekku i pafaan*, e te ripunimi i *Serafina Topisë*. me emrat e tyre na shpjen në botën arabe të Spanjës mesjetare si na del te *Romansero* e Sidit. Emri i Aidesë që del si e motra e Skënderbeut, na kujton poemat e Bajronit. Nuk mungojnë dhe reminishencat e botës klasike. si pëllumbi i Anakreontit e motivi i Psikës, frymëzuar nga *Gomari i artë* i poetit Apuleius. Ideja e fatit (moira) si na shfaqet në dramën greke, sidomos te Sofokli, depërton edhe kjo në veprat e poetit. Edhe Bibla ka lënë mbresa të thella tek ai.

## Eqrem Çabej

Këtu ndërkaq do vënë në dukje dhe një tjetër ndikim. i pavënë gjer më sot. Për të mbushur skenat luftarake me figura burrash e grash të Orientit, që duhej të dilnin aty në lagjen e osmanëve, poeti pati idenë të merrte disa motive dhe emra nga poezia klasike e Indisë. Kështu motivi i kqyrjes së një pikturë që paraqet Anmaria Kominiaten, nga ana e së motrës Delia dhe të së bijës Adine te *Nata e Kërshëndellave*, na kujton një skenë analoge të dramës *Sakuntala* të Kalidasës. ku mbreti Dushanta vëren një pikturë që paraqet Sakuntalën me dy shoqet e saj. Paraqitja e ngjarjeve nëpërmes tablosh të pikturuara na del dhe në të tjera vepra të De Radës. Emri i Vantisanës te libri i pestë i poemës *Skanderbekku i pafaan*, shihet se është marrë nga Savantasena, heroina e dramës *Marhakatika*, të Dandinit, poeti indas i shekullit VII të erës së re. Një tjetër emër indas është Davadasa, emri i një heroine që na del në këngën e gjashtë e të tetë të *Serafina Topisë*. Te drama e Dandinit, Vasantasena hipën në stivë të druve për t'u djegur së toku me fëmijët e saj, po shpëton bashkë me të shoqin. Një skenë të tillë na paraqit De Rada te punimi i dytë i *Serafina Topisë*, ku Evoda pëson këtë vdekje të tmerrshme për hakmarrje politike të popullit. Kjo skenë mund të jetë frymëzuar së andejmi. Po ajo, në anë tjetër, na kujton një pamje të *Jeruzalemit të liruuar* të Tasos, në të cilën virgjëresha kristiane Sofronia duhet të digjet në turrë të druve së bashku me të dashurin e saj Olindo, po ndërmjetëson Klorinda për shpëtimin e tyre. Gjurmët e poezisë inde te De Rada kanë lidhje me faktin që në gjysmën e parë të shekullit XIX, literatura inde kishte marrë një hov të madh në Evropë, duke dëpërtuar kudo nëpërmes përkthimesh në gjuhë të ndryshme.

Burimet e poezisë popullore shqiptare e të literaturës botërore e pasuruan krijimin poetik të De Radës, po kjo në qenësi mbetet pjella e frymëzimit të tij.

Nga veprat e poetit, për ne nuk ka dyshim se kryet e vendit e zë *Milosaat*. Kjo poemë idilike e me frymëzim romantik, e përshtuar fund e krye me poezinë naive-arkaike të rapsodive shqiptare të Italisë, për karakterin e ngjeshur që ka mbetet një nga ato fort të pakta vepra të literaturës shqiptare, që e bëjnë këtë të përfaqësohet në literaturën botërore. Nuk mungojnë ndërkaq episode madhështore përderdhur nëpër veprat e mëpastajme të poetit, si te *Serafina Topia*, te ripunimi i saj me titull të ndryshuar, te *Skanderbekku i pafaan* e në të

*Eqrem Çabej*

tjera. Gjithkund në këto poema ndritin vise-vise shkëndijat e një poeti me frymëzim gjenial, arti i të cilit konsiston, në mënyrë të Rembrandtit, në një qartë-errët (clair-obscur), në ndriçimin e disa pamjeve e figurave e në lënien e të tjerave në errësirë. Është një detyrë për ne t'i njohim këto vepra e me botime të ndryshme të përhapim njohjen e tyre brenda e jashtë atdheut.

### 13. NJË SHKRIM I PANJOHUR I DE RADËS<sup>1</sup>

I ndyeri prof. M. Marchiano me veprën e tija «L'Albania e l'opera di Girolamo de Rada» (1902) e me përkthimin e disa pjesëve prej veprash të De Radës (I Poemi albanesi di Girolamo De Rada, 1903), është 'ay që ka vënë bazat e studimeve deradiane e ka shënuar direktivat e përgjithëshme në të cilat ata duhen vazhduar. Vepra e parë, tani e sosur, blehet edhe tek i biri i të ndyerit, avv. R. Marchiano, Via Maffei a S. Gaetano 12, Napoli, e dyta tek Ditta Vecchi Vlo, Trani, ku gjindet edhe një biografi e shkurtër e De Radës.

Por edhe sot e gjithëditën shpirti pavdekëtar i këtij kolosi arbëresh lufton me veshin e shurdhët të kohës për famën më të madhe q'i përshtatet. Nga librat e tija, si nga thellësit' e ndë-nëdheut a nga dete të largët, ndihet zëri i tij legjendar, duke shkuar i padëgjuar nër veshet e botës, një vox clamantis in deserto...

Një shënjë se nuk e njofim De Radën, jo vetëm nga pikë-pamja e vlerës spirituale e artistike, por dhe nuk i a dimë veprat të gjitha, është dhe kjo se në asnjërën nga të dy veprat e prof. Marchiano-it nuk përmendet një përkthim i vogël i tij, i cili, sado pa ndonjë vlerë letrare të vetë, prapë si shkrim i De Radës ka rëndësi të veçantë për ne\*.

---

1) AQSH F. 295, d. 124, v. 1929 (Botohet për herë të parë — Shënim i Red.).

\*) Përveç këtij shkrimi kemi dhe një vjershë, si duket, të panjohur, të De Radës kushtuar një adhuruesi të Dora d'Istrias. Ndodhet në librin e D. Camardas «A Dora d'Istria gli Albanesi» (Le Grand, Bibliographie albanaise Nr. 302).

Më 1875, në rastin e kremtimit të pesëqindvjetorit të vdekjes së Giovanni Boccaccio-s, G. Papanti qiti në dritë një veprë\*, e cila përmban nj'a 700 përkthime në dialektet e ndryshme italice e në gjuhët e huaja që fliten n'Itali të novelës IX të ditës I prej Dekameronit.

Në faqet 659-677, pas një parathënjeje së shkurtër të D. Camardas, autorit të veprës «Laggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese», mbi shqipen, gjinden 12 përkthime të novelës në këta dialekte arbëreshë: Badessa (Abruzzi), Barile (Basilicata), Trascineto, S Demetrio Corone e Macchia, Santa Caterina, Spezzano Albanese (Calabria), Ururi (Molise), Contessa, Palazzo Adriano, Piana de'Greci (Sicilia), Greci (Capitanata).

Duke folur mbi Sh. Mitrin, thotë Papanti: «Shtesa Corone që i u-dha vendit S. Demetrio rrieth nga besimi që atje u-paskan përmbledhur disa fëmijë Grekësh e Shqiptarësh të ardhur prej Koronës së Moresë, në 1534, ndënë perandorin e mbretin Karol V... Dialekti i S. Demetrios, i Macchia-s e i vëndevet t'afërm është përdorur në vjershat e tija prej Z. Girolamo De Rada, prej të cilit është dhe përkthimi që ndodhet këtu. Por ky përkthim tregon disa fjalë e mënyra të veçanta të autorit. që si pas të thënurave të bashkëfshatarëve të tij vetë, nuk njihen si të sanksionuara nga përdorimi popullor».

Ja përkthimi i De Radës i transkribuar pothuaj tekstualisht, i cili do t'u tregojë njohtësve të disave nga veprat e tija, pas një vërrejtjeje të hollë, si në formim ashtu dhe në radhitje të fjalëve, gjithë vetijat e stilit t'autorit të Milosaos e të Serafina Thopias:

(Shpiegimet e tekstit i reservojmë për një kohë tjetër)<sup>1</sup>.

---

\*) I parlari italiani in Certaldo di Giovanni Papanti. In Livorno, Coi tipi di Francesco Vigo, 1875.

1) *Shënim i Redaksisë*: Këtë premtim që E. Çabej ia bëri vetes (ndoshta edhe e ka plotësuar, po ende nuk e kemi të dokumentuar), në mungesë të tij, e plotësoi autori i librit, i cili e transkriptoi dhe e përshtati në shqipen e sotme letrare.

**Transkriptimi i Novelës IX të Ditës së parë të veprës «Decamerone» të Giovanni Boccaccio-s, përkthyer nga De Rada dhe botuar në veprën *I parolari italiani in Certaldo* të G. Papanti-t, në vitin 1875, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Bokaçios:**

«Thom u poka se te moti i të parit Regjë të Çiprit, pra që, e mundur

— Thom ú pocca sé té motti i te parit Rhégje të Ciprit, prá ce, e mundur muar goren shéitè Gjottifré. Buljoni, kjé nje buljureshe câ Guasconja, se bëri vute te vée déer mbe déer njera të varri Tinzotti 'Ngacha mbë t'u — përjerrit e ardhur Ciper kjé attié kâ tsa dishëndsera e terperuar. Gatsilja e psuame e verbuar e chëljmit, e pa njerii për të; Këshilti vëj ajo t'i n'caljëssenëj té Rhégji; cur i Kjé thän cá' ndonjèrii, po të mos bür mottin e sai, psé ish vét një trivul i prunjët, ce i

muar gorën shejtë Gotifré Buljoni, qe një bulureshë ka Guaskonja, çë bëri vute te vé dér mbë dér njera te varri Tinzoti. Ngaha mbë t'u përjerrit e ardhur Çiprë qç atje ka ca dishenxëra e terperuar. Ka cila e psuame e verbuar helmit, e pa njeri për të, këshillti të vej ajo t'i 'nkalesënej te Regji; kur i qe thën ka 'ndonjëri, po të mos bir motin e saj, pse ish ai vet një trivull i prunjët, çë i ftesur 'mbar e prap ne skuqej, ne verdhej, aq sa kushdo kish ndonjë mëni, vej e je nxir me të e sjellur e përjerrë të shajturash, e monu çë ng e rrig; lip nani n'ai ndjenej të keqet e guaja me i çëfritur liqë. Cilat të thëna gjegjur gruaja, e bier besën e liqës çë i lipsej, iu dheks poka më oreksur kardazhin e zemërzezës të vej të cingërdhisënej atë regj quk. E iu parastjer ture i qar përpara i tha:

«Zoti im, u s'vinj përpara faqes sate për vinditë çë pres e të dhunëmit çë më qe bën, po 'mbër liqës çë më tokej se ti më thuash si bën votëria jote e duron aqë të terpruame e cënore kë gjegjinj se të jan bënura mose, sa kështu e 'mpsuar ka ti u mund të duronjë timen, cilën di Inzot si me gjith zemër u po, 'ndë mundja, dç t'i shtija nd'ata krag të zakonëme të qellënjën çëdo barr me t'i veget».

Perëndi njera agier një çanfani lem-të-rrë posi i sgjuar gjumi, zu ka të liqët çë gruan kishin terpruar, cilët mir dhunoi, e me mahjere e filaqi kastioi nga një çë pak o shum i pati ftesur 'nderjes zotëris tij, e pa fare më lipisi».

#### **Përshtatja në gjuhën e sotme letrare shqipe:**

«Pra, unë them se në kohën e të parit mbret të Çiprit, pasi Gotfred Buljoni ngadhnjew vendin e shenjtë, ndodhi që një bujareshë nga Guaskonja bëri premtim të vente derë më derë deri te varri i Zotit. (= i Krishtit). Si u kthye andej dhe erdhi në Çipër, u turperua nga disa njerëz të ligj. E helmuar nga ky pësim dhe duke mos pasur njeri, vendosi të vente të ankohej te mbreti. Atëherë i qe thënë nga dikush, që të mos humbiste kohën, sepse ai vetë ishte një burracak i përlulur, që, (edhe) i fyer mbarë e prapë, as skuqej, as verdhej, aq sa kushdo

## *Eqrem Çabej*

ftessur 'mbaar e prap né 'nkukjèj, né vérdhej, akj sâ cush do kish 'ndônjë menù, vèi e jé 'ndsur mé te' e sjelur e përjéerre të shaiturash. e monu ce ng' e rrig (rrigh); ljip nanní n'ai ndiénëj te kékjèt e guaja (huaaja) mé i cefritur ljikjé. Tsiljat te thëna gjégjur gruaja, e biéer béssen e ljekjés ce i ljipsèj, i u dhése pocca mée oréxur cardazcún e zézes te vèi te tsingérdhis-senëj ate Rhégje Kjuk. E i u-parastièr turè i kjaar perpara i tha: «Zotti im, ú s'vinj perpara fakjés satta per vinditte cé prés e te dhimemit ce «me kjé boen po' mbéer ljikjès ce me tockèj se ti te me thuash si bôn zottéria jotè e duron akje te terpruamè e tsenóre ke gjégjinj sé te jaan bônura mossè; sá keshtú e 'mpsuar kâ ti ú mund te duronje timèn: tsiljen dii Inzott si me gjith zemer ú po, 'nde múundia, dee t'i shtija nd'atta craag (krahë) të zovëónemè te Kjëlenjen ce do baarr mæe t'i vëegèt (vihet)».

Pérëndi njëra agièr nje tcanfani ljém-te-rhii posi i sgjuar gjumi, zú câ te' ljíkjet ce gruan kishin tepruar, tsiljet mir dhunoi. e mé mahjere e filjakji castioi 'nka një ce pak o shùm i patti ftessur 'ndériès zotteriis tij, e pâ farè mæe ljipisí. —

*Eqrem Çabej.*

*Graz, 4.II.1929*

---

që kishte ndonjë brengë, vente e nxirrte duke i drejtuar të shara, dhe gati sa nuk e rrihte. Mendo tani nëse ai ndjente të këqiat e të tjerëve për të bërë drejtësi. Si dëgjoji këto fjalë dhe e humbi besimin në drejtësinë që i duhej, mendoi pra të lehtësonte hidhërimin e zemrës dhe të vente e ta nxiste atë mbret të pamend. Dhe iu paraqit duke iu qarë dhe i tha:

«Imzot, unë nuk vij para teje për të kërkuar hakmarrje për dhunimin që m'u bë. Por në vend të drejtësisë që më takonte, dua që ti të më thuash se si bën e duron zotrote aq turpërime dhe fyerje që po dëgjoj se të janë bërë vazhdimisht, kështu që, duke mësuar nga ti, unë të mund të duroj timen, të cilën unë, po të kisha mundësi, do ta shtija në atë krahë të mësuar për të mbajtur çdo barrë, që t'u vihët».

Mbreti, deri atëhere një njeri i ngathët e përtac, posi një i zgjuar prej gjumi, zuri nga të ligjtë që kishin turpëruar gruan dhe i ndëshkoi mirë, dhe me shpatë e burg dënoi cilindo që pak a shumë kishte fyer nderin e zotërisë së tij, dhe pa treguar më fare mëshirë».

## 14. KUNDËR PSEUDOFILOLOGËVE<sup>1</sup>

Nga shtyllat e Shekullit të Ri të verës, si dhe nga ato të Gazetës së Re duket çiltas se një epidemi grafomanie paska kapur shumë «Krena të naltë»! Kush në jetën e tija ka pasur raste të mësojë anglishten nëpër fabrikat e Amerikës, gjer-manishten në tabarin-et e Vjenës, frengjishten në Mont-Martre, e italishten në Kafet' e Barit, sot, i fryrë si gjel deti, na del përpara, i stolisur me rrobën transparente të pseudonimit, e... — o tempora, o mores! — me gjest dramatik na flet mbi filologji! Avanti pra! Parturiunt montes, nascetur ridiculus mus!

Pra, sikundër në fletoret e Perëndimit ndodhet feuilleton-i, tek ne nuk do të mungojë, si frukt pas buket, një artikull «filologjik», i cili ka misionin, si ç'duket, të zëvendësojë një zakon shqiptar që është duke u shuar: luftën e gjelavet. Nënë maskën e shkabës, këta gjela luftojnë trimërisht me njerijetrin, duke u gjakësuar por dhe me maskë që jeni, e dimë se jeni gjela, o gjela! —

Tash, duke lënë të qeshurit, duhet të konstatojmë me hidhërim se është një turp kulturor për ne, që Atdheu i ynë është ay vend i Europës, në të cilin në shekullin e XX, njerës që mundet të jenë të zotë për nëpunësira ndofta dhe të nalta, por që s'dinë as pikë prej filologjisë, njerës që në jetën e tyre s'kanë dëgjuar një Konferencë filologjike, njerëz që s'kanë

---

1) AQSH, f. 295 d. 124, v. 1929 (Botohet për herë të parë — Shën. i Red.).



## *Eqrem Çabej*

as më të vogëlën idë mbi mënyrën si punohet sot në lëmin e gjuhës, që të tillë njerëz dalin e mbushin shtyllat e fletorevet me artikuj jo vetëm fare të kotë, por edhe të dëmshim e duke u sharë me shoqishoqin, dhe si! Kush i përflet tjetrit se tash doli nga veja, dhe se kur ay ishte në «shpërgajt» e djepit, ky punonte për Shqipëri! Bukur! Patriota! Por kush ju tha të futeni në labirinthe e gjuhës? E me ç'të drejtë e quan tjetrin «ignorant» vetëm pse është kundërshtar i «ideve filologjike» të tua?

A është kjo filologji? A imponohet njeriu me sharje?

Zakoni i botës së qytetëruar e do që të luftohet për ide, e jo për inate personale, për ç'fryrjen e të cilavet janë të çelura kaq gjykatore!

Sot secili në Europën e qytetëruar, para se të merret me shkrime filologjike, i shkon meaft viet në bankat e universitetit, atje ku gjuha studiohet e analizohet me exaktitudë matematike, duke qenë se filologjia është një nga dituritë më të shtrëngueshme (sevëre) e më exakte që munt të jenë në botë.

Se të mos ishte kështu, nuk rrinte Gustav Meyer -i të merreshin tridhetë viet me radhë me albanologji d.m.th. me studimin e asaj gjuhe të shkretë, të cilën «filologët» t'anë të sodit, të dalë shpejt si kërpullat pas një shiu, janë duke e përçmuar në një mënyrë të tillë!

Kurrkush nuk ka të drejtë të shkruaj mbi gjuhë pa u pat marrë viet me radhë me studimin e vërtetë të saj! Kurrkush! Se gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli, dhe për popullin shqiptar është i vetëmi thesar! Dhe mos e ngani thesarin me duart t'uaja, zotërinj dilettanta!

Gjuha është një element i naltë kulture, nuk është një objekt mode! Nuk mundet të «riformohet» aq shpejtas si ç'mundet secili të vishet à la Perrot për Karnaval!

Kush ju ka shtyrë ju të shkruani mbi gjuhë? Kur keni manin' e shkrimit, pse nuk shkruani ç'të doni mbi numismatikë, grafologji, matematikë, thelogji, përmbi fizikë, anatomi, analytikë e histori? E t'a lini rehat këtë gjuhë të shkretë, e t'a punojnë të tjerë të cilët të merren me të vërtetë me studimin e saj?

Kush do të shkruaj mbi shqipen, më parë duhet të jetë marrë me studimin e gjuhëvet indoeuropiane përgjithërisht, e

*Eqrem Çabej*

pastaj duhet të ketë studiuar gjithë shkrimtarët shqiptarë e gjithë albanologët e huaj, numëri i të cilëvev është' aq i math, sa studimi i tyre lyp viet me radhë pune të parreshtur.

Se filologjia nuk është zbavitje, është larg nga dilettantismi. Është dituri, dhe që të kapesish me dituri, duhet të dish!

*Eqrem Çabej*

*Graz, 8-II-1929*

## 15. SHQIPËRIME

Gjuhëtari ynë i shquar Eqrem Çabej ka lënë në dorëshkrim edhe këto pak shqipërime nga poetë lirikë gjermanë të shekullit të kaluar dhe një sonet të Dante Aligerit. Janë shqipërime të rinisë, që botohen për herë të parë (përveç sonetit «Beatrice»), sipas dorëshkrimit origjinal.

### H. FON FALERSLEBEN

#### Kënga e mbrëmjes

*Mbrëmja prap po bie  
Përmbi fush' e mal,  
Prehja përmbi botë  
Ulet mengadal.*

*Vetëm prroi po derdhet  
Përmbi shkëmb atje,  
Sulet tatëpjetë  
E gjëmon mbi dhé.*

*Atij prehje nata  
Nuk i falka dot  
Mbrëmja këngë paqje  
I këndon më kot.*

*Porsi val' e prroit  
Vala jote zjen,  
Zjen ti, zemra ime,  
Prehje dot nuk gjen.*

**TEODOR SHTORM**

**Një fletë e blerët**

*Një fletë ditërash verore  
E mora shtegëtar u pas,  
Të më rrëfejë sa gazmore,  
Bilbil, qe kënga që ja more,  
Sa blerët pylli që m'u has.*

**Hie të rënda**

*Ndoherë shpirtin helmi lë  
Qe rreh qëkur u bëre hie.  
Sërish si motit që s'vjen më  
Do ndiqja gjurmë lumtërie.*

*Po kur po pyes për lumtëri  
Nuk di përgjigje un' i mjerë,  
Veç të më vije përsëri  
Të rronim bashkë si njëherë.*

*Ahere shoh atë agim  
Kur kurmi yt në varr u shtrua,  
Dhe hesht dëshira shpirtit tim  
E lumtëria s'qe për mua.*

**Dorë e gruas**

*Po, un' e di, as fjal' e as vaj  
Nga buza jote s'do të dalë  
Po ç'ëmbël goja hesht si varr,  
E shkreta dorë flet ngadalë.*

*Te dora jote, e kam ndër sy,  
Një vrag u gdhend nga helm e shkruar.  
Se ajo u dergj' tek s'flije dot,  
Mbi një të vrarë kraharuar.*

*Eqrem Çabej*

**DANTE ALIGJERI**

BEATRIÇE

*E nderme duket aq e aq bujare  
E imja vashë, kur njeriut i truhet,  
Sa dridhet gjuha, fjala vjen e shuhet,  
E syri dot s'kuxon ta shohë fare.*

*Ajo e veshur n'unjësi mitare  
Kalon, e rrethas saj lavdia thuhet.  
E duket send i ardhur qiejsh të vuhet  
Mbi dhet të derdhë mrekulli hajdhjare.*

*Kujt e këqyr i duket aq hirplotë,  
Sa jep me sy në shpirt një ëmbëlsirë,  
Që kush s'e vrejti dot nuk mund ta ndjejë.*

*E duket që nga buz' e saj të vejë  
I ëmbël fllad të dal' e plot dëshirë  
Që shpirtit flet e psherëti! i thotë.*

«Nëntori» 1984/9, f. 190 v.

*Eqrem Çabej*

# I. Nga korrespondenca me albanologë

*Ellinorsvej 8 Charlottenlund  
bei Kopenhagen  
23 Janar 1932*

Shumë i nderuari Zotëri.

Ju falenderit shumë që më njoftuat në lidhje me *sklata shqiptare të kësaj epoke*. Pa dyshim që keni plotësisht të drejtë.

Me respekt të veçantë  
HOLGER PEDERSEN

\*\*\*

*Gersonsvej 69 II  
Kopenhagen Hellerup  
31 korrik 1938*

Shumë i nderuari zoti doktor.

Ju falenderoj shumë që më dërguat punimet tuaja interesante «Konstandini i vogëlith dhe kthimi i Odiscut» dhe «Shqiptarët dhe sllavët në Italinë e Jugut». Është shumë e gëzueshme që tani, për herë të parë, një shqiptar i lindur trajton gjuhën dhe historinë e popullit të vet, duke zotëruar mirë metodën e zhvilluar në Evropën Perëndimore.

Përshëndetje të përzemërta  
HOLGER PEDERSEN

*Eqrem Çabej*

\*\*\*

*Gersonsvej 69 II  
Kopenhagen Hellerup  
8 shkurt 1939*

Shumë i nderuari Zotëri,

Ju falenderoj për zemërisht që më dërguat librin me vlerë  
«Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe».

Përhëndetje të për zemërta  
Juaji me nderime

HOLGER PEDERSEN

\*\*\*

*Gersonsvej 69 II Kopenhagen  
Hellerup  
28 Mars 1940*

Shumë i nderuari zoti koleg,

Ju falënderoj për zemërsisht që më dërguat punimin tuaj  
interesant «Die Albanische Volksdichtung» («Poezia popullore  
shqiptare»).

Me respekt të veçantë

HOLGER PEDERSEN

*Eqrem Çabej*

\*\*\*

*Gersonsvej 69 II Kopenhagen  
Hellerup  
16 Qershor 1944*

Shumë i nderuari zoti koleg,

Nga ambasada juaj në Romë kam marrë një riprodhim të fotografuar të veprës së rrallë të Gjon Buzukut me aq rëndësi për shkencën gjuhësore, si dhe «Volsktum und Volksname der Albaner» (Kombësia dhe emri i shqiptarëve). Për këto dhurata të çmuara ju falënderoj përzemërsisht, gjithashtu dhe për letrën tuaj miqësore, që më ka gëzuar shumë. «Albanische Wortkunde» («Etimologjia shqipe») më ka bërë përshtypje.

Përhëndetjet dhe urimet më të ngrohta

HOLGER PEDERSEN

\*\*\*

*Gersonsvej 69 II  
Hellerup Danemark  
11 Qershor 1936*

Shumë i nderuari zoti koleg,

Ju falënderoj përzemërisht që më dërguat punimin tuaj «Mundartliches aus Albanien» («Dialekte të shqipes»).

Përhëndetjet më të përzemërta

HOLGER PEDERSEN



## *Eqrem Çabej*



*Vienë 62, VII  
17 Prill 1940*

Mik i dashur,

Ju falemnderit shumë për letën e datës 10 janar 1940. Edhe dy kartolinat që i keni nënshkruar miqësisht së bashku me zotërinjtë e tjerë, i kam marrë, si edhe atë të nënshkruar në radhë të parë nga prof. Taliavini më datë 10 mars, Tiranë, apo atë të Romës të datës 25 mars, që ju vetë e nxitët. Në qoftë se keni rast të takoheni me zotërinjtë e tjerë, atëherë ju lutem t'i dërgoni falenderimet e mia të përzemërta...

Aq sa u gëzova kur mora vesh pas kaq kohësh për ju. Aq shumë më mërzi lajmi i humbjes së babait tuaj. Gjatë viteve të studimeve në Vjenë më keni treguar shumë për të, kështu që unë mund të krijoj fare mirë një përftyrim të karakterit dhe të portretit të tij, të kuptoj sa e ndjeni humbjen e tij dhe sa jetim ndiheni. Dhimbja e fëmijës për humbjen e babait dhe të nënës na shoqëron gjithë jetën dhe, megjithëse siç thonë poetët, dhimbja kthehet ngadalë në fllad malli të qetë, ajo prapëseprapë shpeshherë hapet si plagë e re. Por unë dua, dhe ky është urimi i zemrës së shokut që merr pjesë në hidhërimin tuaj, që ky fllad i mallit të qetë t'ju qetësojë dhimbjen dhe të jetë balsam që t'i bëjë mirë shpirtit tuaj të plagosur. Në pozicionin tuaj të ri të punës si drejtor i Liceut të Tiranës, ju jeni i ngarkuar me shumë punë administrative, por më shumë më gëzon puna tuaj e gjallë shkencore. Punimin tuaj të bukur të botuar në revistën tremujore të Lajpcigut për Evropën Juglindore s'do ta kisha gjetur aq lehtë sikur të mos ma kishit dërguar ju. E kam lexuar me ëndie dhe kam përfituar shumë. Ju falemnderit shumë edhe për botimin shoqë të Holger Pedersenit. Për mua janë me rëndësi të vecantë nga pikëpamja gjuhësore përktimi, shofegimi dhe përshtatja nga ana tuaj e vëllimit «Këngë pleqërishte» (fq. 205). Titullin e dija vetëm nga poezia e shkëlqyer e Lazgush Poradecit «Ylli i zemrës» (fq. 18) dhe kam thyer kokën përsëri për përktimin e saktë

## *Eqrem Çabej*

shqip. Në ekzemplarin tim të këtij vëllimi unë shënova përkthimin e vjetër. Përkthimi juaj i «Këngës pleqërishte» më duket më i arriri, sidomos nga ana gramatikore, sepse bëhet fjalë edhe për formimin e ndajfoljeve modale me prapashtesa.

Në fund, edhe diçka për mua. Që dua të vazhdoj punën, s'është nevoja ta them. Një jetë pa punë shkencore për mua do të ishte krejtësisht e padurueshme. Por ju mund ta merrni me mend se kushtet për vazhdimin e punës sime nuk janë të përshtatshme. Ju falenderoj juve dhe zotërinjtë e tjerë shqiptarë, shkëlqesinë prof. A. Xhuvani etj., që përpiqen të më bëjnë më të përshtatshme kushtet e punës dhe gjithashtu ta bëjnë të mundur ardhjen time atje. Me gjithë pasigurinë paralizuese dhe shtypëse të kushteve të mia të punës, nuk dua ta humbas durimin. Për mua ka qenë gjithmonë gëzim i madh që vitet e studimeve tuaja në Vjenë kanë lënë te ju mbresa të përzemërta e miqësore. Shpesh kujtoj me ëndje ato vite të punës sonë të përbashkët, bisedat e shumta e të zjarrta për të gjitha problemet e shkencës albanologjike dhe të historisë së saj.

Por letra juaj i bën më të gjalla të gjitha këto kujtime. Megjithatë, ka shumë kohë që unë nuk kam lajme. Prof. Xhuvanit, i cili gjithashtu pati mirësinë që gjatë dimrit të më jepte një informacion të shkurtër, do t'i shkruaj vetë.

Edhe një lutje tjetër. Ka shumë muaj që përpiqem të gjej veprën e Mitrush Kutelit «Netë shqiptare», që është traituar hollësisht në faqet e gazetës «Përpjekja shqiptare». 1938, e cila për fat të keq është mbyllur. Në librari mora vesh që libri është shitur i tëri. A thua nuk gjendet në Tiranë ndonjë ekzemplar? Në çoftë se jo, atëherë do t'i shkruaj vetë zotit M. Kuteli në Bukuresht, sense adresën e tij e kam. Por do të doja të dija, a ka ndonjë ekzemplar? A s'mund ta pyesni për këtë zotin Pasko në Tiranë?

Shumë faleminderit dhe shumë të fala.

Juaji  
NORBERT JOKI.

Përsëritje të vecanta të gjithë zotërinjve:  
Prof. Selman Rizës, prof. Leko Budës, Lazgush Poradecit etj.

*Eqrem Çabej*

\*\*\*

*Vienë 62 VII  
27 Shkurt 1941*

Mik i dashur,

Po shfrytëzoj praninë e profesor Taliavinit për t'ju dërguar dy ekzemplarë të «Dialektet e Borgo Erizzos në Dalmaci» dhe raportin e literaturës albanologjike nga Vjetari indogjerman vëll. XXIV. Të parin ua kam dërguar që në gusht 1940 me ndërmjetësinë dashamirëse të zotit konsull Rrota. Për fat të keq, ekzemplari nuk ju ka arritur në dorë. Të tjerët, — unë dërgova atëherë nja 20 copë, — më kanë njoftuar se i kanë marrë. Kështu që sot po ju dërgoj me prof. Taliavinin një ekzemplar të dytë. Ju faleminderit shumë për të gjitha letrat tuaja dhe për kurtinë e mrekullueshme që më solli prof. Taliavini. Besoj se e keni marrë letrën time të fundit. Të gjitha të tjerat do t'jua tregojë profesor Taliavini.

Përshëndetje të përzemërta  
miku juaj i singertë  
NORBERT JOKL  
Urgjente

\*\*\*

*Vienë, 9.1.41*

I dashur zoti doktor,

Shumë ju faleminderit për letrën dhe urimet e përzemërta. Gëzohem që dëgjoj prej jush se jeni emëruar në detyrën e frytshme të drejtuesit të Liceut, e cila sigurisht që ju pëlqen, dhe ju uroj mbarësi. Dimri kësaj radhe është shumë i ftohtë

## *Eqrem Çabej*

në Vjenë dhe në përgjithësi në Gjermani. Në Romë dhe pastaj në Italinë e Jugut do ta kem më mirë. Universiteti e ka kthyer semestrin në trimestër, që të shpejtojë procesin e mësimit.

Po merrem me skedat e botimit të dytë të gjeografisë sime të fjalëve të gjuhës letrare të folur gjermane, d.m.th. me një punë të ngjashme me tuajën.

Me përshëndetjet më të përzemërta edhe nga familja.

Juaji

P. KRETSCHMER

\*\*\*

*Vienë, 26.I. 38*

I dashur zoti doktor,

Ju falenderoj për urimet tuaja për Vitin e Ri, të cilave u përgjigjem po aq përzemërsisht. S'i jam përgjigjur ende letrës suaj, sepse nuk e di cilin shkrim duhet t'ju rekomandoj për qëllimet tuaja. Duhet t'ju lutem të kërkoni vetë dhe të gjeni në shkrimet e mia diçka të përshtatshme për Shqipërinë. Kap. VIII i «Hyrjes» sime sot është i vjetëruar. Gruaja ime është gëzuar shumë për pullat që i keni dërguar dhe ju falenderon nga ana e saj.

Shpresoj të jeni mirë. Sido që me vonesë, ju uroj për festën tuaj kombëtare. Ndoshta do të bëj ndonjë vizitë në Shqipëri. Në Durrës dhe Vlorë kam qenë para disa vjetësh, kur kaluam andej me Heliosin.

Përshëndetje të përzemërta

P. KRETSCHMER

*Eqrem Çabej*

\*\*\*

*Vienë, 30.I. 1940*

Shumë i nderuari zoti doktor,

Faleminderit për letrën që mora sot, d.m.th. pas 9 ditësh, dhe urimet e mia më të mira për gradën tuaj. Për fat të keq puna drejtuese në shkollë do t'ju pengojë me siguri në punën shkencore. Do të kisha botuar me kënaqësi në revistën e komisionit tonë të Ballkanologjisë diçka nga ju. Për shqipten duhen në radhë të parë punime përmbledhëse, veçanërisht për fjalëformimin, ose një fonetikë historike e gjuhës suaj amtare. Ndoshta gjeni kohë për të mbledhur material për punë të tilla.

Po ju dërgoj këto botime të veçanta dhe ju falënderoj për librin «Poezia popullore shqiptare» që më duket interesante dhe ashtu është vërtet.

Ju përshëndes. Gjithashtu edhe gruaja ime dhe vajza, që ndërkohë është me studime në Berlin.

Juaji

P. KRETSCHMER

\*\*\*

*Vien VIII, Florianigasse 23  
9.II.43*

Shumë i nderuar dhe i dashur zoti doktor,

Letrën tuaj të datës 10 janar e kam marrë me vonesë të madhe. Ju falënderoj për urimet e Vitit të Ri dhe i përgjigjem me singëritet, duke ju uruar gjithë të mirat në të ardhmen.

## *Eqrem Çabej*

Mendimin tuaj për t'i dërguar revistës së komisionit të Ballkanologjisë një dorëshkrim për morfologjinë shqiptare e përshëndes me gëzim dhe ju lutem të ma dërgoni sapo ta keni gati. Duhet të botoj përsëri diçka albanologjike në letrat tona. Ndoshta e keni marrë vesh që Jokli ka përgatitur një punim për emrat e pjesëve të trupit në shqip. Lajmi i vdekjes së tij nuk është vërtetuar, por megjithatë ai nuk është në Vjenë. Na ka ardhur shumë keq që s'mund të vini në Vjenë: Të gjitha ftesat për kumtesën tuaj ishin shpërndarë.

prof. dr. P. KRETSCHMER

\*\*\*

*Vienë 3.1.1941*

I dashur zoti doktor,

Ju faleminderit shumë për letrën që më dërguat për krishtlindje. Ajo më ka gëzuar shumë se mësova që jeni mirë dhe të lidhur me mua dhe me institutin tonë të vjetër. Unë mendoja se ishit në Gjirokastër. Nuk dija gjë që punonit në Tiranë, meqë ka kohë që s'kam lajme nga Shqipëria. Nga ju mora vesh se ku ndodhen zotërinjtë e tjerë.

Që ju po merreni me punën përgatitore për atlasin gjuhësor të shqipes, kjo është për t'u përshëndetur. Kështu që keni mundësi të punoni me një vepër fundamentale, nga e cila do të dalin vëzhgime me vlerë. Ju jeni personi adapt për këtë punë. Zoti Kreçmer do të jetë dakord me mendimin tim. Ai është mirë, por shumë i dobësuar. Unë me gjithë familjen jemi mirë, faleminderit zotit. Punoj si përpara, por megjithatë më mungon përqendrimi i duhur për punët e mëdha.

Do t'ju rekomandoja të lexonit kumtesën e F. Folgersit «Rezultatet e shkencës gjermane për studimin e Ballkanit në shekullin e kaluar» dhe njoftimet e Akademisë për studimet shkencore dhe për lëvrimin e gjermanishtes, Mynih 1940, ku mund të gjeni një vlerësim për mua dhe për prof. Kreçmerin.

## *Eqrem Çabej*

Instituti ynë në rrugën Libig është zëvendësuar me prof. Civailerin, pasardhësin e princit Trubeckoi. Kështu, do të ngrihet në Lajpcig një institut analog, por jo më pak i subvencionuar, me zotërinjtë F. Folger dhe G. Shtatmyler, me qëllim që të përqëndrojnë në Vjenë studimet gjermane për Evropën Juglindore.

Dr. Dimiçi është ndërkohë në Beograd. Dr. Isaçenkoja përgatiti doktoratën në Laibah. Dh. Vinski është njeri me influencë, është në pension dhe punon me zell në Agram. Ai më ka dhuruar një punim të tijin me rastin e 75-vjetorit tim, më 14.9.1940. Doktor Bergneri dhe doktor Lindsbergu duhet të kenë shkuar ushtarë. Në fakt kemi gjëra të tjera për të cilat duhet të mendojmë. Ju lutem, zoti doktor, më rekomandoni te profesor Bartoli.

Ju përshëndes me gjithë zemër.

Juaji prof. C. PATSCH

\*\*\*

*Markkleeberg, 15.1.1957*

I dashur dhe shumë i nderuar zoti koleg

Çabej!

Ju falenderoj përzemërsisht për letrën Tuaj të datës 27.11., së cilës iu desh një kohë e gjatë për të mbërritur deri tek unë, dhe për telegramin Tuaj dhe të bashkëshortes suaj të nderuar me rastin e Vitit të Ri. Urimeve Tuaja miqësore u përgjigjemi të dy, bashkëshortja ime dhe unë, me urimet më të përzemërta për familjen Tuaj të dashur. Le t'ju sjellë viti 1957 shumë gëzime dhe suksese!

Ju falenderoj edhe për njoftimet tuaja në lidhje me I.G. fon Hanin dhe Bektashinjtë. Gjithçka ishte shumë e vlefshme për mua...

Për sa i përket punimit Tuaj «Mbi disa fjalë në shqipe që fillojnë me Z», Revista për Fonetikën sipas shkencave të përgjithshme gjuhësore më dërgoi 30 kopje të veçanta, ndërsa unë

## *Eqrem Çabej*

Ju lutem të më njoftoni se ç'duhet të bëj me këto kopje të veçanta. Ju shkrova gjithashtu se keni për të marrë një honorar në Berlin. Honorari është ende atje dhe është i mirë. Më shkruani se si dhe kujt duhet t'ia dërgojë revista honorarin.

Do t'ju jem shumë mirënjohës po të më dërgonit nëpërmjet Institutit të Shkencave në Tiranë «Nëntorin», nr. 9, 1956, dhe veç kësaj për institutin tim numrat e «Shkencave shoqërore» për vitet 1950, 1951, 1952, 1953, 1954, 1955. Sipas mundësive këto të dërgohen ca nga ca në pako të vogla dhe në dy numra.

Nuk e di në se e keni marrë Ju, Instituti dhe Biblioteka Kombëtare në Tiranë, librin tim «Shqipëria tregon», shtëpia botuese «Volk und Wissen», Berlin, 1956. Ai boton një përzgjedhje të letërsisë shqiptare, veçanërisht të asaj të botuar qysh nga viti 1944 në gjuhën gjermane me hyrje, shënime dhe me një shtojcë biografike. Po të mos e keni, po e dërgoj.

Ju lutem më shkruani! Me përshëndetje më të mira për miqësinë e vjetër.

Juaji

**M. LAMBERTZ**

\*\*\*

*Markklebergl. Leipzig*

*den. 23.1.1961*

*Dolitzer Strabe. 10*

Shumë i nderuar dhe i dashur zoti koleg dhe mik Çabej,

Ju shkruaj me kënaqësi në gjermanisht, të cilën e zotëroni në mënyrë të përsosur. Ju falenderoj për librin tuaj të bukur «Bambi». Historinë interesante me kafshë të F. Saltenit e keni përkthyer në një shqipe jashtëzakonisht të bukur. Zgjedhja e këtij punimi të këndshëm të Saltenit dëshmon për njohjen e thellë e të gjerë nga ju të letërsisë gjermane, por edhe se me sa shije dini të zgjidhni. Shqiptarët, bashkatdhetarët tuaj të zgjedhur, do t'ju jenë shumë mirënjohës për këtë dhuratë. Edhe mua më pëlqen shumë ky libër dhe, siç thashë, shqipja



## Eqrem Çabej

juaj e shkruaj aq bukur më ka mrekulluar. Ju faleminderit shumë.

Zonjës Neka Turkeshi t'i shprehni falenderimin tim për përkthimin e shkëlqyer të 53 vjershave të zgjedhura mirë të vëllezërve Grim. Zgjedhja, përkthimi dhe ilustrimet janë shumë të arrira. Libri më ka gëzuar shumë dhe do të pëlqehet edhe në Shqipëri nga i madh e i vogël. Të dy këta libra do t'i trajtoj në studimet për juglindjen. Ju falënderoj me për- zemërsi për diskutimin tuaj dashamirës të punimit tim «Epika popullore shqiptare» në Lingua Posnaniensis. Ju kam dërguar punimin tim të fundit «Kolë Jakova — Toka jonë» të përkthyer dhe shpresoj se e keni marrë. Këto ditë do t'ju dërgoj një ekzemplar të punimit tim Epika Popullore, që është botuar në VEB Max Niemeyer në Halle. Do të kërkoj edhe gjëra të tjera dhe do t'ju dërgoj. Ju falënderoj edhe për separatin e punimeve të bukura me përmbajtje të pasur «Vise» etj. dhe «Shumë probleme» etj., nga Lingua Posnaniensis VII, VIII dhe Academia «Studii si cercetări» etj., 1959 (X 4), që janë për mua me shumë vlerë dhe më japin mundësi të hedh një vështrim në njohuritë tuaja të gjëra dhe në metodën tuaj të rreptë.

Punimin «Vise» e kisha lexuar në Lingua Posnaniensis, që unë e drejtoj. Më ka vlejtur shumë. Faleminderit edhe një herë. Punimin për folklorin shqiptar e ka marrë zoti Balduin Saria. Ai ka shkruar e do ta japë në SOF. Që Valjaveci ka vdekun duhet ta dini me siguri. Edhe diçka. A mund ta gjeni botimin e ri të Buzukut të Namik Resulit me kritikën e Marlekajt? Unë i kam të dyja, edhe punimet e Camajit për Buzukun. Ju vetë keni bërë gjëra me vlerë në fushën e Buzukut. Pas botimit të Resulit, a mund t'i dërgoj Institutit tuaj në Tiranë direkt një botim të Buzukut? Edhe një pyetje. Në kalendarin e vjetër të jezuitëve në Shkodër, Elejja i zemrës së Jezu Krishtit të vitit 1900, Kallnuer, teksti fillon me fjalët «Emilim e finkamun do me than qi t'rritun e ai lulzim kah e mara e mira e nierit». Si e shpjegoni etimologjikisht Emilim? A mos është xmile «vihesh në lëvizje» (f Bashkimi Wb)? Ju falënderoj në emër të gruas për përsëndetjet dhe urimet e përzemërta. Gruaja ime për fat të keq është e sëmurë dhe qëndet për kurim (zemre) në një banjë të Austrisë (Tatzmannsdorf). Tani jam vetëm në shtëpi. Gëzohem që fëmijët tuaj të mirë janë rritur. Ju uroj atyre, bashkëshortes suaj

## *Eqrem Çabej*

të nderuar dhe juve shëndet dhe gëzime. Përshëndetni ju lutem të gjithë shokët e atjeshëm: Xhuvanin, Budën, Fullanin, Domin, Zamputin, Kostallarin, Pollon, Papariston, Zojzin, Sokolin, Mitrushin, Kolë Jakovën, Duhanaxhiun, Dh. Shuteriqin, Dr. Siliqin, Vehbi Balën, Zihni Sakon, Shefqet Musarajm, Treskën e të gjithë të tjerët që kam harruar t'i përmend.

I kujtoj të gjithë dhe sot ju përshëndes veçanërisht ju dhe familjen tuaj me zemër dhe në shenjë miqësie të vjetër.

MAXIMILIAN LAMBERTZ  
që ju vlerëson gjithnjë  
shumë.

5.8.1961

Fort i nderuemi Zotni profesor  
Çabej!

Ju falemi nderit nga zemra për urime me rastin e ditëlindjes sime. Edhe unë Ju uroj Juve edhe familjes së Zotnis Suaj shumë të mira edhe suksese të bukura në punë shkencore. Unë gëzohem sepse mundem të Ju shkruaj, se vepra e Zotnis Sate përmbi folklorin do të jetë e shtypun tashti në revistën shkencore e «Institut für Geschichte des Volksdemokratien der Karl-Marx-Universität Leipzig». Shpresoj se keni me qenë i kënaqun me atë zgjidhjen e çështjes përmbi veprën e Zotnis Suaj e vlefshme dhe e bukur edhe interesantshme, si kanë thanë të gjitha, qi e kanë lexue. Kam me Ju shkruar përsëri përmbi atë punën.

Për sot po Ju dërgoj Juve shumë përshëndetje e të fala për Ju, për Zonjën edhe për Artanin e Brikenën, edhe nga ana e Zonjës sime.

Unë mbetem n'miqsi të vjetër gjithmonë i Juaji.

M. LAMBERTZ



*Poznanj, më 4 prill 1959*

Mik i dashun,

Pas këhimit tim në shtëpi s'kam pasë mundësi të Ju shkruaj një letër jo vetëm nga mungesa e kohës por më shumë nga shkakut se s'kam mujtë ta gjej librin, që ja premtova prof. Xhuvanit: V. Brondal, *Théorie des prépositions*. Përpara dy javësh e gjeta dhe e dërgova gruen teme në Varshavë në Ambasadën e Shqipënisë. Zoti Ambasadori i tha se do ta dërgojë librin me postën diplomatike në Tiranë, kështu që libri do t'arrijë në Tiranë mbrenda një jave e aty do t'i dorëzohet profesorit. Shpresoj se Zoti profesor Xhuvani sot do ta ketë në dorë.

Profesori mund ta mbaj librin 2-3 muej. Pas këtij afati Ju lutem ta dërgoni librin në adresën teme, si një pagetë të porositun, gjithashtu të më dërgoni librat prej Institutit Tuej, nëqoftëse kjo s'asht e ndalueme nga ana e postës shqipëtare.

Unë vetë s'kam pasë mundësi ta dërgoj librin me anën e postës nga Polonia, sepse te na asht e ndalueme për vetat private me i dërgue botime të huaja jashtë shtetit, — posta nuk i pranon.

Kam pasë frikë, se puna do të ngjatej për së tepri, nëqoftëse do ta kishe dërgue librin me ndërmjetsi të Bibliotekës sonë Universitare, e cila sigurisht do të kishte pasë nevojë, qi t'i paraqitej një porosi nga anë e Bibliotekës Kombëtare në Tiranë, e kush e di ndoshta diçka tjetër. Për këtë arsye e zgjodha «rrugën diplomatike».

Çka i përket artikullit Tuej, do të kem kujdesë për korrektime, atëherë që do të niset puna e të shtypurit të vëllimit VIII të «Lingvës».

Shpresoj se vëllimin VII dhe ekstraktet Tueja i muërt. A jini i kënaqur me të shtypun të punës Suej? Më shkrueni, Ju lutem, se si asht puna me sasi gabimesh shtypi? Mos janë tepër të shumta?

Unë po punoj dal nga dal, mjerisht ma të shumtën merrëm tashti me punët didaktike, kam mjeftë mësimë «vetëm» 18 orë në javë. S'asht për me u çuditë, sa me padurim të madh i pres pushimet verore, të cilat për mue do të fillojnë me gjysmën

## *Eqrem Çabej*

e qershorit — atëherë do të merrem vetëm me punën e shkencës.

Të gjitha librat, që i kam pa në Tiranë (ata të Georgievit e të tjera) i kam tashti në shtëpi, i kam porositë nga Biblioteka në Sofi.

Profesor Otrabski asht kënaqë fortë, se Ju jini gati të shkrueni recenzionin e librit të Bavic-it (Hymja në historinë e gjuhës shqipe). Kur do të kryeni këtë recenzion, ja dërgoni, Ju lutem, fill profesorit. Ay e pret me një interes të madh.

Pardje e mora letrën prej profesorit Lambertz. Artikulli im, që asht botue në Buletinin Tuej mbi prejardhjen e gjuhës shqipe i ka pëlqye shumë. E ka lëvdue fortë. Më shkroj, se tashti argumente shkencore për prejardhjen ilire të shqipes janë bindëse. Profesor Lambertz s'ka dyshim se përpjekjet tona (tue marrë parasysh studime Tueja të fundit edhe ato të mijat) sigurisht do të provojnë fare tezën e prejardhjes ilire të shqipes.

Në javën qi na vjen do t'i dërgoj një letër shokut Androkli me një lutje, që të më përgjigjet për disa pyetje.

Prof. Otrabski ka porositë te unë një artikull përmbi historinë dhe punimet e Institutit Tuaj, i cili do të botohet në vëllimin e fundit të «Linguës» në kronikën shkencore.

Më duket mue, se kjo asht detyra jeme, t'informoj botën e jashtme përmbi suksese të mëdha të shkencës shqipëtare në fushatën e filologjisë dhe të gjuhësisë.

Mik i dashtun, duhet ta mbaroj letrën teme, edhe Ju çoj të fala me shëndet shumë për Ju edhe për të shoqen Tuajë e për fëmit. Prof. Otrabski Ju çon gjithashtu të falat.

Shumë përshëndetje miqësore për Z. Xhuvanin, Kostallarin; edhe për Mahirin, Siron, Selmanin e për të gjithë shoqët nga Instituti.

WACLAW CIMOCHOWSKI  
i Juaji gjithmonë

P. S. Ditë e fundit i dërgova Selmanit një copë të «Dialektit të Dushmanit».

*Eqrem Çabej*

\*\*\*

*Bukuresht, 30 qershor, 1960*

I dashur shok,

Universiteti «C. I. Parhon» i Bukureshtit dhe një komitet i kryesuar nga unë i krijuar kohët e fundit, do të organizojë këtë verë nga data 1 deri më 31 gusht kurse për gjuhën, letërsinë, historinë dhe artin e popullit rumun.

Kurset do të jenë për specialistë, pedagogë dhe njerëz të kulturës që interesohen për studimin e gjuhëve dhe kulturave latine. Ato do të zhvillohen në Sinaia, qendër klimatike në Karpatat Meridionale, një nga krahinat më të bukura të vendit. Njëkohësisht do të organizohen edhe ekskursione e vizita në institucione të ndryshme, në uzina, monumente historike etj.

Duke pasur parasysh interesimin tuaj të veçantë për studimin e gjuhës, letërsisë dhe artit të vendeve latine, më lejoni t'ju ftoj të merrni pjesë në këto kurse, të cilat do t'ju japin mundësi të njiheni drejtpërsëdrejti si me traditat ashtu edhe me jetën e sotme të popullit rumun.

Shpenzimet e qëndrimit do të përballohen nga organizatorët e kursit. Do t'ju ishëm tepër mirënjohës po të na kthenit përgjigje para 15 korrikut.

Po ju dërgoj, gjithashtu, edhe një program të kurseve. Rektori i Universitetit «C.I. Parhon» të Bukureshtit u ka dërguar ftesa zyrtare edhe universiteteve dhe instituteve të tjera të specializuara në vendin tuaj.

Në pritje të përgjigjes suaj dhe me shpresë se do të takohemi këtë verë në Rumani, ju lutem pranoni konsideratën time më të lartë.

Prof. dr. IORGU IORDAN

P.S. Adresa e Universitetit «C. I. Parhon»

64, Bd. 6 Martie.

Bucuresti — Republica Populare Române.

*Eqrem Çabej*

\*\*\*

*Bolonjë, 14. 2. 1961*

I dashur Çabej,

Mora studimin Tuaj mbi fjalën shqipe «vise», të cilin e lexova me shumë kënaqësi dhe interes. Unë Ju admiroj dhe Ju vlerësoj, e me shumë të drejtë, do të thosha se Ju jeni albanologu më i shquar i të gjitha kohërave. Ju keni botuar shumë shkrime e unë do të desha t'i kisha të tëra në dispozicion, por posedoj pak të tilla. Kam lexuar dhe vazhdoj të lexoj te «Buletini» i Fakultetit tuaj si dhe te «Nëntori» artikujt tuaj, që dëshmojnë për një zotërim të jashtëzakonshëm të gjuhës shqipe. Do të desha të kisha një të katërtën e njohurive Tuaja për gjuhën shqipe. Ju përgëzoj dhe shpresoj të më dërgoni ndonjë punim tjetër Tuajin. Jam filatelist e do të dëshiroja të më dërgonit disa pulla shqiptare. Ju falënderoj paraprakisht për favorin që do të më bëni.

Ju njoftoj se kam ndërruar adresë.

Adresa ime e re është:

Via Candino 14<sup>50</sup>

Juaji,  
A. LEOTTI

\*\*\*

*Firence, 21.2.63*

I dashur koleg,

I prita me shumë kënaqësi dy shkrimet tuaja në rumanisht, që ishin mjaft interesante. Miku ynë i përbashkët, Roveti, së fundi më foli për ju në mënyrë shumë miqësore. Shpresoj t'ju takoj së shpejti.

Përschëndetje të përzemërta

Juaji

GIACOMO DEVOTO

*Eqrem Çabej*

\*\*\*

*Firence, 24 tetor 1974*

I dashur koleg,

Mora shkrimin tuaj shumë interesant mbi origjinën e gjuhës shqipe dhe ju falënderoj nga zemra. Duke shpresuar t'ju takoj një ditë, mbetem.

Singerisht juaji  
GIACOMO DEVOTO

\*\*\*

AKADEMIA E SHKENCAVE E BULLGARISË

Nënkryetari  
Sofje, Bullgari

*Sofje, 3 shkurt, 1965*

I dashur koleg,

Kam nderin t'ju njoftoj që në bazë të vendimit të Komitetit Ndërkombëtar të Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve të Evropës Juglindore, mbledhur në shkurt 1964 në Sofje, do të mbahet këtu nga 30 gushti deri më 5 shtator 1966, nën kujdesin e UNESKO-s, Kongresi I Ndërkombëtar i Studimeve të Evropës Juglindore.

Nënkomisioni i zgjedhur nga Komiteti Ndërkombëtar për përpunimin e sugjerimeve në lidhje me punën e sektorit të Filologjisë dhe Gjuhësisë në Kongres propozon që raporti i katërt kryesor: *Çështje themelore të gjuhësisë së Ballkanit të përgatitet nga një grup pune me pjesëmarrjen e zotërinjve Andriotis, Bernshtajn, Çabej, Deanoviç, Georgiev, Kurmulis, Petroviçi dhe Roseti. Raporti nuk duhet të jetë më i gjatë se 60 faqe shtypi (ose 120-130 faqe të daktilografuara). Nënkomisioni*

## *Eqrem Çabej*

është i mendimit që ju të merreni me çështjen e kontributit të shqipes në formimin e një komuniteti gjuhësor ballkanik.

Meqenëse Komiteti Ndërkombëtar më ka nderuar me detyrën e përgatitjes dhe redaktimit përfundimtar të raportit në fjalë, ju lutem të më njoftoni nëse do të pranoni të jepni ndihmën tuaj dashamirëse për redaktimin e raportit. Do t'ju isha shumë mirënjohës po të më kthenit përgjigje deri më 10 maj 1965 dhe po të më dërgonit pjesën e raportit të redaktuar nga ju deri nga fundi i tetorit.

Ju lutem kini parasysh se raporti që do të përgatisni s'duhet të jetë më i gjatë se 15 faqe të daktilografuara (1 faqe me 30 rreshta).

Në pritje të një përgjigjeje pozitive, pranoni, i dashur koleg, konsideratën time të lartë.

Prof. V. GEORGIEV

\*\*\*

*Milano, 1 prill 1970*

I dashur mik,

Një ish-studenti im, prof. Emanuele Banfi, autor i një shkrimi të rëndësishëm mbi latinishten në greqishten e re e në përgjithësi në Gadishullin Ballkanik, dëshiron që verën e ardhshme të studiojë pranë një instituti gjuhësie në Shqipëri ose në Rumani dhe veçanërisht me Ju. A do të ishte e mundur një gjë e tillë?

Ju si jeni? Të afërmit si i keni?

Unë tani jam 75 vjeç, por, megjithëse mjaft i plakur, vazhdoj të mbahem. Po kështu edhe ime shoqe. E keqja është se bota po bëhet gjithnjë e më e shëmtuar!

Përhëndetje të përzemërta Juve dhe zonjës Çabej,

Juaji

VITTORE PISANI

Përhëndetini nga ana ime miqtë e atjeshëm, duke filluar nga Buda.





Dubrovnik, 8.4.71

Mikut Çabej nga Kongresi i Dubrovnikut me kujtimet tona  
më të mira,

GERHARD ROHLFS

(Kartolina është sigluar edhe nga 15 vetë të tjerë pjesëmarrës në Kongres.)

25.8.74

Fort i dashur mik Çabej,

Jam me pushime në bregdetin spanjoll në Atlantik. Që këtej po Ju dërgoj një pyetësor për emërtimet e disa kafshëve shtëpiake.

Më intereson fenomeni që ndodh me disa emra të lashtë kafshësh, të cilët në vend që të ruajnë emërtimin e vjetër latin ose grek (e në mënyrë të ngjashme edhe në gjuhë të tjera), kanë marrë një emërtim të ri (pa histori), të lindur sigurisht në kushtet e intimitetit të jetës shtëpiake.\*

A do të ishte e mundur që Ju t'ia jepnit këtë pyetësor një kolegut Tuaj kompetent në këtë fushë?

Nga data 29 do të jemi përsëri në shtëpi.

Nga data 8-13 tetor mendoj të marr pjesë në Kongresin

\*) Për shembull:

*porcus* sot në frëngjisht *coshon*

*canis* sot në spanjisht *perro*

etj. etj.

Shënim: Bashkëngjitur prof. G. Rolfs dërgon pyetësorin me emërtimet e disa kafshëve shtëpiake në italisht dhe kërkon të dijë analoget e tyre në shqipen letrare si dhe fjalët me të cilat emërtohen këto kafshë në gegërisht e toskërisht.

*Eqrem Çabej*

Ndërkombëtar të Studimeve të Mesdheut në Samo, ku, do të vijë patjetër edhe një përfaqësues i Shqipërisë.

Mbeteni për mua i paharruar,  
me shumë përzemërsi  
Juaji

G. ROHLFS

Përschëndetje të përzemërta familjes Suajt  
Marianne Rohlfs

\*\*\*

21. 10. 79

I dashur mik Çabej,

Sapo u ktheva nga një udhëtim i gjatë për qëllime kërkimore në Kalabri dhe Salento, gjeta në shtëpi letrën Tuaj të 20 shtatorit.

Ju falënderoj nga zemra për informacionin e saktë rreth emërtimeve që përdoren në Shqipërinë Veriore për kafshët shtëpiake.

Në «Studia Albanica» (1979 I) lexova artikullin e pasur të prof. Domit kushtuar veprimtarisë shkencore të Eqrem Çabejt. Përfitoj nga rasti për t'i shprehur mikut tim Çabej urimet e mia më të mira për 70-vjetorin e lindjes.

Mbeteni për mua i paharruar,  
përschëndetje të përzemërta,  
Juaji

G. ROHLFS

Duke Ju falënderuar nga zemra,  
konfirmoj marrjen e:

1. Rreth leksikut të të folmeve shqipe të Kalabrisë.
2. Mbi disa fenomene të historisë së gjuhës shqipe.  
(I lexova të gjitha me shumë interes.)

## 2. Poezi kushtuar E. Çabejt

**XHEVAHIR SPAHIU**

### TEK RRËNJA E FJALËVE

Prof. Eqrem Çabejt

*Fjalëve të moçme përtej Iliadës,  
fjalëve të reja si bisku i njomë  
u merren këmbët,  
për një çast mjegullohen.*

*Ai iku...*

*Zbriti në heshtje drejt ashtit të dheut,  
atje ku nis shqipja dhe brumi i vullkaneve.*

*Ai s'është më.*

*Shkoi ta ngrejë shtëpinë përgjithnjë  
tek rrënja e fjalëve.*

17 gusht 1980

(Nga libri «Heshtje s'ka» — 1990)

**SABRI HAMITI**

*EQREM ÇABEJ*

*Ku ndriçon plisi, përthekon guna,  
Ku buka është bukë e uji ujë,  
Ku digjet qiriu e tymon una,  
Rrjedh lumë Drini, rrjedh lumë Buna.*

*Hesht Ili Iliri flet vetë Albani,  
Në valle Lisi ku feston fisi,  
Merr në thua e bie tirani,  
Në male të bardha bardhon plisi.*

*Në natën e zezë del para Abeja,  
Ti thur ballin me kujtime e gjak,  
Midis krahërorit të shkrep rrufeja,  
Klithjen e moçme e zgjon në prak.*

*Ku ndriçon plisi përthekon guna,  
Ku buka është bukë e uji ujë,  
Ku digjet qiriu e tymon una,  
Rrjedh lumë Drini, rrjedh lumë Buna.*

*Vallëzon shqipja në teatrin antik,  
Me bukuri të thurur fije më fije,  
Në shi furtunë kërkon një mik,  
Për heshtje urti, për besë e dije.*

*Në shpresa syrin e hap në diell,  
E në natën me peshë të vonë,  
Fjala fluturon fletë vetë në qiell,  
Këngën e moçme e bën jehonë.*

*Eqrem Çabej*

*Ku ndriçon plisi përthekon guna,  
Ku buka është bukë e uji ujë,  
Ku digjet qiriu e tymon una,  
Rrjedh lumë Drini e lumë Buna.*

*Në vete thur vetë-dijen e durimit,  
Si këngën e dhembjes së pafund,  
Në botën e gjallë të humbjes shpëtimit,  
I njohur rinjohur përdit pa mund.*

*Ku ndriçon plisi përthekon guna,  
Ku buka është bukë e uji ujë,  
Ku digjet qiriu e tymon una,  
Rrjedh lumë Drini rrjedh lumë Buna.*

(Nga libri «Leja e njohtimit — 1985»)

*Eqrem Çabej*

**MUSTAFA SPAHIU**

**UJËVARË MALLI**

Prof. Eqrem Çabejt

*Në mugëtirën e shekujve ngadalë zbriti me zemër,  
Me afsh e ndjesi. Seç zbuloi trungun e ilirishtes,  
Çka s'shënoi me penë, nisi ta gërmojë me thembër,  
Nga gjeneza e lashtësisë i dha shpirtin shqipes.*

*Korifej i korifejve zbukuroi fjalën stërggjyshore,  
Që me sharki këndohej nëpër shekuj fluturim,  
As në histori vlimesh s'e ndali frymëmarrjen prore,  
Të gjallërojë ndër zemra stralli i fisit plot besim.*

*Nestor i gjurmimeve të përhershme — zbuloi fjalën magji,  
Nëpër vepra e mbolli. Brez nitë mos ta harrojnë kurrë,  
Të trokasin, të këndellet e të mësohet nahí më nahí...*

*Ngadalë shkrumi e ngeci fjalën pa e vënë në kartë,  
Që fjala e pathënë të piquej në përjetësi si në furrë,  
Nëpër hapërime motesh të shkëlqejë si një yll i artë...*

(«Jehona»)

7/1980

## BIBLIOGRAFI E PËRZGJEDHUR E VEPRAVE TË PROF. EQREM ÇABEJT

1929

Poezia e Lasgush Poradecit, *Gazeta e Re* 22.2.

1934

Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare, *Normalisti* 6. f. XIX-XXI.

1935

Tekste italo-shqiptare, *Hylli i Dritës* XI, 196-206.  
Sitten und Gebräuche der Albaner, *Revue internationale des études balkaniques* II/I, 556-572.

1936

*Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, me pjesë të zgjedhura, për shkollat e mesme. Tiranë 201.

Mundarliches aus Italien, *Glotta* XXV 50-57.

*Rumänisch-albanische Lehnbeziehungen*, *Revue internationale des études balkaniques*, II. 172-184.

*Parallele Auadrücke und Redensarten in den Balkansprachen*, *Revue internationale des études balkaniques*, II, 226-331.

1937

*Albaner und Slaven in Süditalien*, *Revue internationale des études balkaniques* III, 555-566.

*Eqrem Çabej*

*Miszellen*, Revue internationale des études balkaniques III, 571-574.

Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut, *Hylli i Dritës* XIV, 77-84.

Për gjenezën e literaturës shqipe, *Hylli i Dritës* XIV, 647-661.

**1939**

Për gjenezën e literaturës shqipe, *Hylli i Dritës*, 8-15, 84-93, 149-180.

Shqiptarët në Itali të mesme dhe në Napoli, *Hylli i Dritës* XV, 542-546.

**1941**

*Kult und Fortleben der Göttin Diana auf dem Balkan*, Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa V, 229-240.

Albanija. Književnost Arbanasa — Etnografija, Hrvatska Enciklopedija I, 180-182.

**1942**

Zur Erforschung der Siedlungen Südalbaniens, Südost-Forschungen VII 244-256.

*Articles Budi, Buzuku, Çajupi, Çamëria, Dara, De Rada, Dozon, Gjeçov, Kristoforidhi etc*, në Hrvatska Enciklopedija I.

**1943**

Atlasi gjuhësor shqiptar (në 5 fashikuj, pyetje) 1-2578. *Grottaferrata*.

**1947**

*Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*. 119

**1949**

*Disa eufemizma të shqipes*. Buletin i Institutit të Shken-cave III, 72-84.



*Eqrem Çabej*

**1951**

Në bashkëpunim me A. Xhuvanin dhe K. Cipon, *Ortografia e gjuhës shqipe*.

**1952**

Përmbi disa fjalë të shqipes që nisin me z — *Buletin për shkencat shoqërore* III, 37-44.

Detyrat e gjuhësisë shqiptare në lidhje me gjuhën letrare kombëtare dhe probleme të tjera, *Buletin për shkencat shoqërore* IV 114-119.

**1953**

Grupet *nd, ng* në gjuhën shqipe, *Buletin për shkencat shoqërore*. IV, 30-38.

**1954**

Rreth disa etimologjive të Kristoforidhit. *Buletin për shkencat shoqërore* II 31-49, III 57-75. Bashkëpunim në fjalërorin e gjuhës shqipe.

**1955**

Gjon Buzuku, *Buletin për shkencat shoqërore* I 9-23, II 71-100, III 39-50, IV 113-124.

Gjon Buzuku dhe gjuha e tij, *Nëntori* 3, 70-73.

**1956**

Për historinë e zanores *ë* në gjuhën shqipe, *Buletin për shkencat shoqërore* I, 123-146.

Parashtesat e gjuhës shqipe (në bashkëpunim me A. Xhuvanin), *Buletin për shkencat shoqërore* IV, 66-103.

**1957**

Mbishkrime unazash të Shqipërisë veriore, *Buletin për shkencat shoqërore* II 122-126.

Maximilian Lambertz në 75-vjetorin e ditëlindjes, *Buletin për shkencat shoqërore* II, 127-130.



20730

Eqrem Çabej. Nxënës në Vjenë (1921)



1



2

1 Në familjen Rimyler, në qytetin St. Pölten pranë Vjenës, ku jetoi vitet e para të shkollimit në Austri.

2 Vjenë 1921. Me bashkënxënësit e tij. Në radhën e dytë, i pari nga e djathta.




1 2



1 Libohovë (Shtator 1928).

2 Vjenë 1930. Në një mbrëmje me shokë dhe kolegë. E. Çabej në radhën e parë, i dyti nga e djathta. Në të djathtë të tij profesor Norbert Jokli, në të majtë Lasgush Poradeci.



Një fotografi pas mbrojtjes së doktoratës. (Vjenë, janar 1934).

20130



# NOS RECTOR UNIVERSITATIS LITTERARUM VINDOBONENSIS

ERNESTUS TOMEK, s. s. theologiae doctor, professor historiae ecclesiasticae publicus ordinarius;  
ADOLPHUS FRANKE, philosophiae doctor, professor chemiae publicus ordinarius, ordinis  
philosophorum h. t. decanus; CAROLUS MRAS, philosophiae doctor, professor philologiae  
classicae publicus ordinarius, promotor rite constitutus, in virum clarissimum

## EQREM ÇABEJ

ex Argirokastro in Albania ortum

postquam et dissertatione cui inscribitur „Italoalbanische Studien“ et examinibus legitimis  
laudabilem in scientia linguarum comperativa doctrinam probavit, doctoris philosophiae  
nomen et honores iura et privilegia contulimus in eiusque rei fidem hasce litteras uni-  
versitatis sigillo sancindas curavimus.

Vindobonae, die XX. mensis Decembris MCMXXXIII.

*Caroline*

*E. Tomek*

*A. Franke*

*C. Mras*

Doktorata.



13x18  
15x24

1

2



1. Romë, fillimi i viteve 40.

2 Me profesor Aleksandër Xhuvanin  
gjatë kohës kur punonin së bashku  
në një zyrë (tetor 1950).



1



2

1 Tiranë 1964. Duke folur në një konferencë shkencore me rastin e 150-vjetorit të lindjes së De Radës.

2 Me profesor Mahir Domin dhe Jup Kastratin pas diskutimit të veprës «Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe» (Shkodër 28 shkurt 1968).





1

2



1 Me nxënës e mësues të fshatit Kabash të Pukës (1971).

18424

2 Innsbruck (Austri), shtator, 1972. Me albanologun Herman Elberg dhe kolegët e tij shqiptarë pas një kolokiumi për albanologjinë, të zhvilluar për kujtim të Norbert Joklit, në 30-vjetorin e vdekjes së tij.



1



2

- 1 Prof. Eqrem Çabej dhe prof. Aleks Buda gjatë një bisede të lirë me shokun Enver Hoxha në ditën e themelimit të Akademisë së Shkencave (Tetor 1972).
- 2 Duke mbajtur fjalën e hapjes me rastin e themelimit të Akademisë së Shkencave (Tetor 1972).



Një kujtim para shtëpisë ku u themelua Lidhja Shqiptare e Prizrenit (Prizren, dhjetor 1972)



Në Prishtinë me kolegë kosovare.



Me studentë e pedagogë kosovarë. (Prishtinë 1971).



Arbëreshët e Italisë e prisnin gjithmonë me gëzim e nderim prof. E. Çabein. (Fundi i viteve 70).



Stamboll, gusht 1979. Me një grup kolegësh shqiptarë.



Një fotografi me kolegët e tij dhe miqtë në kufirin greko-turk (Shtator 1979).



1

2



*Fotografia e prof. E. Çabej  
me kushtimin: «Zotnisë  
së tij prof. Eqrem Çabej  
për shenjë miqësie dhe kujtim  
prof. Norb. Jokli».*

1 Me prof. J. Jordanin, prof. Bahnerin dhe Marius Salën në Konferencën për hulumtime gjuhësore rumune. (Bukuresht, tetor 1964).

2 Prof. Norbert Jokli. Foto e Joklit dhuruar prof. E. Çabejt me kushtimin: «Zotnisë së tij prof. Eqrem Çabej për shenjë miqësie dhe kujtimi, prof. Norb. Jokli».



1



2

18124

1 Gjatë një bisede në hollin e hotel «Dajtit».

2 Shkodër, maj 1977. Me kolegët e tij Mahir Domi, Andromaqi Gjergji dhe Jup Kastrati.



Në emër të Djalës së Ri dhe "Bajo  
 Topullit" Lamartiniere - i fundit.  
 Jo me këto graris do t'a varrosim, ve  
 sot kanë çelë ditë për ri. Në do t'a varrosim  
 në burra.  
 Mëmundë Kosto i madhës Leonardo da  
 Vinci tërëse njeriu përveç rekurgen e  
 mbirëviz, për një ditë me penë, arditë  
 dhe vëllja çelësi kështu në fundin e  
 jetës, për një jell të përdorur mirë; arditë  
 dhe ti, o shpirt bujar, dardhe tësi pasin  
 e jete, për këto shpirt dhe tani, herë re  
 dhe do të flori në këtë tasi e ti e dardhe  
 ditë jetën në dardhe re shpirtin. dhe  
 zave të qarkun e do udhëtuesi andej;  
 nga varri, varri e do t'u regjellit me dardhe  
 ditë një atij hequr dhe do t'u shpirti: Ja tani  
 të alia jellin për Atinë!  
 Vëprat e tua janë të injlura dhe t'dan  
 komentit. Në e flet njëjtë dardhe i  
 shpirtin, shpirti i vrasëjtë dhe njëjtë  
 nëvet tuaja. Në të do flori faret e kushtit  
 e gjakshpirti të korubit nëmë i Bajo Topullit  
 jo njëjtë sa non ajalla i mborrit.  
 Ja edhe në këto kolë matyjet ka  
 dhe për shpirtin tani të ri të madhe faret  
 bardhe njëjtë koruptioneve dhe dardhe  
 ditë e ti kanë shpirtin të flet të do  
 notë riubot i burrosit dhe e atij dardhe  
 këi shpirtin se burrosit të poto; dardhe, dardhe  
 for, për të çelësi bashkë tani, herë e me të  
 për çdo shpirti.  
 Të madhe ditë e me të p'ta njëjtë  
 në emër Bajo Topullit. Por në, dardhe, e dardhe  
 në vetë ndër të gjurmë dardhe e dardhe me  
 ti, o mëmësi lig e ata lisa e njëjtë  
 ndër e me të tona! Të mëmësi, e dardhe e  
 njëjtë bresave dardhe!  
 Bajo, jualla për! Dardhe tani dardhe të salla  
 e jete. Në Atinë e do e beje dhe në e dardhe  
 me të flet! Në dardhe bledhe në këto mure  
 të njëjtë tani re e jete të me do t'u njëjtë  
 njëjtë edhe me ajalla tona. Flori për dardhe  
 e kushtit.  
 Bajo, lamartiniere! O shpirt i dardhe dardhe,  
 bejron! Lamartiniere!  
 Egreu casq

Faksimile. «Fjala mbi varrin e Bajo Topullit». Dorëshkrimi i E. Çabejt ruhet në Muzeun e Gjirokastrës. Kjo fjalë, e mbajtur më 25 korrik 1930, është botuar në gazetën «Demokratia» të Gjirokastrës më 26 korrik 1930.



Një shkrim (1)

J'ndyeri prof. M. Marchiano, me veprim e tij  
"L'Albania e L'opera di Girolamo De Rada (1902)  
e me përthithurin e disa mesive prej veprave të  
De Rada (i Pevri albanesi di Girolamo De Ra-  
da 1903), është një që ka vënë bazat e studimeve  
deradiane e ka shënuar; drejtësiat e përgjithshme  
me në të cilat ata duken vaxhduar. Vjera e  
parë, havi e vaur, shëhet edhe tek i biri i të  
ndryshk, avr. P. Marchiano, i cili ka qenë i të  
tano 121 avr. P. Marchiano, i cili ka qenë i të  
ni, i cili ka qenë i të  
e De Radës.

(1)

Kundër pseudofilologëve!

Shoqësitë e Kështullit të Pë të veris, si dhe nga ato  
të Gaxatës si dhe dikur, viltas se një epideimi grafomani  
manis pastka hapur shumë u këna të nallë, në  
në jetën e tij, ka pasur rast të mësojë anglishten  
nëpër fabrikat e Amerikës, gjermanishten në  
tabaron et e Vjenës, frëngjishten në Mont-Alban, në  
e italishten në Kafet e Parisit, sot, i fryrë si gjel  
dëti, na del përpara, i stolur me vrosbi trashë  
parentë të pseudonimit, o tempora, o mores! -  
me gjatë formatik na flet mbi filologji! Kurrë  
të shë! Partizanant moritë, nasetur rëndësues  
muri!

Pa, rikunder në fletoret e Perëndimit, ndodhet  
fenuilleton-i, tek ne mukt do të mungojë, si projekt  
pas bukës, një artikull filologjik, i cili ka marrë  
sionin, si i duket, të rëndësosh një zakon shqipë-  
tar që është dukur u shuar: luftën e gjelloreve.  
në maskën e shkabës, këta gjela luftojnë tërësisht  
trijerërikt me njërijetrin, duke u gjakosuar, por  
dhe me maskë që jeni, e dimë se jeni gjela, o  
gjela! -

Faksimile. «Një shkrim i panjohur i De Radës» dhe  
«Kundër pseudofilologëve». (Botohen për herë të parë.  
Shën. i Red.)

Fernseesvej 69<sup>z</sup> Copenhagen - Hillerup  
d. 5 Februar 1938

Ihr geehrter Herr

Für die freundliche Zusendung Ihres wertvollen Buches  
"Elemente de qubésité e të Moratoriums shqipe"  
danke ich Ihnen sehr herzlich.



Mit den besten Wünschen  
für ein glückliches  
Neujahr  
Götter Elsson

Herrn Dr. P. Kreischner  
Wien  
27. Februar 1941

Lieber Freund

Die Sprache der Albanen hat trotz der langen Jahre  
immer ihren Charakter behouden, die albanischen Dialekte  
sind in ihrer Entwicklung und in ihrer Struktur  
immer noch die gleichen geblieben. Die albanische  
Sprache ist eine der ältesten Sprachen der Welt.  
Die albanische Sprache ist eine der ältesten  
Sprachen der Welt. Die albanische Sprache  
ist eine der ältesten Sprachen der Welt.

Die albanische Sprache ist eine der ältesten  
Sprachen der Welt. Die albanische Sprache  
ist eine der ältesten Sprachen der Welt.  
Die albanische Sprache ist eine der ältesten  
Sprachen der Welt.

Herrn Dr. P. Kreischner  
Wien  
27. Februar 1941

E. J. ...

Albanische Sprache, Dr. P. Kreischner und Dr. Z. ...  
Albanische Sprache, Dr. P. Kreischner und Dr. Z. ...  
Albanische Sprache, Dr. P. Kreischner und Dr. Z. ...

Bitte, um die Albanische Sprache, Dr. P. Kreischner  
und Dr. Z. ...

Wien,  
den 3. I. 1941.


Prof. Dr. P. Kreischner  
WIEN, VIII. 9. II. 43.  
Florianigasse 23.

Ihr Brief  
vom 10. Jan. ist mir mit grosser Vergnügung zugegan-  
gen. Ich danke Ihnen herzlich für Ihre freundlichen  
Neujahrswünsche & erwidere sie aufrichtig, indem ich  
auch Ihnen alles gute für die Zukunft wünsche.

Ihre Abstoht uns ein Manuskript zur Alban. Fortkun-  
ft für die Schriften der Balkankommission zu senden  
de für die Schriften mit Freude & bitte Sie, es mir nach Per-  
begüsse ich mit Freude & bitte Sie, es mir nach Per-  
telligstellung zu schicken. Ich würde gern wieder et-  
was Albanologisches in unsern Schriften veröffentli-  
chen. - dass J. eine Arbeit über die Namen der Köni-  
serteile in Alban. vorbereitet, ist Ihnen vielleicht  
bekannt. Ubrigens hat sich die Nachricht von seinem  
Tode nicht bestätigt, doch ist ernicht in Wien.

Vir haben lebhaft bedauert, dass Sie nicht nach  
Wien kommen konnten. es waren schon alle Einladungen  
zu Ihren Vortrag versandt.

Faksimile. Nga korrespondenca me albanologë.



Eqrem Çabej. Grafikë nga Dritan Braho.

187 w

- 1 Eqrem Çabej me Ismail Kadarenë në Stamboll (1979).
- 2 Eqrem Çabej me Lasgush Poradecin në Vjenë



20130

1



2



20130

Eqrem Çabej në fund të viteve 60.

## Eqrem Çabej

Trajtimi i zanoreve iniciale te Gjon Buzuku, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore I*, 96-102.

Kuantiteti i zanoreve të theksuara, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore II*, 207-214.

Paul Kretschmer, *Nëntori 2*, 197-201.

Gjendja e sotme e etimologjisë së gjuhës shqipe, *Nëntori 8*, 194-206.

### 1958

Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe. *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore I*, 31-80.

Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore II*, 54-62.

Diftongje e grupe zanoresh të shqipes, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore III*, 71-88.

Rumänische und albanische Wortdeutungen, *Cercetări de lingvistică III. Supliment 131-134 (Mélanges linguistiques offerts à Emile Petrovici par ses amis étrangers à l'occasion de son soixantième anniversaire.)*

### 1959

Alb. *vise* «Orte, Plätze» und die singularisierten Plurale im Albanischen, *Lingua Posnaniensis VII* 145-200, VIII (1959-60), 71-132.

I. Hyrje në historinë e gjuhës shqipe II, *Fonetika historike e shqipes* 94, botuar si libër në Prishtinë më 1970. 147.

Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre. *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria shkencat shoqërore II*, 104-117.

Unele probleme ale istoriei limbii albaneze, *Studii și cercetări lingvistice X*, 4. 527-560.

### 1960

Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe I. *Buletin i*

## Eqrem Çabej

Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore IV, 9-102.

A. Xhuvani-E. Çabej, Parashtesat e gjuhës shqipe. *Compte rendu, Bibliotheca classica orientalis* V 287.

### 1961

Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe II, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore I*, 60-92-III, *Buletin II*, 47-78. — IV. *Buletin III*, 53-72. V. *Buletin IV*, 106-133.

Disa parime e kritere për hartimin e një fjalori etimologjik të gjuhës shqipe, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria shkencat shoqërore IV*, 178-184.

Die älteren Wohnsitze der Albaner auf der Bçlkanhalbinsel im Lichte der Sprache und der Ortsnamen, *Atti e memorie del VII Congresso internazionale di scienze onomastiche. Firenze-Pisa I*, 241-251. *Crăciun, Studii și cercetări lingvistice XII*, 3, 313-317.

Poezia popullore e arbëreshëve të Italisë, *Arsimi popullor XVII*, Nr. 10, 78-81.

### 1962

Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe. VI, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore I*, 83-120-VII? *Buletin...* II, 225-232. VIII, *Buletin...* 49-75.

Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria shkencat shoqërore IV*, 117-148 = *Studia albanica I*, 1, 1964 69-89 = Konferenca e parë e studimeve albanologjike, 1965, 89-108.

Në bashkëpunim me A. Xhuvanin, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* 112.

Zur Charakteristik der lateinischen Lehnwörter im Albanischen, *Revue de linguistique VII*, 1, 161-199.

Problemi i burimit të popullit shqiptar e të gjuhës shqipe, *Arsimi popullor XVIII* No. 6, 9-12.

Maximilian Lambertz, *Nëntori IX* 9 174-177 (Nekrologji).

Un ancien monument de la langue albanaise, *l'Albanie nouvelle* 6, p. 10.

## Eqrem Çabej

1963

Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe IX. *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore I*, 110-129. X. *Buletin II*, 127-153 — XI, *Buletin IV*, 83-97.

Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe, *Buletin...* III 69-116.

Ringinschriften aus Nordalbanien, *Lingua Posnaniensis IX*, 98-102.

Pesëqindvjetori i shkrimit shqip, Kuvendi kishtar i Matit i vitit 1462 dhe Formula e pagëzimit, *Arsimi popullor XIX*, I, 109-114.

1964

Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XII. *Studime filologjike I*, 61-98. XIII. *St. fil. II*, 11-43 — XIV. *St. fil. III*, 15-54. XV. *St. fil. IV* 91-115.

Ältere Stufen des Albanischen im Lichte der Nachbarsprachen, *Zeitschrift für Balkanologie II*, 6-32 — *Revistë shkencore e Institutit pedagogjik dyvjeçar*, Shkodër I. 5-27.

Nochmals die Ringinschriften aus Nordalbanien. *Studi Salentini (Lecce) fasc. XIV* 337-340.

Maximilian Lambertz (1882-1963), *Orbis XIII* 1 326-336 — *Studime filologjike I* 211-216.

Angelo Leotti, *Studime filologjike II*, 207.

Disa karaktere të poezisë së De Radës, *Drita IV* 49 (206), 6, 12. p. 1-2.

Kongresi VIII ndërkombëtar i studimeve onomastike në Amsterdam. *Studime filologjike I* 208-209.

Kuvendi IV ndërkombëtar i linguistëve në Milano, *Studime filologjike I*, 209, *Studia albanica I*, 277.

Note introductive à une étude de N. Jokl. *Studia albanica I*, 2, 75.

1965

Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe. XVI, *Studime filologjike I*, 3-45. — XVII. *St. fil. II*, 7-53. *St. fil. III?* 41-84 — XIX. *St. fil. IV* 41-70.

Stand und Aufgaben der albanischen Wortforschung, *Studia albanica II* 9-29.



## Eqrem Çabçaj

Bertrachtungen über die rumänisch-albanischen Sprachbeziehungen, *Revue roumaine de linguistique* X, 1-3 101-115.

Su alcuni antichi elementi balcanici nell'Italia meridionale e in Sicilia, *Rendiconti dell'Istituto Lombardo di Scienze e Lettere, Classe di Lettere* 99, 214-220.

Vatra dhe bota në poezinë e De Radës në vëllimin *Jeromin de Rada* 50-55.

Ai mbetet i gjallë ndër ne. (Fan Noli), *Nëntori* XII 4 21-32.

### 1966

Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XX, *Studime filologjike* XX (III) I 3-58. XXI. *St. fil.* XX (III) II 51-105 — XXII. *St. fil.* XX (III) III 51-67. — XXIII, *St. fil.* XX (III) IV 53-82.

Pjetër Budi dhe gjuha e tij. *Studime filologjike* XX (III) IV, 139-150.

Die Herkunftsfrage der albanischen Kolonien in Italien im Lichte vornehmlich der Sprache und der Eigennamen, *Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences* 364-375.

Albanische Volkskunde, *Südost-Forschungen* XXV, 333-387.

Ai vuri një gur themeltar në ndërtesën e kulturës shqiptare. (P. Budi), *Drita* 2. 10.

### 1967

Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XXIV, *Studime filologjike* XXI (IV) I, 65-96. — XXV, *St. fil.* II, 3-20 — XXVI, *St. fil.* III, 31-46.

Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe. 215.

Das Albanische und seine Nachbarsprachen, *Die Sprache* XIII 39-51.

Zur Geschichte der mundartlichen Struktur des Albanischen, *Zeitschrift für Mundartforschung, Beihefte, Neue Folge* 3 und 4, *Verhandlungen des zweiten internationalen Dialektologenkongresses* 136-145.

Ngulimet shqiptare jashtë atdheut, *Ylli* I, 22-24.

Rregullat e drejtshkrimit të shqipes 213 (në bashkëpunim).

## Eqrem Çabej

1968

«Meshari» i Gjon Buzukut (1955), *Botim kritik* I, II. 299, 404.

Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe XXVII, *Studime filologjike* XXII (VI) I 107-142-XXVIII, *St. fil.* II 85-118.

Zum Wortschatz der albanischen Mundarten in Kalabrien: *Serta romanica, Festschrift für Gerhard Rohlfs zum 75. Geburtstag* 115-124.

Gestalten des albanischen Volksglaubens, *Gedenkschrift für Wilhelm Brandenstein* 279-287.

Der Beitrag des Albanischen zum Balkansprachbund, *Actes du Premier Congrès des études balkaniques et sud-est européennes* VI 265-275 = *Studia albanica* IV 1 47-58 = *Studime filologjike* XXIV (VII) IV 3-15.

1969

Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre, *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike* III, 107-115.

Ilirishtja dhe shqipja, Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve 41-52 = *Mësuesi* 26. 7 = *L'illyrien et l'albanais. Questions de principe, Studia albanica* VII, 1970, 1 157-170.

Keltisch-albanische Isoglossen; *Studi linguistici in onore di Vittore Pisani* I, 167-186.

1970

Mbi disa rregulla të fonetikës historike të shqipes. *Studime filologjike* XXIV (VII) II, 77-95 = *Über einige Lautregeln des Albanischen. Die Sprache* XVIII 132-154.

1971

Disa aspekte të fonetikës historike të shqipes në dritën e gjuhës së Gjon Buzukut, *Buletin shkencor, Shkodër* VIII 1 91-107.

Heimische Elemente in der die Gebirgslandschaft betreffenden geographischen Nomenklatur des Albanischen, *Disputationes ad montium vocabular aliorumque nominum significationes pertinentes* III 187-216.

Le problème de l'origine de la langue albanaise, *L'Albanie nouvelle* 6, 18.

## Eqrem Çabej

Zur slavischen und albanischen Wortgeschichte. *Serta slavica in memoriam Aloisii Schmaus* 92-103.

Te burimet e gjuhës shqipe, *Drita* 19. 12.

### 1972

Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe. *Studime filologjike* XXVI (IX) IV 3-27 = *Studime historike* XXVI (IX) III 97-120 = *Studia albanica* IX 2 125-151 = *Zeitschrift für Balkanologie* X Heft 27-32 = *Bulletin Aiesse Bucarest* X 2 71-99.

Ënga historia e gjuhës shqipe, Probleme dhe rezultate, *Zëri i Popullit* 23. 1.

L'ancien nom national des Albanais, *Studia albanica* IX 1 31-40.

Les noms nationaux des Albanais. *L'Albanie nouvelle* 1, 16

Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes, *Mësuesi* 13. 12 = Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe I, 247-264. *Studime filologjike* XXVII (X) I 97-107.

Në 30-vjetorin e vdekjes së Norbert Joklit. *Mësuesi* 25. 10.

Kuvendi i parë i studimeve ilire në Tiranë. *Ylli* 12. 12-13.

Çështja e prejardhjes së ngulimeve arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetjakë, *Studime filologjike* XXVI (IX) II, 23-34.

Über einige Lautregeln des Albanischen, *Die Sprache* XVIII, 2, 132-154.

### 1973

Emri i Dardanisë dhe izoglosat shqiptare-kelte, *Studime filologjike*, XXVII, (X) III, 55-65.

Hyrje në studimin krahasimtar të gjuhëve indoevropiane. *Dispensë*, Prishtinë, 254.

Një saktësim. *Studime filologjike* XXVII (X) III, 73-75.

Elementet latine të gjuhës shqipe, *Jehona*, IV, 3-20.

### 1974

Karakteristikat e huazimeve latine të shqipes, *Studime filologjike* XXVIII (XI), II, 13-53.

Gjurmime etimologjike të reja në fushë të shqipes, *Studime filologjike* XXVIII (XI) III, 3-14.

## Eqrem Çabej

Riesen und Zwerge im albanischen Volksglauben, *Actes du XI<sup>e</sup> Congrès International des Sciences Onomastiques*, I 203-206.

Disa burra të shquar të arbëreshëve të Italisë, *Revista pedagogjike* IV, 140-146.

Dy fjalë për gjuhën e Petro Luarasit. *Petro Nini Luarasi* (Artikuj, studime, kujtime), 51-55.

Për historinë e strukturës dialektore të shqipes. *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë. 1974. 429-438. (Më parë botuar gjermanisht më 1967 në *Zeit. f. Mund.*).

Les éléments latins de la langue albanaise, *Macedonian Academy of Sciences and Arts, Contributions* 2, 5-22, Cf. 1973.

### 1975

Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare. *Studime filologjike* XXIX (XII), I. 49-65.

Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë. *Studime filologjike* XXIX (XII), II. 51-69.

Mbi disa elemente ballkanike të lashta në Italinë Jugore e në Sicili. *Studime filologjike* XXIX (XII), III. 9-14.

Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke në gjuhën shqipe. *Studime filologjike* XXIX (XII), IV. 79-86.

Zu einer chronologischen Schichtung der türkischen Lehnwörter im Albanischen. Türk dili bilimsel kurultayl na sunulan bildiriler 1972' den arybasım 123-130.

Zu einigen slawisch-albanischen Isoglossen. Bereiche der Slavistik. Festschrift zu Ehren von J. Hamm 37-51.

### 1976

Histori fjalësh të sllavishtes e të shqipes. *Studime filologjike* XXX (XIII) I. 123-135.

Mbi disa izoglosa të shqipes me sllavishten, *Studime filologjike* XXX (XIII) II 1976. 63-76.

Mbi disa probleme dhe detyra të gjuhësisë historike shqiptare. *Zëri i Popullit*, 9 e 10 V., 3.

Iberorumanishtia dhe shqipia. izoglosat e tyre latine, *Studime filologjike* XXX (XIII), 4. 69-73.

Zur aromunischen Wortforschung, *Studii și cercetări lingvistice* XXVII I. 3-16.

Albanische Beiträge zur Kenntnis des lateinischen Wort-

## Eqrem Çabej

schatzes, *Bolletino dell'Atlante linguistico mediterraneo* 13-15, 1971-1973, 365-377.

Studime etimologjike në fushë të shqipes II (A-B) 615.

Storia linguistica e struttura dialettale dell'albanese d'Italia, *Problemi di morfosintassi dialettale* 9, 5-30 Cf. 1975.

Das albanologische Werk Norbert Jokls, Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Sonderheft 41, 3-21.

Neue etymologische Forschungen im Bereich des Albanischen, *ibidem* 246-260.

Problemi i burimit të popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij, *Shkenca dhe jeta* IX 3, 14-16.

Te arbëreshët e Kalabrisë. *Ylli* XVIII. 6. 20-21.

Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrim gjuhësor, *Studime filologjike* XXXI (XIV), 2, 11-27.

### 1977

Norbert Jokl — albanolog i madh. *Shqipëria e re*, 2, 20-21.

Emri i Pukës, *Puka dhe shkolla*, 4, 6-10.

### 1978

Das Alpenwort «malga» (Fjala alpine «malga»). *Studii și cercetări linguistice* XXIX, 519-521.

Dy çështje gjuhësore: 1) Disa mendime mbi nazalizmin e shqipes. 2) Gjerbës. *Gjurmime albanologjike. Seria shkencat filologjike* (Prishtinë) VII — 1977.

### 1979

Nga leksiku i dialekteve arbëreshe të Italisë, *Studime filologjike* 2, 1979, 51-58.

Elemente vendëse në terminologjinë gjeografike malore të gjuhës shqipe. *Studime filologjike* 3, 1979, 31-47.

Vepra e Gjon Buzikut në vështrimin gjuhësor historik. *Studime filologjike* 1, 1979, 13-26.

Mbi disa dukuri të historisë së gjuhës shqipe të para në lidhje me gjuhët e tjera ballkanike, *Studime filologjike* 4, 1979, 58-68.

Për pastërtinë e gjuhës shqipe, *Mësuesi* 28 mars dhe 4 prill 1979.

*Eqrem Çabej*

1980

Aleksandër Xhuvani dhe gjuhësia historike shqiptare, *Studime filologjike* 1, 1980, 57-61.

Mbi parimet dhe metodën e studimeve etimologjike, *Studime filologjike* 3, 1980, 21-50.

Der Name Alexander in der albanischen Volksprache (Emri Aleksandër në të folmen popullore shqipe), *Megas Alexandros*, Thessaloniqi, 157-159.

*Shënim:*

Për njoftime më të plota shih *Bibliografinë e punimeve të prof. Eqrem Çabejt* nga prof. Jup Kastrati në *Studime filologjike* 3, 1981, 219-254.

INDEX

CONTENTS

1011. *Journal of the American Medical Association* ..... 1011

1012. *Journal of the American Veterinary Association* ..... 1012

1013. *Journal of the American Dental Association* ..... 1013

1014. *Journal of the American Pharmaceutical Association* ..... 1014

1015. *Journal of the American Nurses Association* ..... 1015

1016. *Journal of the American Dietetic Association* ..... 1016

1017. *Journal of the American Physical Therapy Association* ..... 1017

1018. *Journal of the American Occupational Therapy Association* ..... 1018

1019. *Journal of the American Speech-Language-Hearing Association* ..... 1019

1020. *Journal of the American Music Therapy Association* ..... 1020

1021. *Journal of the American Association of Nurse Practitioners* ..... 1021

1022. *Journal of the American Association of Nurse Anesthetists* ..... 1022

1023. *Journal of the American Association of Nurse-Midwives* ..... 1023

1024. *Journal of the American Association of Nurse Practitioners* ..... 1024

1025. *Journal of the American Association of Nurse Practitioners* ..... 1025

1026. *Journal of the American Association of Nurse Practitioners* ..... 1026

1027. *Journal of the American Association of Nurse Practitioners* ..... 1027

1028. *Journal of the American Association of Nurse Practitioners* ..... 1028

1029. *Journal of the American Association of Nurse Practitioners* ..... 1029

1030. *Journal of the American Association of Nurse Practitioners* ..... 1030

## PASQYRA E LËNDËS

	Page
Dy fjalë .....	3
Parathënie .....	5

### KREU I

<b>Jeta dhe vepra .....</b>	<b>9</b>
§ 1. Arsimi fillor, i mesëm dhe i lartë.	
§ 2. Kthimi në Shqipëri dhe shërbimi në Shkodër, Elbasan, Tiranë, Gjirokastrë.	
§ 3. Qëndrimi në Itali dhe kthimi në Shqipëri.	
§ 4. Në Institutin e Shkencave, në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë dhe puna në shkollat e larta.	
§ 5. Veprimtaria shkencore para dhe pas Çlirimit.	
§ 6. Metoda e ndjekur në studimet diakronike.	
§ 7. Ndihtesat kryesore në fusha të ndryshme.	
§ 8. Pjesëmarrja në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare e botimet kryesore jashtë vendit.	
§ 9. Vlerësimi i punës së tij shkencore.	

### KREU II

<b>Për historinë e gjuhës shqipe .....</b>	<b>54</b>
§ 1. Çështja e prejardhjes së gjuhës shqipe.	
§ 2. Kundërshtimi i tezës për prejardhjen joilire të gjuhës shqipe.	
§ 3. Argumentet në të mirë të tezës për prejardhjen ilire të shqipes.	
§ 4. Marrëdhëniet e shqipes me rumanishten.	
§ 5. Huazimet nga greqishtja e vjetër, latinishtja, sllavishtja dhe turqishtja.	



### KREU III

<b>Studimet etimologjike</b> .....	<b>74</b>
§ 1. Puna dhe synimet e E. Çabejt në këtë fushë studimesh.	
§ 2. Hulumtimi i fjalorit të trashëguar të shqipes.	
§ 3. Shqyrtimi i huazimeve të shqipes.	
§ 4. Disa nga arritjet e tij në këtë fushë studimesh.	

### KREU IV

<b>Fonetikë dhe gramatikë historike</b> .....	<b>88</b>
§ 1. Ndhimesat kryesore në fushën e fonetikës historike (theksi, çështje të evolucionit të sistemit zanor dhe bashkëtingëllor).	
§ 2. Ndhimesat kryesore në fushën e gramatikës historike (sistemi nyjor, shumësi i singularizuar, gjinia dhe disa përemra).	

### KREU V

<b>Dialektologji</b> .....	<b>104</b>
§ 1. Ndhimesat kryesore në fushën e dialektologjisë.	
§ 2. Hulumtimi i të folmeve arbëreshe të Italisë.	

### KREU VI

<b>Autorët e vjetër</b> .....	<b>115</b>
§ 1. Studimi i gjuhës së veprës së Buzukut.	
§ 2. Transkriptimi dhe transkribimi i veprës së Buzukut dhe ndhimesat kryesore.	
§ 3. Studimi i veprës së Budit.	

### KREU VII

<b>Për shqipen e sotme</b> .....	<b>129</b>
§ 1. Ndhimesat kryesore në studimin e shqipes së sotme-pjesë-	

- marrja në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës shqipe (1972).  
 § 2. Artikulli: Për pastërtinë e gjuhës.  
 § 3. Parashtesat e gjuhës shqipe dhe Prapashtesat e gjuhës shqipe (në bashkëpunim me Aleksandër Xhuvanin).

*KREU VIII*

**Folklor-Letërsi** ..... 140

- § 1. Ndhimesat kryesore në fushën e folklorit.  
 § 2. Ndhimesat kryesore në fushën e studimeve për letërsinë shqiptare.

*S E L E C T A E*

1. Nga «Studime albanologjike në fushë të shqipes»; Emri arbër-arbën .....	155
2. Fjala e mbajtur mbi varrin e Bajo Topullit .....	165
3. Mbi poezinë e Lazgush Poradecit .....	167
4. Dy fjalë për gjuhën e Petro Luarasit .....	172
5. Fan Noli ynë .....	174
6. Dy fjalë kujtimi për profesor Aleksandër Xhuvanin .....	176
7. Në 30-vjetorin e vdekjes së Norbert Joklit .....	180
8. Paul Kreçmer .....	186
9. Maksimilian Lamberg (në 75-vjetorin e ditëlindjes) .....	191
10. Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare .....	196
11. Konstandini i Vogëlith dhe këthimi i Odiseut .....	203
12. Vatra dhe bota në poezinë e De Radës .....	210
13. Një shkrim i panjohur i De Radës .....	215
14. Kundër pseudofilologëve .....	220
15. Shqipërime .....	223

*SHTOJCA*

1. Nga korrespondenca me albanologë .....	229
2. Poezi kushtuar E. Çabejt .....	250
3. Fotografi, dokumente .....	254
4. Bibliografi e përzgjedhur .....	254

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

100

Demiraj, Shaban

Eqrem Çabej — një jetë kushtuar shkencës / Shaban Demiraj; Red.: A. Xhezo. — T.: «8 Nëntori», 1990. — 272 f.: me il.; 21 cm.

/ Çabej, Eqrem për atë

809.198.3(092)

+92:800.198.3

[Çabej, Eqrem]

Ç 12

U dorëzua për shtyp qershor 1990

Doli nga shtypi korrik 1990

Tirazhi 12000 kopje

Formati 60x88/16

Stash 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1990